



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë të ushtruar**  
**në “Bashkinë Këlcyrë”**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**  
**FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË**  
**NË**  
**“BASHKINË KËLCYRË”**

**TIRANË, Maj 2024**

<b>Përmbajtja</b>	<b>Faqe</b>
Legjenda dhe shkurtime	1-3
<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-10
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	
<b>II. HYRJA</b>	
Objekti dhe qëllimi i auditimit	
Identifikimi i çështjes	
Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
Përgjegjësitë e audituesve	10-15
Kriteret e vlerësimit	
Standardet e auditimit	
Metodat e auditimit	
Dokumentimi i auditimit	
<b>III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	15-16
2. Përshkrimi sipas drejtimeve të auditimit	16-16
2.1. Mbi kontrollin e brendshëm financiar publik	16-20
2.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit	20-48
2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar	48-69
2.4 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik	69-124
2.5 Mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit	124-126
6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)	126-129
7. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	129-151
8. Të ndryshme të dala gjatë auditimit	151-157
<b>IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET</b>	157-177
<b>V. ANEKSE</b>	177-179

***Tabela e shkurtimeve***

KLSh	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
BK	Bashkia Këlcyrë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
FZhR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
IT	Teknologjia e Informacionit.
NjA	Njësi Administrative.
ShA	Shoqëri Anonime.
OE	Operator Ekonomik
TVSh	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
AK	Autoriteti Kontraktor
LPP	LPP
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomik
NjP	Njësia e Prokurimit
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
DST	Dokumente Standarde të Tenderit

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### *a. Përshkrim i shkurtër i Institucionit*

Bashkia Këlcyrë kufizohet në veri me Bashkinë Poliçan, në lindje me Bashkinë Skrapar, në jug me Bashkinë Përmet dhe Libohovë dhe në perëndim me Bashkinë Tepelenë dhe Memaliaj. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Këlcyrës. Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia ka një popullsi prej 6.113 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrat Civil, kjo bashki numëron 12.468 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 304.86 km<sup>2</sup>, me një densitet prej 40.92 banorë/km<sup>2</sup>.

Këlcyra është një qytezë e shtrirë mes maleve Trebeshinë dhe Nemerckë, e cila përshkohet nga ujërat e kthjellëta të Vjosës. Zona me peizazhe mahnitëse dhe vende historike ofron pak sa i përket strukturës arkitekturore. Zhvillimet urbane pa kriter, mos-kombinimi i ndërtimeve para viteve '90 me ato të tranzicionit dhe mungesa e një plani urban për zgjerimin kanë sjellë pasoja për qytezën e Këlcyrës.

Të ardhurat ekonomike të banorëve janë të ulëta. Ato vijnë nga aktivitete të vogla tregtare dhe shërbimi, por edhe nga bujqësia dhe blegtoaria e pakët. Popullsia e Këlcyrës është e përbërë kryesisht nga vendas dhe të ardhur nga fshatrat përreth. Shumë banorë kanë migruar drejt Tiranës, ndërsa një pjesë e madhe e popullsisë kanë emigruar kryesisht drejt Greqisë fqinje.

### *b. Rëndësia e institucionit*

Misioni për njësinë që auditohet është: Kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (të ardhurat e veta, grantin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin). Objektivat burojnë nga ligji “Për vetëqeverisjen vendore”.

Ndërsa administrata (aparati) i këtij institucioni ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.

Për vitin 2023 Bashkia Këlcyrë ka funksionuar duke planifikuar si buxhet 453,094,938 lekë realizimi i të cilave është në masën 89.5%.

### *c. Qëllimi i auditimit*

Qëllimi i këtij auditimi ishte dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga subjekti i audituar. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në këtë njësi,
- planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, si edhe shpenzimet administrative;
- zbatimi i dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabël, ndjekjen e debitorëve, kreditorëve si edhe menaxhimin e aktiveve të bashkisë;
- zbatimi i dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike, planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve;
- zbatimi i dispozitave ligjore në krijimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore;
- zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm;
- zbatimi i dispozitave ligjore për organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;

- zbatimi i dispozitave ligjore për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).

*d. Metodologjia e përdorur*

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikes, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku.

Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës për blerjet e vogla apo pagesat operacionale, për investimet me vlera të konsiderueshme (rasti i procedurave të prokurimit) janë audituar plotësisht procedurat.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve bazuar mbi gjykimin e tyre profesional, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

verifikim i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për marrjen e dëshmive të auditimit në lidhje me shumatat dhe dhënien e informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura janë përcaktuar në varësi të gjykimin dhe skepticizmit të audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

*e. Gjetjet dhe rekomandimet në numër*

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë sikundër në material trajtuar. Me qëllim përmirësimit e gjendjes, grupi i auditimit ka konstatuar 29 gjetje dhe ka dhënë 29 rekomandime.

*f. Gjetjet kryesore:*

Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me procedurat e mbajtjes së sistemit të kontabilitetit; me plotësimin e dokumenteve kontabël në përputhje me bazën ligjore dhe rregullatore; me hartimin dhe plotësimin e gjurmës së auditimit; me procesin e inventarizimit; dhe me mosfunksionimin e Njësisë së Auditit të Brendshëm dhe Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore, si dhe me mënyrën e kryerjes së procedurave të prokurimit publik.

Në procedurat e prokurimeve u konstatuan mangësi në inventarizimin e dokumentacionit, përcaktimin e personave përgjegjës për prokurimin, ngritjen e njësisë së prokurimit duke përfshirë punonjës që nuk janë pjesë e strukturës së njësisë ekonomike, argumentimin e kritereve nga ana teknike si dhe me përzgjedhjen e operatorëve ekonomik pa kërkuar argumentime shtesë për mangësi të evidentuara (megjithëse në trajtën e devijimeve të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thellësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit).

*Në mënyrë të detajuar problematikat mbi çdo pikë si më poshtë vijon:*

***Mbi Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik***

- Nga auditimi mbi hartimin dhe funksionimin e strukturës organike të Bashkisë Këlcyrë, nuk gjejmë të pasqyruar strukturën e Auditit të Brendshëm.

- Rekrutimi i punonjësve pozicioni i të cilëve korrespondon me status të nëpunësit civil nuk është kryer në zbatim të ligjit nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

***Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e Buxhetit të Shtetit***

- Nuk është bërë analiza dhe monitorimi i buxhetit çdo 4-mujor gjatë vitit 2023.

- Raportet e monitorimit nuk janë diskutuar dhe miratuar në Këshillin Bashkiak, dhe nuk janë dërguar në Ministrinë e Financave brenda afateve ligjore

### ***Mbi vlerësimin e raportimit financiar.***

- Nga auditimi u konstatua se, referuar detyrimeve të prapambetura llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" e cila pasqyrohet në bilancin kontabël në vlerën 29,234,563 lekë dhe përbëhet nga detyrimet që 73 persona e subjekte kanë ndaj Bashkisë Këlcyre. Përpjekjet për arkëtimin e shumave nga ana e Bashkisë Këlcyre kanë qenë të pamjaftueshme dhe jo rezultative.

- Për vitin 2023 Bashkia Këlcyre nuk ka kryer inventarizimin fizik të pasurisë së institucionit, njësisive administrative, gjendjeve civile, shkollave, kopshteve, në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*".

- Llogaria 4342 "*Të tjera operacione me shtetin*" nuk kuadron me kundër partin e vet për vlerën 28,453,410 lekë, si rrjedhojë rezultojnë të jetë e nënvlerësuar për këtë vlerë.

- Nuk rezultojnë i hartuar regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet.

### ***Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.***

- Nga auditimi i procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, të hartuar nga njësia e prokurimit në dy procedura prokurimi rezultojnë se kriteret e kapacitetit teknik nuk janë të argumentuara nga ana teknike, në kundërshtim me nenin 2, pika 2, germa (c); nenin 39 pika 6 germa ç, nenin 78 pika 1 dhe 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

- Nga auditimi i kriterëve të veçanta të DT, seksioni i kapacitetit teknik, rezultojnë se në dy procedura prokurimi nga ana e AK kualifikimi i tyre është kryer pa kërkuar paraprakisht shpjegime mbi mangësitë në plotësimin e kriterëve, në kundërshtim me nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*" dhe nenin 82, pika 2, paragrafi IV, të VKM nr.285, datë 23.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar.

- Nga verifikimi i dokumentacionit në dosjen fizike dhe SPE për procedurën e prokurimit "*Blerje karburant për automjetet*" rezultuan parregullsi në dokumentet e tenderit, në kundërshtim me pikën 2 nenin 76 dhe pika 2 nenin 78 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar.

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: "*Blerje karburanti për automjetet*", është konstatuar se, kriteri për shpalljen e ofertës fituese "*oferta me çmim më të ulët fiks*", është një kriter i përcaktuar në mënyrë të gabuar për procedurat me objekt "karburant". Veprimi i NJP (*specialistit të fushës*) në mospërputhje me nenin 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*" si dhe nenin 45 pika 2.1 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

- Nga auditimi konstatohet se AK Bashkia Këlcyre për vitin 2023 për dy procedura prokurimi janë caktuar si anëtar të njësisë së prokurimit dhe njëkohësisht persona përgjegjës për prokurimin dy punonjës të cilët nuk janë pjesë e strukturës organizative të bashkisë.

- Nga auditimi i procesverbalit të hartuar nga ana e komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike mbi procedurën e prokurimit "*Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare Kamber Bënja, Këlcyre*", rezultojnë se, është hartuar në kundërshtim me nenin 76 pika 2 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar.

### ***Mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.***

Bashkia Këlcyre nuk ka krijuar Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor, në kundërshtim me ligjin 107/2014 "*Për planifikimin e territorit*", me ligjin 9780 "*Për inspektimin e ndërtimit*" Neni 4 "*Përgjegjësitë e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës*", Neni 5 "*Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës*", me rregulloren e brendshme nr.13 datë 25.02.2022 "*Detyrat e Specialistit*"

*h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:*

Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon

***Mbi Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik***

Nga ana e Bashkisë Këlcyrë të merren masat:

- Për ngritjen dhe miratimin në strukturën organizative të Bashkisë Këlcyrë, Njësinë e Auditit të Brendshëm

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Këlcyrë të marrë masa për rekrutimin e punonjësve dhe plotësimin e vendeve vakante sipas detyrave funksionale nëpërmjet shpalljeve në Shërbimin Kombëtar të Punësimit.

***Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e Buxhetit të Shtetit***

- Kryetari i Bashkisë Këlcyrë në bashkëpunim me sektorin e Buxhetit, për hartimin e PBA dhe buxhetit vjetor, më parë të kryej konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit, njësitë administrative etj duke dokumentuar në çdo rast këto konsultime.

- Të marrë masa për plotësimin e raporteve të monitorimit me të gjitha anekset e domosdoshme për justifikimin e veprimtarisë.

- Të kryej analizën dhe monitorimin e buxhetit çdo 4-mujor duke i kaluar për miratim në Këshillin Bashkiak.

***Mbi vlerësimin e raportimit financiar***

- Sektori i Financës Bashkia Këlcyrë të marrë masa për sistemimin në kontabilitet të llogarisë 4342 “*Të tjera operacione me shtetin*”, në mënyrë që kjo llogari të paraqesë vlerën e saktë në pasqyrat financiare.

- Bashkia Këlcyrë të marrë masa për kryerjen e inventarizimit fizik të pasurisë së institucionit, njësisë administrative, gjendjeve civile, shkollave, kopshteve, të pa kryer për vitin 2023.

Bashkia Këlcyrë të marrë masa:

- Nga Bashkia Këlcyrë të kërkohet dhe të ndiqet në vijimësi arkëtimi i të drejtave të arkëtueshme (debitorët), duke zbatuar të gjitha procedurat e nevojshme në rrugë administrative e ligjore, deri në finalizimin e arkëtimit të këtyre vlerave.

- Sektori i Financës Bashkia Këlcyrë të marrë masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë,

***Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.***

- AK (*grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës*), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim duhet të bëhet edhe argumentimi teknik (përveç ligjërimit) i secilit kriter të vendosur, ku të shpjegohet se me cilin zë të preventivit lidhet çdo kriter i hartuar nga autoriteti kontraktor, duke i dokumentuar në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të vlerësojë si të vlefshme dhe të kualifikojë një ofertë vetëm kur ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit që autoriteti kontraktor ka vlerësuar të nevojshme. Përrjashtimisht, kur një mangësi në dokumentacionin e paraqitur nga OE pjesëmarrës do të konsiderohet si “devijim i vogël”, i argumentuar, i cili nuk ndryshojn thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, KVO-ja, përpara kualifikimit, duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesi, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.

- Autoriteti Kontraktor (*grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës*), të marrë masa për të plotësuar bazën dokumentare konform ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për

*prokurimin publik*” si dhe të plotësoj praktikat shkresore me të gjithë dokumentacionin justifikues të domosdoshëm.

- Autoriteti Kontraktor (*grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës*), në rastin e procedurave me objekt furnizimin me karburant, gazoil, benzol, kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit, si kriter për shpalljen e ofertës fituese, të përlllogaritet bazuar në: a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike; b) elementet fiskale; c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.

- Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, të marrë masa për ndërprerjen e aktmarrëveshjes që ka bërë me Znj. F.S , në të cilën është përcaktuar si person përgjegjës për prokurimin publik, si dhe të përcaktojë në këtë pozicion punonjës brenda strukturës së vet, duke siguruar trajnimin e tyre. Për procedurën e kontraktimit të Z. E.A , të plotësohet praktika dokumentare dhe të merren masa për ndërprerjen e aktmarrëveshjes.

- Personi përgjegjës i prokurimit, të marrë masa që të hedh në sistemin e prokurimit elektronik të dhënat në kohë reale dhe brenda afateve ligjore të përcaktuara në aktet rregullatore mbi procedurat e prokurimit publik.

#### ***Mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit***

- Kryetari i Bashkisë të marrë masa për krijimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, me qëllim garantimin e zbatimit të ligjshmërisë dhe standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe ndërtimet.

### **I.1 Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit**

#### **OPINIONI I AUDITIMIT**

##### ***Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2023***

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Këlcyrë, për vitin ushtrimor 2023, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare, fondet neto, investimet e aktivet afatgjata si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

##### ***Opinion i pakualifikuar:***

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të Bashkisë Këlcyrë paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar në datën 31.12.2023 dhe rezultatet e operacioneve të tyre dhe të flukseve monetare për vitin e përfunduar, referuar kuadrit rregullator; UMFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

##### ***Baza për dhënien e opinionit:***

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të



pavarur nga Subjekti i audituar në përputhje me kërkesat etike, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në [juridiksionin], dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit, që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISSAI 1700) Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se; pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare nuk përmbanin gabime materiale, por ekzistojnë aspekte që duhen nënvizuar.

Për këto arsye kemi dhënë opinion të pakualifikuar, sipas përshkrimit të çështjeve të trajtuara në gjetjet e raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 4.3 milion lekë si dhe anomalitë e konstatuara:

-Për vitin 2023, nuk është kryer procesi i inventarizimit, si dhe për këto llogari nuk ekziston një regjistër kontabël, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik

- Nuk është hartuar regjistër kontabël për aktivet afatgjata.

#### **Opinion mbi përputhshmërinë (opinion i modifikuar)**

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Këlcyrë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të modifikuar të përputhshmërisë.

#### **Baza për dhënien e opinionit të përputhshmërisë.**

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-t). Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI-P 10, Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 130- Kodi Etik, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 "Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë" si dhe në mbështetje të Kodit të Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 27, datë 20.04.2018. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Dokumentacioni administrative dhe procedurat prokuruese, janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, përfshirë marrjen në konsideratë të risqeve të mospërputhshmërisë materiale të transaksioneve me kriteret e parashikuara.

Ne kemi përdorur gjykimin objektiv dhe kemi zbatuar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinionit me siguri të arsyeshme.

Disa nga arsyet që kanë ndikuar në dhënien e opinionit të modifikuar janë:

- Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve, pasi në datën 31.12.2023 rezultojnë detyrime të pa arkëtuara në vlerën 29,234,563 lekë për 73 persona e subjekte.

- Nuk janë marrë masa të plota për uljen e detyrimeve të prapambetura.

-Janë konstatuar anomali në hartimin e kriterëve të veçanta të DST në procedurat e prokurimit publik, pasi në dy procedura janë vendosur kritere të cilat nuk kanë lidhje të ngushtë me natyrën e kontratës dhe nuk janë argumentuar nga ana teknike këto kritere.

- Në një rast, në procedurat e prokurimit publik është kualifikuar, shpallur fitues dhe lidhur kontratë me operatorin ekonomikë i cili nuk plotëson të gjithë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit.
- Për dy procedura prokurimi janë caktuar si anëtar të njësisë së prokurimit dhe njëkohësisht persona përgjegjës për prokurimin dy punonjës të cilët nuk janë pjesë e strukturës organizative të bashkisë.

## **II. HYRJA** (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit)

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 136/1 Prot, datë 29.01.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 29.01.2024 deri në datën 28.02.2024, në subjektin Bashkia Këlcyrë u krye “Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

- 1.A. K.– përgjegjës grupi;
- 2.B. B. – anëtar;
- 3.H.M – anëtar;

## **OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA**

### **1. Objekti dhe qëllimi i auditimit.**

Objekti i përgjithshëm është shprehja e një opinioni me një siguri të arsyeshme nga ana e audituesve nëse transaksionet financiare dhe shpenzimet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 si dhe nëse janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar.

Për auditimin Financiar, qëllimi i tij është të rrisë shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare të Projektit për periudhën për periudhën 01.01.2023-31.12.2023.

Auditimi financiar do të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI) të miratuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), dhe standardet e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili është një anëtar i INTOSAI-t.

Këto standarde kërkojnë që audituesi të planifikojë dhe kryejë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale. Një auditim përfshin ekzaminimin, në bazë të testit, të provave që mbështesin shumat dhe dhënien e informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e parimeve të kontabilitetit të përdorura dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për marrjen e dëshmimeve të auditimit në lidhje me shumat dhe dhënien e informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi konsideron kontrollin e brendshëm të rëndësishëm për përgatitjen e pasqyrave financiare nga secili prej entiteteve, në mënyrë që të hartojë procedura auditimi që janë të përshtatshme në rrethana, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të njësisë ekonomike.

Auditimi i përputhshmërisë ka për qëllim;

- vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Bashkia Këlcyrë.

- dhënia e opinionit mbi rregullshmërinë dhe përputhshmërinë apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime.

- Dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuarat si: Rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: Standarde, ligje, Vendime të Këshillit të Ministrave, Vendime të Këshillit Bashkiak, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë, që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.

- Njëherësh aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik).

- Promovimin e qeverisjes së mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korigjuese, si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

## **2. Identifikimi i çështjes.**

Referuar analizës së riskut, në fazën e planifikimit të auditimit, u identifikuan fushat me risk të cilat përbëjnë drejtimit e auditimit, të miratuara me programin e auditimit, si më poshtë:

1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.
2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.
3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për pasqyrat financiare për vitin 2023.
4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.
5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.
6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).
7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.
8. Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

## **3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:**

Drejtimi i Bashkisë Këlcyrë është përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike, zbatimin e kuadrit rregullator ligjor dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare. Ky Institucion duhet që të menaxhojnë burimet dhe të ushtrjnë autoritetin në përputhje me vendimet dhe kërkesat e legjislacionit.

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar dhe për vendosjen dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm, që ai i konsideron të nevojshme, për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa anomali materiale për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Është përgjegjësi e subjektit të audituar për të siguruar besueshmërinë dhe saktësinë e pasqyrave financiare, si edhe pohimet respektive në pasqyrat vjetore.

Drejtimi ka përgjegjësinë e tij për hartimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kontrollit të brendshëm për të parandaluar, ose për të zbuluar dhe rregulluar gabimet materiale ose mospërputhshmëritë, që të jetë i përshtatshëm për këtë qëllim.

Drejtimi dhe menaxhimi janë përgjegjës për përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësisë publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet. Ata përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator.

#### **4. Përgjegjësitë e audituesve**

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Në këtë kontekst duhet:

-Të vlerësojë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (ISSAI 1000 - 2999 dhe ISSAI 4000), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde ne aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

-Të kryej në mënyrë efektive auditimin (ISSAI 1300)

-Të vlerësojë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në këtë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse (ISSAI 1500/ISA 300).

-Të kryej procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objekti.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 30 “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të vlerësuar përputhshmërinë e aktivitetit. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar.

**5. Kriteret e vlerësimit.** Kriter vlerësimi është i gjithë kuadri rregullator në fuqi (baza ligjore, aktet e brendshme të institucionit, kushtet e kontratës etj., me të cilat krahasohet aktiviteti i njësisë vendore që auditohet) dhe kryesisht:

##### **Standardet e Auditimit:**

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 200; 400 etj;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA);
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH;

- Manuali i Auditimit të Zbatimit të Rekomandimeve në KLSH;
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, KLSH;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.

#### **Akte ligjore:**

- Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, etj.
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar.

#### **Akte nënligjore**

- VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”;
- VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”;
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim.
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

#### **Udhëzime, Urdhra dhe Rregullore:**

- Udhëzimi MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme” ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";
- Udhëzimi MF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njëjësive të vetëqeverisjes vendore” etj.;
- Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së”;
- Rregullore e Procedurat të Auditimit në KLSH;
- Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Këlcyrë, etj.

#### **6. Standardet e auditimit**

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 200; 400 etj;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit”;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, KLSH me ndryshime;
- Manuali i zbatimi të rekomandimeve të KLSH;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.

#### **7. Metodat e auditimit**

Përzgjedhja e metodave të përdorura, u mbështet në vlerësimin e riskut, materialitetit, kostos dhe efikasitetit të auditimit, duke patur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit. Duke qenë se thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë, së pari u vlerësua niveli i zbatimit të këtij ligji si dhe funksionimi i 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm nga njësitë e audituar, si një prej elementëve kryesorë të vlerësimit të riskut të auditimit.

Përsa i përket funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, zbatueshmërisë nga ana e subjektit të audituar të MFK-së, grupi i auditimit ka kryer intervista verbale si dhe ka kryer teste kontrolli.

Për arsye se në bazë të vlerësimit sistemi i kontrollit të brendshëm është përcaktuar jo në nivelin e duhur (risiku në nivelin mesatar), grupi i auditimit u mbështet më shumë në procedurat thelbësore dhe më pak në qasjen e mbështetur në sistemin e kontrollit të brendshëm. Siguria e auditimit është marrë më shumë nga procedurat thelbësore, si:

Kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi, intervistimi, raporte dhe informacione, pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm etj.

Procedurat e auditimit kanë për qëllim të sigurojnë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme cilat do të përbëjnë një bazë të arsyeshme për vlerësimet dhe përfundimet e auditimit (ISSAI 300, 3.5.1).

Audituesit përzgjedhin ato procedura auditimi të cilat sipas gjykimit të tyre profesional janë më të përshtatshme në varësi të rrethanave (ISSAI 300, 3.4.5).

## **8. Dokumentimi i auditimit**

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën, dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave, evidencat e marra gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale të bëra në arritjen e konkluzioneve u konsideruan të përshtatshme dhe të rëndësishme për të konfirmuar dhe mbështetur konkluzionet dhe raportin e audituesve dhe shërbyen si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e evidencave të marra, akt – konstatimeve të mbajtur, observacioneve të paraqitura u përgatit Raporti i Auditimit.

## **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

### **1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin**

*Zona Gjeografike:* Këlcyra kufizohet në veri me bashkinë Poliçan, në lindje me Bashkinë Skrapar, në jug me bashkinë Përmet dhe Libohovë dhe në perëndim me Bashkinë Tepelenë dhe Memaliaj. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Këlcyrës.

*Popullsia:* Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia ka një popullsi prej 6.113 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrisë Civile, kjo bashki numëron 12.468 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 304.86 km<sup>2</sup>, me një densitet prej 40.92 banorë/km<sup>2</sup>.

*Të dhëna të tjera:* Këlcyra është një qytezë e shtrirë mes maleve Trebeshinë dhe Nemerckë, e cila përshkohet nga ujërat e kthjellëta të Vjosës. Zona me peizazhe mahnitëse dhe vende historike ofron pak sa i përket strukturës arkitekturore. Zhvillimet urbane pa kriter, mos-

kombinimi i ndërtimeve para viteve '90 me ato të tranzicionit dhe mungesa e një plani urban për zgjerimin kanë sjellë pasoja për qytetën e Këlcyrës.

Të ardhurat ekonomike të banorëve janë të ulëta. Ato vijnë nga aktivitete të vogla tregtare dhe shërbimi, por edhe nga bujqësia dhe blegtoaria e pakët. Këlcyra është dalluar gjithmonë për cilësinë e lartë të frutave dhe rrushit dhe është njohur si qendër për kultivimin e rakisë dhe verës. Por kaosi në tregun shqiptar të pijeve dhe spekulimet kanë bërë që Merloti i famshëm i Këlcyrës pothuajse të humbasë në tregun shqiptar të verës.

Edhe vreshtaria ka pësuar luhatje të ndjeshme, ndërsa kantinat kanë pak peshë në ekonominë e zonës. Të ardhurat nga emigracioni kanë mbështetur mjaft familje të zonës, por rënia e tyre për shkak të krizës ka rënduar situatën ekonomike të banorëve.

Popullsia e Këlcyrës është e përbërë kryesisht nga vendas dhe të ardhur nga fshatrat përreth. Shumë banorë kanë migruar drejt Tiranës, ndërsa një pjesë e madhe e popullsisë kanë emigruar kryesisht drejt Greqisë fqinje.

Emri i Njësive	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
<b>Këlcyrë</b>	<b>Qyteti:</b> Këlcyrë, Fshatrat <b>Fshatrat:</b> ; Fshat Këlcyrë, Mbrezhdan, Maleshovë, Limar, Leskaj
<b>Ballaban</b>	<b>Fshatrat:</b> Ballaban, Vinokash, Vinokash Fushë, Komarak, Mazhar, Kondas, Psar, Ball, Kajcë, Pavar, Toshkëz, Bubës 1, Bubës 2, Beqaraj
<b>Sukë</b>	<b>Fshatrat:</b> Sukë, Goricë, Fshat i Ri, Rodenjë, Podgoran, Podgoran Fushë, Ujmirë, Zhepovë, Shelq, Topojan, Luar, Delilaj, Çorogunj, Taroninë
<b>Dishnicë</b>	<b>Fshatrat:</b> Beduqas, Tolar, Panarit, Riban, Varibop, Kuqar, Mërtinjë, Xhanaj, Bënjë, Fratar, Senican, Katundishtë, Leskovec, Gërdas, Kodrishtë

Veprimtaria e saj bazohet në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, etj.

Vendimet merren nga Këshilli Bashkiak i përbërë nga 15 anëtarë;

Drejtimi i Bashkisë kryhet nga Kryetari i Bashkisë;

Njësitë Administrative drejtohen nga Administratorët e Njësive Administrative;

**Detyrat dhe kompetencat e Bashkisë Këlcyrë fokusohen kryesisht në:**

- Shërbimin publik;
- Shërbimin social;
- Shërbimin kulturor dhe sportet;
- Biznesin.

Misioni për njësinë që auditohet është: Kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (të ardhurat e veta, grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin).

Objektivat burojnë nga ligji “Për vetëqeverisjen vendore”.

Ndërsa administrata (aparati) i këtij institucioni ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.

Për vitin 2023 Bashkia Këlcyrë ka funksionuar duke planifikuar si buxhet 453,094,938 lekë realizimi i të cilave është në masën 89.5%.

Bashkia siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet: njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; respektimit i të drejtave dhe lirive

themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimin efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.

## **2. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT SIPAS PIKAVE TË PROGRAMIT**

### **Pika 1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik**

Në zbatim të pikës 1 dhe nën pikave “1.1”, “1.2” dhe “1.3” të programit të auditimit nr. 136/1 prot. Datë 29.01.2024, nga grupi i auditimit u kërkua dokumentacioni i mëposhtëm:

*1- Struktura dhe auditimin mbi kontrollin e brendshëm financiar*

1.1 Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaria e kontrollit, informimi dhe komunikimi, Monitorimi.

Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

1.2 Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm:

1.3 Vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

Sipas programit u kërkuan dhe dokumentacioni i vitit 2023 si më poshtë:

- Struktura e vitit 2023 e miratuar nga Këshilli Bashkiak
- Karta e Auditimit të Njësisë AB të bashkisë Këlcyrë
- Plani Strategjik dhe pasqyrat shoqëruese
- Planifikimi vjetor për vitin 2023 dhe pasqyrat shoqëruese
- Programimi i auditimeve të brendshme për vitin 2023
- Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm.
- Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara
- Dosjet koherente të subjekteve të audituara
- Projekt-raportet dhe raportet përfundimtare të auditimit të brendshëm të njësisë publike.
- Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditit të Brendshëm dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

Sipas organi gramës së Bashkisë Këlcyrë me nr.25 Prot datë 04.01.2023 dhe Urdhrit me nr.2 datë 04.01.2023 është miratuar struktura organizative e punonjësve sipas nivelit të pagave për vitin 2023.

Në strukturë është miratuar Auditimi i Brendshëm një punonjës ( pika 5 e Organigramës së Bashkisë Këlcyrë ) *e cila nuk ka funksionuar në vitin 2023 në kundërshtim me Rregullores së Brendshëm me nr.13 datë 25.02.2022 e cilësuar “Detyrat e Auditit të Brendshëm”.*

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se *Organizimi i njësisë së auditimit të brendshëm sipas përcaktimeve në VKM nr. 83, datë 03.02.2016” Për Miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisë të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” nuk ka gjetur zbatim në Bashkinë Këlcyrë. Referuar Vendimit nr. 136, datë 30.05.2022, të Kryetarit të KLSH-së, për përmirësimin e gjendjes, është rekomanduar “Kryetarit të Bashkisë Këlcyrë të marrë masa për*



ngritjen dhe miratimin në strukturën organizative të Bashkisë Këlcyrë, Njësinë e Auditit të Brendshëm për kryerjen e funksioneve kontrolluese të veprimtarisë ekonomike financiare të kësaj njësie vendore.

### **I/1-Vlerësimi kontrollin e brendshëm financiar publik.**

Thelbi i sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Brendshëm ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Këlcyrë, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale dhe realizimin e objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “Mjedisi i kontrollit”, “Menaxhimi i riskut”, “Aktivitetet e kontrollit”, “Informimi dhe Komunikimi” si dhe “Monitorimi”, në referim të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime”.

**Konstatim:** Nga analizimi i komponentëve të MFK-së, rezultoi se, Bashkia Këlcyrë nuk e zbaton kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, manualit të MFK, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, si dhe urdhërat e udhëzimet e dala në zbatim të tij.

Nga auditimi rezultoi, mangësi në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar në Bashkinë Këlcyrë.

Nga auditimi i pesë komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, rezultoi se:

- Bashkia Këlcyrë nuk ka hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre, në kundërshtim me pikën 8 të ligjit të MFK.
- Nuk është hartuar, miratuar dhe arkivuar harta (lista) e proceseve të punës, si dhe gjurma e auditimit për këto procese. Nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kreu III, paragrafi 3.1
- Në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit nuk janë kryer trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS- n).
- Për vitin 2023 nuk rezultoi asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS, në kundërshtim me Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 ‘Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike’
- Nuk ka hartuar një strategji risku, në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit nr. 10296 për MFK.
- Titullari nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK.
- Nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e menaxhimit të riskut.
- Si rrjedhojë e vakancave në Sektorin e Auditit të Brendshëm, Bashkia Këlcyrë nuk ka veprimtari të auditit të brendshëm.

Duke operuar kështu në kundërshtim dhe moszbatim të plotë të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit dhe Udhëzimit nr. 16 dt 20.07.2016 për Koordinatorin MFK dhe koordinatorin e riskut në njësinë publike.

Si rezultat i sa më sipër, rrishtet mosnjohja e plotë si dhe sa duhet e koncepteve të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin duke sjellë një nivel të moderuar të riskut të funksionimit (mosfunksionimit) të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Titulli i Gjetjes: Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit

Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit

- ✓ Nga auditimi i pesë komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, rezultoi se:
- ✓ Në Bashkinë Këlcyrë nuk është ngritur një sistem efektiv i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, dhe ka mangësi të plotë të rregullave të shkruara për funksionimin e institucionit.
- ✓ Bashkia Këlcyrë nuk ka hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre, në kundërshtim me pikën 8 të ligjit të MFK.
- ✓ Nuk është hartuar, miratuar dhe arkivuar harta (lista) e proceseve të punës, si dhe gjurma e auditimit për këto procese. Nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kreu III, paragrafi 3.1
- ✓ Në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit nuk janë kryer trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS- n).
- ✓ Për vitin 2023 nuk rezulton asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS, në kundërshtim me Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 ‘Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinatorit të riskut në njësinë publike’
- ✓ Nuk ka hartuar një strategji risku, në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit nr. 10296 për MFK.
- ✓ Titullari nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK.
- ✓ Nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e menaxhimit të riskut.
- ✓ Nga ana e nëpunësit autorizues, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut dhe dokumentimin e tij, Ndërkohë për minimizimin e riskut, mashtrimin dhe parregullsi, nga nëpunësi autorizues nuk janë regjistruar dhe raportuar masat e marra për parandalimin e këtyre fenomeneve.
- ✓ Nga auditimi i dosjeve të punonjësve u konstatua se, në të gjitha rastet e testuara, nuk ishte nënshkruar kontrata e punës, siç përcaktohet nga Kodi i Punës.

Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, ka sjellë mungesë të kontrollit të brendshëm, duke riskuar në përdorimin pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve financiare publike. Gjithashtu ka ndikuar negativisht në performancën institucionale për kryerjen e veprimtarisë në përputhje me parimet e transparencës dhe ligjshmërisë, si dhe nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave,

procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, duke reflektuar kështu nivel të lartë të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm

Sa më sipër në kundërshtim me Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 8, pika 8/a, 8/b; neni 9/3; neni 10; neni 12/3; neni 16; neni 18/1; neni 21/2; neni 27, Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, Udhëzimi nr.16, datë 20.07.2016 ‘Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike’, Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.1/b dhe neni 64 germa (a) dhe (j); Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 21, Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nenet 2 dhe 19 dhe VKM nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucioneve të pavarura”, i ndryshuar.

Titulli gjetjes: Parregullsi në plotësimin e vendeve vakante të cilat janë më status të nëpunësit civil.

Nga auditimi, dokumentacionit dhe informacioni i marrë pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore rezultoi se;

Rekrutimi i punonjësve me status të nëpunësit civil nuk është kryer në përputhje Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:

Nga 41 vende pune me statusin e nëpunësit civil, asnjë punonjës nuk ka statusin e nëpunësit civil dhe punojnë në vendin e punës dhe kategorisë që i korrespondon.

U konstatuan se vendet që i korrespondojnë pozicionit të nëpunësit civil janë plotësuar me punonjës të cilët nuk i përkasin kategorisë së vendeve vakante por thjeshtë janë punësuar për të plotësuar numrin e punonjësve i cili është miratuar me Vendimin nr. 36 të Këshillit Bashkiak, datë 30.11.2022, “Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Këlcyrë, e njëjësive në varësi dhe caktimin e kufijve të pagave e shpërblimeve të funksionarëve të zgjedhur dhe emëruar, të nëpunësve civil e punonjësve administrative të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2023”

41 vende pune me statusin e nëpunësit civil, paraqite më poshtë:

6 pozicion i kategorisë së lartë

- pozicione të kategorisë së mesme drejtues

9 pozicione të kategorisë së ulët drejtuese (2 vakant)

26 pozicione të kategorive ekzekutive (5 vakant)

Të gjithë punonjësit e mësipërm marrëdhëniet e punësimit i rregullojnë me Kod Pune.

Si rrjedhojë riskohet realizimi i detyrave sipas funksioneve të përcaktuara në strukturën e Bashkisë Këlcyrë dhe plotësimi numrit të punonjësve të Bashkisë Këlcyrë sipas strukturës faktike dhe jo sipas detyrave funksionale të tyre.

Sa më sipër në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

### **I/2-Vlerësimi dhe aktivitetit i Auditit të brendshëm në sektorin publik.**

Për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, në Bashkinë Këlcyrë nuk ka funksionuar Njësia e Auditimit të Brendshëm sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe pikat 3 dhe 6 të, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”,

me emërtesën “Njësia e Auditimit të Brendshëm” dhe ka si funksion kryesor mbështetjen e menaxhimit të lartë në zbatimin e objektivave, për Bashkinë e Këlcyrës, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, germa “c” si dhe nenit 64, germa “a” të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” duke ngarkuar me përgjegjësi z. K.N në cilësinë e nëpunësin Autorizues.

## **Vlerësim mbi veprimtarinë e Njesisë së Auditit të Brendshëm.**

Titulli i gjetjes: Mosfunksionimi i Sektorit të Auditimit të Bashkisë Këlcyrë

Nga auditimi mbi hartimin dhe funksionimin e strukturës organike të Bashkisë Këlcyrë, nuk gjejmë të pasqyruar strukturën e Auditit të Brendshëm (AB), kjo për mungesë të specialistëve si dhe nuk ka lidhur aktmarrëveshje me bashkitë kufitare për kryerjen e këtij shërbimi.

Mungesa e ngritjes së strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm nuk sjell një veprimtari të pavarur që jep siguri objektive dhe këshillim për të përmirësuar performancën e institucionit, mosidentifikim të anomalive që janë konstatuar nga KLSH në fushën e MFK-s, pasqyrave financiare si dhe buxhetit.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, shkronja (c), si dhe nenit 64, shkronja (a) të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, pikat 3 dhe 6, te VKM nr. 83, datë 3.2.2016, pika 6 shkronja (a). Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Manuali i Auditit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, Vendimin Nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”

### **Pika 2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit**

Këshilli Bashkiak Këlcyrë përbëhet nga 15 anëtarë për vitin 2023.

Nga verifikimi me zgjedhje i protokollit të mbledhjeve të KB për vitin 2023 (E.M ), lidhur me vendimmarrjet e tij, rezultoi se:

Vendimet e këshillit bashkiak në përgjithësi janë marrë me shumicën e votave të anëtareve mbi 50% ose 3/5 e anëtareve, sipas kërkesave të neneve 48/4 dhe 17/3 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

a. në 5 raste, Vendimet e Këshillit Bashkiak kanë qenë pa shumicën e votave të anëtareve të KB nën 50% ose nën 3/5 e 15 anëtareve tij për 2023, në kundërshtim me nenin 48/4 dhe nenin 17/3 ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht:

1. Në mbledhjen KB datë 21.6.2023 kanë votuar dhe nënshkruar 7 veta nga 8 veta që duhej.
2. Në mbledhjen KB datë 13.7.2023 kanë votuar dhe nënshkruar 5 veta nga 8 veta që duhej
3. Në mbledhjen KB datë 28.4.2023 kanë votuar dhe nënshkruar 7 veta nga 8 veta që duhej
4. Në mbledhjen KB datë 26.9.2023 kanë votuar dhe nënshkruar 5 veta nga 8 veta që duhej.
5. Në mbledhjen KB datë 28.2.2023 kanë votuar dhe nënshkruar 4 veta nga 8 veta që duhej

b. ***Në VKB mungojnë pjesëmarrja dhe konfirmimi i palës interesit (qytetarët), pra nuk është zbatuar “Karta Evropiane e vetëqeverisjes lokale”.***

*Menaxhimi i një qyteti duhet drejtuar që të sigurojë që ata njerëz, të drejtat dhe pronat e të cilëve preken në një shkallë të rëndësishme nga aktet e propozuara dhe vendimtare administrative, të jenë të informuar rreth tyre, tu dëgjohen mendimet dhe të bëhen kështu një pjesë aktive në procesin e vendimmarrjes. Qytetarët janë baza e demokracisë lokale. Ata janë*

*partnerët e përfaqësuesve të zgjedhur dhe zyrtarëve qeverisës lokalë në planifikimin dhe menaxhimin e komunitetit. Me qëllim që t'i ushtrojnë këto detyra, ata duhet të informohen rreth të gjitha planeve kryesorë të perceptuara nga përfaqësuesit dhe zyrtarët e tyre të zgjedhur.*

*Ngarkohet me përgjegjësi kryetari i këshillit bashkiak Këlcyrë z. ish-N.I (deri Qershor 2023) dhe A.R. (pas Qershorit 2023).*

Nga auditimi dokumentacionit KB Këlcyrë te vitit 2023, rezultoj se në procesverbalin e mbledhjeve për 5 vendimmarrjet e marra rezulton se kanë nënshkruar nën 50 % ose 3/5 të KB si dhe mungon konfirmimi i palës së interesit (qytetarët), në zbatim të “Kartës Evropiane e vetëqeverisjes lokale”. Veprime në kundërshtim me nenet 48/4 dhe 17/3 të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” .

Si rrjedhojë e mungesës së nënshkrimit nga anëtarët e KB të protokollit mbledhjeve, sjell mangësi në mbajtjen e protokollit KB, për vendimmarrjen kolegjiale.

**Buxheti.** Bashkia Këlcyrë për vitin 2023 ka hartuar dhe miratuar buxhetin, në zbatim:

- të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,
- të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin sistemit buxhetor RSH” ndryshuar,
- të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar,
- të ligjit nr. 84/2022, datë 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023”,
- të UMF 8 datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor afat mesëm 2023-2025”,
- të shkresës nr. 22954 datë 14.12.2022,
- të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,
- të VKB nr. 3 datë 29.12.2022 “Për miratimin e buxhetit bashkisë Këlcyrë për 2023”.
- të VKB nr. 37 datë 19.7.2023 “Për shtese miratimi buxhet bashkisë Këlcyre për 2023”.

Detajimi i shpenzimeve dhe ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre janë miratuar me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar e ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit.

## **2.1. Programimi i PBA dhe programimi i buxhetit vjetor 2023;**

Programimi buxhetor i vitit 2023 i Bashkisë Këlcyrë parashikon një mbulim sa më të plotë të territorit me shërbime publike cilësore, me qëllim përmirësimin e jetës komunitetit, përmirësimin dhe modernizimin të infrastrukturës rrugore urbane dhe rurale, përmirësimin e pastrimit qytetit, rritjes sipërfaqeve të gjelbëruara, zhvillimin e mirëmbajtjen e tregjeve, zhvillimin e turizmit, mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të biznesit, mbrojtjen e tokave bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, mbulimin e territorit me shërbime sociale, zhvillimin e aktiviteteve kulturore e sportive, menaxhimin e situatave natyrore, etj. Bashkia Këlcyrë administron dhe menaxhon fondet, sipas programeve të miratuara 2023-2025, sa vijon:

Programi i planifikim-menaxhim-administrim Programi i ceshtje financiare dhe fiskale Programi i shërbimit gjendjes civile Programi i zgjedhjeve përgjithshme e lokale Programi i borxhit brendshëm Programi i shërbimit policisë vendore Programi i mbrojtjes nga zjarri e civile Programi i mbështes për zhvillim ekonomik	Programi i administrimit të pyjeve Program infrastrukturës, kullimit, ujitjes Programi urbanistikës Programi i ndriçimit rrugëve Programi i kujdesit social për sëmurët dhe paftës Programi i strehimit social Programi i emergjencave civile Programi fondit rezerve e kontigjenca
--	--

Programi i shërbimit tregjeve dhe inspektimit Programi shërbimeve bujqësore, Programi i kujdesit social për familje dhe fëmijë Programi menaxhimit mbetjeve, shërbime publike Programi mbrojtjes nga zjarri dhe emergjencave	Programi mbrojtjes mjedisit Program arsimi, parauniversitar dhe edukimit Programi i arsimit,parashkollor dhe arsimit bazë Programi i arsimit mesëm,
--	--

Programimi i PBA 2023-2025 parashikon burimet e financimit që janë: Të ardhurat e veta, transferta e pakushtëzuar dhe transferta pakushtëzuar sektoriale. Eshtë bërë miratimi i tavanëve të buxhetit afatmesëm 2023-2025 me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 44 datë 30.12.2022 “Për miratimin e tavanëve dhe pasqyrave të programimit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025”, sipas kërkesave ligjit 68/2017 “Për financat vetëqeverisjes vendore”, neni 37. Po kështu disponohet ky vendim i KB “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Këlcyrë për vitet 2023-2025”, sipas kërkesave të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 34. Dokumenti i PBA 2023-2025 nga bashkia Këlcyrë është derguar MF, Drejtorise Pergjithshme Buxhetit dhe Drejtorise Financave Vendor , sipas shkrësës nr. 1285 datë 08.06.2022. Këshilli Bashkiak Këlcyrë ka marrë Vendim për Miratimin e Kalendarit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 sipas kërkesave të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 33. Eshtë ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023- 2025. Disponohet Plani i Masave dhe Veprimet, për fazën përfundimtare të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Projektbuxhetit Vjetor për të gjithë periudhën e auditimit, ku të jenë përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen, afati, personat përgjegjës. Ka mbledhje të dokumentuara të GMS për të diskutuar rreth planifikimit dhe monitorimit të politikave strategjike, PBA, risqeve kryesore dhe çështjeve të tjera të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Planifikimi Buxhetor Afatmesëm është kryer duke u mbështetur në PBA- të e viteve të mëparshme dhe jo mbi një analizë të mirëfilltë.

Sa sipër, Bashkia Këlcyrë është mbështetur në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, konkretisht sipas neneve, sa vijon:

*\* Neni 33 thuhet: “ Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim në këshillin njësisë kalendarin programit buxhetor afatmesëm dhe buxhetit vjetor, bazuar në UMF për procedurat standarde përgatitjen buxhetor afatmesëm qendror e vendor.*

*\* Neni 34 thuhet: Pika 1. Jo më vonë se data 31 janar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet për shqyrtim e miratim në këshill raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për: a) dy vitet para vitit buxhetor; b) vitin buxhetor;”.*

*\* Neni 35 thuhet: Pika 1. Jo më vonë se 5 ditë nga data e miratimit të tavanëve përgatitore shpenzimeve programit buxhetor afatmesëm, kryetari i njësisë vetëqeverisjes vendore miraton udhëzimin përgatitjes buxhetit dhe e shpërndan tek të gjitha njësitë shpenzuese.*

*\* Neni 36 thuhet: Pika 4. Programi buxhetor afatmesëm vendor përfshin informacionin për 2 vitet fundit, vitin buxhetor dhe 3 vitet vijuese për çdo program të çdo njësie .....a.*

*Pika 5. Brenda 1 qershorIT kryetari dërgon MF projekt programit buxhetor afatmesëm.*

*\* Neni 37 thuhet: Kryetari i njësisë vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin njësisë vetëqeverisjes tavanet përfundimtare shpenzimeve programit buxhetor afatmesëm në nivel programi. Këshilli njësisë vetëqeverisjes vendore miraton tavanet përfundimtare të shpenzimeve programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik. ”*

*- Udhëzimi 7 datë 27.02.2022 dhe Udhëzimi 23 datë 08.08.2022 “Për procedurat standarde përgatitjes PBA të njesive vendore”.*

Për vitin 2023, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr. 3 datë 29.12.2022 “Për miratimin e buxhetit bashkisë Këlcyrë për 2023”, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Gjirokastrë: me shkresën nr. 24/1 datë 16.01.2023. Në këtë VKB, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2023 kanë vlerën 20,274 mijë lekë, të ardhura të trashëguara në vlerën 7,614 mijë lekë, transferata e pakushtëzuar kap vlerën 80,163 mijë lekë, transferata specifike kap vlerën 67,949 mijë lekë ose në total të ardhurat kanë vlerën 176,000 mijë lekë, po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën 176,000 mijë lekë, të cilat sipas sektorëve janë planifikuar të zbërthyera, sa vijon:

- Aparati i bashkisë 39,100 mijë lekë (paga 26800 +4500 sig. +7800 llogaria 602).
- Sherbime publike 33,950 mijë lekë (paga 26000 +4300 sig. +3650 llogaria 602).
- Menaxhim mbetjeve 17,000 mijë lekë (paga 13000 +2200 sig. +1800 llogaria 602).
- Arsimi 9-vjecar 14,300 mijë lekë (paga 8870 +1500 sig. +3930 llogaria 602).
- Arsimi Mesem 3,093 mijë lekë (paga 2593 +500 sig.).
- Sherbimi pyjor 3,433 mijë lekë (paga 2300 +400 sig. +733 llogaria 602).
- Ujitja e Kullimi 10,796 mijë lekë (paga 1400 +300 sig. +9096 llogaria 602).
- Rruge Rurale 34,820 mijë lekë (paga 11500 +1950 sig. +512 llogaria 602).
- SHMZ 14,748 mijë lekë (paga 10300 +1750 sig. +2578 llogaria 602).
- Sporti 1000 mijë lekë (602). - Kultura Turizmi 700 mijë lekë (602).
- Trasferime Qarku 400 mijë lekë.
- Te tjera 360 mijë lekë.
- Fondi rezerve 600 mijë lekë,
- Fondi emergjence 1700 mijë lekë,

Per vitin 2023 buxheti bazë është ndryshuar për shtesën 16,000,000 lekë, sipas VKB nr. 37, datë 19.07.2023

**Programimi i PBA 2023-2025 dhe programimi i buxhetit vjetor 2023, në lekë:**

	Emërtimi	Buxheti Faktik 2022	Faza e I PBA 2023	Faza e II PBA 2023	Projekt Buxhet 2023
600	Paga	80,433,010	94,703,000	94,703,000	110,514,000
601	Sigurime Shoqërore	14,040,537	16,400,000	16,400,000	18,671,000
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	22,413,451	31,997,000	31,997,000	32,095,000
604-606	Trans Buxh. Fam. & Individ	2,396,000	1,498,000	1,498,000	3,060,000
<b>I</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>119,282,998</b>	<b>144,598,000</b>	<b>144,598,000</b>	<b>164,340,000</b>
231	Kapitale të Trupëzuara	12,000,000	13,000,000	13,000,000	27,660,000
<b>II</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>12,000,000</b>	<b>13,000,000</b>	<b>13,000,000</b>	<b>27,660,000</b>
<b>III</b>	<b>Shp. nga ardhur jasht limit</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>I+II +III</b>	<b>Totali I Shpenzimeve</b>	<b>131,282,998</b>	<b>157,598,000</b>	<b>157,598,000</b>	<b>192,000,000</b>

U konstatuan edhe keto mangësi, perkatesisht:

- nuk është bërë analiza dhe monitorimi i buxhetit çdo 4-mujore gjatë vitit 2023.
- raportet e monitorimit nuk janë diskutuar dhe miratuar në Këshillin Bashkiak, dhe nuk janë dërguar në ministrin e financave brenda afateve ligjore, sipas kërkesave të shtojcës 2 "Përmbajtja raportit monitorimit", shtojcës 5 "Treguesi të monitorimit të performancës së programeve e treguesit financiarë", të UMFE 22 datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde".

- raportet e monitorimit nuk janë të plota me të gjitha anekset, sipas kërkesave të ligjit 68/2017 "Për Financat Vetëqeverisjes Vendore", neni 48 dhe Udhëzimit 22 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde monitorimit buxhetit njësisive vendore", pika 10, 12, 28, 29, 48.
- ka mungesë dokumentacioni për dëgjuesat publike me komunitetin dhe grupet e interesit.

*Titulli gjetjes:* Raportet e monitorimit nuk janë diskutuar dhe miratuar në KB dhe nuk janë të plota me të gjitha anekset.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi programimin e planit afatmesëm të buxhetit dhe atij vjetor për vitin 2023 paraqiten këto mangësi:

- Nuk është bërë analiza dhe monitorimi i buxhetit çdo 4-mujor gjatë vitit 2023.
- Raportet e monitorimit nuk janë diskutuar dhe miratuar në Këshillin Bashkiak, dhe nuk janë dërguar në Ministrinë e Financave brenda afateve ligjore, sipas kërkesave të shtojcës 2 Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe shtojcës 5 "Treguesit monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të UMFE nr.22 datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde monitorimit buxhetit njësisive vetëqeverisjes vendore", si dhe nuk janë të plota me të gjitha anekset, sipas kërkesave të ligjit 68/2017 "Për Financat Vetëqeverisjes Vendore", neni 48 dhe Udhëzimit 22 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde monitorimit buxhetit njësisive vendore", pika 10, 12, 28, 29, 48.
- Ka mungesë dokumentacioni për dëgjuesat publike me komunitetin dhe grupet e interesit

Impakti: Në hartimin dhe planifikimin e programeve buxhetore afatmesëm, treguesve kryesorë të buxhetit, të ardhurat dhe shpenzimet.

Sa më sipër operuar në kundërshtim me Ligjin nr.68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore": Udhëzimi 22 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde monitorimit buxhetit njësisive vendore", pika 10, 12, 28, 29, 48.

## **2.2. Celja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;**

### **Miratimi i planit të shpenzimeve 2023 në KB .**

Buxheti i Bashkisë Këlcyrë për vitin 2023 është miratuar me VKB nr. 3 datë 29.12.2022 "Për miratimin e buxhetit bashkisë Këlcyrë për vitin 2023", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër nr. 24/1 datë 16.01.2023, konkretisht konfirmohen këto vendime:

- VKB nr. 1 datë 29.12.2022 "Për dhënien me qira te tokave bujqësore" ne zbatim te udhëzimit nr. 1 datë 18.07.2012 "Për procedurat e dhënies tokave bujqësore te pandara me qira", ku para nisjes procedurave duhet te merret certifikata e pronësisë nga ASHK.
- VKB nr. 2 dhe nr. 4 datë 29.12.2022 "Për miratimin e ndihmës ekonomike".
- VKB nr. 3 datë 29.12.2022 "Për miratimin e buxhetit bashkisë Këlcyrë për vitin 2023",
- VKB nr. 5 datë 29.12.2022 "Për miratimin e ngastrave pyjore dhe plotësimin e fshatrave me dru zjarri", bazuar ne VKM 438 datë 08.06.2016 "Për kriteret dhe rregullave te shfrytëzimit pyjeve dhe shitjes lendes drusore...".
- VKB nr. 6 datë 29.12.2022 "Për miratimin e planit te aktiviteteve dhe buxhetit 2023".

Miratimi i buxhetit nga njësia vendore për vitin 2023 është bërë brenda afateve ligjore, në përputhje me kërkesat e nenit 32 të ligjit 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ku citohet:

*Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore. Si rregull, brenda muajit nëntor të vitit buxhetor, Kryetarët e njësisive të qeverisjes vendore paraqesin për miratim buxhetet në këshillat e tyre.*



*Këshilli brenda datës 25 dhjetor, miraton buxhetin vendor, në bazë vlerësimit ardhurave dhe transfertave pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin buxhetit vjetor.*

Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore.

Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga KB me vendimet përkatëse.

Plani buxhetor është detajuar në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli për çdo muaj.

Treguesit buxhetit janë mbajtur tek llogaria thesarit, e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Disponohen akt-rakordimet periodike e vjetore me thesar.

Plani i të ardhurave dhe shpenzimeve për buxhetin e vitin 2023 është planifikuar duke përcaktuar fushat prioritare përkatëse. Në varësi të vlerave të fondeve të çelura në thesar në fillim të vitit ushtrimor janë bërë edhe miratimet e buxhetit fillestar. Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të granteve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, granteve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit. Gjate vitit 2023 buxheti ka pësuar ndryshime shtesa/paketime, sipas VKB te cituar me sipër.

**Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve te aparatit bashkisë Këlcyrë sipas artikujve për vitin 2023, bashke me ndryshimet (shitesat), ne lekë:**

Nr	EMERTIMI	Plani vjetor	Shtese	Plani vjetor Ne/ lekë	Fakti Ne /leke	Realizimi mi ne %
1	<b>600 Paga</b>	102,763,000	7,751,000	110,514,000	93,781,583	85%
2	601 Sigurime Shoqërore	17,400,000	1,271,000	18,671,000	16,592,355	89%
3	<b>602 Shpenzime operative</b>	31,799,000	296,000	32,095,000	25,046,611	78%
4	<b>231 Investime</b>	20,978,000	6,682,000	27,660,000	13,857,913	50%
5	604 Transferta	400,000	0	400,000	100,466	25%
6	606 Transferta	360,000	0	360,000	360,000	100%
7	609 Fond Rezerve, emergjenca	2,300,000	0	2,300,000	150,000	6.5%
	<b>Shuma</b>	<b>176,000,000</b>	<b>16,000,000</b>	<b>192,000,000</b>	<b>149,888,928</b>	<b>78%</b>

**Shpenzimet e aparatit bashkisë Këlcyrë për 2023, sipas artikujve, te përmbledhura:**

Nr	EMERTIMI	Plani vjetor	Fakti ne lekë	ne %
	600 + 601 Paga + Sigurime	129,185,000	110,373,938	85%
	602+603+651+166 Shpenzime operative	32,095,000	25,046,611	78%
	604 +605+606+609 Transferta	3,060,000	610,466	20%
	230+231 Investime	27,660,000	13,857,913	50%
	<b>Shuma</b>	<b>192,000,000</b>	<b>149,888,928</b>	<b>78%</b>

**Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve ne total për vitin 2023,**

*(sipas rakordimit me thesarin, përfshire fondet jashtë buxhetit bashkisë ku futen investimet e ardhura nga buxheti shtetit, gjendja civile, ndihma ekonomike, fonde deleguara).*

Nr	EMERTIMI	Plani	Fakti ne lekë	Realiz. %
1	<b>600 Paga</b>	114,488,500	97,234,844	85%
2	601 Sigurime Shoqërore	19,031,000	16,885,471	88.7%

3	<b>602 Shpenzime operative</b>	32,223,100	25,137,111	78%
4	603 Subvencione	0	0	0
5	230 Studime, projekte	0	0	0
6	<b>231 Investime</b>	202,136,609	188,330,273	93%
7	604 Transferta	2,138,729	100,466	4.7%
8	605 Transferta me jashte	0	0	0
9	606 Transferta	80,777,000	77,798,889	96%
10	609 Fond Rezerve, emergjenca	2,300,000	150,000	6.5%
	<b>Shuma</b>	<b>453,094,938</b>	<b>405,637,054</b>	<b>89.5</b>

### **Miratimi i planit të ardhurave 2023 në KB.**

**Burimet e financimit** buxhetit bashkisë Këlcyrë për 2023 vijnë nga 2 drejtime, përkatësisht:

- ✓ **Nga burimet e veta vendore**, ku përfshihen te ardhurat nga taksat e tarifave vendore, të ardhura të tjera, donacione dhe të ardhura të trashëguara.
- ✓ **Nga burimet qendrore**, ku përfshihen transferta e pakushtëzuar, transferta specifike për funksione të reja (sektoriale), transferta të kushtëzuara dhe investime nga FSHZH.

Këshilli Bashkiak Këlcyre me vendimin nr. 3 datë 29.12.2022 ka miratuar të ardhurat për 176,000,000 lekë dhe me vonë ka miratuar shtesën prej 16,000,000 lekë, sipas VKB nr. 37 datë 19.07.2023, gjithësej 192,000,000 lekë, nga këto:

- \* Te ardhura tatimore 13,271 mijë lekë, + shtesa 5758 mijë lekë.
- \* Te ardhura jo tatimore 7,003 mijë lekë, + shtesa 1220 mijë lekë.
- \* Transferta e pakushtëzuar e trashëguar nga viti 2022 për 7,614 mijë lekë,
- \* Transferta e pakushtëzuar gjithsejtë viti 2023 për 80,163 mijë lekë,+ shtesa 7499 mijë lekë.
- \* Transferta sektoriale 67,949 mijë lekë,+ shtesa 1,523 mijë lekë, ku përfshihen: arsimiti parashkollor, parauniversitar, ujitje-kullim, pyjor, SHMZ, rruge rurale, menaxhim mbetjeve.

### **Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve operative 2023, sipas zërave analitikë, paraqitet :**

*Ne lekë*

Nr	EMERTIMI	Plani vjetor	Fakti	%
1	6020 Kancelari, tonera	440,000	298,200	67.7%
2	6020 Materiale pastrimi e dezinfektimi	210,000	110,400	52.5%
3	6021 Uniforma, veshje speciale	900,000	796,800	88.5%
4	6021 Plera kimike, furnitorë etj	300,000	0	0
5	6021 Trajtim ushqimor për futbollistet	2,105,000	2,100,000	99.7%
6	6021 Blerje pajisje te veçanta për Zjarrfikës	800,000	0	0
7	6022 Energji elektrike	4,055,000	3,514,046	86.6%
8	6022 Pagesa për Ujë	1,750,000	1,698,256	97%
9	6022 Shërbim telefon dhe internet	185,000	184,356	99%
10	6022 Pagesa shërbimi postar	140,000	142,835	101%
11	6022 Blerje dru zjarri per shkolla e kopshte	1,200,000	1,075,818	89.5%
12	6023 Karburant për automjetet	6,970,000	6,948,560	99.6%
13	6023 Vaj e filtra per automjetet	703,000	56,400	8%
14	6023 Blerje pjese këmbimi për automjetet	1,020,000	999,600	98%
15	6023 Siguracione për mjetet	540,000	353,781	65%
16	6024 Dieta për punonjësi ekipi sportit	420,000	233,710	55.6%
17	6025 Shpenzime mirëmbajtje KUZ e KUB	400,000	0	0
18	6025 Shpenzim mirëmbajtje, lysterje shkolla	460,000	251,880	54.7%
19	6025 Shpenzime dezinfektim shkolla kopsht	150,000	0	0
20	6025 Shpenzime blerje material elektrike	550,000	0	0
21	6025 Shpenzime blerje material hidraulike	450,000	55,200	12.2%
22	6025 Shpenzime mirëmbajtje te rrugëve	312,000	0	0
23	6025 Shpenzim mirëmbajtje kanale vaditëse,	900,000	0	0
24	6025 Shpenzime për mirëmbajtje varreza	0	0	0
25	6025 Shpenzime blerje kazanë mbeturinash	1,000,000	996,000	99.6%
26	6025 Shpenzime mirëmbajtje pajisje zyresh	110,000	45,000	41%
27	6026 Shpenzime pagese qera objekti MZSH	205,000	204,000	99.5%
28	6027 Shpenzime likuid vendim gjyqësore	1,280,000	1,230,000	96%

29	6029 Shpenzime këshilltarë, kryepleq	3,600,000	2,885,769	80%
30	6029 Shpenzime security, futb, federat etj	520,000	449,000	86%
31	6029 Shpenzime aktivitete social kulturore	300,000	300,000	100%
32	6029 Shpenzime tjera materiale, dekor etj	120,000	117,000	97.5%
	<b>Shuma</b>	<b>32,095,000</b>	<b>25,046,611</b>	<b>78%</b>

### **Kontrolli i realizimit të shpenzimeve.**

Referuar situacionit të shpenzimeve të bashkisë Këlcyrë për vitin 2023, lidhur me planifikimin dhe realizimin e tyre, rezulton se:

- *Shpenzimet e bashkisë në total* për vitin 2023 nuk kanë tejkalime në total, pasi këto kanë qenë dhe nën kontrollin e degës thesarit Përmet. Kështu, shpenzimet e buxhetit për vitin 2023 janë realizuar në masën 90 % ose në vlerë absolute 405,637,054 lekë nga 453,094,938 lekë të planifikuara.

- *Shpenzimet e aparatit të bashkisë* për vitin 2023 janë realizuar në masën 78 % ose në vlerë absolute 149,888,928 lekë nga 192,000,000 lekë të planifikuara.

#### **a. Shpenzimet për paga**

Shpenzimet për paga janë realizuar 93,781,583 lekë nga 110,514,000 lekë të planifikuara.

Për vitin 2023 organika e bashkisë Këlcyrë përbehet prej 209 punonjës gjithsej, nga këto:

- 168 punonjës paraqet aparati e bashkisë bashke me 3 njësitë administrative,*
- 4 punonjës paraqet gjendja civile (si funksion i deleguar).*
- 37 punonjës paraqet arsimit parashkollor dhe parauniversitar 17 veta (edukatore, sanitare, sekretar), shërbim pyjor 4 veta, shërbim ujitje kullim 2 veta dhe PMNZSH 14 veta.*

Bashkia Këlcyre paraqet shpenzime për paga në nivel të lartë krahasuar me numrin e ulët të banorëve që mbulon brenda juridiksionit saj. *Kështu, nuk argumentohet numri i lartë i të punësuarve prej 168 punonjës në raport me ngarkesën e punës për disa vende pune,* pasi nuk justifikohen me dokumente dhe programe pune, konkretisht:

- *Zyra e integritetit në BE, marrëdhënie me publikun dhe turizmin përbehet nga 4 punonjës,*
- *Zyra e taksave vendore bashke me agjentet tatimor te njërive përbehet nga 6 punonjës,*
- *Zyra e shërbimeve publike e strehim përbehet nga 5 punonjës,*
- *Agjencia e shërbim pastrimit, gjelbërimit, mirëmbajtje varrezash, KUZ, pyje e kullota, ujitje-kullim, rruge rurale e bujqësia përbehet nga 108 punonjës,*

Për rrjedhojë, *lind domosdoshmëria e rishikimit dhe reduktimit të organikës së bashkisë për 2024.*

Marrëdhëniet e punës për punonjësit e Bashkisë Këlcyrë rregullohen sipas ligjit nr. 152-2013, “Për Nënpunësin Civil” dhe ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në RSH”.

*Pagat dhe ndalesat tatimit mbi pagat personale e sigurime shoqërore e shëndetësore.*

Bashkia ka planifikuar dhe miratuar pagat për vitin 2023 për çdo vend pune sipas strukturave organizative, mbështetur në VKM, në ligjin nr. 10405 datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar, në VKM nr. 165 datë 02.03.2016, “Për Pagat e Vetëqeverisjes Vendore”, me VKM nr. 187 datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve pagave të nëpunësve Civilë”, ndryshuar, bazuar në klasat, kategoritë, pagën e grupit dhe shtesën për vjetërsi e pozicion. Pagat dhe shtesat mbi paga si vjetërsia e punës etj janë përllogaritur drejtë, sipas tabelës së pagave, në përputhje me VKM-të e sipërcituara. Janë llogaritur dhe ndaluar sistematikisht për çdo muaj, detyrimet për tatimin mbi të ardhurat personale dhe sigurime shoqërore e shëndetësore. Pagesat për punonjësit bëheshin për çdo muaj mbi bazën e kohëshënuesit që lëshohej nga përgjegjësi i administratës. Kjo listë prezence konfirmohej nga kryetari dhe i dërgohej sektorit të financës për të kryer veprimet.

Pagesat për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Bashkisë janë kryer në masën 10 për qind të pagës së kryetarit të Bashkisë. Numri 15 i Këshilltareve Bashkiak është bazuar në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 24 “Numri i anëtarëve të Këshillit Bashkiak” ndryshuar me ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

### **b. Shpenzimet për ndihmën ekonomike**

Shpenzimet për ndihmën ekonomike dhe paaftësinë paraqiten për vlerën 77,798,889 lekë nga 80,777,000 lekë planifikimi, dhe zënë rreth 20% ndaj totalit të shpenzimeve (405,637,054 lekë). Kështu, me ndihme ekonomike për vitin 2023 trajtohen mesatarisht 197 familje dhe 307 persona me aftësi të kufizuar. Për shkak të këtij niveli relativisht të lartë të familjeve të trajtuara me ndihmë, gjykohet si efektive hapja e vendeve të reja pune, stimulimi dhe subvencionimi i fermerëve bujqësorë dhe fermave blegtorale, ngritja e qendrave prodhuese industriale, koordinimi me kompanitë private etj, në mënyrë që të tërhiqet sa më shumë forcë pune, për zbutjen e papunësisë dhe varfërisë.

### **c. Shpenzimet operative.**

Shpenzimet operative janë realizuar në masën 25,137,111 lekë nga 32,223,100 lekë të planifikuara, ose në terma relativ 78 %. Midis shpenzimeve operative dhe shpenzimeve për paga ka një raport të drejtë prej 26 %, çka tregon kryerjen me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet të shpenzimeve operative në funksion të aktivitetit kryesor të Bashkisë. Zërat që kanë peshë më të madhe tek shpenzimet analitike janë, shpenzimet për automjetet 8,358,341 lekë, shpenzimet elektrike 3,514,046 lekë dhe shpenzimet për dru zjarri 1,075,818 lekë, me hollësisht:

- Shpenzimet për automjetet paraqiten të realizuara në vlerën 8,358,341 lekë (*karburant, pjesë këmbimi, vajra-lubrifikante, goma, bateri, shërbime, sigurime makinat*), dhe zënë peshën prej 33 % ndaj totalit të shpenzimeve operative.

Thëksojmë se, ndikim në këto shpenzime kanë pasur automjetet e rënda të pastrimit (*shërbim ky i cili mbulohet nga bashkia*), mjetet e ujitje-kullimit të tokave dhe mjetet për mirëmbajtjen e rrugëve rurale të 3 njësive administrative.

Shpenzimet për automjetet ndahen në, shpenzime për pjesë këmbimi 999,600 lekë, shpenzime për karburant dhe vaj 6,948,560 lekë, shpenzime për vaje e filtra 56,400 lekë dhe shpenzime sigurime mjetesh 353,781 lekë.

Bashkia Këlcyrë për vitin 2023 ka hartuar dhe miratuar normativat e karburantit për automjetet e saj, sipas vendimit të KB nr. 37 datë 30.11.2022, përkatësisht:

- për makinat e aparatit bashkisë dhe njësive administrative deri 400 litra/ muaj.
- për makinat e pastrimit dhe largimit mbeturinave urbane deri 10 litra/dite,
- për makinat e shërbimeve rrugëve (fadrome, kamion) nga 0 deri 80 litra /dite.
- për makinat shërbimeve rrugëve, ujitje-kullim (Eskavator zinxhirë) nga 0 deri 50 litra /dite.
- për makinat e shërbimit mbrojtjes zjarrit (SHMZ) me limit 25 litra/100 km.

Disponohet procesverbali i komisionit 17.02.2023 për sondazhet mbi harxhimin e karburantit sipas automjeteve që ka bashkia.

Nga auditimi me zgjedhje, rezultoi se, për automjetet e bashkisë për vitin 2023 disponohen fletudhëtime dhe rakordime për efekt të justifikimit të karburantit, përjashtuar 1 rast, konkretisht:

- Për mjetin teknologjik me targa AA347RD të pastrimit mbeturinave urbane mungojnë fletudhëtimet sipas grafikut ditor dhe mujor, për pasqyrimin e km të përshkuara nga

vendgrumbullimi deri tek pika e depozitimit, në kundërshtim me UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitë publik”, çka bën përgjegjës A.M përgjegjës shërbimeve publike të bashkisë. Theksojmë se, disponohet informacioni datë 20.12.2023, mbi punën dhe menaxhimin e pastrimit të qytetit, me të cilin është vënë në dijeni bashkia Këlcyrë.

- Shpenzimet e energjise elektrike paraqiten të realizuara për vlerën 3,514,046 lekë dhe zënë peshën prej rreth 14 % ndaj totalit të shpenzimeve operative.

Financa e bashkisë nuk ka ushtruar kontroll mbi faturat e energjisë elektrike të FSHU-së, pasi padrejtësisht në këto fatura është përfshirë edhe tarifa prej 100 lekë/muaj për aparatura (televizore), të cilët nuk ekzistojnë, pra mungojnë gjurmet dhe oponenca ndaj këtyre fenomeneve, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në germën “F” pika 4 e nenit 9, germën “e” pika 3 e nenit 12 dhe 22 të ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitë sektorit publik”. Kështu, sipas urdhër shpenzimeve të vitit 2023 (nr. 223, 224, 225 datë 29.06.2023 e tjerë), Bashkia Këlcyrë ka likuiduar faturat e OSHEE (FSHU) bashkë me taksën e aparateve, konkretisht: për bashkinë, 3 njësitë administrative Dishnice, Suke dhe Ballaban, tregun e lirë, fusha futbollit, Shkollat e mesme dhe 8-vjeçare, shkolla Ballaban, Katunisht, shkolla e mesme dhe kopshti Suke, kopshti Këlcyrë, kopshti Gur-Këlcyrë,, ndriçimi rrugor Këlcyre dhe Ballaban, fshati i ri, etj gjithsej 20 njësi x100 lekë/muaji x 12 muaj=24,000 lekë likuidim te tepërt, për të cilën nuk ka ankimim pranë OSHEE, në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 9, pika 4, neni 12 pika 3. Ngarkohen me përgjegjësi V.K me detyrë përgjegjëse e sektorit të financës.

- Shpenzimet për dru zjarri, për kopshtet, shkollat në bashki dhe 3 njësitë administrative janë realizuar për vlerën 1,075,818 lekë dhe zënë peshën prej rreth 4 % ndaj totalit shpenzimeve operative.

Bashkia Këlcyrë për vitin 2023 ka hartuar dhe miratuar normativat e harxhimit për drutë e zjarrit për 4 m<sup>3</sup>/ sobe/vit, sipas vendimit të KB nr. 37 datë 30.11.2022.

#### **d. Shpenzimet për investime.**

Shpenzimet për investime për vitin 2023 janë realizuar në masën prej 50 % ose në vlerë absolute prej 13,857,913 lekë nga 27,660,000 lekë planifikimi. Gjatë vitit 2023 **nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2023**, në mospërputhje me nenin 46 “Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor” të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ku thuhet:

“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji”.

**b.** Për investimet e mëparshme të përfunduara dhe në proces është çelur fond edhe nga qendra për vlerën gjithsej 188,330,273 lekë (173 milion nga qendra+15 milion te ardhurat veta bashkisë, gjithsej 188 milion lekë), e detajuar sipas objekteve investuese, sa vijon:

- 141 milion lekë nga buxheti i shtetit për objektin “Ndërtim ujësjellës për njësitë administrative Ballaban, Suke dhe Dishnice “ në proces likuidimi.
- 19 milion lekë nga buxheti i shtetit për objektin “Përmirësim i kushteve të banimit Këlcyrë” në proces pune.

- 13 milion lekë nga MASH për objektin “Rikonstruksion shkolla 9-vjeçare Kamber Benja Këlcyrë” në proces pune.
- 15 milion lekë pjesa e te ardhurat te veta bashkisë.

Titulli gjetjes: Shpenzimet e buxhetit për paga, operative dhe ndihmën ekonomike.

Situata: Nga auditimi i shpenzimeve të buxhetit të Bashkisë Këlcyrë për 2023, rezultoi se:

- Shpenzimet për karburant për automjetet e bashkisë shoqërohen me fletudhëtime, me përjashtim të mjetit teknologjik të pastrimit, për të cilin nuk janë mbajtur fletudhëtime, për pasojë nuk ka dhe rakordime përkatëse nga sektori i shërbimeve që mbulon pastrimin e qytetit, për efekt të justifikimit të karburantit.

- Sektori i shërbimeve të Bashkisë Këlcyrë paraqet mangësi në dokumentacionin justifikues së pagesave të kryera për punëtorët e normuar (56 punëtorë të normuar), lidhur me riparimin e rrugëve rurale dhe pastrim-gjelbërimin e qytetit.

Shpenzimet për pastrimin e gjelbërimin e qytetit nuk disponojnë dokumentacion të plotë, pasi mungojnë procesverbalet ditore për cilësinë e shërbimeve sipas zërave pastrimit, për pasqyrimin e vërejtjeve, për pasqyrimin e ditëve me shi, për zbritjen e zërave të fshirjes të sipërfaqeve të rrugëve të zëna nga rikonstruksionet e vitit 2023.

Veprime në kundërshtim me rregulloren e brendshme të bashkisë dhe me UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” si dhe me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” Kriteri: ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë publik”,

Shkaku: Raport i zhdrejte midis numrit punonjësve me ngarkesën e punës si dhe likuidim i padrejte i 1 zëri në faturat e OSHE.

Efekti: shpenzime për paga dhe për shpenzime operative me ndikim të vogël në buxhet.

Rëndësia: I Lehtë.

### **2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit;**

Sipas situacioneve të shpenzimeve të rakorduara me thesarin për vitin 2023 shpenzimet buxhetore në Bashkinë Këlcyrë janë realizuar në masën 90 %. Është rakorduar çdo muaj me degën e thesarit Përmet, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordime përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me degën e thesarit Përmet duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me VKB, ose të diktura nga grandet e deleguara nga pushteti qendror. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se është respektuar disiplina buxhetore. Për shpenzimet e reja kapitale janë zbatuar hallkat e miratimit për përfshirjen në buxhet, pasi janë bazuar në prioritetet e caktuara, në kërkesat e paraqitura dhe verifikimit në vend të problemit. Në çdo rast janë ndjekur hapat për realizimin e pagesave shpenzimeve, duke nxjerre urdhër prokurim, është zhvilluar procedura e prokurimit, është lidhur kontrata, pune apo shërbime, janë marrë në dorëzim në çdo rast nga grupi i kolaudimit i ngritur për këtë qëllim, ndërsa për investimet grupi i ngritur nga Zyra e Urbanistikës. Në çdo procedure prokurimi janë dokumentet nga urdhri prokurimit, kontrata, fatura tatimore, situacioni në rastet e punëve apo

shërbimeve, fletë hyrja e magazinës etj. Për çdo procedurë prokurimi, urdhri është regjistruar në kohë dhe kanë vullën dhe datën e depozitimit tyre në Degën Thesarit. Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në Degën Thesarit dhe të shtrira në kohë sipas financimit. Për çdo rast të depozitimit të kontratave në thesar është hartuar shkresë përcjellëse ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit, ku është shtrirë në disa vite, vlera për secilin vit.

**2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli i realizimit të ardhurave; (Faturat e pa likuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të grandëve si FZHR, Ministritë linjës etj.**

*a. Fatura të pa likuiduara.*

Fatura të pa likuiduara për investime dhe shpenzime operative deri më datë 31.12.2023, Bashkia Këlcyrë paraqet një detyrim ndaj të tretëve për vlerën 51,082,975 lekë nga kjo:

- vlera 535,127 lekë, shpenzime operative (602), llogaria 401, të cilat i përkasin muajit dhjetor 2023 dhe janë brenda afatit ligjor për likuidim në fillim të vitit 2024.

- vlera 9,498,646 lekë, shpenzime paga, sig (600 +601), të cilat i përkasin muajit dhjetor 2023 dhe janë brenda afatit ligjor për likuidim në fillim të vitit 2024.

- vlera 41,049,202 lekë, shpenzime investimesh (231), e cila u përket 3 faturave të prapambetura të vitit 2021 dhe fillimit të vitit 2023.

**Bashkia Këlcyrë nuk ka shlyer detyrimet ndaj subjekteve, sipas radhës dhe në afatin e duhur prej 30-60 dite**, në kundërshtim me: UMF 5 datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, me Udhëzimin plotësues “Për buxhetin vitit”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura në Njësitë Vetëqeverisjes Vendore” si dhe me nenin 52 të ligjit nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar, ku thuhet:

Neni 52: Nëpunësit zbatues të njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik.

Sa sipër, konkretisht 3 faturat:

- fatura nr. 6/2021 datë 03.11.2021 për vlerën 5,889,346 lekë e subjektit H shpk, për “Rruga Gorice Podgoran Fushe etj”, nuk është likuiduar për një periudhë mbi 1 vit,

- fatura nr. 164/2021 datë 15.12.2021 për vlerën 1,879,632 lekë e subjektit “SH ” shpk, për “Sistemim asfaltim ura Mbrazh-Maleshove”, nuk është likuiduar mbi 1 vit,

- fatura nr. 8/2023 datë 12.01.2023 për vlerën 33,280,224 lekë e subjektit “SH ” shpk, për “Sistemim asfaltim ura Mbrazh-Maleshove”, nuk është likuiduar për 1 vit.

**Ngarkohet me përgjegjësi V.K**, me detyrë përgjegjëse finance bashkisë. Detyrimet të bashkisë janë raportuar sakte dhe sipas klasave të buxhetit për të gjitha detyrimet e prapambetura, të cilat janë pasqyruar në aktiv të bilancit në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe sipas llogarive 231 dhe 602.

Bashkia Këlcyrë ka përfshirë në buxhetin e vitit 2024-2025 shlyerjen e plote të detyrimeve prapambetura prej 41,049,202 lekë bazuar në udhëzimin e MFE nr. 37 datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin e detyrimeve të prapambetura”.

**Lista faturave pa likuiduara për vlerën 51,082,975 lekë deri në fund të vitit 2023**, paraqitet:

Nr	Operator/Furnitor	Nr.Fat	Datë, .Fature	Shuma/leke	Pershkrimi i shpenzimit	Llog
1	H shpk Permet	6/2021	03.11.2021	5,889,346	Likuid Rruga Gorice,Podgoran Fushe, etj	231
3	SH	164/2021	15.12.2021	1,879,632	Lik.Sit. Sist-asfalt Ura Mbrezh-Malshove	231
4	SH	8/2023	12.01.2023	33,280,224	Lik.SituacSist-asfalt Ura Mbrezh-Malsho	231
	<b>SHUMA INVEST.</b>			<b>41,049,202</b>		231
1	F sh.a Tirane	indeksi	31.12.2023	376,908	Lik. Fat. dhjet 2023, aparat, sherbim, arsim,	602
2	A sh.a Tir	82626/24	06.01.2024	4,900	Likuidim fatura dhjetor 2023 Aparati	602
3	A sh.a Tir	50493/24	05.01.2024	4,319	Likuidim fatura dhjetor 2023 Aparati	602
4	A sh.a Tir	72879/24	05.01.2024	1,200	Likuidim fatura dhjetor 2023 MZSH	602
5	Posta Shqiptare sh.a	1/2024	03.01.2024	3,680	Likuidim fatur dhjetor 2023, sherb. postare	602
6	Shoqeria Ujesjelles	6621	03.01.2024	144,120	Likuidim fatura dhjetor 2023, furnizim uje	602
	<b>SHUMA SHPEN.</b>			<b>535,127</b>		602
1	Punonjes Bashkis		31.12.2023	6,842,646	Pagat punonjes Bashki, dhjetor 2023	600
2	Drejt. Pergj Tatime	deklarata	11.01.2024	180,761	Tatim page i muajit dhjetor 2023	600
3	Drejto. Pergj Tatime	deklarata	11.01.2024	2,475,419	Sigu.shoqer-shendet dhjetor 2023	600-601
	<b>SHUMA SHPENZ.</b>			<b>9,498,646</b>		
	<b>SHUMA TOTAL</b>			<b>51,082,975</b>	<b>DETYRIME NGA VITI 2021 dhe 2023</b>	

*Titulli i gjetjes:* Mos marrja e masave të duhura për uljen e vlerës detyrimeve prapambetura Situata: Bashkia Këlcyrë paraqet një detyrim ndaj të tretëve në fund vitit 2023 për vlerën 41,049,202 lekë, e cila u përket 3 faturave të pa likuiduara për investime, që i përket periudhave të prapambetura 2021-2023, konkretisht:

- ✓ fatura nr. 6/2021 datë 03.11.2021 për 5,889,346 lekë e subjektit H shpk, për “Rruga Goricë Podgoran Fushe etj”, nuk është likuiduar për një periudhë mbi 1 vit,
- ✓ fatura nr. 164/2021 datë 15.12.2021 për 1,879,632 lekë e subjektit “SH ” shpk, për “Sistemim asfaltim ura Mbrezh - Maleshove”, nuk është likuiduar mbi 1 vit,
- ✓ fatura nr. 8/2023 datë 12.01.2023 për 33,280,224 lekë e subjektit “SH.” shpk, për “Sistemim asfaltim ura Mbrezh - Maleshove”, nuk është likuiduar për 1 vit.

Pra, Bashkia Këlcyrë nuk ka shlyer detyrimet ndaj subjekteve në afatin e duhur prej 30-60 ditë, në kundërshtim me UMF 5 datë 27.12.2014 “Për shlyerjen detyrimeve prapambetura”, me Udhëzimin plotësues pikat 82-91 si dhe me nenin 52 të ligjit nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar. *Sqarojmë se:* Bashkia Këlcyrë ka përfshirë në buxhetin e vitit 2024-2025 shlyerjen e plotë të detyrimeve të prapambetura prej 41,049,202 lekë, bazuar në udhëzimin e MFE nr. 37 date 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin e detyrimeve te prapambetura”.

Kriteri: Marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion dhe krijimi i detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e udhëzimin e MFE 37 datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin e detyrimeve te prapambetura”, me nenin 52 të ligjit 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor RSH”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Likuidimi jo në kohë të detyrimeve të prapambetura, përveçse është moszbatim i kuadrit rregullator në fuqi, e vë nën vlerë vendore në kushtet e palës përgjegjëse ndaj kreditorëve. Ndodhur në kushtet kur shkelur marrëveshja e përcaktuar në kontratë me kreditorët për afatin e kryerjes së këtyre pagesave, krijohen premisa që kreditorët nëpërmjet proceseve gjyqësore, përveç vlerës së detyrimit sipas situacionit dhe kontratës, të kërkojnë edhe përqindje të interesave etj., gjë e cila rrit kostot financiare në mënyrë artificiale.

Shkaku: Mos vendosja e fondeve buxhetor në masën e duhur në likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe krijimi i detyrimeve të reja gjatë vitit buxhetor.

Rëndësia: E Mesme

*b. Vendime gjyqësore.* Për vitin 2023 disponohet **1 rast vendim gjyqësor** i subjektit “E ” shpk, i ardhur nga viti 2022, për vlerën 4,808,146 lekë me efekte negative në buxhet. Për vitin 2023



bashkia ka vazhduar likuidimin për vlerën 1,230,000 lekë. Nga titullari i bashkisë nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, në kundërshtim me udhëzimin nr. 4, datë 27.01.2011 “Për zbatimin e buxhetit” pika 6.1 “Vendimet gjyqësore” dhe pika 62 UMF 2 datë 6.02.2012 “Për procedurat standarde zbatimit buxhetit” .

c. *Vendime shpronësimesh.* Bashkia Këlcyre nuk ka vendime shpronësi për vitin 2023.

## **2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara nëpërmjet FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;**

Bashkia Këlcyre nuk ka pasur fonde të çelura nga FZHR për vitin 2023, por ka pasur fonde të çelura nga: Ministria Infrastrukturës 141 milion lekë objekti “Ndërtim ujësjellësi për njësitë administrative Ballaban, Suke dhe Dishnice”, nga MF Drejtoria Strehimit 19 milion lekë objekti “Përmirësim i kushteve të banimit Këlcyre” dhe nga MSHA 13 milion lekë objekti “Rikonstruktion shkolla 9-vjeçare Kamber Benja Këlcyre”.

## **2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave.**

Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Ligjshmëria e lidhjes së kontratave për dhënien me qira të aseteve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor.

a) Taksat dhe tarifave vendore.

### ***Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore***

Për vitin 2023 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 38, datë 30.11.2022, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Këlcyre dhe Institucioneve të Varësisë dhe funksioneve të transferuara për vitin 2023”, ku përfshihet edhe struktura e sektorit taksave e tarifave vendore, e cila përbëhet nga 6 punonjës, nga keto: 1 përgjegjës, 2 specialist, 3 agjent në Njësite Administrative, Dishnice, Suke, Ballaban, konkretisht tabela:

<i>Nr.</i>	<i>Emri Mbiemri</i>	<i>Funksioni</i>	<i>Profesioni</i>	<i>Arsimimi</i>	<i>Urdhri emërimit</i>
<i>a</i>	<i>b</i>	<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>
1	L.J	Përgjegjëse	Fin-Kontab	I larte	nr. 94 datë 20.09.2021
2	M.C	specialist	Fin-Kontab	I larte	nr. 67, datë 01.09.2016
3	I.K	Specialist,	Fin-Kontab	I larte	nr. 103 datë 20.09.2021
4	S.S	Agjent, Dishnice		I mesëm	nr. 77 datë 22.12.2017
5	Y.I	Agjent, Suke		I mesëm	nr. 94 datë 06.09.2018
6	A.Q	Agjent, Ballaban		I mesëm	nr. 87 datë 21.09.2015

### **Sektori i taksave e tarifave vendore bashkisë Këlcyre ka funksionuar dhe menaxhuar në mënyrë të pamjaftueshme në mbledhjen dhe realizimin e taksave e tarifave vendore, pasi:**

- Fakt për këtë është realizimi i ulët i të ardhurave vendore në masën 60 % ose në vlerë absolute prej 16,628 mijë lekë nga 27,252 mijë lekë të planifikuara, pra me një diferencë prej (10,624) mijë lekë si mungesë të ardhurash.
- Disa taksa e tarifa vendore nuk janë kontribut i sektorit taksave vendore, por i institucioneve dhe sektorëve të tjera, konkretisht:

- taksa e ndikimit ne infrastrukture 1,205 mijë lekë mblidhet nga sektori i urbanistikes, pasi pa pagesën e kësaj takse nuk jepet leja e ndërtimit.
- taksa mbi regjistrimin automjeteve 2,651 mijë lekë mblidhet nga DRSHTRR Gjyrokastër.
- tatimin thjeshtuar mbi fitimin 47 mijë lekë mblidhet nga agjentit tatimor DRTGJ,

***Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:***

Administrimi i taksave vendore nga sektori i taksave vendore është pasqyruar ne regjistrat, sipas aktiviteteve, detyrimeve, pagesave si për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë. Dinamika e lëvizjes së subjekteve gjate vitit 2022 dhe 2023, paraqitet si më poshtë:

Nr	Lloji Biznes	Viti	Gjendja ne fillim	Regjistrime reja	Mbyllur	Gjendja fund vitit
1	Biznes Vogël	2022	141	16	1	156
		2023	156	0	1	155
2	Biznes Madh	2022	22	0	0	22
		2023	22	0	0	22
1+2	Gjithsej	2022	165	16	3	178
		2023	165	0	1	177

Për vitin 2023, kanë ushtruar aktivitet **177 subjekte**, nga keto: 155 subjekte të biznesit të vogël dhe 22 subjekte të biznesit të madh. Nga të dhënat e tabelës konstatohet se për vitin 2023 nuk ka asnje regjistrim të ri dhe 1 subjekt tregtar A.G ka mbyllur aktivitetin me datë 06.10.2023. Per rrjedhoje numri i bizneseve në 2023 eshte ne nivelet e vitit 2022 (nga 178-177 subjekte). Sektori taksave tarifave vendore ka mbajtur dhe administruar dosjet e bizneseve dhe keto dosje ne pergjithesi kane dokumentacionin e duhur. Nga sektori i taksave janë hapur rregjistrat për biznesin e vogël ku janë përcaktuar taksat vendore si ajo e pastrimit, tabelës, ndërtimit, etj.

**Evidenca mbi realizimin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore për periudhën 2023:**

Nr	Lloji taksës	Plani filles.	Plani shtese	Plan 2023	FAKT 2023	%
<b>I</b>	<b>Te ardhura nga Tatimet</b>	13271	5,758	19,029	<b>9,028,</b>	
1	Tatimi Thjesht mbi Fitimin	70	0	70	<b>47</b>	67
<b>II</b>	<b>Te ardhura nga Taksat</b>					
2	Taksa ndertese biznes&familje	2260	926	3186	<b>1,577</b>	49
4	Taksa mbi token Bujgesore	2300	970	3270	<b>887,</b>	27
5	Takse mbi rregj e Automjete	2200	181	2381	<b>2,651,</b>	111
6	Taksa e ndikimit ne infrastruktur	5300	2800	8100	<b>1,205,</b>	15
7	Takse trualli jo hapësire publike	200	261	461	<b>1,553,</b>	336
8	Takse table	20	0	20	<b>13</b>	65
9	Takse per hapësira publike	380	0	380	<b>202,</b>	53
10	Takse table per qellim reklame	350	620	970	<b>507</b>	52
	Taks tjera te perkohme	171	0	171	<b>386</b>	226
<b>III</b>	<b>Te ardhura jo tatimore</b>	7,003	1,220	8,223	<b>6,900</b>	
12	Tarife Pastrimi	1866	300	2166	<b>1,834,</b>	85
13	Tarifë ndriçimi biznes+ familje	410	100	510	<b>619,</b>	121
14	Tarif gjelberimi familje + biznes.	554	100	654	<b>640.</b>	98
15	Tarife kuz familje + biznesi	300	20	320	<b>738</b>	231
16	Tarife per prerje lende drusore	370	0	370	<b>40,</b>	11
17	Tarife e kullotjes se bagetive	1050	0	1050	<b>311</b>	30
<b>IV</b>	<b>Te ardhura te tjera</b>					
18	Qera trualli	600	0	600	<b>940</b>	156
19	Tarif (leje transp ,certif., autoriz)	183	0	183	<b>101</b>	55
20	Tarifa Qira toke, MZSH,TAP	160	0	1650	<b>1,677</b>	102
	<b>GJITHSEJ ( I+II+III+IV)</b>	20274	6,978	<b>27,252</b>	<b>16,628</b>	<b>61</b>

Plani i të ardhurave për vitin 2023 paraqitet për vlerën 27,252 mijë.

Paketa fiskale është miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 38, datë 30.11.2022 “*Per miratimin e taksave dhe tarifave vendore si dhe penalitetet per kundravajtjet per vitin 2023*”.

Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore ka rakorduar me Degën e thesarit Permet për realizimin ardhurave për periudhën 1 janar deri 31 dhjetor 2023, sipas akt-rakordimit bashkengjitur. Të ardhurat ne total jane realizuar 61 % ose 16,628 mijë lekë nga 27,252 mijë lekë te planifikuara, pra **10,624 mijë lekë mungesë të ardhurash** për vitin 2023 (27,252-16,628), në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*”, neni 23. Të ardhurat gjithsej për vitin 2023 jane realizuar 16,628 mijë lekë, me konkretisht **sipas zerave analitik**, sa vijon:

- **Tatimi thjeshtuar mbi fitimin është realizuar 67 %** ose në vlerë absolute 47 mijë lekë nga 70 mijë lekë të planifikuara, pra 23 mijë lekë mungesë të të ardhurave.

Drejtoria rajonale tatimore Gjirokastrë, në rolin e agjentit tatimor për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin, nuk ka bërë njoftime për bashkinë për punën e bërë për nivelin e vjeljes së këtij tatimi për vitin 2023. Bashkia Këlcyrë ka pasur bashkëpunim me DRT Gjirokastrë për arkëtimin e debitorëve për taksën e tatimit thjeshtuar, sipas kërkesave te nenit 15, pika 5 të ligjit 9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*” i ndryshuar. Bashkëpunimi midis policisë bashkiake me sektorin e taksave dhe financën bashkisë ka funksionuar dobët, për përdorimin e kasës fiskale, lëshimin e kuponit tatimor, plotësimin e librave të shitjes dhe blerjes, nëse subjekti ka ose jo të reklamuar listën e çmimeve etj, bazuar ne kërkesat e nenit 4/3 te ligjit 9632 datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*” i ndryshuar, ligjit 106/2017, pika 10, “*Konrolli tatimor*” të UMF dhe MB nr. 655/1 datë 06.02.2007 “*Për përcaktimin e uniformitetit të Standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore*”. Për vendosjen e saktë të ngarkesës tatimore në disa raste nuk janë bërë verifikime e kronometrike në vend. Kontrollat në vend për mbajtjen e librit shitjeve, librit blerjeve, nivelit xhiros, etj kanë qenë të pakta, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, nenin 15.

- **Taksa vjetore të mjeteve të përdorura është realizuar 111 %** ose në vlerë absolute 2,651 mijë lekë nga 2,381 mijë lekë të planifikuara. Realizimi i kësaj takse paraqitet me tejkalim, pasi ndikim kanë pasur likuidimet e detyrimeve te prapambetura. Nuk ka pasur bashkëpunim dhe rakordim me DRSHTRR për të ardhurat që përfiton bashkia nga pagesa e taksës vjetore të mjeteve të përdorura, sipas udhëzimit të përbashkët të MPVD dhe MF nr. 9, datë 04.02.2003 “*Për regjistrimin e përvitshëm të mjeteve të transportit*”. Nuk ka patur një inventar të plotë të mjeteve në pronësi të qytetarëve sipas llojit të tyre, tonazhit, etj per vitin 2023.

- **Tarifa e pastrimit** dhe largimit të mbeturinave eshte realizuar 85 % ose 1,834 mijë lekë nga 2,166 mijë lekë e planifikuar ose 332 mijë lekë mungesë të ardhurash.

- **Taksa e fjetjes në hotel nuk ka**, megjithese ne paketen fiskale 2023 te miratuar ne vendimin e KB nr. 38 datë 30.11.2022 ajo percaktohet 35 lekë/nate.

- **Taksa per hapësire publike** eshte realizuar 53 % ose 202 mijë lekë nga 380 mijë të planifikuara, pra 178 mijë lekë mungesë të ardhurash. Eshte percaktuar dhe miratuar tarifa e hapësires publike prej 60 lekë/m<sup>2</sup>/dite miratuar ne VKB.

- **Taksa e reklamës** është realizuar 52 % ose 507 mijë lekë nga 970 mijë lekë parashikimi, pra 463 mijë lekë mungese ardhurash. Nuk disponohet inventar fizik për reklamave e vendosura brenda territorit Këlcyrë me të dhëna për numërin përgjithshëm reklamave, përmasat dhe sipërfaqet tyre, vendodhjen sipas rrugëve, lagjeve, shoqëritë, individët që i kanë vendosur.

- **Taksa e ndërtesës per biznese e familje** është realizuar 49 % ose 1,577 mijë lekë nga planifikimi prej 3,186 mijë lekë, pra 1,609 mijë lekë mungesë të ardhurash. Taksa e ndërtesës për bizneset është llogaritur në bazë të evidencave që janë nxjerrë nga grupi i punës i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë për verifikimin e sipërfaqeve të tatueshme të subjekteve që ushtrojnë aktivitet privat, ndërsa për familjarët disponohen evidencat për sipërfaqet e tatueshme, bazuar në dokumentet hipotekore.

- **Taksa e tokes bujqësore** është realizuar 27 % ose ne vlere absolute 887 mijë lekë nga 2,370 mijë lekë e planifikuar, gjë e cila ka sjell të ardhura të munguara në vlerën 1,483 mije lekë. Theksojme se 3,360 familje i nënshtrohen taksës për këtë pasuri të paluajtshme. Në Bashkinë Këlcyrë rezulton se toka bujqësore u përket kategorive IV deri VII, sipas përkatësisë, Kategoria e V per 753 Ha, kategoria VI per 1,971 Ha dhe kategoria VII per 1,928 Ha, gjithsej fondi i tokës bujqësore është 4,652 Ha. Nga auditimi rezulton se **ka rezerva në planifikimin e kësaj takse**, pasi duhej planifikuar 5,427 mijë lekë nga 2,370 mijë lekë që është planifikuar për vitin 2023, më hollësisht pasqyra:

*Pasqyra për “Vlerësimin e tokës sipas sipërfaqes/kategorisë/cmimit”*

Nr.	Kategoria/tokë	Cmimi/ha/vit	Sipërfaqia/ha	Shuma/lekë	Planifikimi taksës/vit 2023
1	Kategoria V	1,250 lekë	753	941,250	
2	Kategoria VI	1,200 lekë	1971	2,365,200	
3	Kategoria VII	1,100 lekë	806	2,120,800	
	<b>Totali</b>	-	<b>4,652 hektar</b>	<b>5,427,250</b>	<b>2,370,000</b>

Baza ligjore për taksën e tokës bujqësore është ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 23 ku thuhet:

**“Taksa mbi tokën bujqësore**

1. Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Kategoritë minimale të tokave bujqësore jepen në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Për çdo kategori minimale tokës bujqësore, KB mund të miratojë nën kategorizime.

2. Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen në aneksin 2 të këtij ligji.

3. Përrjashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për 5 vitet e para nga çasti i mbjelljes. 4. Taksa e mbledhur në mbështetje të këtij ligji paguhet në buxhetin bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme”.

**Tarifa për dhënien e përsëritjen e licencave.**

Bashkia Këlcyrë ka pajisur 4 subjekte me autorizime për ushtrimin e aktivitetit për tregëtimin e karburanteve brenda territorit saj, bazuar në ligjin 8450 datë 24.02.1999 ndryshuar me ligjin 9218 datë 8.4.2004 “Për disa shtesa për përpunimin, transportin dhe tregëtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tij” në VKM 129 datë 01.3.1999 ndryshuar me VKM 970 datë 02.12.2015, VKM 344 datë 19.04.2017, miratuar me VKB 38 datë 30.11.2022, për:

- pagesë për dhënien e përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së naftës dhe gazit të lëngshëm, naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante për tarifen 1,000,000 lekë /5 vjet,
- pagesë për dhënien e përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së tyre që ushtrojnë veprimtarinë e tregëtimin të tyre për përdorim nga konsumatorët fundor me tarifen 100,000 lekë/5 vjet,.

Pagesat e licencave për tregtimin e hidrokarbureve paraqiten të likuiduara pjesërisht, pasi 4 subjekte nuk kanë shlyer detyrimet për vlerën 10,200,000 lekë të ardhura munguara për buxhetin deri në fillim të vitit 2023, në kundërshtim me ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 35 i VKM 344 datë 19.04.2017, për disa ndryshime në VKM 970 datë 02.12.2015, pika 15.1., konkretisht në mënyrë analitike, sipas subjekteve:

Nr.	Subjekti	Afati i Autorizimit		Detyrimi për autorizimin	Pagesat e 2022	diferenca
		Fillimi	Mbarimi			
1	D shpk	30.05.2015	30.05.2020	2.200.000	400.0000	1,800,000
2	A	05.01.2018	04.01.2022	1.100.000	400.000	700,000
3	“E” sh.pk.	01.12.2016	01.12.2021	4.400.000	0	4,400,000
4	D	12.01.2015		3.300.000	0	3,300,000
	<i>shuma</i>			11,000,000	800.000	10,200,000

Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 35 ku thuhet:

“1. Çdo pagesë tjetër në buxhetin bashkisë, të komunës ose qarkut klasifikohet si tarifë kur:  
a) përkon me përcaktimet e pikës 3 të nenit 16 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”;  
b) nuk është taksë bashkiake, si dhe gjobë e lidhur me to, në përputhje me këtë ligji.  
2. Tarifat vendosen dhe administrohen në përputhje me ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj ose në ligje të tjera, që rregullojnë funksionet dhe tarifat e lidhura me to, këshilli bashkiak dhe ai komunal vendosin për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, përcaktojnë nëse tarifat do të mbledhen nga vetë strukturat bashkiake ose komunale apo nga një agjent”.

VKM nr.170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, kapitulli II, kapitulli III, pika 4, ku thuhet:

II. Procedura për dhënien e autorizimeve: Dhënia e autorizimeve për funksionimin e stacioneve të shitjes së karburanteve, të ndërtuara në autostrada, bëhet nga ministri që mbulon veprimtarinë e transportit, ndërsa dhënia e autorizimit për stacionet e tjera të shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm dhe vajrave lubrifikante dhe stacionet e mbushjes së bombolave të gazit të lëngshëm bëhet nga organet e qeverisjes vendore.

III. Pagesat: Dhënia e lejeve të tregtimit dhe të autorizimeve bëhet kundrejt pagesës nga subjekti kërkues. Tarifat e pagesës për lejet dhe autorizimet, që jepen për herë të parë, janë:

1. për lejet e tregtimit të llojit "A " 500 000 lekë
2. për lejet e tregtimit të llojit "B" 200 000 lekë
3. për lejet e tregtimit të llojit "C" 200000 lekë
4. për autorizimet për stacione shitjeje karburanti, gazi të lëngshëm, vajrash lubrifikante dhe të stacioneve të mbushjes së bombolave të gazit të lëngshëm 100 000 lekë.
5. për autorizime për njësitë e lëndëve djegëse 50000 lekë.

Tarifat për përsëritjen periodike të lejeve të tregtimeve dhe të autorizimeve janë sa gjysma e tarifave të mësipërme.

VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pikës 1 germës “b” ku thuhet:

II. Procedura për dhënien e licencave për tregtimin pakicë karburanteve, gazit lëngshëm naftës, për automjetet, lubrifikante dhe lëndëve djegëse përdorim nga konsumatorët fundorë.

*1. Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga:*

*b) Organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit karburanteve për automjete, gazit lëngshëm vajrave lubrifikante dhe njësive shitjes lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë tregtimit tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen territoret tjera.*

*9. PAGESA PËR DHËNIEN DHE PËRSËRITJEN E LICENCAVE PËR STACIONET E SHITJES SË KARBURANTEVE, GAZIT TË LËNGSHËM TË NAFTËS, PËR AUTOMJETET, DHE VAJRAVE LUBRIFIKANTE ËSHTË 5 000 000 (pesë milionë) lekë, për Bashkinë e Tiranës dhe 2,000,000 (dy milionë) lekë, për bashkitë e tjera.*

*- Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon: me VKM nr.344, dt. 19.4.2017.*

*"9. PAGESA PËR DHËNIEN DHE PËRSËRITJEN E LICENCAVE PËR STACIONET E SHITJES SË KARBURANTEVE, GAZIT TË LËNGSHËM, TË NAFTËS PËR AUTOMJETET DHE VAJRAT LUBRIFIKANTE, ËSHTË 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera."*

*10. PAGESA PËR DHËNIEN DHE PËRSËRITJEN E LICENCAVE PËR NJËSITË E SHITJES SË LËNDËVE DJEGËSE, QË USHTROJNË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË TYRE PËR PËRDORIM NGA KONSUMATORËT FUNDORË, ËSHTË 1 000 000 (një milion) lekë, për Bashkinë e Tiranës dhe 200 000 , për bashkitë tjera.*

*- Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon: me VKM nr.344, dt. 19.4.2017.*

*"10. PAGESA PËR DHËNIEN DHE PËRSËRITJEN E LICENCAVE PËR NJËSITË E SHITJES SË LËNDËVE DJEGËSE, QË USHTROJNË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË TYRE PËR PËRDORIM NGA KONSUMATORËT FUNDORË, ËSHTË 500 000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100,000 lekë për bashkitë e tjera."*

*"15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë.*

*15.2 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për subjektet e licencuara dhe vendndodhjen e pikave të depozitimit apo të tregtimit, në mënyrë që këto të fundit të kontrollojnë zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi."*

*VKM 344 datë 19.04.2017, për disa ndryshime ne VKM 970, "Për përcaktimin procedurave dhe kushteve për dhënie licencave për tregtimin naftës bruto dhe nënprodukteve saj".*

*pika 15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë.*

*15.2 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për subjektet e licencuara dhe vendndodhjen e pikave të depozitimit apo të tregtimit, në mënyrë që këto të fundit të kontrollojnë zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi."*

### **Debitorët e taksave e tarifave vendore 2023.**

Debitorët e taksave vendore të vitit 2023 pasqyrohen për vlerën 8,244,881 lekë, te cilët zënë peshën prej 50 % ndaj totalit të të ardhurave gjithsej prej 16,628,000 lekë, (pra kanë peshë të madhe), rrjedhimisht kthehet në domosdoshmëri vjelja e tyre në një kohë sa më të shkurtur.

Në mënyrë të detajuar debitorët e taksave tarifave vendore deri më 31.12.2023 paraqiten:

A. sipas llojit taksave,

- 2,224,330 lekë debitor biznesi i madh dhe biznesi i vogël,
- 1,396,184 lekë debitor familjet e bashkisë Këlcyrë dhe 3 njësive administrative,
- 4,624,367 lekë debitor për token bujqësore,

B. sipas 4 njësive të bashkisë Këlcyre:

- 3,499,204 lekë Bashkia Këlcyrë,
- 1,717,532 lekë Njësia administrative Dishnice,
- 1,565,141 lekë Njësia administrative Suke,
- 1,463,004 lekë Njësia administrative Ballaban,

Pra peshën më të madhe prej 57 % e zënë debitorët e 3 njësive administrative (taksë biznesi+taksë bujqësore +tarifë familjare).

Debitorët e taksave të bashkisë Këlcyrë dhe 3 njësive administrative për vitin 2023 janë evidentuar nga zyra e taksave vendore dhe i janë përcjellë financës për kontabilizim, sipas shkresës nr. 298 datë 13.02.2024.

Pasqyra e debitorëve të taksave, tarifave vendore vitit 2023 te bashkisë Këlcyrë, paraqitet:

EMERTESA	BIZNESI/DEBITOR viti 2023 Ne lekë
<b>Bashkia Këlcyrë</b>	3,499,204
Biznesi Juridik	1,387,443
Biznesi/Fizik	720,734
Taksa tarifa familjare	989,923
Takse per toke bujqesore	401.104
<b>Njesia AD. Dishnice</b>	1,717,532
Biznesi	10,961
Taksa dhe tarifa familjare	138,475
Taksa per token bujqesore	1,568,096
<b>Njesia AD. Suke</b>	1,565,141
Biznesi	8,700
Taksa dhe tarifa familjare	165,420
Taksa per token bujqesore	1,391,021
<b>Njesia AD. Ballaban</b>	1,463,004
Biznesi	96,492
Taksa dhe tarifa familjare	102,366
Taksa per token bujqesore	1,264,146
<b>Shuma totale taksave:</b> biznes madh, biznesi vogel, familjare e 3 njësive dhe bashkise, toka bujqësore e 3 njësive + bashkia	
<b>Biznesi fizik + juridik</b>	<b>2,224,330</b>
<b>FAMILJET</b>	<b>1,396,184</b>
<b>TOKAT</b>	<b>4,624,367</b>
<b>TOTALI I DEBITOREVE TAKSAVE VENDORE VITIT 2023</b>	<b>8,244,881</b>

Ne mënyrë analitike sipas llojit të taksave e tarifave vendore dhe subjekteve si dhe njësive, debitorët e taksave, tarifave vendore për vitin 2023, përbëhen nga:

- debitorë **biznes i madh**, paraqiten për **2 subjekte** me vlerën **196,745 lekë** konkretisht: M.K. 79,825 lekë dhe D shpk 116,920 lekë.
- debitorë biznes ivogël**, paraqitet **70 subjekte** fizike për vlerën **720,734 lekë**, sipas listës ne akt konstatimin nr. 2.
- debitorë të Njesisë administrative **Dishnice**, paraqitet **2 subjekte** fizike për vlerën **10,961 lekë**, konkretisht: F. Q. 6,385 lekë dhe P.B.4,576 lekë.

- d) debitorë të Njesisë administrative **Suke**, paraqitet **5 subjekte** fizike për vlerën **38,700 lekë**, konkretisht sipas tabelës analitike:

NR	EMER MBIEMER	AKTIVITETI	DEBITOR 2023
1	L.B		7820
2	N.D	BAR- KAFE	5620
3	T.K	AKTEVITET#	6620
4	P.S	BAR- KAFE	9320
5	F.S		9320
	<b>TOTALI</b>		<b>38,700</b>

- e. Pasqyra e debitorëve taksave, tarifave vendore vitit 2023 Njësia administrative **Ballaban**, paraqitet **11 subjekte** fizike për vlerën **96,492 lekë**, sipas tabelës bashkëngjitur në Aneks.

Nga auditimi u konstatua se:

- 26 punonjës te Bashkisë Këlcyrë dhe 3 njësive administrative si dhe Ujësjellësit ne varësi bashkisë nuk kane likuiduar detyrimet e taksave familjare dhe biznesit te familjeve tyre, për vlerën 933,656 lekë, ku ka qene i mundur arkëtimi nga pagat e tyre, konkretisht sipas punonjësve, sa vijon tabela:

Nr.	Emir mbiemri	Detyrimi I taksave vendore e tarifave deri me 31.12.2023. ne lekë
1	A.Z	71,405
2	M.K	261,571
3	A.H	115,895
4	M.P	149,926
5	Q.H	71,141
6	D.D	47,920
7	E.K	7,380
	<b>biznesi</b>	<b>739,020</b>
8	T.K	5,561
9	E.SH	10,929
10	R.C	15,339
11	B.B	14,149
12	A.S	5,975
13	E.XH	7,760
14	L.P	9,723
15	B.H	1,518
16	F.M	17,806
17	M.P	7,394
18	M.M	10,097
19	B.B	16,926
20	E.RR	4,994
21	E.Z	1,075
22	DH.A	14,499
23	E.B	11,975
24	E.M	14,697
25	A.M	8,174
26	H.B	16,065
	<b>Familjare</b>	<b>194,636</b>
	<b>TOTALI</b>	<b>933,656</b>

**Përmbledhtazi sa më sipër**, lidhur me taksat dhe tarifat vendore, rezulton se:

- **Mos arkëtimi i detyrimeve tatimore** bie ndesh me nenin, 17, 34 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar me ligjin 122/2020, me nenet 90, 91, 93, 111, 113 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në RSH” dhe pikat 3 dhe 5 të udhëzimit përbashkët të MF dhe MPVD nr. 5, datë 27.01.2003; pikat 10 të UMF nr. 655/1 datë 06.02.2007 “Përpërcaktimin uniformitetit të Standardeve procedurale dhe raportimit sistemit taksës vendore”, pasi nuk janë



mbyllur bizneset kur nuk kanë paguar detyrimet në afat, nuk është vendosur barra siguruese, apo masa e sekuestros etj.

- **Mos aplikimi me dënim me gjobë për pagesat e vonuara** në masën 25%, në kundërshtim me nenin 114, të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat Tatimore në RSH", ku thuhet: *mospagimi i taksës brenda afatit të caktuar dënohet me gjobë nga 5% në muaj, por jo më shumë se 25 % të detyrimit për taksën.*
- **Mos aplikimi i masave shtrënguese për arkëtimin e debitorëve**, në kundërshtim me Kreun XI-Mbledhja me forcë detyrimit tatimor papaguar, të ligjit 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", ndryshimet dhe Udhëzimit 24 datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", me ndryshime; ligjin nr. 7895 datë 27.01.1995, "Kodi Penal i RSH", ndryshuar, neni nenet 15 dhe 181 -*Mospagimi i taksave dhe tatimeve<sup>1</sup>*, apo të parashikimit vendimeve gjobave, përcaktuar në nenin 46 ligjit "Për Kundërvajtjet Administrative".
- **Subjektet te pa licencuara paraqiten 10 subjekte fizike** për vitin 2023 te cilat janë identifikuar nga sektori i taksave vendore. Nga auditimi rezultoi se pavarësisht mungesës NIPTIT disa prej tyre janë mbledhur dhe disa janë verifikuar, konkretisht:
  1. Për 4 subjekte pa NIPT janë mbledhur taksat vendore për vlerën gjithsejtë 37,240 lekë, përkatësisht: XH.D 11,120 lekë, G.R 11,120 lekë, M.K 8,000 lekë, A.D 7,000 lekë.
  2. Për 3 subjekte nuk ka pagese te taksave vendore, përkatësisht: ZH.Z, F.M , A.C ,
  3. Për 3 subjekte e kane mbyllur aktivitetin, përkatësisht: XH.M, D.P, L.Z, sipas akt konstatimeve te sektorit taksave vendore.
  4. Sa sipër, pa mohuar punën e bërë, për problemet e trajtuara për taksat vendore, veprimet e mësipërme bien ndesh me kërkesat e ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006, ndryshuar me ligjin nr. 9745, datë 28.05.2007 "Për sistemin e taksave vendore", udhëzimin e Ministrisë Financave dhe Ministrisë Brendshme nr. 655/1, datë 06.02.2007, si dhe nuk janë zbatuar procedurat e nevojshme ligjore të përcaktuar në ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 10415, datë 07.04.2011", ngarkojnë me përgjegjësi: L.J përgjegjëse e taksave vendore, M.C dhe I.K specialiste taksave vendore, S.S, Y.I dhe A.Q agjent tatimor ne 3 njësite administrative. Përgjegjësi për vjeljen në kohë dhe administrimin e të ardhurave ka edhe kryetari i bashkise Këlcyrë z. K.N.

*Titulli gjetjes:* Puna e pamjaftueshme e agjentëve tatimorë në arkëtimin e detyrimeve taksave vendore dhe neglizhenca e strukturave të Bashkisë Këlcyrë në menaxhimin e situatës.

Sektori i taksave dhe tarifave vendore te bashkisë Këlcyrë është mjaftuar me njoftime ne adrese te subjekteve për vlerësimin tatimor për debitorët privat dhe familjar dhe në vijim nuk ka ndjekur të gjitha rrugët ligjore për:

- Për arkëtimin e detyrimeve prej 8,244,881 leke, nga debitorët e privat dhe familjar, te cilët nuk kane likuiduar taksat e tarifave vendore (2,224,330 leke debitor biznesi madh dhe i vogël, 1,396,184 leke debitor familjet bashkisë Këlcyrë dhe 3 njësite administrative dhe 4,624,367 leke debitor tokës bujqësore).

- Per arkëtimin e vlerës debitorë prej 933,656 leke ndaj 26 punonjësve bashkisë Këlcyrë, 3 njësive administrative, Ujësllësit, për detyrimet e taksave familjare dhe biznesit të familjeve tyre, me mundësi arkëtimi të tyre, sipas tabelës në projekt raport.

- Për arkëtimin e detyrimeve për vlerën 10,200,000 leke nga 4 subjektet debitor, për taksën e lëshimit të licencave për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, konkretisht: D shpk 1,800,000 leke, "E" shpk 4,400,000 leke, A 700,000 leke dhe D&P." 3,300,000 leke.

- Për mos regjistrimin e 10 subjekteve fizike të pa licencuara,

- Për mos aplikimin e gjobave në 5 raste, për tejkalim të afatit ligjor në pagesën e qirasë tokës bujqësore dhe taksave tjera.

Operuar në kundërshtim me Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar me ligjin 122/2020, ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat Tatimore në RSH", Udhëzimi përbashkët MF dhe MPVD nr. 5, datë 27.01.2003, UMF nr. 655/1 datë 06.02.2007 "Përpërcaktimin uniformitetit të Standardeve procedurale dhe raportimit sistemit taksës vendore",

### **Auditim mbi shqyrtimin edhe miratimin e kërkesave për dhënien me qira të aseteve të Bashkisë apo Njesisë Administrative. Lidhja e kontratave. Arkëtimi i të ardhurave nga qiraja dhe përdorimi i tyre.**

#### *a. Qira për Antenat.*

Bashkia Këlcyrë ka dhënë me qira në 2 raste, pasuri nga fondi pyjor e kullësor, për përdorim vendosjen e antenave celulare e telefonike. Për këtë bashkia ka lidhur kontratat përkatëse, duke përcaktuar tarifën e pagesës, të cilat janë arkëtuar në mënyrë të rregullt, konkretisht:

- Kontrata datë 27.06.2018 lidhur për 8 vjet me shoqërinë private të V.Albania sh.a , për qira fondit pyjor-kullësor për 0,05 ha x 10,000,000= 500,000 lekë tarifa 1 vjeçare, për vendosjen e antenës telefonike, rezulton se: për vitin 2023 është arkëtuar detyrimi kontraktor prej 500,000 lekë, sipas MA R datë 12.12.2023.

- Kontrata datë 26.08.2021 me afat 9 vjet me shoqërinë private të O sh.a , për qira të fondit pyjor e kullësor prej 0,0079 ha x 10,000,000= 79,000 lekë + 10,850 lekë për rrugëkalim gjithsej 89,850 lekë tarifa 1 vjeçare, për vendosjen e antenës celulare, rezulton se për periudhën 01.01.2023 deri 31.12.2023 është arkëtuar detyrimi prej 89,850 lekë sipas MA datë 30.11.2023. Lidhja e kontratave, përcaktimi i tarifave dhe pagesat e tyre janë në përputhje:

- me kërkesat e VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", i ndryshuar, lidhja 2, pika 7, ku thuhet:

"Për vendosje antene telefonike fikse lëvizshme, televizive, radio-komunikimit.... Tarifa sipas kohëzgjatjes kontratës 6-10 vjet për zërin "Pyll trungishte", është 10,000,000 lek/ha/vit....".

- me VKM 1064 datë 22.12.2010 "Për përcaktimin tarifave në sektorin pyjor dhe kullotave", ndryshuar me VKM 1156 datë 24.12.2020 "Për përcaktimin ardhurave gjeneruara nga tarifën që paguhen zonat mbrojtura të masës dhe kritereve përdorimit të tyre" etj.

- me VKM 1353 datë 10.10.2008, i ndryshuar "Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, dhe të kritereve procedurave të zvogëlimit të vëllimit të fondit pyjor", i ndryshuar.

- me Ligjin nr. 9385 datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin Pyjor" .

*b. Qira e tokës bujqësore,*

Disponohet VKB nr. 01 datë 29.12.2022 “ Për dhënien me qira të tokave bujqësore”, por në dhënien e tyre nuk është zbatuar certifikimi i tyre pranë ASHK Përmet, pra fillimit të procedurës konkursit tyre. Në lidhje me dhënien me qira të tokave bujqësore të pa ndara, sipas informacionit dhe evidencave të paraqitura nga specialisti i kadastrës së Bashkisë rezultoi se për periudhën 2017-2023 janë zhvilluar procedura të dhënies me qira të tokave bujqësore të pa ndara, pasi ka pasur kërkesa dhe interesim nga fermerë të bashkisë dhe jashtë saj. Dhënia me qira e tokave bujqësore të pandara është bere, sipas kërkesave të VKM nr. 531, datë 21.8.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, nenet 1 dhe 2, të ligjit nr. 8312 datë 26.3.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, dhe UKM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, pika 2, thuhet:

*“Zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës (ZMMT), në komunë ose bashki, evidenton sipërfaqet tokës bujqësore për dhënie me qira, objekt të pikës 1 këtij kreu, duke pasqyruar numrin kadastral ngastrave, madhësinë në hektarë, si dhe vendndodhjen e tyre”.*

Pasqyra mbi ndarjen e tokës dhe ndjekja e debitorëve të tokës.

Nr	Njesia Administrative	Toke bujq. gjithsej	Nr. Fam. Qe kanmar AMTP	Sipërfaqja e tokësndar në faket Ligji 7501	Sipërfaqja e tokës se pandar
		Ha ne 1991			
1	Bashkia Këlcyrë	808	433	495	313
2	Nj.AD.Suke	2166	1016	1497	669
3	Nj.AD .Ballaban	2284	1296	1484	800
4	Nj.AD .Deshnice	2399	1009	1748	655
Shuma		7,657	3,754	5,224	2,437
Çmimi sipas VKB					

Ne përgjithësi ka rregullsi në pagesat e qirave tokës bujqësore, dhe për ndonjë rast mos pagese është sistemuar duke u paguar për 2 vitet bashke, sipas mandat arkëtimeve, bashkëlidhur dhe tabelave sipas viteve, konkretisht:

*Lista e qirave tokës bujqësore për 2023 dhe 2017–2022, , paraqitet sipas tabelave sa vijon:*

**Viti 2023:** Qira toke në përdorim e papaguar sipas kushteve të kontratave për vitin 2023, paraqitet 1 rast për diferencën 350 lekë Ferdinant Kafeja, pasi ka likuiduar 4,200 lekë nga 4,550 lekë që duhej në baze të kontratës 30.03.2023, sipas tabelës mëposhtme:

Nr	NjesAd	Subjek qeramarr	ZK	Sip/h a	Kontrat lidhur	Lloji Kultu bujq	Vlera qeras vjetor lek/ha	Vlera per likuid sipas kontr	Likuiduar		Shuma e likuidur (Leke)
					Datë				Me MA		
									Nr	Datë	
1	Suk	F.K.	3007	0.6	30.3.23	Ul-Ar	7,000	4,550	374	3.4.23	4,200
2	Ball	E. I.	3607	1.9	29.3.23	Ullish	6,000	11,220	514	28.8.23	11.200
3	Kelc	K. D.	2652	0.5	23.3.23	Pemt	6000	3000	531	8.9.23	3000

**Viti 2022:** Qira toke ne përdorim e paguar sipas kushteve te kontratave për vitin 2022, paraqitet 3 raste për vlerën 32,400 lekë, përkatësisht: A.S 2,400 lekë, E.M 21,900 lekë, E.SH 3,000 lekë dhe A.C 3,000 lekë, sipas tabelës mëposhtme:

Nr	Njesia Admin	Subjekt qeramarres	ZK	Sip/ha	Nr. kadaspa rcel	Kontrata e lidhur	Lloji i Kulture bujqeso	Afat vite i kont	Vlera qeras vjetor lekë/ha	Vlera e likuiduar sipas kontr
1	Deshn	A.S	3179	0.4	375/A	25.7.22	Ullinj	99	6,000	2,400
2	Ballaba	E.M	2554	3.65	26/A	24.7.22	Ullinj	99	6,000	21,900
3	Kelcyr	E.SH	2131	0.5	63/A	22.12.22	Arrore	99	6,000	3,000
4	Deshn	A.C	1152	0.9	A	29.12.22	Arrore, Ull	99	6,000	5,100
	Shuma									32,400

**Viti 2021:** Qira toke ne përdorim e paguar sipas kushteve te kontratave për vitin 2021, paraqitet 5 raste për vlerën 104,860 lekë, përkatësisht: A.A 3,600 lekë, M.I 3,450 lekë, K.N 52,210 lekë, M.Z 24,000 lekë dhe R.H 21,600 lekë, sipas tabelës mëposhtme:

	Njesia Adminis	Subjekti qeramarres	ZK	Sip/ha	Nr. kadastral i parcele	Kontrata e lidhur	Lloji Kulture bujqesore	Afati ne vite kontr at	Vlera e qerases vjetore ne lekë/ha	Vlera likuiduar sipas kontrate
						Datë				
1	Ballab	A.A	3782	0.6	40/a	19.4.21	Vresht	35	6,000	3,600
2	Kelcyr	M.I	2131	0.6	165	24.5.21	Ullinj	99	6,000	3,450
2	Deshni	K.N	3179	8.7	86, 813	02.7.21	Arrore	99	6,000	52,210
4	Ballab	M.Z	2554	4	26/1,2,	07.7.21	Arrore, Ullij	99	6,000	24,000
5	Deshni	R.H	2873	3.6	330/A	20.7.21	Arrore, Ullij	99	6,000	21,600
	Shuma									104,860

**Viti 2020:** Qira toke ne përdorim e paguar sipas kushteve te kontratave për vitin 2020, paraqitet 2 raste për vlerën 3,900 lekë, përkatësisht: G.B 1,440 lekë dhe B.M 2,460 lekë, sipas tabelës mëposhtme:

Nr	Njesia Admin	Subjekti qeramarre	Z K	Sip/ha	Nr. kadas parcel	Kontrata e lidhur	Lloji i Kulture bujqeso	Afati te kontr at	Vlera e qerases vjetore ne lekë/ha	Vlera likuidua sipas kontrate
						Datë				
1	Kelcyr	G.B	2131	0.2	166	10.11.20	Arrore	99	6,000	1,440
2	Deshn	B.M	2126	0.4	418	16.11.20	Arrore	99	6,000	2,460
3	Shuma									3,900

**Viti 2019:** Qira toke ne përdorim e paguar sipas kushteve te kontratave për vitin 2019, paraqitet 6 raste për vlerën 34,870 lekë, përkatësisht: E.B 2,220 lekë, E.S 2,700 lekë, E.SH 3,600 lekë, F.S 4,680 lekë, A.C 3,670 lekë, F.A 18,000 lekë, sipas tabelës mëposhtme:

Nr	Njesi Admi	Subjekti qeramarres	Sip/ha	Nr. kadastral parcele	Kontrat lidhur	Lloji i Kulture bujqesore	Afati	Vlera qerases vjetore lekë/ha	Vlera likuiduar sipas kontrates
					Datë				
1	Balla	E.B	0.4	451	18.1.19	Molle, Kumb	35	6,000	2,220
2	Kelcy	E.S	0.5	276/2	12.2.19	Ullinj, Lajthi	99	6,000	2,700
3	Kelcy	E.SH	0.6	167	15.4.19	Ullinj	99	6,000	3,600
4	Balla	F.S	0.8	53/1,	16.5.19	Arre, Ullinj	99	6,000	4,680
5	Desh	A.C	0.6	31/5	14.8.19	Arre, Lajthi	99	6,000	3,670

6	Balla	F.A	3	353/A,	04.9.19	Molle, Arre	35	6,000	18,000
	Shuma								34,870

**Viti 2018:** Qira toke ne përdorim e paguar sipas kushteve te kontratave për vitin 2018, paraqitet 1 rast për vlerën 9,000 lekë P.K, sipas tabelës mëposhtme:

Nr	Njesia Admini	Subjekti qeramarr	ZK	Sip/ha	Nr. Kadaster parcel	Kontrata e lidhur	Lloji i Kultures bujqes or	Afat vite kont	Vlera qerese vjetore ne lekë/ha	Vlera per likuidim sipas kontrates
						Datë				
1	Ballaba	P.K	2211	1.5	170/1	06.11.18	Arrior	99	6,000	9,000
2	Shuma									9,000

**Viti 2017:** Qira toke ne përdorim e paguar sipas kushteve te kontratave për vitin 2017, paraqitet 4 raste për vlerën 25,350 lekë, përkatësisht: A.B 6,300 lekë, G.L 7,050 lekë, T.A 6,000 lekë, A.K 6,000 lekë, sipas tabelës mëposhtme:

Nr	Njesei Adm	Subjekti qeramarr	ZK	Sip/ha	Kontrata e lidhur	Lloji i Kultures bujqes or	Afati ne vite i kontrate	Vlera qeras vjetor lekë/ha	Vlera likuiduar sipas kontrat
1	Kelc	A.B	2131	1.1	27.7.17	Arrore	99	6,000	6,300
2	Kelc	G.L	2131	1.2	14.8.17	Arrore	99	6,000	7,050
3	Balla	T.A	3782	1	21.8.17	Vresht	35	6,000	6,000
4	Balla	A.K	3782	1	18.12.17	Arrore	99	6,000	6,000
		Shuma							25,350

Sa sipër, lidhur me qiratë e tokës bujqësore, rezulton se:

U konstatuan **5 raste, tejkalim te afatit ligjor ne pagesën e qirasë tokës bujqësore**, për te cilat **nuk janë aplikuar gjoba**, ne kundërshtim me kërkesat e nenit 2/a, e nenit 6 “sanksione” te kontratave përkatëse, konkretisht:

- 1) R.H ka likuiduar me 1 vit vonese qiranë e tokës ne përdorim te vitit 2022, sipas mandat arkëtimit nr. 31 datë 09.02.2024 për vlerën 43,200 lekë ( 2022=21,600 +2023=21,600), dhe ndaj tij nuk është aplikuar gjobe. Veprime ne kundërshtim me kërkesat e nenit 2/a, e nenit 6 “sanksione” te kontratës datë 20.07.2021.
- 2) A.A ka likuiduar me 1 vit vonese qiranë e tokës ne përdorim te vitit 2022, sipas mandat arkëtimit nr. 23 datë 02.02.2024 për vlerën 10,800 lekë ( 2022=3,600 +2023=3,600+2024=3,600) dhe ndaj tij nuk është aplikuar gjobe. Veprime ne kundërshtim me kërkesat e nenit 2/a, e nenit 6 “sanksione” te kontratës datë 20.07.2021.
- 3) F.A ka likuiduar me 2 vite vonese qiranë e tokës ne përdorim te vitit 2021 dhe 2022, sipas mandat arkëtimit nr. 27 datë 05.02.2024 për vlerën 54,000 lekë (18,000 x 3 vite 2021+ 2022+2023=54,000 ) dhe ndaj tij nuk është aplikuar gjobe. Veprime ne kundërshtim me kërkesat e nenit 2/a, e nenit 6 “sanksione” te kontratës datë 31.04.2019.
- 4) T.A ka likuiduar me 3 vite me vonese qiranë e tokës ne përdorim te vitit 2018-2019 dhe 2020, sipas mandat arkëtimit nr. 25 datë 02.02.2024 për vlerën 18,000 lekë (6,000 x 3 vite 2018+2019+2020=18,000) dhe nuk është aplikuar gjobe. Veprime ne kundërshtim me kërkesat e nenit 2/a, e nenit 6 “sanksione” te kontratës datë 21.08.2017.
- 5) G.B nuk ka likuiduar vlerën 2,880 lekë si ka likuiduar me 2 vite me vonese qiranë e tokës ne përdorim te vitit 2021 dhe 2022, sipas mandat arkëtimit nr. 393 datë

23.05.2023. Nuk janë aplikuar gjoba për vonesën 2 vjet. Veprime ne kundërshtim me kërkesat e nenit 2/a, e nenit 6 “sanksione” te kontratës datë 10.11.2020.

Sa sipër, Për mos aplikim gjobash për tejkalim afatesh pagesash te qirave tokave bujqësore 2023-2024 mban përgjegjësi **O.H** , specialist kadastre dhe emergjenca civile.

*c. Qira te fondit kullosor e pyjor.*

Nga auditimi i procedurave dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Këlcyrë, në lidhje me kontratat e qirave për pyje dhe kullota, rezulton se: nga Bashkia Këlcyrë për periudhën **para vitit 2023**, ka lidhur **30 kontrata** për vlerën prej 325,500 lekë, të cilat janë likuiduar totalisht sipas pasqyrës mëposhtme:

Nr.	Emir mbiemri	Ekonomia pyre/kullosore	Nr.ngasres	Sip. Shfrytz ha	Nr. Kreteve Lloji; tarifa/krer	Tarif.nde rt. provizor	Pagesa sipas mand.arket.
1	B.K	Deshnice	120/a;120/b;122a	65	100 dhi x 100	3000	13,000
2	D.R	Lesk.-pacomit	Bregu dhespes	3	30 dhen x100		3,000
3	A.L	Lesk-pacomit	10 (kushove)	15	150 dhen		15,000
4	S.R	Lesko-Pacomit	29	1.3	3 gjedh x1000		3,000
5	V.T	Deshnice	113	44	250 dhi		25,000
6	G.P	Bubes leskov	59	55	150 dhi x80		12,000
6	G.P	Deshnice L-P	58;124/a	45	100 x1000	3500	13,500
7	G.P	Deshnice	119/a;60	60	140 dhi		14,000
8	N.C	Deshnice	74/a,b, 29	43	150 dhi		12,000
9	B.SH	Trebeshine	24	40	250 dhi x 80		20,000
10	SH.S	Trebeshine	16	25	200 dhen x100		20,000
11	ZH.Z	Trebeshine	35;34/a,b	68	220 dhi x100		22,000
12	A.C	Deshnice	72;73	30	100 dhi		10,000
13	H.G	Deshnice	101/102	43	190 dhi		19,000
14	L.M	Deshnice	42	26	70 dhi		7,000
15	A.V	Trebeshine	20	60	300 dhen		30,000
16	B.K	Trebeshine	7	24.6	150 dhen		15,000
17	Y.S	Trebeshine	10	11.5	100 dhen		10,000
18	A.K	Leskovec-pac.	141	10	10 gjedh		10,000
19	V.RR	Lesko-Pacomit	Musha fshati	10	50 dhen		5,000
20	S.R	Lesk-pacomit	29	1	2 gjedh		2,000
21	A.F	Lesko-pacomit	7;52	35.7	120 dhen		12,000
22	XH.H	Leskovec pac.	39	1	2 gjedh		2,000
23	A.D	Lesko-pacomit	55/56	52	100 dhi		10,000
24	K.M	Lesko -Pac	8/37	13+5	60 dhen		4,000
25	Z.C	Lesk -Pacomit	8/49	15+20	80 dhen		5,000
26	I.H	Leskovec-Pac.	50	3	2 gjedh x 800	1000	2,600
27	I.H	Lesko-pacom	49	2.9	4 dhi	1000	1,400
28	H.B	Lesko-Pacomit	7/9 musha	18	20 dhen		2,000
29	SH.SH	Lesko-Pacomit	50	3	20 dhen 2gjedh		4,000
30	A.K	Lesk-Pacomit	29	1	20 dhen		2,000
						8,500	325,500

Nga auditimi i procedurave dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Këlcyrë, në lidhje me kontratat e qirave për pyje dhe kullota, rezulton se: nga Bashkia **Këlcyrë për**

**periudhën e vitit 2023, ka lidhur 18 kontrata** për vlerën prej 190,100 lekë, të cilat janë likuiduar totalisht brenda vitit 2023, sipas pasqyrës mëposhtme:

Nr.	Emir mbiemri	Nr. Kreveve	MA	Pagesa sipas mandatë arketimit
1	E.SH	50	345 datë 02.2.2023	5,000
2	M.L	50	346 datë 02.2.2023	5,000
3	S.SH	60	347 datë 06.2.2023	6,000
4	A.L	150	349 datë 09.2.2023	15,000
5	D.R	30	370 datë 28.3.2023	3,000
6	S.R	2	373 datë 03.4.2023	2,000
7	G.P	250	387 datë 11.5.2023	25,500
8	G.P	150	391 datë 22.5.2023	15,500
9	B.SH	200	397 datë 30.5.2023	20,000
10	SH.S	150	398 datë 30.5.2023	15,000
11	B.K	150	461 datë 14.7.2023	15,000
12	G.M	50	444 datë 26.6.2023	4,000
13	S.Z	160	581 datë 9.10.2023	16,000
14	Y.S	100	579 datë 09.5.2023	10,000
15	E.G	150	560 datë 27.9.2023	15,000
16	H.G	150	553 datë 25.9.2023	12,000
17	S.C	30	629 datë 6.11.2023	3,000
18	Y.H	3	17 datë 09.11.2023	3,600
	shuma			190,100

Për vitin 2023 pagesa e qirasë të sipërfaqeve të fondit pyjor e kulloror dhënë ne përdorim subjekteve private është ne përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr. 01, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kulloror publik" i ndryshuar, ku citohet:

*“Pagesa e qirasë është vjetore, duke u llogaritur nga data e lidhjes së kontratës dhe shlyhet në momentin e lidhjes së kontratës dhe në të njëjtën datë në vitin pasardhës”.*

Nga auditimi i dokumentacionit qirasë të sipërfaqeve të fondit pyjor e kulloror dhënë ne përdorim subjekteve private, rezulton:

Në kontratat nuk është bërë përcaktimi se kujt akti i janë referuar për ndarjen e kullotave sipas vendimit të komisionit të ndarjes së kullotave apo vendimit të këshillit të komunës.

Në kontratë është përcaktuar se ato i referohen hartës bashkëlidhur çdo kontrate. Lidhja e tyre është bërë në mungesë të vërtetimit të numrit bagëtime qe lëshohet nga Drejtoria Rajonale Shërbimeve Veterinare, dhe konfirmon regjistrin bagëtime dhe matrikullit të tyre sipas sistemit “Ruda”, duke mos bërë krahasimin e llojit dhe numrit të krerëve sipas kontratës me regjistrin e DRSHV, për secilin vit.

Lidhur me **pyjet e kullotat**, ndonëse kanë kaluar në pronësi, **nuk janë pasqyruar në kontabilitet, llogaria nr. 211 “pyjet, kullotat dhe plantacione”**, pasi aktivi i bilancit nuk paraqet fare gjendjen e kësaj llogarie. **Nuk është kryer procedura e aplikimit të regjistrimit të parcelave** në ish-ZVRPP Gjirokastër, sot ASHK Drejtoria Gjirokastër.

Për kontratat e dhënies me qira të fondit pyjor e kulloror janë dosjet individuale, ku pasqyrohen të dhënat mbi fermerin, llojin e bagëtime që mbarështon, numrin e tyre, si dhe vërtetimin nxjerrë nga sistemi RUDA, si dhe parcela kullorore e dhënë në përdorim, sipas skicës së miratuar dhe

pjesëza e hartës. Sektori i pyjeve dhe kullotave si dhe ndjekja e zbatimit të kontratave qirave mbulohet nga **Q.P** me detyre teknik pyjesh.

*Titulli gjetjes:* Mos pasqyrim në kontabilitet, llogaria nr. 211 “pyjet, kullotat dhe plantacione” dhe mos pajisje me certifikate pronësi pranë ASHK Përmet, për vitin 2023.

Sektori i kadastrës bashkisë paraqet neglizhence në drejtim të aplikimit dhe mos regjistrimit të pyjeve e kullotave pranë ASHK Drejtoria Gjirokastrë, nuk janë pasqyruar në kontabilitet, llogaria nr. 211 “pyjet, kullotat dhe plantacione”, pasi aktivi i bilancit nuk paraqet fare gjendjen e kësaj llogarie.

Operuar në kundërshtim me ligjin 20/20 “Per Kadastrën”, ligji 9228 datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin” ndryshuar me ligjin 24/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Udhëzimi 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në shtetë sektorit publik”,

**Pika 3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.**

**3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.**

***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare:***

Për vitin 2023 nga njësi shpenzuese “Aparati i Bashkisë Këlcyrë” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Përmet si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestimi.

***Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.*** Për vitin 2023 janë hartuar pasqyrat financiare për njësinë shpenzuese bashkia Këlcyrë dhe 3 njesite administrative Dishnice, Suke dhe Ballaban. Nuk ka pasqyra financiare të konsoliduara.

***Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare.*** Është zbatuar afati ligjor për mbylljen dhe dorëzimin e bilancit 2023 të bashkisë Këlcyrë, pasi është brenda afatit ligjor 30 mars 2024. Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Përmet për vitin ushtrimor 2023 me shkresën përcjellëse nr. 349 datë 21.02.2024. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari i Bashkisë Këlcyrë z. K.N dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Përgjegjësia Financë Buxhetit V.K .

***Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.***

Për vitin 2023, nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari në total, mujore dhe vjetore rezultoi se nuk ka diferenca. Ditari i bankës është mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.



***Rakordimi i llogarive aktiv pasivit me pasqyrat financiare (anekset) ose formatet përkatëse.***

- Rezultati i veprimtarisë ushtrimore 2023 pasqyrohet në bilanc për vlerën 1,243,763 lekë ose Aktivi i Bilancit, i evidentuar në “pasqyrën e pozicionit financiar” ,formati 1.
- Totali Pasivit Bilancit 1,243,763 lekë rakordon me totalin e aktivit bilancit 1,243,763 lekë.
- Te ardhurat nga taksat e tatimet dhe jo tatimore janë pasqyruar në formatin 2 “pasqyra e performances financiare” për vlerën 16,628,308 lekë dhe rakordon me vlerën e evidencës te ardhurave vendore te rakorduar me thesarin për vlerën 16,628, 308 lekë.
- Format 2 ose “pasqyra e performances financiare” në përmbajtjen e saj ka saktësi, pasi totali i shpenzimeve të pasqyruara për 217,984 mijë lekë duke zbritur ardhurat prej 257,510 mijë lekë kuadron me tepricën/deficitin prej 39,526 mijë lekë llogaria 85 (rezultati i veprimtarisë të vitit ushtrimor 2023).
- Teprica e “likuiditeteve në fund të vitit ushtrimore 2023” për vlerën 59,233,218 lekë evidentuar në “pasqyrën e flukseve monetare” (formati 3) rakordon me llogarinë 520 (formati 1) me “pasqyrën e pozicionit financiar”.
- Fondi i konsoliduar 1,168,164,987 lekë i evidentuar tek formati 1 “pasqyra e pozicionit financiar” pika (D) rakordon me vlerën gjithsej të fondeve tek “pasqyra e ndryshimeve të fondeve” 2023 (formati 4).
- Fondi i pagave i pasqyruar në formatin 2, pika B “shpenzimet”, llogaria 600 paraqitet për vlerën 97,903,790 lekë, e cila rakordon me formatin 8 “numri punonjësve dhe fondi pagave”.
- Aktivitet afatgjatë materiale për 1,088,929,093 lekë në formatin 1 “pasqyra e pozicionit financiar” kuadron me formatin 7/b “Gjendja e ndryshimeve të aktiveve afatgjatë”.
- Aktivitet afatgjatë jo materiale për 77,458 lekë në formatin 1 “pasqyra e pozicionit financiar” kuadron me formatin 7/b “Gjendja e ndryshimeve të aktiveve afatgjatë”.

***Mënyra mbajtjes kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues dhe sigurimi informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore. Kështu u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

*Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara për vlefshmërinë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);*

*Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve të kryera dhe e mbartësve të tyre;*

*Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.*

U vlerësua nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- Shqyrtimit vlefshmërisë regjistrimit fillestar duke krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë.***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se: Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues. Kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel”. Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin. Azhurnimet e veprimeve ekonomike në partitarët analitik janë kryer në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditaret e bankës, të arkës, magazinës, pagave, të ndryshme etj. Është mbajtur libri i madh apo centralizator duke kaluar veprimet e llogarive nga ditaret perkates në center, duke nxjerre saldot debitore dhe kreditore të kuadruara, mbi bazën e të cilave është hartuar bilanci kontabel 2023. Kalimet e llogarive nga ditaret në center dhe në bilanc janë pa gabime dhe të kuadruara debia me kredine. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit regjistruar në mënyrë kronologjike e sistematike të efekteve veprimeve kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese. Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet. Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues në përgjithësi është bërë i plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhenat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arketimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj. Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të drejtave konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet njësisë ekonomike.

### **3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2023 deri më datën 31.12.2023. Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës. Janë mbartur saktë tepricat e llogarive 2022 në celjen vitit pasardhës për bilancin vitin 2023 dhe rakordojnë. Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e Pasqyrave Financiare.

Llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit të bilancit 2023 bashkia Këlcyrë, sipas pasqyrës:

Referenca e	E M E R T I M I	Ushtrimi	Ushtrimi
Logarive		I	Paraardhes
A	A K T I V E T	Mbyllur	
	I.Aktivët Afat shkurtra	1,243,763,136	1,117,849,045
	I.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	154,834,043	101,403,848
		59,233,218	25,153,484
531	Mjete monetare ne Arke		
512,56	Mjete monetare ne Banke		

*lekë*

520	Disponibilitete ne Thesar	59,233,218	25,153,484
50	Letra me vlere		
532	Vlera te tjera		
54	Akreditiva dhe paradhenie		
59	Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-)		
	<b>2.Gjendje Inventari qarkullues</b>	<b>10,475,141</b>	<b>10,475,141</b>
31	Materiale	0	0
32	Inventar I imet	10,475,141	10,475,141
33	Prodhim nre proces		
34	Produkte		
35	Mallra		
36	Kafshe ne rritje e majmeri		
37	Gjendje te pa mbitura,ose prane te treteve		
38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
39	Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-)		
	<b>3.Llogari te Arketushme</b>	<b>85,125,684</b>	<b>65,775,223</b>
411	Kliente e llogari te ngjashme	41,584,329	28,453,410
423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba		
431	Tatim e Taksa		
432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohe nga shteti		
435	Sigurime Shoqerore		
436	Sigurime Shendetore		
437,438,	Organizma te tjere shteterore		
44	Institucione te tjera publike		
465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
468	Debitorre te ndryshem	29,234,563	28,796,938
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	14,306,792	8,524,875
45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
49	Shuma te parashikuara per xhvlersim(-)		
	<b>4.Te tjera aktive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
409	Parapagime		
473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
477	Diferenca konvertimi aktive		
481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		
486	Shpenzime te periudhave te ardhshme		
	<b>II.Aktivet Afat gjata</b>	<b>1,088,929,093</b>	<b>1,016,445,197</b>
<b>20</b>	<b>1.Aktive Afatgjata jo materiale</b>	<b>77,458</b>	<b>100,204</b>
201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
202	Studime dhe kerkime	77,458	100,204
203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
<b>21</b>	<b>2.Aktive Afatgjata materiale</b>	<b>1,088,851,635</b>	<b>1,016,344,993</b>
210	Toka, Troje, Terene		
211	Pyje, Plantacione		
212	Ndertesat e Konstruksione	380,592,360	365,492,210
213	Rruge, rrjete, vepra ujqore	688,676,909	627,911,271
214	Instalime teknike, makineri e paisje	996,237	1,230,679
215	Mjete Transporti	12,103,688	14,041,401
216	Rezerva Shteterore		
217	Kafshe pune e prodhimi		
218	Inventar ekonomik	6,482,441	7,669,432
24	Aktive afatgjata te demtuara		
28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
25-26	<b>3.Aktive Afatgjata Financiare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
	<b>4.Investime</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
231	Per Aktive Afatgjata materiale	0	0
<b>B</b>	<b>PASIVET(DETYRIMET)</b>	<b>75,598,149</b>	<b>47,323,679</b>
	<b>I.Pasivet Afat shkurtra</b>	<b>75,598,149</b>	<b>47,323,679</b>
	<b>1. Llogari te Pagushme</b>	<b>75,598,149</b>	<b>47,323,679</b>
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	41,584,329	28,453,410
42	Detyrime ndaj personelit	6,842,466	6,153,280
16,17,18	Hua Afat shkurtra		
460	Huadhenes		
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	180,761	201,001
432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
435	Sigurime Shoqerore	2,475,419	2,170,594
436	Sigurime Shendetore	0	0

437,438,	Organizma te tjere shtetore		
44	Institucione te tjera publike		
45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	19,707,028	10,345,394
467	Kreditore te ndryshem	4,808,146	0
4341	Operacione me shtetin( detyrime		
49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
	<b>2.Te tjera pasive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
419	Kreditore, Parapagime		
475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
478	Diferenca konvertimi pasive		
480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit		
	<b>II.Pasivet Afat Gjata</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
Klase 4	Llogari te pagushme		
16.17.18	Huate Afat gjata		
	Provizjonet afatgjata		
Klase 4	Te tjera		
<b>C</b>	<b>AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)</b>	<b>1,168,164,987</b>	<b>1,070,525,366</b>
<b>D</b>	<b>FONDI I KONSOLIDUAR :</b>	<b>1,168,164,987</b>	<b>1,070,525,366</b>
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	1,128,638,797	1,055,717,276
12	Rezultatet e mbartura	0	0
85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	39,526,190	14,808,090
111	Rezerva	0	0
115	Nga Fondet e veta te investimeve	0	0
15	Shuma te parashikuara per rrezique e Zhvleresime	0	0
105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme	0	0
106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja	0	0
107	Vlera e mjeeteve te caktuara ne perdorim	0	0
109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata	0	0
	Te Tjera	0	0
<b>E</b>	<b>TOTALI I PASIVEVE(B+C)</b>	<b>1,243,763,136</b>	<b>1,117,849,045</b>

Zëri Aktive paraqitet për 1,243,763,136 lekë

Ky post është i barabartë me shumën e postit “Aktive Afatgjata” plus “Aktive Afatshkurtra”.

Aktive Afatgjata. Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve afatgjata dhe pasqyrohet në vlerën 243,763,136 lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive “aktive afatgjata jomateriale” dhe “aktive afatgjata materiale”.

Përbërës të këtij posti janë llogaritë:

1. Llogaria 20 “Aktive Afatgjata Jomateriale” me vlerë totale prej 77,458 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 22,746 lekë përbëhet nga:

Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” me vlerë 77,458 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 22,746 lekë si rrjedhojë e amortizimit.

Kjo llogari përfaqëson tre studime, si më poshtë vijojnë:

- Studim plani rregullues i qytetit Kelcyrë në vlerën prej 40,548 lekë e vitit 2010.
- Rikonstruksion ujesjellesi Varibop dhe Kuqar në vlerën prej 16,776 lekë e vitit 2012.
- Rikonstruksion kanali vaditës fshati Beduqas në vlerën prej 20,134 lekë e vitit 2013.

*Titulli i Gjetjes:* Problematikë lidhur me kontabilizimin e llogarisë 202 “studime dhe projekte”.

Nga auditimi rezultoj mungesë e gjurmës dokumentare justifikuese të këtyre studimeve po ashtu mungesë e një liste analitike të përbërjes së tyre në mënyrë që vlera e paraqitur në pasqyrat financiare të jetë e mbështetur ne dokumentacionin vërtetues.

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion (tabela excel) rezulton se, të tre këto studime janë jetëzuar por vijojnë të mbahen në llogarinë 202 pa kryer veprimet tranzitore rregulluese. Për të tre këto studime vijon të llogaritet amortizim.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), me VKM nr 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e qëndrueshme të pa trupëzuara” Pika 1/b “Klasifikimi kontabël”.

- Sa i takon amortizimit, rezulton problematik, lidhur me normën e përdorur.

Në rastin e studimit Studim project ujesjellesi KUZ dhe Plani Rregullues i Qytetit norma e përdorur ka qenë 25% dhe për studimin Rikonstruksion ujesjellesi Varibop dhe Kuqar dhe Rikonstruksion kanali vaditës fshati Beduqas ka qenë 20%, në të dy rastet, u konstatua mos zbatim i UMF nr.8 datë 9.3.2018 pika 36 e tij, VKM nr. 401, datë 23.10.1989 Kreut III, pika 3.7.2 “Normat e amortizimit sipas grupeve”, ku përcaktohet se, aktivet e patrupëzuara amortizohen me normën vjetore të amortizimit prej 15 % në vit.

Operuar në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, VKM nr 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”

2. Llogaria 21 “Aktive Afatgjata Materiale” me vlerë totale prej 1,088,851,635 lekë shtuar nga viti i shkuar me 72,506,642 lekë përbëhet nga:

Llogaria 212 “*ndërtesa e konstruksione*” gjendja kontabël ne aktiv është 380,592,360 lekë dhe kuadron me pasqyrimin e kësaj llogarie tek aneksi i PF formati 7/b.

**Konstatim:**

- Nga auditimi rezultoj se, në përbërje të llogarisë 212 “*ndërtesa e konstruksione*” janë 3 ndërtesa me statusin “në përdorim” me vlerë konkrete *njësia Këlcyrë prej 360,792,070 lekë, njësia Sukë prej 62,529,728 lekë, njësia Ballaban 38,459,254 lekë* dhe një me statusin “në pronësi” *njësia Dëshnicë me vlerë prej 17,307,930 lekë.*

Nga nga ana e bashkisë Këlcyrë rezultoj zbatim i pjesshëm i VKM 500, konkretisht për 3 njësitë që kanë statusin “në përdorim” sa i përket zbatimit të detyrimit të pikës nr. 10, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, mungon lista e inventarit, dy fazat e tjera të VKM, lista shtesë e pronave për të cilën është mbajtur korrespondenca, plan rievimi i tokës, relacioni shpjegues dhe konfirmimi nga ASHK.

- Nga auditimi rezultoj se, periudha e hyrjes dhe rregjistrimit të asetëve në aktivet e Bashkisë Këlcyrë është shumë e largët në krahasim me periudhën aktuale. Gjatë kësaj kohe nga ana e institucionit nuk janë kryer rivlerësime të asetëve me qëllim përafrimin e vlerës kontabël me vlerën aktuale të tregut për aktivin sikurse parashikohet në SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”, Paragrafi “Trajtimet kontabël për aktivet afatgjata materiale”, pika 23-32 “Modeli i rivlerësimit”, duke sjellë që vlera e aktiveve të nënvlerësohet. Aktivet afatgjata në sektorin publik nevojitet të rivlerësohen me vlerën aktuale në mënyrë që Pasqyrat Financiare të japin një pamje të plotë të aktiveve që ka subjekti publik, me qëllim që përdoruesit të kuptojnë vlerën ekonomike të aktivitetit.

*Titulli i Gjetjes:* Zbatim i pjesshëm i VKM nr.500 datë 14.08.2001 Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar,

Nga auditimi rezultoj se, në përbërje të llogarisë 212 “ndërtesa e konstruksione” janë 3 ndërtesa me statusin “në përdorim” dhe një me statusin “në pronësi”. Nga nga ana e bashkisë Këlcyrë për 3 njësitë që kanë statusin “në përdorim” rezultoj zbatim i pjesshëm i VKM 500, konkretisht për 3 njësitë të detyrimit të pikës nr. 10, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar. Mungon plan rievilimi i tokës, relacioni shpjegues dhe konfirmimi nga ASHK si dhe mbajtja e korrespondencës me këtë institucion.

- Nga auditimi rezultoj se, periudha e hyrjes dhe rregjistrimit të asetëve në aktivet e Bashkisë Këlcyrë është shumë e largët në krahasim me periudhën aktuale. Gjatë kësaj kohe nga ana e institucionit nuk janë kryer rivlerësime të asetëve me qëllim përaftrimin e vlerës kontabël me vlerën aktuale të tregut për aktivin sikurse parashikohet në SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”, Paragrafi “Trajtimet kontabël për aktivet afatgjata materiale”, pika 23-32 “Modeli i rivlerësimit”, duke sjellë që vlera e aktiveve të nënvlerësohet. Aktivet afatgjata në sektorin publik nevojitet të rivlerësohen me vlerën aktuale në mënyrë që Pasqyrat Finaciare të japin një pamje të plotë të aktiveve që ka subjekti publik, me qëllim që përdoruesit të kuptojnë vlerën ekonomike të aktivitetit.

Operuar në kundërshtim me VKM nr.500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar pika 10 dhe SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”

Llogaria 213 “*rruge, rrjete, vepra ujore*” gjendja kontabël ne aktiv është 688,676,909 lekë, kuadron me pasqyrimin e kësaj llogarie tek formati 7/b, kjo pasqyron shtesat dhe pakësimet.

Llogaria 214 “*Iinstalime teknike, makineri e paisje*” gjendja kontabël ne aktiv është 996,237 lekë, kuadron me pasqyrimin e kësaj llogarie tek formati 7/b.

Llogaria 215 “*mjete transporti*” gjendja kontabël ne aktiv 12,103,688 lekë, kuadron me pasqyrimin e kësaj llogarie tek formati 7/b.

Llogaria 218 “*inventar ekonomik*” gjendja kontabël ne aktiv 6,482,441 lekë, kuadron me pasqyrimin e kësaj llogarie tek formati 7/b.

**Konstatim:** Nga auditimi rezultoi se, në kushtet e mungesës së procesit të inventarizimit të aktiveve të njësisë nuk arrijmë dot të shprehemi me siguri të arsyeshme mbi vërtetësinë dhe transparencën e llogarive të mësipërme.

Nga auditimi ka rezultuar se, për bashkinë Këlcyrë nuk ka gjetur zbatim Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, kapitulli III “*Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre*”, konkretisht me pikat.

*Pika 26 ..* Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjister kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshirë dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar.

*Pika 27 ...* Nëpunësi Autorizues i njësisë, brenda strukturës së institucionit, cakton nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit.

*Pika 30 ...* Format i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjate apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, lidhen me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim,

përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, lidhen me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia,

#### *Titulli i Gjetjes: Mungesë e rregjistrimit të aktiveve*

Nga auditimi ka rezultuar se, për bashkinë Këlcyrë nuk ka gjetur zbatim Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, konkretisht me pikat.

*Pika 26 ..* Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjister kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshirë dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar.

*Pika 27 ...* Nëpunësi Autorizues i njësisë, brenda strukturës së institucionit, cakton nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrimit.

*Pika 30 ...* Format i regjistrimit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjate apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, lidhen me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, lidhen me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Operuar në kundërshtim me Udhëzimi nr.5 datë 21.02.2022 “ Mbi ndryshimin e udhëzimit numër. 8, datë 09/03/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” dhe UMFE nr.30 datë. 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Sektorin Publik”, i ndryshuar.

Aktive Afatshkurtra. Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve afatshkurta e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive “Mjeteve monetare dhe ekujvalente të tyre” me “Gjendje inventarit qarkullues” dhe “Llogarive të arkëtueshme” dhe rezulton në 154,834,043 lekë.

Përbërës të këtij posti janë llogaritë:

1. Mjete Monetare dhe ekuivalente të tyre me vlerë 59,233,218 lekë, shtuar nga viti i shkuar me 34,079,734 lekë. Përbërës i këtij posti është llogaria 520 “disponibilitete në thesar”.

Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” me vlerë 59,233,218 lekë e cila përfaqëson gjendjen e fondeve të trashëguara të mbetura si fonde pa përdorura përgjatë vitit si dhe garancitë e punimeve. Referuar UMF nr.8 datë 09.03.2018 “ Për procedurat e përgatitjes dhe paraqitjes të PF vjetore të NJQP” llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” në kushtet e njësisë që po trashëgon të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, kjo llogari ka pasqyruar tepricën debitore të saj në aktivet e pasqyrës së pozicionit financiar dhe tepricat e llogarisë 520, “Disponibilitete në thesar” vërtetohen me aktrakordim me thesarin.

2. Gjendja e inventarit qarkullues me vlerën 10,475,141 lekë.

Totali i llogarisë Gjendje inventari qarkullues vijon të mbartet me të njëjtën vlerë nga viti i shkuar 2022 prej 10,475,141 lekë. Nga krahasimi i të njëjtave poste, rezulton se diferenca e gjendjeve të inventarëve në fund vitit, përputhet me efektin debitor të llogarisë 63 “*Ndryshimi i gjendjes së materialeve*” në pasqyrën e shpenzimeve të ushtrimit. Në këtë të fundit kjo vlerë rezulton në 0 lekë. Në përbërje të kësaj llogarie është llogaria 32 “inventar i imët”.

Llogaria 32 “Inventar i imët” me vlerë 10,475,141 lekë, mbartur e pandryshuar nga viti i shkuar. Në total ndryshimi i gjendjes së materialeve është 0 lekë, e njëjtë me llogarinë 63 evidentuar në pasqyrën e shpenzimeve të ushtrimit.

3. Llogari të Arkëtueshme me vlerë 85,125,684 lekë e cila përbëhet nga:

Llogaria 411 “Klientë e llogari të ngjashme me to” me vlerë 41,584,329 lekë shtuar nga viti shkuar me 13,130,919 lekë, shtim i ardhur si rrjedhojë e vlerës së faturave dhe situacioneve të investimeve të palikuiduara në fund të vitit 2023, të cilat kalojnë si detyrim për vitin 2024.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin” me vlerë 14,306,792 lekë shtuar nga viti shkuar me 5,781,917 lekë, *kjo llogari përfshin detyrimet afatshkurtra për pagesën e punonjësve për muajin dhjetor 2022, pagesën e tatimeve dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore po për këtë muaj si dhe fatura të pa likuiduara të vitit korrent.*

Llogaria 4342 është kundërparti e shumës së llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, llog.42 “Detyrime ndaj personelit”, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, llog.435 “Sigurime shoqërore” dhe llog. 436 “Sigurime shëndetësore”, dhe nuk rakordon me to për vlerën 28,453,410 lekë. Nga auditimi rezultoi se, kjo llogari nuk kuadron me kundërpartin e vet.

Në kushtet kur kjo llogari është kundërparti e shumës së llogarive të sipërcituara, rezulton se nuk rakordon me to për vlerën 28,453,410 lekë, si rrjedhojë rezulton të jetë e nënvlerësuar për këtë vlerë.

(Llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vlerën 28,453,410 lekë, llog.42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 6,153,280 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 201,001 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 2,170,594 lekë, llog. 436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 0 lekë). Sa më sipër operuar në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, neni 10 dhe 11, Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 32 e tij, i ndryshuar



*Titulli gjetjes:* Llogaria 4342 “Operacione me shtetin” për vitin 2023.

Llogaria 4342 është kundërparti e shumës së llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, llog.42 “Detyrime ndaj personelit”, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, llog.435 “Sigurime shoqërore” dhe llog. 436 “Sigurime shëndetësore”, dhe nuk rakordon me to për vlerën 28,453,410 lekë. Nga auditimi rezultoi se, kjo llogari nuk kuadron me kundërpartin e vet.

Në kushtet kur kjo llogari është kundërparti e shumës së llogarive të sipërcituara, rezulton se nuk rakordon me to për vlerën 28,453,410 lekë, si rrjedhojë rezulton të jetë e nënvlerësuar për këtë vlerë.

(Llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vlerën 28,453,410 lekë, llog.42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 6,153,280 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 201,001 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 2,170,594 lekë, llog. 436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 0 lekë). Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar, për sa i përket gjendjes kontabël të të drejtave që i lindin subjektit Bashkia Këlcyre ndaj shtetit për angazhimet e ndërmarra me fondet nga buxheti i shtetit, të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2023 si dhe në Pasqyrën e Performancës Financiare.

Sa më sipër operuar në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, neni 10 dhe 11, Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 32 e tij, i ndryshuar ku citohet: ...“*Të drejtat duhet të evidentohen në kohën e lindjes së tyre, ndërsa si të ardhura të njihen dhe evidentohen në pasqyrat financiare në çastin e arkëtimit të tyre në llogaritë financiare, duke mbajtur nën kontroll evidentimin e të ardhurave me baza rritëse (llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”), të cilat evidentojnë të drejta të njëjve të qeverisjes së përgjithshme në marrëdhënie me shtetin (llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta”), subjektit i lind e drejta e regjistrimit të pjesës së mbetur të kontratës në vitin përkatës, pasi i ka zbritur likuidimet e vitit, të regjistroj te drejtën në 4342 Operacione me shtetin me kundërparti të ardhurën 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.*

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” me vlerë 29,234,563 lekë shtuar nga viti shkuar me 437,625 lekë. Lidhur me këtë llogari (llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”) e cila sikundër rezulton në analizën që vijon më poshtë, mbart vlera prej vitesh, nga ana e Bashkisë Këlcyre jo vetëm nuk janë marr masa për iniciimin e procedurave për mbledhjen e detyrimeve ndaj saj, por është vijuar me shtimin e këtyre vlerave.

*Në analizë llogaria e debitorëve :*

**llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”,** e cila përfaqëson shumën e të drejtave arkëtueshme nga tretët, në mbyllje vitit 2023 paraqitet në vlerën **29,234,563 lekë** për **73** persona e subjekte, e zbrërthyer në mënyre analitike, sipas pasqyrës te akt konstatimit nr. 3. (lista e debitorëve bashkangjitur në Aneksin nr.1)

Pasqyra e debitorëve sipas njëjve, për vitin 2023, paraqitet sa vijon:

NR.	EMERTIMI	Llog: 468	Debitor me 31.12.2023 në lekë
1.	Bashkia Këlcyre		23,626,688

2.	Njësia Administrative Dishnice	4,466,354
3.	Njësia Administrative Suke	815,278
4.	Njësia Administrative Ballaban	326,252
	<b>SHUMA</b>	<b>29,234,563</b>

**Sa sipër**, lidhur me debitorët 2023, rezulton se:

debitorët e vitit 2023 kanë pësuar rritje nga viti 2022 për 437,625 lekë (28,796,938 lekë), ku peshën më të madhe e zënë debitorët e bashkisë Këlcyre prej 23,626,688 lekë ose në terma relative 80 % ndaj totalit.

Në mënyrë të detajuar konkretisht:

- 470,845 lekë debitor të ndryshëm,
- 1,033,632 lekë debitor të taksave e tarifave vendore të vitit 2023.
- 22,122,211 lekë debitorë të lënë ndër vite nga KLSH, për këtë të fundit më hollësisht:

Bashkia Këlcyre nuk ka bërë ndalesa dhe nuk ka ndjekur të gjitha hapat ligjore, për arkëtimin e vlerës 22,122,211 lekë lënë nga KLSH për vitet para periudhës 2023, detyrime të pranuar dhe kontabilizuara nga bashkia, madje në disa raste ka pasur mundësi arkëtimi, pasi disa punonjës vijnë të jenë në marrëdhënie pune me bashkinë, me shëndetësinë, me arsimin, me institucionet të tjera si dhe anëtare këshillit bashkiak. Veprime në kundërshtim me UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitë sektorit publik”, pika 93, me ligjin 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21 dhe 33 dhe me ligjin 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi Procedurave Administrative në RSH” nenet 98 dhe 102.

*Ngarkohen me përgjegjësi përgjegjësja e financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues zj. V.K .*

Debitorët e tjerë të ish-komunave, të njësive administrative të mbartur nga e kaluara, rezultojnë se zënë një peshë më të ulët.

Këto zëra debitorësh janë të zberthyera në emra nominalë dhe subjekte konkrete me kuadraturë të rregullt, ku problem mbetet ndjekja dhe arkëtimi i tyre, përkatësisht 4,466,354 lekë njësia administrative Dishnice, 815,278 lekë njësia Suke dhe 326,252 lekë njësia Ballaban.

Debitorët e taksave dhe tarifave vjetore të bashkisë Këlcyre dhe 3 njësive administrative për vitin 2023 janë evidentuar në emra nominalë konkret dhe nga zyra e taksave vendore dhe i janë përcjellë zyrës financës për kontabilizim, sipas shkresës nr. 298 datë 13.02.2024.

*Nga auditimi u konstatua se, procesi i inventarizimit nuk është kryer për vitin 2023.*

*Titulli gjetjes: Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” për vitin 2023.*

Spektori i Financës paraqet neglizhencë në drejtim të ndjekjes dhe arkëtimit të debitorëve në vlerën 29,234,563 lekë për 73 persona e subjekte, pasi nuk janë ndërmarrë të gjitha hapat ligjore për vjeljen e tyre.

Operuar në kundërshtim me Udhëzimin 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitë sektorit publik”, pika 93, ligji 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21 dhe 33 dhe ligji 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi Procedurave Administrative në RSH” nenet 98 dhe 102.

*Gjendja e llogarive pasive në fund të vitit 2023*

Duke analizuar pasivin e bilancit të këtij viti dhe duke e krahasuar me një vit më parë, rezulton se llogaritë pasive janë më shumë se një vit më parë për 28,274,470 lekë, ndërsa me klasa dhe llogari rezultojnë si më poshtë:

Llogaritë e detyrimeve afatshkurtëra, shtuar këtë vit me vlerën prej 28,274,470 lekë si më poshtë:

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, është shtuar këtë vit me 13,130,919 lekë dhe përfaqëson vlerën e detyrimeve për fatura dhe situacione të palikuiduara në fund të vitit 2024.

Llogaria 42 “Personeli e llogari të lidhura me to-paga”, është shtuar këtë vit me 689,186 lekë si rrjedhojë e detyrimit për pagat e papaguara të muajit dhjetor 2023, të cilat paguhen në muajin janar 2024.

Llogaria 431 “Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa” përfaqëson detyrimet e Institucionit ndaj drejtorisë së tatimeve dhe është pakësuar këtë vit me vlerën 20,240 lekë për shkak se për shkak se për vitin 2023 vlera e tatimit të mbajtur mbi pagat rezultoi më i ulët se në vitin 2022.

Llogaria 435 “Sigurime shoqërore” është shtuar këtë vit me 304,825 lekë si rrjedhojë e si rrjedhojë e shtimit të pagave të punonjësve si rezultat i efektit të rritjes së pagave.

*Konstatim:* Nga ana e Bashkisë Këlcyre në pasqyrat financiare llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” figuron pa vlerë financiare. Prej institucionit është operuar duke i shtuar tek llogaria 435 “sigurime shoqërore”.

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, në vlerën 19,707,028 lekë është shtuar nga viti i shkuar, me vlerën 9,361,634 lekë dhe përfaqëson vlerën e ngurtësuar gjatë vitit 2023 përsa i përket garancisë së punimeve të investimeve në masën 5%.

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, në vlerën 4,808,146 lekë është krijuar këtë vit dhe përfaqëson vlerën e vendimit gjyqësor sipas pasqyrës bashkëlidhur, për një vendim gjyqësor.

Llogaritë 101“Fonde bazë”, është shtuar me 72,921,521 lekë. Këto fonde i përgjigjen pjesës së aktivitetit të bilancit. Kjo llogari përfaqëson vlerën prej 72,506,642 lekë e cila rrjedh si diferencë shtesë e AQT (ushtrimi i mbyllur 1,088,851,635 – ushtrimi paraardhës 1,016,344,993), vlerën prej 437,625 lekë e cila rrjedh si diferencë shtesë e llog 468 Debitorë të ndryshëm (ushtrimi i mbyllur 29,234,563 lekë – ushtrimi paraardhës 28,796,938 lekë), si edhe vlera prej 22,746 lekë e cila rrjedh si diferencë pakësimi i AQTPT (ushtrimi i mbyllur 77,458 – ushtrimi paraardhës 100,204). Pra  $72,506,642 + 437,625 - 22,746 = 72,921,521$  lekë.

Llogaria 85 "Rezultati i ushtrimit nga funksioni" kur del me saldo kreditore, përfaqësohet si rubrikë me vehte dhe përbën rezultatin nga viti ushtrimor si tepricë kreditore e kësaj llogarie në vlerën 39,526,190 lekë (Të ardhurat 257,510,595 – shpenzimet 217,984,405 = 39,526,190 lekë).

Shtesa prej vitit të shkuar në vlerën 24,718,100 lekë përfaqëson vlerën e fondeve të trashëguara nga viti 2023 për në vitin 2024 nga granti i papërdorur dhe të ardhurat e veta të njësisë të papërdorura. (grantit në vlerën prej 24,437,274 lekë + të ardhurat që trashëgohen prej 15,088,916 lekë).

### **Auditimi i llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve**

Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr. 2 “Pasqyra e përformancës financiare” të PF të vitit 2023 paraqitet si më poshtë:

Nr.	VITI	VITI
-----	------	------

Llogarije	P E R S H K R I M I I OPERACIONEVE	USHTRIMOR	I MEPARSHEM
<b>b</b>	<b>c</b>	1	2
<b>A</b>	<b>TE ARDHURAT</b>	<b>257,510,595</b>	<b>226,400,877</b>
<b>70</b>	<b>I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET</b>	<b>8,058,857</b>	<b>7,527,280</b>
<b>700</b>	<b>1.Tatimi mbi te Ardhurat</b>	<b>46,641</b>	<b>5,000</b>
7000	Tatim mbi te ardhurat personale		
7001	Tatim mbi Fitimin		
7002	Tatim mbi Biznesin e vogel	46,641	5,000
7009	Te tjera Tatime mbi te ardhurat		
<b>702</b>	<b>2.Tatimi mbi Pasurine</b>	<b>2,464,073</b>	<b>2,498,621</b>
7020	Tatim mbi Pasurine e palujtshme	2,464,073	2,452,573
7021	Tatim mbi shitjen e pasurise se palujtshme	0	0
7029	Te tjera tatime mbi Pasurine	0	46,048
<b>703</b>	<b>3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit</b>	<b>5,548,143</b>	<b>5,023,659</b>
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar(TVSH)		
7031	Akciza		
7032	Takse mbi sherbimet specifike		
7033	Takse mbi perdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	2,651,546	2,334,006
7035	Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	2,896,597	2,689,653
<b>704</b>	<b>4.Takse mbi tregtine dhe transaksionet nderkombtare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
7040	Takse doganore per mallrat e importit		
7041	Takse doganore per mallrat e eksportit		
7042	Tarife sherbimi doganor e kaliposte		
7049	Te tjera taksa mbi tregtine e transaksionet nderkombtare		
<b>705</b>	<b>5.Takse e rruges</b>		
<b>708</b>	<b>6.Te tjera Tatime e Taksa kombtare</b>		
<b>709</b>	<b>7.Gjoha e Kamat vonesa</b>		
<b>75</b>	<b>II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHENDETESORE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
750	NGA TE PUNESUARIT		
751	NGA PUNEDHENESI		
752	NGA TE VETPUNESUARIT		
753	NGA FERMERET		
754	NGA SIGURIMET VULLNETARE		
755	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHOQERORE		
756	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHENDETESORE		
<b>71</b>	<b>III.TE ARDHURA JO TATIMORE</b>	<b>8,569,451</b>	<b>7,410,722</b>
<b>710</b>	<b>1.Nga ndermarrjet dhe pronesia</b>	<b>2,492,838</b>	<b>2,087,046</b>
7100	Nga Ndermarrjet publike jo financiare		
7101	Nga Ndermarrjet publike financiare		
7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia	2,492,838	2,087,046
<b>711</b>	<b>2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare</b>	<b>3,402,516</b>	<b>3,106,947</b>
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	2,575,325	1,840,161
7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh	821,191	1,250,786
7112	Takse per veprime gjyqsore e noteriale		
7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve	6,000	16,000
7114	Te ardhura nga biletat		
7115	Gjoha, kamatvonesa, sekuestrime e zhdemtime		
7116	Te ardhura nga transferimi prones,Legalizimi i ndertimeve pa leje		
<b>719</b>	<b>3.Te tjera te ardhura jo tatimore</b>	<b>2,674,097</b>	<b>2,216,729</b>
<b>76</b>	<b>IV.TE ARDHURA FINANCIARE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
760	Nga interesat e huadhenies se brendshme		
761	Nga interesat e huadhenies se Huaj		
765	Nga interesat e depozitave		
766	Nga kembimet valutore		
<b>72</b>	<b>V.GRANTE KORENTE</b>	<b>240,882,287</b>	<b>211,462,875</b>
<b>720</b>	<b>1.Grant korent I Brendshem</b>	<b>240,882,287</b>	<b>211,462,875</b>
7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	0	0
7201	Nga Buxheti per NJQP(Vendore)	226,575,495	202,938,000
7202	Nga Buxheti per pagesa te posacme te ISSH		
7203	Nga Buxheti per mbulim deficiti(ISSH E ISKSH)		
7204	Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale		
7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit		
7206	Financim I pritshe nga buxheti	14,306,792	8,524,875
7207	Sponsorizime te brendshme( nga te trete)		
7209	Te tjera grante korent te brendshme		
<b>721</b>	<b>2.Grant korent I Huaj</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	Nga Qeveri te Huaja		
	Nga Organizata Nderkombetare		
	<b>VI.TE ARDHURA TE TJERA</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
781	Te ardhura nga investimet ne ekonomi		
782	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatshkurtra		
783	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatgjata		

784	Rimarrje Shumash per shpenzime te viteve ardhshme		
787	Terheqje nga seksioni I investimeve		
73	<b>VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>B</b>	<b>SHPENZIMET</b>	<b>217,984,405</b>	<b>211,592,787</b>
<b>600</b>	<b>IPAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE</b>	<b>97,903,790</b>	<b>81,932,523</b>
6001	Paga, personel I perhershëm	97,903,790	81,932,523
6002	Paga personel I Perkohshëm	0	
6003	Shperblime	0	
6009	Shpenzime te tjera per personelin	0	
<b>601</b>	<b>ILKONTRIBUTE TE SIGURIMEVE</b>	<b>17,190,296</b>	<b>14,359,678</b>
6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	17,190,296	14,359,678
6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore	0	0
<b>602</b>	<b>III.BLERJE MALLRA E SHERBIME</b>	<b>24,515,964</b>	<b>22,606,201</b>
602	Mallra dhe sherbime te tjera	0	0
6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	408,600	484,536
6021	Materiale dhe sherbime speciale	2,954,800	1,042,000
6022	Sherbime nga te trete	6,557,311	7,449,052
6023	Shpenzime transporti	8,448,841	8,142,052
6024	Shpenzime udhetimi	233,710	173,420
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	1,348,080	1,835,288
6026	Shpenzime per qeramarrje	204,000	204,000
6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	1,230,000	0
6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua	0	0
6029	Shpenzime te tjera operative	3,130,622	3,275,853
<b>603</b>	<b>IV.SUBVEZIONE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
6030	Subvecone per diference cmimi		
6031	Subvecone per te nxitur punesimin		
6039	Subvecone te tjera		
	<b>V.TRANSFERIME KORENTE</b>	<b>78,374,355</b>	<b>92,888,536</b>
<b>604</b>	<b>1.Transferime korente te brendshme</b>	<b>100,466</b>	<b>422,102</b>
6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise	100,466	422,102
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme		
6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqerore e Shendetesore		
6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse		
<b>605</b>	<b>2.Transferime korente me jashte</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
6051	Transferime Per Organizatat Nderkombetare		
6052	Transferime Per Qeverite e Huaja		
6053	Transferime Per institucionet jo fitimprurse te huaja		
6059	Transferime Te tjera korrente me jashte shtetit		
<b>606</b>	<b>3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe</b>	<b>78,273,889</b>	<b>92,466,434</b>
6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		
6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	78,273,889	92,466,434
	<b>VI.SHPENZIME FINANCIARE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>65</b>	<b>1.Shpenzime Financiare te brendshme</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
650	Interesa per bono thesarit dhe kredi direkte		
	<b>VI.SHPENZIME FINANCIARE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>65</b>	<b>1.Shpenzime Financiare te brendshme</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
650	Interesa per bono thesarit dhe kredi direkte		
651	Interesa per huamarrje te tj. Brendshme		
652	Interesa Letra tjera vlere Qeverise		
656	Shpenz.nga kembimet valutore	0	0
<b>66</b>	<b>2.Shpenzime Financiare te jashtme</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
660	Interesa per huamarrje nga Qeverite te Huaja		
661	Interesa per financime nga Institucionet.nderkomb		
662	Interesa per huamarrje te tjera jashtme		
	<b>VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
681	Kuotat e amortizimit te AAGJ, te shfrytezimit		
682	Vlera e mbetur e AAGJ, te nxjerra jashte perdorimit e te shitura		
683	Shuma te parashikuara te shfrytezimit		
686	Shuma te parashikuara per aktivet financiare		
<b>63</b>	<b>VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT</b>	<b>0</b>	<b>-194,151</b>
	<b>IX.SHPENZIME TE TJERA</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>85</b>	<b>TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES</b>	<b>39,526,190</b>	<b>14,808,090</b>
	<i>(Rezultati I Vepimitarise se vititUshtrimor)</i>		

Të ardhurat dhe shpenzimet janë pasqyruar saktë tek pasqyra shpjeguese për raportimin e Pasqyrave Financiare vjetore 2023, formati 2, përkatësisht:

**a. Te ardhurat** total pasqyrohen 257,510,595 lekë, e cila kuadron me ardhurat sipas grupeve:

- Te ardhura nga taksat dhe tatimet për 8,058,857 lekë,
- Te ardhura jo tatimore për 8,569,451 lekë,
- grante korente për 240,882,287 lekë,

**b. Shpenzimet** total pasqyrohen 217,984,405 lekë, kuadron me shpenzimet sipas grupeve:

- *paga dhe përfitime punonjësve për 97,903,790 lekë,*
- *kontribute te sigurimeve për 17,190,296 lekë,*
- *blerje mallra e shërbime për 24,515,964 lekë,*
- *transferime korente për 78,374,355 lekë,*

**c. Teprica/deficiti** periudhës 2023 rezulton për 39,526,190 lekë (257,510,595-217,984,405).

**Krahasimi mes pasqyrës së performancës dhe situacionit të shpenzimeve:**

U konstatua se, vlerat e paraqitura në pasqyrën e performancës financiare në total nuk përputhen me vlerat e paraqitura në situacionin me degën e thesarit Përmet, “Shpenzimet korrente” sipas pasqyrave për llogaritë 601-602-602 me diferenca konkrete:

<i>llogaria</i>	<i>Pasqyra financiare</i>	<i>Situacioni shpenzimeve</i>
<i>llogaria 600 “Pagat dhe perfitimet e punonjësve”</i>	<i>97,903,790</i>	<i>97,234,844</i>
<i>llogaria 601 “Kontribute te sigurimeve”</i>	<i>17,190,296</i>	<i>16,885,471</i>
<i>llogaria 602 “Blerje mallra e shërbime”</i>	<i>24,515,964</i>	<i>25,137,111</i>
<i>Totali diferencave</i>	<i>139,610,050</i>	<i>139,257,426</i>

**Konstatim:** Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare nuk specifikohet se çfarë përfshihet në vlerën e rakorduar me thesarin dhe çfarë vlerash përfshihen në pasqyrat financiare dhe përse nuk rakordojnë këto shuma.

Në kundërshtim me UMF nr. 24128, dt. 27.12.2011 “Procesimi i transaksioneve në fund të vitit” dhe UMF nr. 2, dt. 06.02.2012 “Procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike” “Rakordimi mujor i shpenzimeve”:

172. *Nëpunësi zbatues rakordon me strukturën përgjegjëse për thesarin deri në datën 5 të çdo muaji, mbi shpenzimet mujore/progresive që ka kryer njësia e qeverisjes së përgjithshme. Formati i raportit përcaktohet nga struktura përgjegjëse për thesarin.*

173. *Pas rakordimit mujor të shpenzimeve, njësitë e qeverisjes së përgjithshme përgatisin raportet financiare për vendimmarrjen dhe struktura përgjegjëse për thesarin përgatit raportet financiare periodike të konsoliduara të qeverisë, të cilat publikohen nga Nëpunësi i Pare Autorizues në faqen e internetit të Ministrisë së Financave” dhe UMF nr. 46, dt. 24.12.2020 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2020” pika 34 “Degët e thesarit ..... gjenerojnë ... informacionin financiar disponibël/pasqyrat financiare vjetore për njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Ky informacion shërben si refrencë për nëpunësit zbatues gjatë procesit të hartimit të pasqyrave financiare të institucioneve që përfaqësojnë, të dhënat përfundimtare të cilat i pasqyrojnë në sistemin informatik të qeverisë nëpërmjet strukturës përgjegjëse të thesarit ne ë degë në zbatim të manualeve përkatës”.*

**Pasqyra e lëvizjes numrit të punonjësve dhe fondit pagave.**

Pasqyra e lëvizjes fondit pagave formati 8 e vitit 2023 rakordon me pasqyrën e shpenzimeve për paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2023.

Pasqyra e lëvizjes fondit pagave “formati 8” për vitin 2023 pasqyron 189 punonjës me fond page për vlerën 97,903,790 lekë dhe 17,190,296 lekë kontribute te derdhura për sigurime shoqërore dhe shëndetësore si dhe 2,124,381 lekë tatim mbi te ardhurat personale.

**3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.**

### Arka 2023.

Me arkën janë kryer transaksione financiare të kufizuara vetëm për arkëtimin e disa tarifave dhe taksave vendore për të cilat janë prerë mandatë arkëtimet të plotësuar me të gjitha ekstremitetet. Te hollat e krijuara ne arke, përbehen nga: arkëtimi i taksave tokës bujqësore, taksa familjare, taksa biznesi i vogël, certifikata transporti, qira kullote me kontrate pullave, takse hapësire publike, e tjera. Mandatpagesat janë kontabilizuar periodikisht në ditarin e arkës dhe shoqërohen me dokumentet bazë dhe justifikuese. Janë bere azhurnimet përkatëse ne mënyre analitike. Mandatpagesat janë prerë dhe nënshkruar nga arkëtarja dhe përgjegjësja e financës. Mandatpagesat janë prerë sipas numrit kronologjik dhe ne përgjithësi janë plotësuar me gjithë te dhënat dhe pa mangësi. Janë kryer rakordimet për gjendjen kontabël me gjendjen fizike te arkës me 31.12.2023, llogaria 532 “*vlera tjera*”, e cila paraqitet me vlerën 0 (zero), sipas aktivitetit të bilancit 2023, formati nr. 1, zëri “*mjete monetare*”. Mbajtja e kontabilitetit të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera nëpërmjet arkës është realizuar në ditarin e arkës. Çdo regjistrim kontabël bëhet sipas mandat-arkëtimeve dhe mandat-pagesave të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues. Dokumentet bazë si mandatarkëtimet dhe mandat-pagesat ishin të shoqëruara me dokumentet plotësues sipas natyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve. Kontabilizimi të ardhurave është bërë i saktë në llogaritë e klasës 7 sipas llojeve të ardhurave dhe kuadron me akt-rakordin e me thesarin për të ardhurat. Të ardhurat e arkëtuara janë bërë derdhje dhe në fund të çdo muaji arka rezulton me gjendje 0. Është respektuar limiti i arkës për vitin 2023, pasi arka paraqitet me të holla brenda limitit saj dhe derdhen në bankë periodikisht, sipas kërkesave pikës 3 të VKM-së nr. 290, datë 14.6.1993 “*Për limitin e arkës*”. Në fund të çdo muaji dhe ne fund te vitit 2023 libri i arkës mbyllet për gjendjen fizike të të hollave dhe është bere rakordimi me financën, duke bere nënshkrimet përkatëse ne akt rekordim. Veprime e arkës për vitin 2023 kane përputhshmëri me kërkesat e ligjit 9228 datë 29.4.2004 “*Për kontabilitetin*” ndryshuar me ligjin 24/2018 datë 10.05.2018 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, me VKM 783 datë 22.11.2006 “*Për përcaktimi standardeve dhe rregullave kontabël*”.

**U konstatuan disa mandat arkëtime me mangësi ne forme dhe përmbajtje** (*korrigjime ne numrin rendor dhe mospërputhje te vlerës ne shifra dhe asaj me shkrim*), konkretisht: MA nr. 682 datë 21.12.2023, MA nr. 663 dhe nr. 664 datë 05.12.2023, MA nr. 667 datë 19.12.2023, MA nr. 667 datë 14.12.2023, ndërsa MA nr. 393 datë 23.05.2023 ne shifra pasqyron vlerën 4,320 lekë ndryshe nga ajo me shkrim për 1,440 lekë (*flet për shlyerje detyrimesh te 3 viteve 2021-2022-2023*), veprime ne kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, pika 36, ku thuhet:

*dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit datën dhe vendin e kryerjes, objektin , treguesit sasiorë dhe ato të vlerës , personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime.*

Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi **arkëtare P.N**

Nga auditimi rezultuan parregullsi në plotesimin e disa mandat arkëtimeve. Ku Sektori i Financës ka prerë disa mandat arkëtime me mangësi në formë dhe përmbajtje (korrigjime ne numrin rendor dhe mospërputhje të vlerës në shifra dhe asaj me shkrim), konkretisht: MA nr. 682 datë 21.12.2023, MA nr. 663 dhe nr. 664 datë 05.12.2023, MA nr. 667 datë 19.12.2023, MA nr. 667 datë 14.12.2023, ndërsa MA nr. 393 datë 23.05.2023 në shifra pasqyron vlerën

4,320 lekë ndryshe nga ajo me shkrim për 1,440 lekë. Në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 36.

### **BANKA 2022.**

Auditimi mbi veprimet e bankës kryhet për vitin 2023, bazuar në programin e auditimit, rezultoi se: Auditimi u krye me metodën hap pas hapi, me teknikën e auditimit të shqyrtimit të dokumentacionit justifikues të veprimitarisë së këtij sistemi për të vlerësuar që kontrollat e brendshme nëse kanë qenë efektive. Për periudhën e audituar veprimet e kryera nëpërmjet bankës janë të dokumentuara me urdhërpagesat përkatëse, të nënshkruara nga nëpunësi zbatues dhe janë konfirmuar nga dega e thesarit të rrethit. Urdhërshpenzimet mbajnë numra rendor progresiv dhe veprimet ekonomike janë hedhur rregullisht në ditarin e bankës dhe ditarin e shpenzimeve sipas nënzërave përkatës. Vlera e urdhërshpenzimeve të likujduara përputhet me vlerën e detyrimit për shërbimet dhe mallrat e kontraktuara. Përpilimi i urdhërshpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si: urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve. Llogaritë janë në pozicionin e duhur në përputhje me kërkesat ligjore, sipas kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin” ndryshuar me ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë Qeverisjes Përgjithshme”, i ndryshuar dhe me Udhëzimet Ministrisë Financave. Likuidimet me bankën për vitin 2023 i përkasin shlyerjes së pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore të punonjësve bashkisë, arsimit baze, parashkollor, mesëm, pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, mirëmbajtjes varrezave, rrugëve rurale, KUZ, bujqësisë, ujitje-kullimit, pagesave të ndihmës ekonomike, trajtim futbollistëve, shpërblim mujore të anëtareve KB, shpërblime lindje prapambetura, karburantit dhe shërbimeve mjeteve ( pjese këmbimi, goma, vaje filtra) raste likuidim situacionesh ose garanci objektsh investimesh si dhe blerje të vogla me peshe të vogël (materiale sanitare, pastrimi, kancelari, shtypshkrime, mirëmbajtje rruge, pajisje, kazanë mbeturinash, etj).

Nga auditimi i veprimeve me bankën për vitin 2023, u konstatuan disa të meta dhe mangësi konkretisht:

#### **Shpenzime për pastrimin, gjelbërimin, ndriçimin, mirëmbajtje varrezash të qytetit.**

1. Pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi, mirëmbajtja e varrezave, rrugëve rurale, KUZ, bujqësia, ujitje-kullimi të qytetit Këlcyrë për vitin 2023 mbulohet nga vete bashkia, e cila disponon 108 punonjës të miratuar me vendimin e këshillit bashkiak nr. 02 datë 04.01.2023.

Pastrimi kryhet për qytezën Këlcyrë, për njësinë Dishnice, Suke dhe Ballaban, ku pastrohen rruge, sheshe, trotuare, grumbullohen dhe transportohen mbetjet urbane, të cilat dërgohen pranë vendit të depozitimit i quajtur Varibop.

Lidhur me pastrimin rezultojnë se:

- Përgjegjësi i shërbimeve publike të bashkisë që mbikëqyre pastrimin e gjelbërimin e qytetit nuk ka mbajtur dokumentacion për verifikimet e pastrimit në terren si: procesverbalet ditore dhe mujore për efekt të pasqyrit të vërejtjeve për cilësinë e shërbimeve sipas zërave pastrimit, nuk pasqyrojnë zbritjet ditë me shi, nuk pasqyrojnë zbritjet në zërat e fshirjes rrugëve e shesheve dhe freskimit tyre (*Prill- Tetor*).



- Dokumentacioni i pagesës se 56 punonjësve te pastrim gjelbërimit paraqet mangesi, konkretisht: mungon liste prezence ditore, preventivi dhe situacioni mujore i punimeve sipas zërave te punës, planet dhe programet e punës etj, pra pagesa nuk shoqërohet me dokumentacion te plote, per efekt te argumentimit të punes kryer.

Veprime ne kundërshtim me rregulloren e brendshme te bashkisë, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik dhe me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", dhe bëjnë përgjegjës A.M me detyre përgjegjës i shërbimeve publike bashkisë Këlcyrë.

### Blerjet e vogla

Nga auditimi i blerjeve te vogla për vitin 2023 ne bashkinë Këlcyrë, rezultoi se ato zëne një peshe te vogël dhe konkretisht janë te destinuar, për blerjen e materialeve sanitare, pastrimit, kancelarive, shtypshkrimeve, vegla pune për mirëmbajtjen rrugëve, pajisje te ndryshme kompjuter, kazanë mbeturinash,.

Ne muajt janar- shkurt-mars 2023 është vazhduar me likuidimin e detyrimeve të trashëguara nga viti 2022. Për këtë është ngritur komisioni i blerjeve te vogla prej 3 vetash H. Sh., V.K , Bektash Allamani, qe do te operojnë gjatë vitit kalendarik 2023, me urdhrin e kryetarit bashkisë nr. 01 datë 04.01.2023 dhe është pajisur me llogari përdoruesi personi i autorizuar sistemit elektronik. Ne fund te vitit 2023 ka ndryshuar ky urdher me urdhrin e kryetarit bashkisë 95 datë 07.12.2023 dhe është pajisur me llogari përdoruesi personi i autorizuar sistemit elektronik, ku është ngritur komisioni i blerjeve te vogla prej 3 vetash H. Sh., O.H , B. A., qe do te operojnë gjatë vitit kalendarik 2023. Per vitin 2023 janë kryer blerje te vogla me procedurën e prokurimit elektronik ne 20 raste për vlerën 4,475,495 lekë fondi limit, nga kjo vlera e fituar ne total për 4,073,045 lekë me një kursim prej 402,450 lekë, në bazë të VKM nr. 285 datë 19.05.2021, sipas pasqyrës se mëposhtme:

Lista e objekteve të prokuruar me vlera te vogla për vitin 2023 (PVV)													
Nr	Objekti i procedurës Emertimi	Fondi limit (Pa tvsh)	Vlera e kontrates (pa tvsh)						Diferenca nga fondi limiti	Nr. Pjes marrësve	Të s'kualifikuar	Nuk janë Paraqitur	Operatori fitues
			Nr. Prot	Datë	Vlera pa tvsh (lekë)	Flete Hyrja pa tvsh							
						Nr	dt	lekë					
1	2	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14		15
	<b>VITI 2023</b>												
1	Blerje dru zjarri per shkolla e kopshte te femijeve	492,500	279	26.01.2023	491,515	1	06.02.2023	491,515	985	15	13	1	B
2	Furnizim vendosje pjese kembimi per automjete	65,500	566	24.02.2023	65,000	2	13.03.2023	65,000	500	10	8	1	B
3	Blerje kazane (kosha) mbeturinash	831,600	567	24.02.2023	830,000	3	29.03.2023	830,000	1,600	36	33	2	B
4	Blerje kancelari te ndryshme e tonera per printer e fotokopje	177,650	902	05.04.2023	108,800	7	14.04.2023	108,800	68,850	19	12	0	A.K
5	Prerje Police Sigurimi per automjetin Audi (karton jeshil)	45,740	1049	26.04.2023	45,740		ska	45,740	0	1	0	0	I sha
6	Blerje detergjente e materiale pastrimi e dezinfektimi	48,440	1894	24.08.2023	43,000	21	06.09.2023	43,000	5,440	24	20	0	H

Lista e objekteve të prokuruar me vlera te vogla për vitin 2023 (PVV)														
Nr	Objekti i procedurës Emertimi	Fondi limit (Pa tvsh)	Vlera e kontrates (pa tvsh)						Diferenca nga fondi limiti	Nr. Pjes marrësve	Të s'kualifikuar	Nuk janë Parajqitur	Operatori fitues	
			Nr. Prot	Datë	Vlera pa tvsh (lekë)	Flete Hyrja pa tvsh								
						Nr	dt	lekë						
1	2	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14		15	
7	Blerje baze materiale per lyerje objekte shkollore	293,875	1895	24.08.2023	209,900	20	04.09.2023	209,900	83,975	32	22	1	H.XH	
8	Prerje Police Sigurimi per automjetet	116,600	1987	04.09.2023	115,390		ska	115,390	1,210	1	0	0	A	
9	Riparime e mirembajtje fotokopje e printera	85,000	2055	11.09.2023	45,000		ska	45,000	40,000	7	6	0	SH.L	
10	Blerje materiale e aksesore hidraulike	50,150	2186	25.09.2023	46,000	24	11.10.2023	46,000	4,150	24	21	1	E	
11	Blerje kancelari te ndryshme e tonera per printer e fotokopje	140,300	2274	03.10.2023	70,000	25	13.10.2023	70,000	70,300	25	19	0	A.K	
12	F.V pjese kembimi e goma per mjetin e MZSH	159,400	2325	06.10.2023	155,000	29	30.10.2023	155,000	4,400	16	14	1	B	
13	Blerje vajra dhe filtra per mjetin e MZSH	47,400	2326	06.10.2023	47,000	28	30.10.2023	47,000	400	13	10	2	B	
14	Blerje baze materiale per sherbime te mjetit teknologjik	60,100	2425	17.10.2023	60,000	27	27.10.2023	60,000	100	8	6	1	E.L	
15	F.V pjese kembimi per automjetet e bashkise	537,500	2591	06.11.2023	522,000	32	14.11.2023	522,000	15,500	17	15	0	Sparkle 32	
16	Blerje materiale per mirembajtje mjete motorrike	31,500	2592	06.11.2023	31,000	33	16.11.2023	31,000	500	13	12	0	E	
17	Blerje dru zjarri per shkolla e kopshte te femijeve	405,000	2642	10.11.2023	405,000	34	20.11.2023	405,000	0	8	6	0	E.L	
18	Blerje uniforma per sherbimin zjarrfikes MZSH	749,200	2719	20.11.2023	664,000	36	19.12.2023	664,000	85,200	10	3	3	G.S	
19	Blerje detergjente e materiale pastrimi e dezinfektimi	62,800	2865	13.12.2023	49,000	37	26.12.2023	49,000	13,800	25	20	0	S	
20	Blerje kancelari te ndryshme e tonera per printer e fotokopje	75,240	2893	18.12.2023	69,700	38	26.12.2023	69,700	5,540	17	14	0	A.K	
	<b>GJITHSEJ</b>	<b>4,475,495</b>			<b>4,073,045</b>			<b>4,073,045</b>	<b>402,450</b>					

Blerje te vogla me vlerë deri në 10,000 lekë nuk ka asnjë rast për 2023.

Procedurat janë kryer konform VKM dhe Urdhrit te Ministrit te Financave dhe me dokumentacion te bashkëlidhur urdhrave të shpenzimit të bankës për blerjet me vlera të vogla përbëhej nga: kërkesa për blerjen e mallit ose kryerjen e shërbimit nga Drejtoritë përkatëse të miratuar nga NA (nëpunësi autorizues, Urdhër Prokurimi nga Titullari i entit kontraktor, ftesa për ofertë me mallin apo shërbimin me specifikimet teknike, procesverbali i vlerësimit të ofertës i firmosur nga KVO, faqja e APP me vlerësimin përfundimtar dhe listën e ofertave, fletë-hyrja dhe fatura e operatorit ekonomik, oferta fituese, formulari i çmimit të ofertës për të gjithë ofertuesit dhe deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike.

Procedura e prokurimit me vlerë të vogël, ka nisur me kërkesën për blerjen e mallit ose kryerjen e shërbimit nga sektorët përkatës, të miratuar nga NA (nëpunësi autorizues).

Është përcaktuar fondi limit në bazë të testimit të tregut. Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, ka hartuar urdhër prokurimin sipas formatit standard, i cili është miratuar nga Nëpunësi Autorizues. Ftesa për oferte është publikuar në sistemin elektronik të prokurimeve nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla (KPVV), duke ftuar të paktën 3 ofertues. Ofertuesit kanë paraqitur ofertën e tyre brenda 24 orëve nga shpallja e saj. KPVV ka bërë vlerësimet në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), sipas çmimit më të ulët dhe kanë kryer blerjen e mallit. Hapat e procesit janë formalizuar në formë narrative në procesverbalin e mbajtur nga KPVV, si dhe njoftimi i fituesit është gjeneruar nga SPE. KPVV ka hartuar procesverbalin përfundimtar pasi ka marrë në dorëzim faturën dhe mallin, i cili është bërë hyrje nga personi materialisht përgjegjës.

Në përgjithësi për vitin 2023 procedurat e prokurimit të blerjeve janë në përputhje me dispozitat ligjore konkretisht:

- me VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin rregullave prokurimit publik”,
- me ligjin nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,
- me udhëzimin nr. 5 datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

**Shpenzime për shpronësim.** Për vitin 2023 në bashkinë Këlcyrë nuk ka shpenzime për shpronësim të pasurive private me interes publik, që preken nga projektet dhe investimet, madje nuk ka dhe VKM për këtë qellim.

**Veprimet nëpërmjet magazinës.** Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhet në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhet sipas dokumentacionit bazë si flet-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave.

Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se veprimet ishin kontabilizuar saktë. Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara.

Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

**Inventarizimi i pasurisë.** Për vitin 2023 nuk është kryer inventarizimi fizik i pasurisë të institucionit, njësisive administrative, gjendjeve civile, shkollave, kopshteve, në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Ngarkohet me përgjegjësi **llogaritare, inventarizuese D.D**.

**Nxjerrjet jashtë përdorimit,** Për vitin 2023 Bashkia Këlcyrë nuk ka nxjerre jashtë përdorimit materiale dhe pajisje ndryshme.

**Titulli gjetjes:** Mos kryerja e inventarizimit fizik të pasurisë për vitin 2023.

Situata: Nga auditimi ka rezultuar se, lidhur me inventarizimin e aktiveve sektori i Financës për vitin 2023 nuk ka kryer inventarizimin fizik të pasurisë të institucionit, njësisive administrative, gjendjeve civile, shkollave, kopshteve. Sa më sipër është operuar në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2011, kreu IV, “Sistemi i Kontrollit periodik të aktiveve”, pika 73 dhe 74 e tij duke mos kryer procesin e inventarizimit.

*Pika 73 ... . Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe nga titullari i njësisë publike.*

*Pika 74 ... Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.*

Si rezultat, gjendja e të dhënave kontabël në pozicionin financiar të vitit 2023, nuk është rakorduar me gjendjen fizike dhe nuk arrijmë të japim dot siguri të arsyeshme mbi pohimet e nevojshme që lidhen me saktësinë e vlerave të aktiveve.

Kriteri: Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publik*”.

Shkaku: Neglizhence, pasi inventarizimi është shtyrë për në periudhën Mars 2024.

Rëndësia: I Mesëm.

#### **3.4. Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre ne Agjencinë Shtetërore Kadastrës (ASHK).**

Administrimi, marrja në dorëzim, menaxhimi i aseteve është bere ne zbatim të ligjit 8743 datë 22.02.2001 “*Për pronat paluajtshme shtetit*”, te ligjit 8744 datë 22.02.2001 “*Për transferimin pronave paluajtshme publike Njësitë Qeverisjes Vendore*”, VKM 500 datë 14.8.2001 “*Për inventarizimin PP Shtetërore dhe transferimin pronave Njësitë Vendore*” .

- **Bashkia Këlcyrë** ka miratuar listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore te saj dhe njërive administrative prej 39 flete, për **197 pasuri**, sipas kërkesave te VKM nr. 530, datë 01.05.2008 “*Për miratimin e listës së inventarit të pronave paluajtshme shtetërore në Bashkisë Këlcyrë, të Qarkut të Gjirokastrës*”.

- Njësia Administrative **Suke** ka miratuar listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore te saj dhe njërive administrative prej 46 flete, për **274 pasuri**, sipas kërkesave te VKM nr. 142, datë 08.03.2006 “*Për miratimin e listës së inventarit të pronave paluajtshme shtetërore në ish-komunën Suke, Këlcyrë, të Qarkut të Gjirokastrës*”.

- Njësia Administrative **Ballaban** ka miratuar listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore te saj dhe njërive administrative prej 28 flete, për **170 pasuri**, sipas kërkesave te VKM nr. 141, datë 08.03.2006 “*Për miratimin e listës së inventarit të pronave paluajtshme shtetërore në ish- komunën Ballaban, Këlcyrë, të Qarkut të Gjirokastrës*”.

-Njësia Administrative **Dishnice** ka miratuar listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore te saj dhe njërive administrative prej 46 flete, për **310 pasuri**, sipas kërkesave te VKM nr. 529, datë 01.05.2008 “*Për miratimin e listës së inventarit të pronave paluajtshme shtetërore në ish- komunën Dishnice, Këlcyrë, të Qarkut të Gjirokastrës*”. Gjithashtu ka ndryshuar me VKM 1031 datë 08.10.2009 “*Për miratimin e listës paraprake të pronave paluajtshme publike, shtetërore qe transferohen ne pronësi ose ne përdorim në ish- komunën Dishnice, Këlcyrë, të Qarkut të Gjirokastrës*”, për **182 pasuri**.

Njëkohësisht ka ndryshuar me VKM nr. 06 datë 04.01.2013 “*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave paluajtshme publike, shtetërore qe transferohen ne pronësi ose ne përdorim në ish- komunën Dishnice, Këlcyrë, të Qarkut të Gjirokastrës*”, për 48 flete dhe **316 pasuri gjithsejtë**.

**Bashkisë Këlcyrë për vitin 2023 nuk ka aplikuar dhe nuk ka pajisur me certifikate**

**pronësie pronat e paluajtshme shtetërore te sipërcituara, në territorin brenda juridiksionit saj, pranë ASHK Përmet, në kundërshtim me: ligjin nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësit e qeverisjes vendore” neni 18 ku citohet se:**

“...Të gjitha pronat , të cilat u kalohen në pronësi njësive të qeverisjes vendore, sipas këtij ligji, do të regjistrohen në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, me pronar njësinë përkatëse të qeverisjes vendore”;

me ligjin nr. 20/2020 “Për Kadastrën”, neni 43 “tarifat e regjistrimit për institucionet shtetërore dhe njësite e vetëqeverisjes vendore” pika 1 dhe 2 , e cila favorizon regjistrimin e pronave shtetërore me shërbime te reduktuara, me UMF 30 datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin aktiveve në njësitë publik” pikat 37, 42, 60, 74, me ligjit 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me pikat 20, 21, 22.

Ngarkohen me përgjegjësi **inspektori kadastrës O.H .**

Sipërfaqet e zonave te mbrojtura “Gryka Këlcyrë” dhe “Bredhi i Kalasë” janë nen administrimin e Agjencisë Zonave Mbrojtura dhe regjistrimi i tyre pranë ASHK i përket kësaj agjencie (AZM), sipas kërkesave te nenit 55 “Regjistrimi i sipërfaqeve zonave mbrojtura” te ligjit 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”.

#### **Pika 4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik**

**4.1.** Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

**4.2.** Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

**4.3.** Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit etj.), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

**4.4.** Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik fitues.

##### ***4.1 Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve***

Në dosjet e prokurimit nuk administrohen dokumente që të vërtetojnë që nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për vitet ushtrimore. Programi i nevojave nuk është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, si dhe në dosje nuk administrohen listat prioritare për investime.

##### ***4.2 Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara***

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronike të marra nga sistemi i SPE, konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Këlcyrë për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2023 deri më 31.12.2023, Bashkia Këlcyrë ka realizuar 3 procedura prokurimi me vlera

të larta, me vlerë të fondit limit 96,966,398.1 lekë pa tvsh, vlerë të lidhjes së kontratës 94,627,582.8 lekë pa tvsh dhe diferencë midis tyre në vlerën 2,338,815.3 lekë pa tvsh, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

	Objekti i prokurimit	Loji i procedurës së prokurimit	Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit	Data e lidhjes së kontratës	Fondi limit pa TVSh	Vlera e kontratës pa TVSh	Diferenca midis fondit limit dhe vlerës së kontratës	OE Fitues
1	Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara	E hapur	26.10.2023	15.12.2023	16,915,928.30	16,859,556	56,372.3	"A " " " & "E " ShPK
2	Karburant për automjetet	E hapur e thjeshtuar	27.02.2023	30.03.2023	5,808,334	5,806,775	1,559	"A " ShPK
3	Ndërtim Shkolle	Marrveshje kuadër	11.10.2023	14.11.2023	74,242,135.8	71,961,251.8	2,280,884	"Z " ShPK
	<i>Totali</i>				<i>96,966,398.1</i>	<i>94,627,582.8</i>	<i>2,338,815.3</i>	

**4.3.** Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit etj.), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

**1. Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt "Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara", vlerë të fondit limit 16.915.928,30 lekë pa tvsh, zhvilluar në vitin 2023**

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara".</b>			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> REF-82880-10-09-2023 Urdhri nr. 1 prot., datë 06.10.2023	<b>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit</b> Urdhri nr. 74, datë 14.09.2023 1. J.N 2. V.K 3. F.S	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> 1. J.N 2. V.K 3. F.S	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 76 prot., datë 15.09.2023 1. O.H 2. R.S 3. A.Q Ndryshuar me Urdhri nr. 86 prot., datë 26.10.2023 1. A.Q 2. O.H 3. E.B
<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 16.915.928.30 lekë	<b>5. Oferta fituese, vlera fituese:</b> Operatori Fitues: BOE "A " dhe "E " shpk 16.859.556 lekë pa tvsh ose 20.231.467,20 lekë me TVSH		<b>6. Diferenca me fondin limit</b> 56,372.3 lekë pa tvsh
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 26.10.2023	<b>8. Burimi Financimit</b> Buxheti i shtetit.		<b>9. Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender, Kualifikuar A /OE b) S'kualifikuar INA/OE, c) S'KualifikuarA /OE
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 3 muaj</b>			
<b>10. Ankimime</b> AK-s'ka/ka; APP-s'ka/ka; KPP-s'ka/ka	<b>11. Data e lidhjes të kontratës:</b> Nr. 2892 prot., datë 15.12.2023		<b>12. Përgjigje</b> Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK

**Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:**

***a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.***

***AK (Titullari i AK) në lidhje me “Përlllogaritjen e Fondit Limit”:***

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, në zbatim të LPP-së, është ngritur komision me urdhër nr. 74 datë 14.09.2023 “Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike”, me objekt “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”.

***Ky komision përbëhej nga dy anëtar, prej z. J.N dhe z.V.K***

Ky komision ka materializuar në një dokument të posaçëm fondin limit. Në rastin konkret, në proces verbalin pa numër, më datë 14.09.2023 (me korrigjim datë) i mbajtur prej z. J.N dhe z.V.K, si persona të ngarkuar me urdhër të titullarit për përlllogaritjen e fondit limit, specifikohet se: *Nga analiza zë për zë e çdo lloji punimi të parashikuar në preventivin e administruar rezulton se të gjitha çmimet e preventivit të objektit “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara” janë konform manualit në fuqi. Preventivi është i shoqëruar me analizat e çmimeve që bëjnë analizat e kostos për çdo zë të preventivit që është në manual. Gjithashtu edhe specifikimet teknike janë korrekte dhe i përgjigjen kërkesave të projektit dhe bazës ligjore në fuqi për prokurimet.*

Sa më sipër, procesverbali i hartuar nga ana e komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike nuk është hartuar në përputhje nënin 76 pika 2 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar “Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”, për arsye se ngelet në trajtën e një dokumenti formal ku mungon pikërisht të jetë argumentuar dhe dokumentuar në të mënyra e përlllogaritjes së vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet. Po ashtu, ky material (procesverbal) përmban vetëm dy nënshkrime në kundërshtim me VKM 285 datë 19.05.2021 neni 78 pika 2 sipas së cilit “Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit”.

***Observacion i paraqitur pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr.844 prot., datë 22.04.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 136/4 prot., datë 25.04.2024.***

Pretendimi i sjellë nga ana e subjektit është i njëjtë me observacionin e sjellë me shkresën nr. 450 prot., datë 05.03.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.136/2 prot., datë 06.03.2024 sjellë në fazën e projekt raportit.

***Komenti i grupit të auditimit:***

Risjellim në vëmendjen Tuaj se, sa më sipër kemi të bëjmë me një konstatim të grupit të auditimit, i cili i referohet përmbajtjes së dokumentit “Procesverbal” të datës 14.09.2023.

Kjo shkresë zyrtare (procesverbali) përmban vetëm dy nënshkrime dhe nga ana juaj nuk është argumentuar bazueshmëria ligjore e pretendimit të ngritur por është vijuar të citohet e njëjta gjë sikundër evidentuar nga grupi i auditimit.

Në kushtet e mossjelljes së dokumentacionit të ri justifikues që do të ndryshonte situatën, gjetja mbetet e njëjtë.

***Observacioni mësipërm nuk pranohet.***

***AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike”:***

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, në zbatim të LPP-së, është ngritur një komision paraprak me Urdhrin nr. 74 datë 14.09.2023 “Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike”.

Në rastin konkret, konstatohet se specifikimet teknike janë pjesë e dokumenteve të tenderit të përgatitura nga komisionit përkatës (specialisti i fushës), sipas urdhrin të sipërcituar. Preventivi për këtë investim është hartuar nga Z. J.N , inxhinier ndërtimi. Me urdhrin e prokurimit nr.75 prot., datë 15.09.2023, të titullarit të AK Z. K.N , është ngritur njësia e prokurimit e përbërë nga Z. J.N në cilësinë e Përgjegjës të njësisë së prokurimit, me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës, Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Znj.F.S , në cilësinë e anëtarit, me detyrë juriste e kontraktuar nga jashtë Bashkisë Këlcyrë dhe Z.V.K , në cilësinë e anëtarit, me detyrë përgjegjës i Zyrës Ujitjes dhe Kullimit.

***AK (NJP) në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriteve”:***

Në dokumentat standartë të tenderit (DST) , në pikën 2.2.3, të kapacitetit ekonomik dhe financiar, AK ka kërkuar: *“Vërtetim për shlyerje të taksave vendore parashikuar nga pushteti vendor, nga çdo njësi ku zhvillon aktivitetin operatori, për v.2022 dhe v.2023 sipas kërkesave të parashikuara në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar dhe vendimet e këshillave bashkiakë përkatës. Në rastet e BOE çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin e lëshuar nga Autoriteti përkatës vendor në të cilin ka zhvilluar aktivitet”.*

*Shënim:* Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit.

OE 2 AF ShPK në shtojcën nr.8 formular vetdeklarimi nuk është shprehur mbi këtë pikë

OE E ShPK bashkangjitur shtojcës nr.8 formular vetdeklarimi ka shprehur deklaratën e vet për pagesë të të gjitha taksave dhe tarifave vendore, por mungon shkresë justifikuese nga ana e NjPV.

Në dokumentat standartë të tenderit (DST) , në pikën 2.4.1/1, të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: *“Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:*

*- 1 (një) Arkitekt*

*- 1 (një) punonjës i pajisur me Certifikatë: “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”*

*- Minimumi 1 (një) punonjës i pajisur me Certifikatë: “Ekspert në fushën e Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtimin”*

Kërkesa për një arkitekt është e pa argumentuar teknikisht në procesverbalin e hartuar për argumentimin e kriteve të veçanta të DT. Nuk argumentohet lidhja me natyrën dhe tipologjinë e kontratës, dhe nevoja e specifikuar në preventiv për zëra punimesh që diktojnë nevojën për arkitekt. Ky kriter gjykohet si i pa nevojshëm, dhe pa lidhje të ngushtë me aftësinë zbatuese të kontratës, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, si dhe pikën 1 të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratë”.*

Gjithashtu nga auditimi i procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriteve për kualifikim, të hartuar nga njësia e prokurimit, konstatohet se kriteret e kapacitetit teknik nuk janë të argumentuara nga ana teknike. Në këtë procesverbal nga njësia e prokurimit është dokumentuar vetëm baza ligjore, e cila i jep të drejtën autoritetit kontraktor, që gjatë hartimit të kriteve mund t’u kërkojë ofertuesve plotësimin e një numri të caktuar kriteresh të nevojshme, por nuk është argumentuar teknikisht lidhja e kriterit të vendosur me



objektin e kontratës, me zërin konkret të preventivit. Kështu nuk janë dhënë argumenta për numrin e nevojshëm të kërkuar të punonjësve, numrin e nevojshëm të kërkuar të secilës makineri/paisje të kërkuar etj. Numri i punonjësve dhe i makinerive të kërkuara duhej të argumentohej në procesverbal, duke shpjeguar lidhjen e këtij numri me volumin e punimeve, orët e punës, grafikun e punimeve etj. Autoriteti kontraktor ka të drejtën e vendosjes së kriterëve të nevojshme që duhet të plotësojnë operatorët ekonomik, por njëkohësisht ka edhe detyrimin e argumentimit teknik të arsyes së vendosjes së këtyre kriterëve. Për sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:

- nenin 2 “Dokumentimi i procesit”, pika 2, gërma (c), ku thuhet:

*“Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën:... argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit...”*

- nenin 39, pika 6, gërma ç, ku thuhet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: *fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;*

-nenin 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 1 dhe 2, ku thuhet:

*Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi.*

*2. ...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit”.*

*Sa i takon kërkesës për punonjës të pajisur me certifikatën Ekspert në fushën e Mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtim, u konstatua heqja e këtij krteri në vijim pas komenteve të APP dhe reflektuar në Shtojcë për Modifikim DST Banesat.*

*Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi specialisti i fushës, hartues i kriterëve të seksionit të kapacitetit teknik, përgjegjës i njësisë së prokurimeve Z. J.N me detyrë përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës, Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, si dhe anëtarët e tjerë Znj.F.S dhe Z. V.K*

***Observacion i paraqitur pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr.844 prot., datë 22.04.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 136/4 prot., datë 25.04.2024***

Pretendimi i sjellë nga ana e subjektit është i njëjtë me observacionin e sjellë me shkresën nr. 450 prot., datë 05.03.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.136/2 prot., datë 06.03.2024 sjellë në fazën e projekt raportit.

***Komenti i grupit të auditimit:***

Sjellim në vëmendjen Tuaj se, referuar Procesverbal datë 09.10.2023 argumentimi i kryer nga ana Juaj rezulton të jetë:

*Argumentimi: ... Meqënëse objektet në tërrësi kanë një madhësi të konsiderueshme dhe konkretisht kemi të bëjme me banesa të cilat do të kërkojnë disa qasje arktonike rreth zgjidhjeve më të përshatshme nevojitet që të kemi prezent si pjesë e stafit mbështetës një arkitekt.*

Konstatimi i grupit të auditimit, ashtu sikundër në material dhe ballafaqim specifikuar, i referohet kërkesës për arkitekt, si të pa argumentuar teknikisht dhe të pa justifikuar lidhja me natyrën dhe tipologjinë e kontratës, apo nevoja e specifikuar në preventiv për zëra punimesh konkrete që diktojnë nevojën për arkitekt.

Specifikimi Juaj si, objekte me madhësi të konsiderueshme apo banesa që kanë nevojë për qasje arkitonike ngelet në terma subjektive dhe të justifikuara. Në kushtet e mungesës së dokumentacionit të ri justifikues konstatimi vijon të qëndrojë.

***Sa më sipër observacioni nuk pranohet.***

*Titulli i Gjetjes:* Mosargumentimi i çdo kriteri për kualifikim

Nga auditimi rezultoi se, në dy procedura prokurimi është operuar nga ana e AK me mosargumentim të çdo kriteri për kualifikim.

Kështu për procedurën “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara” në dokumentat standartë të tenderit (DST) , në pikën 2.4.1/1, të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: “Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

*1 (një) Arkitekt*

Kërkesa për një arkitekt është e pa argumentuar teknikisht në procesverbalin e hartuar për argumentimin e kriterëve të veçanta të DT. Nuk argumentohet lidhja me natyrën dhe tipologjinë e kontratës, dhe nevoja e specifikuar në preventiv për zëra punimesh që diktojnë nevojën për arkitekt. Ky kriter gjykohet si i pa nevojshëm, dhe pa lidhje të ngushtë me aftësinë zbatuese të kontratës, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, si dhe pikën 1 të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”.

Nga auditimi i procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, të hartuar nga njësia e prokurimit, konstatohet se kriteret e kapacitetit teknik nuk janë të argumentuara nga ana teknike. Në këtë procesverbal nga njësia e prokurimit është dokumentuar vetëm baza ligjore, e cila i jep të drejtën autoritetit kontraktor, që gjatë hartimit të kriterëve mund t’u kërkojë ofertuesve plotësimin e një numri të caktuar kriteresh të nevojshme, por nuk është argumentuar teknikisht lidhja e kriterit të vendosur me objektin e kontratës, me zërin konkret të preventivit. Operuar në kundërshtim me neni 2, pika 2, gërma (c); neni 39 pika 6 gërma ç, neni 78 pika 1 dhe 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,

✓ Për procedurën “Rikonstrukcion i shkollës 9 vjecare, Kamber Bënja” referuar Dokumenteve Standarte të Tenderit, rezulton se:

Në pikën 2.3.8 të Dokumenteve Standarte të Tenderit (DST) nga AK kërkohet që Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë minimalisht në pagesat e muajit të fundit, punonjës të specializuar/kualifikuar si më poshtë vijonë:

1 (një) përgatites i konstruksioneve metalike, 2 (dy) Specialist Fasade, dhe 2 (dy) Karpentierë që të disponojnë certifikatë trajnimi “Për punime në lartësi”, sipas VKM nr.312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet certifikata e trajnimit e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në pikën 2.3.9 të Dokumenteve Standarte të Tenderit (DST) nga AK kërkohet që Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë minimalisht në listëpagesat e muajit të fundit, punonjës të specializuar/të kualifikuar si më poshtë :

1 (një) punonjës të trajnuar dhe të kualifikuar për përdorimin dhe instalimin e kaldajave me avull dhe ujë të nxehtë sipas "Rregullores së sigurimit teknik të kaldajave të avullit dhe ujit të nxehtë" dhe ligjit Nr. 32/2016 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion". Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë;

1 (një) punonjës të trajnuar dhe të kualifikuar për përdorimin dhe instalimin e rezervuarëve të gazit (GLN ose LPG) mbi tokë dhe nëntokë sipas vendimit Nr. 1062, datë 23.12.2015 "Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet dhe bashkësitë nën presion" dhe ligjit Nr. 32/2016 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion". Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për sa më sipër, argumentimi teknik i kriterëve i shërben AK për të përcaktuar në mënyrë efikase nivelin e tyre. Mosargumentimi i kriterëve eventualisht mund të ndikojë tek AK për vendosjen e kriterëve në nivel më të ulët se ato të domosdoshme për realizimin e kontratës, çka përbën një risk të shtuar për realizimin në kohë dhe cilësi të objektit.

Operuar në kundërshtim me Aktet ligjore e nënligjore të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të trajtuara tek situata e gjetjes, VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

***AK (Personi Përgjegjës për Prokurimin) në lidhje me "zyrtarët pjesëmarrës në grupet e punës":***

Referuar procedurës së sipërcituar, specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit janë dhe anëtarët e njësisë së prokurimit janë të njëjtët. Të ndryshëm këta nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Lidhur me anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave konstatohet se me Urdhër të titullarit nr.86 datë 26.10.2023 është ndryshuar përbërja e KVO me një anëtar, ku anëtari R.S është zëvendësuar me E.B . Për këtë ndryshim mungon gjurma reflektuese në SPE.

***Observacion i paraqitur pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr.844 prot., datë 22.04.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 136/4 prot., datë 25.04.2024***

Pretendimi i sjellë nga ana e subjektit është i njëjtë me observacionin e sjellë me shkresën nr. 450 prot., datë 05.03.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.136/2 prot., datë 06.03.2024 sjellë në fazën e projekt raportit.

***Komenti i grupit të auditimit:***

Sjellim në vëmendjen Tuaj se, sa më sipër kemi të bëjmë me një evidentim të situatës nga ana e grupit të auditimit.

Sikundër herën e parë argumentuar, nga ana e grupit të auditimit me kredencialet e veta nuk arrin të gjenerohet dot kjo e dhënë, ndërkohë me anën e observacioneve nuk është sjellë provë e re që të ndryshojë faktet (screenshot apo spin i faktit).

***Observacioni i mësipërm nuk pranohet.***

**Neni 77 i LPP** ku përcaktohet: “Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratë”.

**Neni 39 pika 4 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar** “...Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve..”.

**Neni 39 pika 6 gërma ç) e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar** “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

*fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;*

**Neni 2 pika 2 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar** “Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën:...argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit...”.

**Neni 78 pika 1 dhe 2 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar,** *ku thuhet:*

*Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi.*

*2. ...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit”.*

*Sa i takon kërkesës për punonjës të pajisur me certifikatën Ekspert në fushën e Mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtim, u konstatua heqja e këtij kriteri në vijim pas komenteve të APP dhe reflektuar në Shtojcë për Modifikim DST Banesat.*

### **AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me “Administrimin e Dokumentacionit”:**

Referuar procedurave së sipërcituara, konstatohet se dosjet fizike të prokurimit, të cilat ndër të tjera përmbajnë procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj, nuk janë të pajisura me inventarin e brendshëm të dosjes.

*Referuar nenit 21, 59, 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, ndër të tjera, kërkohet që për çdo njësi ruajtjeje të hartohet inventari i brendshëm i dokumenteve që përmban njësia.*

Gjithashtu, referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Veprimtaria e Kontrollit, si një prej pesë komponentëve të MFK, përmban detyrimin e hartimit të procedurave për dokumentimin, arkivimin dhe ruajtjen e informacionit, të cilat duhet të vendosen për të mbështetur kryerjen e operacioneve dhe kontrollimin e proceseve në njësinë publike.

*Si konkluzion, mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara mbartin riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit.*

Për sa më sipër, AK (personi përgjegjës për prokurimin) të marrë masa për inventarizimin e të gjithë dokumentacionit në lidhje me procedurën e sipërcituara, duke dokumentuar të gjithë

procesin në rend kronologjik, sikurse kërkohet nga normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në RSH.

***Për sa më sipër mban përgjegjësi Z. J.N në cilësinë e Përgjegjësit të njësisë së prokurimit***

Për sa konstatuar më sipër, në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.05.2021 “Për prokurimin publik”, në vëmendje të personit përgjegjës për prokurimin.

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;  
Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”  
Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;  
Normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

**b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.**

Me urdhër nr. 76 prot., datë 15.09.2023 u ngrit Komisioni Vlerësimit të Ofertave me anëtar O.H , R.S dhe A.Q . Me Urdhër nr.86 datë 26.10.2023 të titullarit të Bashkisë, u ndryshuar Komisioni Vlerësimit të Ofertave ku anëtari R.S u zëvendësua me E.B . Nga auditimi u konstatua se, në SPE nuk rezulton gjurmë e pasqyrimin të këtij ndryshimi në anëtarët e KVO.

***Observacion i paraqitur pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr.844 prot., datë 22.04.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 136/4 prot., datë 25.04.2024***

Pretendimi i sjellë nga ana e subjektit është i njëjtë me observacionin e sjellë me shkresën nr. 450 prot., datë 05.03.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.136/2 prot., datë 06.03.2024 sjellë në fazën e projekt raportit.

Me urdhërin nr. 86 datë 26.10.2023, të Titullarit të AK, është ndryshuar një anëtar i KVO. (Anëtari R.S. është zëvendësuar me znj. E.B). Ndryshimi i anatarit dhe zëvendësimi i tij është reflektuar në SPE, sepse në qoftë se nuk reflektohet në SPE, nuk mund të hapen ofertat pjesëmarrëse (duhet të futen në SPE, unanimisht të tre anëtarët e KVO,me qëllim hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse në një procedurë prokurimi).

***Komenti i grupit të auditimit:***

Sjellim në vëmendjen Tuaj se, sa më sipër kemi të bëjmë me një evidentim të situatës nga ana e grupit të auditimit.

Megjithatë, nga ana juaj duhej të linte gjurmë ndryshimi i anëtarit me shënim në SPE.

Në mungesë të sjelljes së dokumentacionit të ri justifikues, observacioni nuk pranohet.

***Observacioni i mësipërm nuk pranohet.***

Në datën 13.12.2023, KVO ka hartuar raportin përmbledhës, protokolluar me nr.2870 prot., datë 13.12.2023.

Me shkresën nr. 2826 prot., datë 05.12.2023, titullari i autoritetit kontraktor Z. K.N ka miratuar procedurën e KVO (raportin përmbledhës) dhe ka shpallur fituesin.

Kohëzgjatja e kontratës: 3 muaj

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: *oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmim*

Në tender kanë marrë pjesë 3 operator ekonomik, sipas të dhënave të mëposhtme:

Nr	Operatorët pjesëmarrës në tender	Vlera në lekë e ofertës pa TVSH	Kualifikimi	NIPT
----	----------------------------------	---------------------------------	-------------	------

1	I	15,380,462	S'kualifikuar	J...Ë
2	"A "ShPK	14,149,952.16	S'kualifikuar	M...L
3	"A " "& "E "ShPK	16,859,556	Kualifikuar, fitues	L...J &K...P

**Arsyet e skualifikimit nga KVO të OE "I" sh.p.k,**

KVO i kërkoi ofertuesit të kualifikuar, i pari Operatorit Ekonomik I , më datë 23.11.2023, nëpërmjet postës elektronike (e-mail), dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike (origjinal ose fotokopje e noterizuar), në mbështetje të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, Autoriteti/enti Kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Operatori ekonomik I , nuk ka depozituar, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Këlcyrë, dokumentacionin e kërkuar, për procedurën e prokurimit me objekt: "Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara" me Nr. REF-82880-10-09-2023.

Në këtë mënyrë Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendosi të s'kualifikojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik I .

Arsyeja e skualifikimit të OE I SHPK është mos dorëzim i dokumentave provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, në trajtë fizike pranë AK. Ky kriter, në DST është specifikuar në trajtën e Shënim. Këto dokumenta janë ngarkuar elektronikisht në SPE.

**Konstatim:** Nga auditimi u konstatua se, nga ana e AK për OE I i cili në momentin e shpalljes paraprake si fitues, nuk ka vijuar me depozitimin e dokumenteve të kërkuara nga ana e Bashkisë Këlcyrë, **nuk ka gjurmë të mbajtjes së vlerës së sigurimit të ofertës prej 338.318,50 lekë.**

**Observacion i paraqitur pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr.844 prot., datë 22.04.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 136/4 prot., datë 25.04.2024.**

Pretendimi i sjellë nga ana e subjektit është i njëjtë me observacionin e sjellë me shkresën nr. 450 prot., datë 05.03.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.136/2 prot., datë 06.03.2024 sjellë në fazën e projekt raportit.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Sjellim në vëmendjen Tuaj se, oferta e ofruar nga OE I , e cila është klasifikuar si ofertë fituese në fazën e parë, ishte oferta ekonomikisht më e favorshme (me çmim më të ulët). Mos vijimi i procedurës nga ana e këtij operatori ekonomik nëpërmjet mosdepozitimit fizik të dokumentacionit në momentin e shpalljes si fitues ka bërë që të vijohet në OE të rradhës "A " "& "E "ShPK (sikundër baza ligjore në fuqi e lejon) e cila ishte oferta më e lartë. Ky veprim i OE I , (i cili në terma të bazës ligjore në fuqi prej jush nuk konsiderohet si tërheqje, në vetvete përbën pikërisht këtë fakt), i ka kushtuar buxhetit të shtetit diferencën e vlerave prej 1,479,094 lekë pa TVSH të paguara më tepër. Sa më sipër, për arsye të veprimit të OE "I." ka rezultuar vijimin me ofertën ekonomikisht më të lartë, duke shkaktuar përdorim pa efektivitet të fondeve publike, e për sa më sipër nga ana e AK duhet të mbahej vlera e sigurimit të kontratës.

Në mungesë të sjelljes së dokumentacionit të ri justifikues, observacioni nuk pranohet.

**Observacioni i mësipërm nuk pranohet.**

Si konkluzion, për sa konstatuar më sipër në zbatim të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, në vëmendje të komisionit të vlerësimit të ofertave.

**Neni 30 pika 6 gërma a) e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “...Autoriteti/enti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës, në rast të:**

*a) tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave;*

*b) mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese;*

*c) refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit. Në rast se kontrata nuk nënshkruhet nga ofertuesi fitues për ndonjë situatë të forcës madhore, autoriteti kontraktor nuk mban sigurimin e ofertës...”.*

### **Arsyet e skualifikimit nga KVO të OE “A ” sh.p.k,**

KVO shprehet se: Operatori Ekonomik “A ” sh.p.k, nuk plotëson pikën 2.4.1/1 të “Kapacitetit teknik” ku kërkohet: “*punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:*

- 1 (një) Inxhinier Ndertimi (profili strukturist)

OE “A ” sh.p.k në shtojcën 8, pika B, DEKLARATE “Për disponimin e punojësve te nevojshem per realizimin e punimeve objekt kontrate” në plotësim të pikës 2.4.1/1 të kapacitetit teknik, ka deklaruar z. A.K me profesion Inxhinier Ndertimi, i punësuar pranë shoqërisë, në cilesine e drejtuesit Ligjor dhe drejtuesit Teknik por nuk ka deklaruar profilin e ing sic eshte kerkuar ne kete kriter teknik per kualifikim.

Duke qenë se OE, nuk ka deklaruar 1 (një) Inxhinier Ndertimi me profil strukturist. OE, nuk e përmbushë kriterin nga pikëpamja e profilit të stafit inxhinierik teknik të kërkuar.

Kjo sepse, është detyrim ligjor i operatorit të plotësojë formularin e vetdeklarimit në të gjitha rubrikat dhe në formën e mënyrën e kërkuar në këtë formular vetdeklarimi si dhe kërkesat e AK-së.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Së dyti: OE, “A ” shpk, nuk nuk plotëson pikën 2.4.4 të “Kapacitetit teknik” Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë punë te vlefshme dhe diplome/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar, nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- Karpentier 2 (dy)
- Murator 2 (dy)
- Suvatues 2 ( dy)
- Hekurkthyes 2 (dy)

- Betonues 2 (dy)
- Bojaxhi 2 (dy)
- Teknik Ndertimi 2 (dy)
- 4 (kater) specialist te certifikuar per "Punime ne lartesi",
- 3 ( tre ) shofere
- 1 manovrator ( automakinist )

Shënim: Për pikat 2.4.1 -2.4.4, Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e pershkrimit korrekt ne Formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Për të dëshmuar plotësimin e këtij kriteri për kualifikim, operatori ekonomik, ka vetdeklaruar si te punesuar ne cilesine e specialistit Karpentier z Z.B dhe z V.M

Ne profesionin Suvatues ka vetdeklaruar z M.L dhe A.D

Ne profesionin Hekurkthyes ka vetdeklaruar z K.M dhe B.SH.

Nag verifikimi i ketyre vetdeklarimeve rezulton se:

Per specialistet Karpentierin z Z.B; Suvatuesin z M.L dhe Hekurkthyesin z K.M, deshmitë e kualifikimit profesional janë lëshuar nga Qendra e Kurseve Fier.

Nga verifikimi që bëri KVO, në faqen zyrtare [www.qkb.gov.al](http://www.qkb.gov.al), në seksionin Kërko për Licence, për shoqërinë "A.D" me NUIS K...R, rezulton se kjo shoqëri është pajisur me licensen LN-0497-11-2009 me datë lëshimi 14.09.2011 me objekt;

Kurse formim profesionale për: Saldator; Hidraulik; Panele diellore; Sistem ngrohje; Elektrik; Hoteleri - Turizëm: (Guzhinier, Banakier, Kamarier, Pastiçer); Rrobaqepsi; Qëndistari; Gjuhë e huaj: (Anglisht, Italisht); Kompjuter; Riparues për Elektroshtëpiake;

Po kështu, nga verifikimi në objektin e veprimtarisë së regjistruar në QKB në ekstraktin e personit Fizik "A.D", rezulton se objekti i veprimtarisë së këtij subjekti është: Kurse profesionale për saldator, hidraulike, panele diellore, sistem ngrohje, elektrik, hoteleri-turizëm (guzhinier, pasticeri, banakier, kamarier), rrobaqepësi, qëndistari, parukeri estetike, gjuhë e huaj, kompjuter, elektroshtëpiake, elektroauto dhe mekanik, kurse berber.

Qartazi evidentohet se, subjekti "A.D" "NUIS K...R as nuk ka objekt të veprimtarisë së vet kurse formimi profesional për specialitet Karpentier, Suvatues dhe Hekurkthyes si dhe as nuk është licensuar për këto specialitete.

Nëpërmjet Vetdeklarimit që ka bërë operatori ai pranon se, dëshmitë e kualifikimit profesional për Karpentierin z Z. B ; Suvatuesin z M.L dhe Hekurkthyesin z K.M, janë lëshuar nga Qendra e Kurseve Fier. Lëshimi i dëshmime të kualifikimit profesional nga subjekte që nuk e kanë në objekt të veprimtarisë të regjistruar në QKB si dhe nuk janë pajisur me licensë nga organi që ligji i ka dhënë këtë të drejtë, i përbën këto dokumenta të pavlefshme e për pasojë nuk mund të merren në konsideratë nga KVO çka përbën mospërmbushje të këtij kriteri për kualifikim.

Për sa më sipër, OE "A" ShPK është në kushtet e mospërmbushjes së pikës 2.4.4 të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit objekt prokurimi, për sa i perket numrit 2 (dy) të kërkuar të specialisteve në profesionet Karpentier, Suvatues dhe Hekurkthyes, pasi nëpërmjet vetdeklarimit ka pranuar se për këto specialitete dëshmitë janë lëshuar nga subjekti i palicensuar dhe i parregjistruar në QKB për këtë objekt veprimtarie.



Së treti: OE ka bërë ndryshime në strukturën e preventivit përmbledhës, duke ndryshuar sasinë e zërit nr analiz 2 166 me emërtim F V hekur betoni periodik fi 6-10 mm nga 2.94 ton ne 2.04 ton .

Pra nuk ka ndryshuar nr e analizës e këtij zeri punimesh, por ka ndryshuar sasine e ketij zeri duke paraqitur sasi më të ulët nga ajo e preventivit të publikuar nga AK-ja.

Në Seksioni I: “Udhëzime për Operatorët Ekonomikë”, pika B “PËRGATITJA E OFERTAVE”, nënpika 4 “Formularët e tenderit dhe preventivat e Çmimeve”, dhe nënpika 6/2 “Çmimet”, të dokumenteve të tenderit është përcaktuar, si më poshtë:

1. Formularët e tenderit dhe preventivat e Çmimeve

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqëruar duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues.

6. Çmimet.

2. Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar zërat e punimeve që do të realizohen, sasi të dhe çmimin e tyre në rastin kur në kohën e ofertimit është e mundur (ka një projekt-preventiv mbi bazën e të cilit të do realizohen punimet).

Në këtë rast operatori ka vepruar në kundërshtim me këto Udhëzime e Përcaktime të DST duke paraqitur zërin e preventivit me sasi të ndryshuar nga sasia e përcaktuar në preventivin e publikuar nga AK në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) .

Nuk jemi në rastin e gabimeve aritmetike sepse në nenin 82 të VKM 285/2021, janë përcaktuar në mënyrë shteruese tre rastet të cilët konsiderohen gabime aritmetike:

Citohet nëneni 82 pika 3 e VKM 285/2021:

- a) Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij
- b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.
- c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur shuma në fjalë ka lidhje me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, për rrjedhojë, në këtë rast, mbizotëron shuma në shifra dhe ajo në fjalë do të korrigjohet.

Në rastin konkret operatori ka ndryshuar sasinë e zërit në preventiv dhe nuk ka gabime aritmetike, ndryshime të cilat janë të papranueshme.

Skualifikimi për ndryshime në preventiv, është praktikë e konsoliduar e KPP- së.

Për këtë arsye, mbështetur në nenin 92/3 të LPP-së , ku përcaktohet se: “... Autoriteti ose Enti Kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit,...” vendos skualifikimin e Operatorit Ekonomik “A ” shpk

### **Mbi kualifikimin e BOE ”A ” & “E ” ShPK**

Në kontratën e bashkëpunimit midis BOE ”A ” & “E ” ShPK, është vendosur që përfaqësuesi i BOE do të jetë OE ”A ” ShPK dhe palët kanë rënë dakord që përqindja e pjesëmarrjes për realizimin e kontratës do të jetë: OE “A ” ShPK do të kryej 2.02% të punimeve, e cila konsiston

në realizimin vetëm të zërit “Tavan me material rapote”, ndërsa OE “E ” ShPK do të realizojë 97.98% të kontratës, e cila konsiston në realizimin e të gjithë zërave të tjerë të preventivit, përveç zërit që do të realizojë OE ”A ” ShPK.

- Në pikën 2.3 seksioni i kapacitetit teknik të DT, nën pikën 2.8 janë listuar kërkesat që OE duhet të disponojnë (pronësi apo qera) si vijojnë:

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues	3 copë	Pronësi ose me qera
Kamioçinë (kapaciteti mbajtës deri ne 3.5 (tre pike pese) ton	2 cope	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Betoniere 500l	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Skela metalike (forme H) të kompletuara	750 m2	Pronësi ose me qera
Pompe suvatimi	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me vinc	1 copë	Pronësi ose me qera
Gjenerator	1 copë	Pronësi ose me qera
Stafatrice elektronike per perpunimin e hekurit	1 copë	Pronësi ose me qera

- kokore minimumi 20 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5 – 7 litra secila minimumi 5 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë

Nga auditimi u konstatua se, referuar shtojcës nr.8 vetdeklarimi BOE “A ” ShPK dhe “E ” ShPK nuk kanë vërtetuar se disponojnë mjetet e kërkuara nga ana e AK me statusin pronësi osë qera. Disponimi i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetë deklaramit (shtojca 8) gjatë fazës së ofertimit. Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetë deklaramit sipas shtojcës 8.

Por nga auditimi i formularit përmbledhës të vetë deklaramit të paraqitur nga OE “E ” ShPK, nuk janë deklaruar se disponohen elementët e sigurisë (kokore, fikse zjarri, komplet ndihmës së shpejtë dhe tabela paralajmëruese) si është kërkuar në DT.

Operatori tjetër ekonomik “A ” ShPK ka deklaruar se disponon:

- Kokore 30 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5 – 7 litra secila 5 copë
- Doreza pune 120 copë
- Uniforma/jelek pune 35 copë

*Ndërkohë fatura bashkangjitur dosjes së prokurimit mbante nr.serail 121931715, nr.fature SO-35957 dhe datë 24.11.2015 dhe jo datë 29.12.2022 sikundër është deklaruar në shtojcën nr.8*

- Sa më sipër mungojnë 2 nga 4 kërkesat e parashikuara për efekt sigurie në kantier, si kompletet e ndihmës së shpejtë dhe tabelat paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë.
- Nga auditimi dokumentacionit rezultoj mungesë e gjurmës justifikuese lidhur me përmbushjen e nënkritereve 2.8 për kamionin vetshkarkues me peshë pa ngarkesë 11625 kg dhe me ngarkesë 26000 kg, fotografia bashkangjitur mjetit të targuar nuk është e dukshme, duke mos plotësuar nën pikën 2.8 gërma a) të kritereve klasifikuese të DT;
- për pajisjen skela metalike (formë H) të kompletuara mungon dokumentacioni justifikues deklarata doganore R 17820 me datë 20.11.2020 duke mos plotësuar nën pikën 2.8 të kritereve klasifikuese të DT;

*Sa më sipër nga ana e AK është operuar duke kryer vlerësimi të OE dhe kualifikim të tij pa kërkuar paraprakisht shpjegime mbi mangësitë në plotësimin e kriterëve.*

Veprimet e mësipërme janë kryer jo në përputhje me:

- ✓ nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku thuhet: *“Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit...”*
- ✓ nenin 82, pika 2, paragrafi IV, të VKM nr.285, datë 23.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar., ku thuhet: ... *“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme...  
...Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.*

***Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO: Z. O.H , Z. A.Q , Znj. E.B***

***Observacion i paraqitur pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr.844 prot., datë 22.04.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 136/4 prot., datë 25.04.2024.***

Pretendimi i sjellë nga ana e subjektit është i njëjtë me observacionin e sjellë me shkresën nr. 450 prot., datë 05.03.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.136/2 prot., datë 06.03.2024 sjellë në fazën e projekt raportit.

***Komenti i grupit të auditimit:***

Sjellim në vëmendjen tuaj se, sikundër herën e parë argumentuar, konstatimi i grupit të auditimit i referohet mos përmbushjes së plotë të kërkesave listuar në pikën 2.3., nën-pikën 2.8 të seksioni i kapacitetit teknik të DT, konkretisht duke marr si të mirëqënë faturën SO-35957 sërisht 2 nga 4 kërkesat e parashikuara për efekt sigurie në kantier, si kompletet e ndihmës së shpejtë dhe tabelat paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë nuk rezultojnë prezente. Po ashtu në bazë të dokumentacionit vendosur në dispozicion nga ana juaj, rezulton mos plotësim i nën-pikës 2.8 gërma a) të kriterëve klasifikuese të DT që .. a) *Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.;*

Në mungesë të sjelljes së dokumentacionit të ri justifikues, observacioni nuk pranohet.

***Observacioni mësipërm nuk pranohet.***

Si konkluzion, për sa konstatuar më sipër në zbatim të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, në vëmendje të njësisë së prokurimit (*specialistit të fushës*).

***Neni 82, pika 2, paragrafi IV të VKM nr. 285, datë 23.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme...”***

*...Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.*

**Neni 92 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”** sipas të cilit: *“Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit...”*

**Titulli i Gjetjes :** Vlerësimi i shoqërive (B/OE) pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit dhe kualifikimi i tyre pa kërkuar paraprakisht shpjegime mbi mangësitë në plotësimin e kriterëve. Nga auditimi rezultoi se në dy procedura vlerësimi i shoqërive pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit dhe kualifikimi i tyre pa kërkuar paraprakisht shpjegime mbi mangësitë në plotësimin e kriterëve, konkretisht:

- Për procedurën “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara” Në kontratën e bashkëpunimit midis BOE ”A ” ShPK & “E ” ShPK, është vendosur që përfaqësuesi i BOE do të jetë OE ”A ” ShPK dhe palët kanë rënë dakord që përqindja e pjesëmarrjes për realizimin e kontratës do të jetë: OE “A ” ShPK do të kryej 2.02% të punimeve, e cila konsiston në realizimin vetëm të zërit “Tavan me material rapote”, ndërsa OE “E ” ShPK do të realizojë 97.98% të kontratës, e cila konsiston në realizimin e të gjithë zërave të tjerë të preventivit, përveç zërit që do të realizojë OE ”A ” ShPK.

- ✓ Në pikën 2.3 seksioni i kapacitetit teknik të DT, nën pikën 2.8 janë listuar kërkesat që OE duhet të disponojnë (pronësi apo qera). Nga auditimi i formularit përmbledhës të vetë deklarimit (form.8) të paraqitur nga OE “E ” ShPK, nuk janë deklaruar se disponohen elementët e sigurisë (kokore, fikse zjarri, komplet ndihmës së shpejtë dhe tabela paralajmëruese) si është kërkuar në DT.

Sa më sipër mungojnë 2 nga 4 kërkesat e parashikuara për efekt sigurie në kantier, (kompletet e ndihmës së shpejtë dhe tabelat paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë).

Nga auditimi dokumentacionit rezultoj, mungesë e gjurmës justifikuese lidhur me përmbushjen e nënkritereve 2.8 për kamionin vetshkarkues me peshë pa ngarkesë 11625 kg dhe me ngarkesë 26000 kg, fotografia bashkangjitur mjetit të targarit nuk është e dukshme, duke mos plotësuar pikën 2.8 gërma a) të kriterëve klasifikuese të DT;

për pajisjen skela metalike (formë H) të kompletuara mungon dokumentacioni justifikues deklarata doganore R 17820 me datë 20.11.2020 duke mos plotësuar pikën 2.8 të kriterëve klasifikuese të DT;

- si dhe në procedurën “Karburant për Automjete”

Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë prokurimi, konstatohet se KVO-ja ka kryer veprime të cilat bien ndesh me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vlerësimit rezulton se AK nuk ka kërkuar dokumenta shtesë apo shpjegime mbi mangësitë në plotësimin e kriterëve nga ana e OE si:

- shkresa me objekt “Kthim përgjigje” nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial rezultonte pa datë, dhe në të specifikohet se: “A ” ShPK me NIPT L...E nuk ka asnjë masë

administrative për shkelje të cilësisë së karburantit deri më 12.12.2022, ndërkohë kjo procedurë prokurimi është nisur në vitin 2023 dhe urdhër prokurimi është nxjerr në muajin shkurt.

- në deklaratën e OE shtojca 8 vetëdeklarimi, paragrafi D. Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës, specifikohet se: OE ka masë ligjore në fuqi, të vendosur nga ISHPSHSH. OE ka ankimuar brenda afatit ligjor pranë Gjykatës Administrative Korçë për vendimin e marrë nga ISHPSHSH. Por mungonë në dosje praktika lidhur me këtë çështje apo kopje e ankimit në Gjykatë;

Kualifikimi i shoqërive (B/OE) pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit, pa kërkuar dhe dokumentuar paraprakisht shpjegimet mbi mangësitë në plotësimin e kriterëve, qofshin këto edhe devijime të vogla, përbën një risk të shtuar për realizimin e kontratës.

Sa më sipër operuar në kundërshtim me nenin 92 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 82 pika 2 paragrafi IV i VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar

#### ***b- Në lidhje me kontratën.***

Mes AK dhe BOE “A ” sh.p.k dhe “E ” sh.p.k është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes me nr.2892 datë 15.12.2023 me afat 3 muaj nga data e nënshkrimit. Aktualisht objekti është në fazën e punimeve në terren.

Vlera totale e kontratës 20,231,467.20 lekë me tvsh, planifikuar likuidimi: viti 2023 në shumën 10,149,556.66 lekë pa tvsh, viti 2024 në shumën 6,766,371.6 lekë pa tvsh.

Referuar Urdhër shpenzimeve rezulton likuiduar për v.2023 totali prej 10,149,556.66 lekë pa tvsh apo 12,179,465 lekë me tvsh. (Nga auditimi dokumentacionit justifikues u konstatua prania e dy urdhër shpenzimeve konkretisht, U.Sh nr 510 datë 26.12.2023 me vlerë 11,570,492 lekë për shpenzime operatori/situcion punimesh dhe U.Sh 511 datë 26.12.2023 me vlerë 608,973 lekë 5% i garancisë së punimeve)

Likuiduar sipas grafikut të parashikuar për v.2023.

#### ***Plan monitorimi të zbatimit të kontratës***

Nga auditimi konstatohet se, Bashkia Këlcyrë nuk ka hartuar plan të monitorimit të zbatimit të kontratës dhe nuk ka përcaktuar person apo grup pune për monitorimin e zbatimit të kontratës, për mbikëqyrjen e veprimtarinë së kontraktorit, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë dhe legjislacionin në fuqi, për çështjet organizative të kontratës, afatet, çështjet ekonomike teknike etj. Operuar sa më sipër në kundërshtim me nenin 124 pika 3 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik” sipas së cilit specifikohet se: *...Plani duhet të nënshkruhet nga autoriteti/enti kontraktor dhe operatori ekonomik, brenda 7 (shtatë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe, në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj. Një kopje e këtij plani i dërgohet APP-së brenda 5 (pesë) ditëve nga nënshkrimi.*

*Personi përgjegjës për prokurimin, ka patur detyrimin që të raportojë pranë APP informacionin lidhur me monitorimin e zbatimit të kontratës, detyrë të cilën nuk e ka kryer, pasi ka munguar informacioni për shkak të mos përcaktimit nga titullari të personit për monitorimin e zbatimit të kontratës. Nga auditimi nuk u konstatua që në rrugë shkresore, personi përgjegjës për prokurimin të ketë vënë në dijeni titullarin e autoritetit kontraktor, për mungesën e këtij informacioni i cili ka sjellë dhe mos përmbushjen e detyrës nga personi përgjegjës për prokurimit, gjë që e ngarkon me përgjegjësi Z.J.N*

Si konkluzion, për sa konstatuar më sipër në zbatim të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, në vëmendje të njësisë së prokurimit (*specialistit të fushës*).

**Neni 124, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,** ku përcaktohet se: “Për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti ose enti kontraktor, nisur nga natyra e objektit të kontratës dhe kohëzgjatja e zbatimit të saj, harton planin e zbatimit të kontratës, duke përfshirë në veçanti çështjet organizative, afatet, çështjet ekonomike e teknike të kontratës së nënshkruar, në përputhje me çdo akt tjetër ligjor. Plani i zbatimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj. Çdo modifikim i kontratës në përputhje me nenin 127 të këtij ligji, pasqyrohet në planin e zbatimit. Autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me planin, ndjek zbatimin e kontratës, administron dokumentacionin e monitorimit dhe harton raportet e monitorimit”

**Neni 107 i VKM nr. 285, datë 23.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar:** “Personi apo strukturat e ngarkuara për ecurinë e zbatimit të kontratës, në funksion të legjislacionit të prokurimit publik ka/në këto përgjegjësi:

- a) Harton e ndjek ecurinë e planit të zbatimit të kontratës;
- b) Kryen monitorimin e zbatimit të detyrimeve të palëve në kontratë, në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë;
- c) Administron dhe verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga kontraktori, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- ç) Sigurohet për kontrollin real e ligjor të kostove, cilësisë, dhe afateve, kur është rasti;
- d) Menaxhon dhe trajton problematikat që shfaqen gjatë ekzekutimit të kontratës dhe që nuk sjellin domosdoshmërisht ndryshime/modifikime/përshtatje të saj;
- dh) Raporton te titullari i autoritetit/entit kontraktor për shkelje të dispozitave kontraktuale;
- e) Administron kërkesat për ndryshime/modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës, dhe sigurohet që këto kërkesa të kalojnë për miratim në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë;
- ë) Mban korrespondencën e përditësuar me të gjitha dokumentet e shkëmbyera me kontraktorin lidhur me zbatimin e kontratës;
- f) Përgatit informacion për çështjet e sipërcituara dhe ia përcjell personit përgjegjës për prokurimin, i cili raporton pranë APP-së”.

## **2. Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Karburant për automjetet”, vlerë të fondit limit 5,808,334 lekë pa tvsh, zhvilluar në vitin 2023**

*Të dhëna mbi objektin e prokurimit:*

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Karburant për automjetet”,.REF-59218-02-15-2023</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi</b> nr.14, datë 07.02.2023 / nr.16 datë 10.02.2023 Njësia e Prokurimit 1. F.S (përgjegjës) 2. J.N 3. V.K	<b>3. Komisioni përlogaritjes së vlerës limit,</b> ngritur me urdhrin nr.13, datë 06.02.2023 1. J.N , 2. V.K ,	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:</b> Urdhër nr. 15, datë 07.02.2023 1. Q.P , 2. O.H , 3. A.Q Për vlerë fondi limit 5,808,334 lekë Urdhër nr. 17, datë 10.02.2023 1. Q.P , 2. O.H , 3. A.Q Për vlerë fondi limit 5,808,204 lekë
<b>2.Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “E hapur e thjeshtuar” REF-59218-02-15-2023		
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> 5,808,334 lekë	<b>6.Oferta fituese: “A ” ShPK</b> 5,806,775 lekë (pa tvsh)	<b>7.Diferenca me fondin limit</b> 1,559 lekë (pa tvsh)

<b>8. Data e hapjes (zhvillimit) të tenderit:</b> 27.02.2023	<b>9. Burimi Financimit:</b> Buxheti shtetit 5,391,667 lekë + vetfinancim 416,667 lekë	<b>10. Operoret Ekonomik</b> a) Pjesëmarrës në tender: 1 OE b) S'kualifikuar - c) Kualifikuar 1 OE
<b>11. Ankimime:</b> AK: Nuk ka patur ankesa	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK:</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP:</b>
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> 30.03.2023	<b>15. Vlera e kontratës:</b> 6,968,130 lekë me TVSH	<b>16. Likuiduar deri</b> 24.10.2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *“Karburant për Automjete” sasi të dhe kohëzgjatja e kontratës: deri më 31.12.2023.*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

**Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:**

*a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.*

**AK (Titullari i AK) në lidhje me “Përlllogaritjen e Fondit Limit”:**

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, në zbatim të LPP-së, është ngritur një komision paraprak me urdhrin nr. 13 datë 06.02.2023 “Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit të kontratës, përcaktimit të specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit me objekt: *“Karburant për Automjete”*. Theksojmë se mënyrat në lidhje me përlllogaritjen e fondit limit përcaktohen në nenin 76 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021, i ndryshuar.

Për përlllogaritjen e fondit limit kanë marrë pjesë 2 nga 3 anëtarët e njësisë së prokurimit pa përgjegjësin e njësisë, në kundërshtim me VKM nr.285 datë 19.05.2021 neni 74, pika 2 e cila specifikon: *Në çdo rast, numri i anëtarëve të njësisë së prokurimit duhet të jetë numër tek dhe neni 78 pika 2 e cila specifikon: Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit.*

**Observacion i paraqitur pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr.844 prot., datë 22.04.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 136/4 prot., datë 25.04.2024.**

Pretendimi i sjellë nga ana e subjektit është i njëjtë me observacionin e sjellë me shkresën nr. 450 prot., datë 05.03.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.136/2 prot., datë 06.03.2024 sjellë në fazën e projekt raportit.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Nga ana juaj nuk është argumentuar bazueshmëria ligjore e pretendimit tuaj, pasi neni 78 pika 2 e cila specifikon: *Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit.*

**Observacioni i mësipërm nuk pranohet**

Sipas procesverbalit të datës 09.02.2023, të mbajtur për efekt të pasqyrimin të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përlllogaritjen e fondit limit ka zbatuar dispozitën e sipërcituar.

*Nga auditimi konstatohet se, nga ana e AK ka një problematikë lidhur me nxjerrjen e Urdhrave të Prokurimit dhe Urdhrrat për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave duke cuar në moszbatim të bazës ligjore, konkretisht:*

Nga auditimi u konstatua prania e dy Urdhrave të ndryshëm prokurimi,

1. Urdhër Prokurimi nr.14 datë 07.02.2023 me vlerë fondi 5,808,334 lekë pa tvsh dhe  
2. Urdhër Prokurimi nr.10 datë 10.02.2023 me vlerë fondi 5,808,204 lekë pa tvsh  
Në SPE rezulton si vlerë fondi limit 5,808,334 lekë pa tvsh pra ai i përcaktuar në Urdhrin e datës 07.02.2023.

1. KVO ngritur me Urdhër nr.15 datë 07.02.2023 për vlerë fondi limit 5,808,334 lekë  
2. KVO ngritur me Urdhër nr.17 datë 10.02.2023 për vlerë fondi limit 5,808,204 lekë  
Procesverbali argumentues mban datën 09.02.2023, pra është hartuar pas nxjerrjes së U.P të parë i cili ka dhe fondin limit të përcaktuar që është marr si referencë në vijim. Sa më sipër, operuar në kundërshtim me pikën 2, të nenit 76 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar konkretisht: *Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.*

***Observacion i paraqitur pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr.844 prot., datë 22.04.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 136/4 prot., datë 25.04.2024***

Sic edhe e theksuam ne observacionet e meparshme, Ju sqarojmë se ky është një lapsus njerzor. E gjithë procedura është nisur dhe përfunduar me vlerën e fondit limit të përcaktuar në Urdhërin e prokurimit nr.14 dt.07.02.2023. Fakti që në SPE është vlera 5,808,334 ( pesëmilion e tetëqind e tetëmijë e treqind e tridhjetë e katër ) lekë pa tvsh, vërteton se ky është një lapsus njerzor. (bashkëngjitur do të gjeni dhe procesverbalin e përlllogaritjes së fondit të ngritur me Urdhërin nr.13 datë 06.02.2023).

**Përsa cituam më lart gjetjet e grupit të audituesve nuk qëndrojnë dhe për rrrjedhojë nuk duhen marrë parasysh në projekt raport.**

***Komenti i grupit të auditimit:***

Sjellim në vëmendjen Tuaj se, mbajmë të njëjtin qëndrim sikundër në projekt raport. Së pari, jemi në kushtet e jo vetëm nxjerrjes së dy Urdhër Prokurimi të ndryshëm, por vijimin duke ngritur dhe dy KVO të ndryshme me përcaktimin e dy fondeve limit të ndryshëm. Nga ana tjetër, fondi limit me të cilin është vijuar procedura, i cili është i pari i përlllogaritur është më i lartë se i dyti, e nga ana juaj nuk është argumentuar ky fakt. Po ashtu, procesverbali argumentues është hartuar pas nxjerrjes së U.P të parë i cili ka dhe fondin limit të përcaktuar që është marr si referencë në vijim.

***Observacioni i mësipërm nuk pranohet***

***Sa më sipër mban përgjegjësi Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit si dhe njësia e prokurimit z.J.N , z. V.K , znj.F.S***

Ky komision ka materializuar në një dokument të posaçëm fondin limit. (i cili mban nënshkrim të vetëm 1 anëtar z.J.N ). Në rastin konkret, sipas specifikimeve teknike të siguruara është përlllogaritur dhe fondi limit, në vlerën 5,808,204 lekë pa tvsh, i ndryshëm nga ai i paraqitur në SPE.

E gjithë procedura e mëvonshme është kryer me fond limit tjetër (për të cilin mungon dhe përlllogaritja), jo atë të përcaktuar në procesverbalin e datës 09.02.2023.

Si konkluzion, për sa konstatuar më sipër në zbatim të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, në vëmendje të njësisë së prokurimit (*specialistit të fushës*).



**Neni 74, pika 2 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar** ku përcaktohet: “Në çdo rast, numri i anëtarëve të njësisë së prokurimit duhet të jetë numër tek”.

**Neni 76, pika 2 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar** Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

**Neni 78, pika 2 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar** ku përcaktohet: Në çdo rast, hartimi i dokumenteve të tenderit duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...”.

**Neni 45 pika 2.1 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar** “...Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlllogaritet bazuar në: a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike; b) elementet fiskale; c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës”.

**Neni 76 pika 2 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, e ndryshuar** “...Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht: Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

Nga auditimi dokumentacionit rezultoj se,

- shkresa me objekt “Kthim përgjigje” nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial rezultonte pa datë, dhe në të specifikohet se: “A ” ShPK me NIPT L...E nuk ka asnjë masë administrative për shkelje të cilësisë së karburantit deri më 12.12.2022, ndërkohë kjo procedurë prokurimi është nisur në vitin 2023 dhe urdhër prokurimi është nxjerr në muajin shkurt.
- në deklaratën e OE shtojca 8 vetëdeklarimi, paragrafi D.Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës, specifikohet se: OE ka masë ligjore në fuqi, të vendosur nga ISHPSHSH. OE ka ankimuar brenda afatit ligjor pranë Gjykatës Administrative Korçë për vendimin e marrë nga ISHPSHSH. Por mungonë në dosje praktika lidhur me këtë çështje apo kopje e ankimit në Gjykatë;

Nga ana e AK nuk janë kërkuar dokumenta shtesë apo shpjegime mbi mangësitë në plotësimin e kriterëve nga ana e OE.

**Observacion i paraqitur pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr.844 prot., datë 22.04.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 136/4 prot., datë 25.04.2024** Pretendimi i sjellë nga ana e subjektit është i njëjtë me observacionin e sjellë me shkresën nr. 450 prot., datë 05.03.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.136/2 prot., datë 06.03.2024 sjellë në fazën e projekt raportit.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Nga ana juaj në observacion specifikohet bashkangjitja e ankimit në Gjykatën e Shkallës së Parë Korçë të masës së gjobës së marr, por në dokumentacion e sjell më shkresën nr.450 prot., datë 05.03.2024 nuk rezulton gjurma e një dokumenti të tillë. Me anë të postës elektronike është dërguar kërkesë padi drejtuar

1. Drejtorisë Rajonale të ISHPSHSH Korçë;

2. Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore

3. Avokatura e Shtetit

Për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, por shkresat bashkangjitur nuk përbëjnë dokument ligjor në kushtet e mungesës së ekstremiteteve të depozitimit në Gjykatë.

***Observacioni i mësipërm nuk pranohet***

Nga auditimi mbi tenderat në dy raste rezultoi se, vlerësimi i shoqërive (B/OE) pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit dhe kualifikimi i tyre është kryer pa kërkuar paraprakisht shpjegime mbi mangësitë në plotësimin e kriterëve, konkretisht:

- ✓ Në kontratën e bashkëpunimit midis BOE "A" ShPK & "E" ShPK, është vendosur që përfaqësuesi i BOE do të jetë OE "A" ShPK dhe palët kanë rënë dakord që përqindja e pjesëmarrjes për realizimin e kontratës do të jetë: OE "A" ShPK do të kryej 2.02% të punimeve, e cila konsiston në realizimin vetëm të zërit "Tavan me material rapote", ndërsa OE "E" ShPK do të realizojë 97.98% të kontratës, e cila konsiston në realizimin e të gjithë zërave të tjerë të preventivit, përveç zërit që do të realizojë OE "A" ShPK.
- Në pikën 2.3 seksioni i kapacitetit teknik të DT, nën pikën 2.8 janë listuar kërkesat që OE duhet të disponojnë (pronësi apo qera). Nga auditimi i formularit përmbledhës të vetë deklaramit (form.8) të paraqitur nga OE "E" ShPK, nuk janë deklaruar se disponohen elementët e sigurisë (kokore, fikse zjarri, komplet ndihmës së shpejtë dhe tabela paralajmëruese) si është kërkuar në DT.

Sa më sipër mungojnë 2 nga 4 kërkesat e parashikuara për efekt sigurie në kantier, (kompletet e ndihmës së shpejtë dhe tabelat paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë).

- Nga auditimi dokumentacionit rezultoj, mungesë e gjurmës justifikuese lidhur me përmbushjen e nënkritereve 2.8 për kamionin vetshkarkues me peshë pa ngarkesë 11625 kg dhe me ngarkesë 26000 kg, fotografia bashkangjitur mjetit të targaruar nuk është e dukshme, duke mos plotësuar pikën 2.8 gërma a) të kriterëve klasifikuese të DT;
- për pajisjen skela metalike (formë H) të kompletuara mungon dokumentacioni justifikues deklarata doganore R 17820 me datë 20.11.2020 duke mos plotësuar pikën 2.8 të kriterëve klasifikuese të DT;

si dhe në procedurën *Karburant për Automjete*

- ✓ Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë prokurimi, konstatohet se KVO-ja ka kryer veprime të cilat bien ndesh me ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar.

Konkretisht, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vlerësimit rezulton se AK nuk ka kërkuar dokumenta shtesë apo shpjegime mbi mangësitë në plotësimin e kriterëve nga ana e OE si:

- shkresa me objekt "Kthim përgjigje" nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial rezultonte pa datë, dhe në të specifikohet se: "A" ShPK me NIPT L...E nuk ka asnjë masë administrative për shkelje të cilësisë së karburantit deri më 12.12.2022, ndërkohë kjo procedurë prokurimi është nisur në vitin 2023 dhe urdhër prokurimi është nxjerr në muajin shkurt.
- në deklaratën e OE shtojca 8 vetëdeklarimi, paragrafi D. Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës, specifikohet se: OE ka masë ligjore në fuqi, të vendosur nga ISHPSHSH. OE ka ankimuar brenda afatit ligjor pranë Gjykatës Administrative Korçë për vendimin e marrë nga ISHPSHSH. Por mungonë në dosje praktika lidhur me këtë çështje apo kopje e ankimit në Gjykatë;

Sa më sipër operuar jo në përputhje me nenet 74, 76, 78 pika 2, 82 pika 2, germa i) të VKM nr. 285, datë 23.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe neni 92 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”

Duke sjell si ndikim se, kualifikimi i shoqërive (OE) pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit, pa kërkuar dhe dokumentuar paraprakisht shpjegimet mbi mangësitë në plotësimin e kriterëve, qofshin këto edhe devijime të vogla, përbën një risk të shtuar për realizimin e kontratës.

Titulli gjetjes: Parregullsi në dokumentet e tenderit

Nga verifikimi i dokumentacionit në dosjen fizike dhe SPE për procedurën e prokurimit “Blerje karburant për automjetet”, rezultojë se:

- Për përllogaritjen e fondit limit kanë marrë pjesë 2 nga 3 anëtarët e njësisë së prokurimit pa përgjegjësin e njësisë, në kundërshtim me VKM nr.285 datë 19.05.2021 neni 78, pika 2.
- Prania e dy Urdhrave të ndryshëm prokurimi me vlera të ndryshme;

Procesverbali argumentues mban datën 09.02.2023, pra është hartuar pas nxjerrjes së U.P të parë i cili ka dhe fondin limit të përcaktuar që është marr si referencë në vijim. Sa më sipër, operuar në kundërshtim me pikën 2, të nenit 76 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021.

Nga ana e AK është shkelur parimi i objektivitetit ‘neni 14’ i Kodit të Procedurave Administrative, ku AK nuk i ka dhënë rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën të cilat mund të çenojnë cilësinë e procesit të rregullt ligjor. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 74 dhe 76, pika 2 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar dhe Ligji nr.44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë.

#### ***AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike”:***

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, në zbatim të LPP-së, është ngritur një komision paraprak me Urdhrin nr. 13 datë 06.02.2023 “Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike”.

Në rastin konkret, konstatohet se specifikimet teknike, pjesë e dokumenteve të tenderit të përgatitura nga komisionit përkatës (specialisti i fushës), sipas urdhrin të sipërcituar, në referencë të LPP dhe VKM-në nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar nuk kanë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër të veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike.

*Konstatim: Procesverbali-Tipi i kontratës-Mall datë 15.02.2023 Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim nuk mban emrat e komisionit/personave hartues të tij por vetëm dy nënshkrime.*

#### ***AK (NJP) në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriterëve”:***

Dokumentet e tenderit të hartuara nga AK, në përgjithësi kanë të argumentuar vendosjen e kriterëve për kualifikim vetëm ligjërisht, operuar kështu jo në përputhje të plotë me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 78, pika 2 “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “... Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre... ”.

Përmbledhtazi, për hartimin e kriterëve dhe argumentimin e tyre NJP është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore duke mos kryer asnjë argumentim teknik që do të justifikonte dhe

ligjëronte vendosjen e secilit kriter. Në këtë procedurë, në mënyrë të gabuar njësia e prokurimit ka vendosur si kriter për shpalljen e ofertës fituese atë të “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët” duke nënkuptuar me vlerë fikse, e duke mos zbatuar nenin 45 pika 2.1 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021, i ndryshuar, i cili përcakton elementët përbërës të çmimit. Në rastin konkret neni 45 pika 2.1 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 përcakton se: *“Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlllogaritet bazuar në: a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike; b) elementet fiskale; c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës”*.

Mënyra e përlllogaritjes së çmimit nga ana e AK, specifikuar në shtojcën nr.2 të DST mungon dhe përcaktohet vetëm sasia e kërkuar e karburantit. Në procesverbalin e datë 09.02.2023 komisioni i përlllogaritjes së fondit limit specifikon çmimin mesatar pa TVSH prej 162.54 lekë për litër, *pa argumentim të nxjerrjes së tij*.

Nga ana e OE është përcaktuar marzhi i fitimit prej 19 lekë/litri dhe çmimi për njësi 162.5 lekë/litër

Operimi me një çmim fiks të përcaktuar është një devijim nga baza ligjore i cili mbart risk të lart në vetvete. Në rastin e procedurave me objekt furnizimin me karburant, kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlllogaritet bazuar në: a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike; b) elementet fiskale; c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës, në zbatim të nenit 45 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*.

*Si konkluzion*, kriteri i sipërcituar përbën një risk të shtuar për AK pasi luhatjet e çmimeve të karburanteve eventualisht mund të ndikojnë negativisht në Buxhetin e Shtetit.

***Observacion i paraqitur pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr.844 prot., datë 22.04.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 136/4 prot., datë 25.04.2024***

Pretendimi i sjellë nga ana e subjektit:

Në Projekt Raportin e Auditimit për këtë procedurë prokurimi audituesit kanë konstatuar mangësi në hartimin dhe argumentimin e kriterëve për kualifikim.

Ju bëjmë me dije se Njësia e Prokurimit ka hartuar procesverbalin tip të kontratës Mall. Cdo kriter është i argumentuar ligjërisht sipas LPP nr.162/2020 dhe VKM nr.285 datë 19.05.2021, i ndryshuar dhe ne asnjë moment nuk janë kontestuar nga operatore ekonomike të interesuar për këtë procedurë prokurimi.

***Komenti i grupit të auditimit:***

Vendosja e kriterëve për kualifikim rezulton e argumentuar ligjërisht, operuar kështu jo në përputhje të plotë me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, neni 78, pika 2 *“hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”* ku citohet se: *“... Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...”*. Përmbledhtazi, për hartimin e kriterëve dhe argumentimin e tyre NJP është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore duke mos kryer asnjë argumentim teknik që do të justifikonte dhe ligjëronte vendosjen e secilit kriter.

Në kushtet e mossjelljes së dokumentacionit të ri justifikues që do të ndryshonte situatën, gjetja mbetet e njëjtë.

**Observacioni mësipërm nuk pranohet.**

**Observacion i paraqitur pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr.844 prot., datë 22.04.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 136/4 prot., datë 25.04.2024**

Pretendimi i sjellë nga ana e subjektit është i njëjtë me observacionin e sjellë me shkresën nr. 450 prot., datë 05.03.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.136/2 prot., datë 06.03.2024 sjellë në fazën e projekt raportit.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Sjellim në vëmendjen tuaj se, sikundër dhënë përgjigjja në fazë e projekt raportit, përcaktimi në mënyrë të gabuar i kriterit për shpalljen e ofertës fituese në rastin konkret, nuk ka të bëjë me përzgjedhjen e alternativës (bazuar në çmim apo kosto), pasi kriteri “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim” është në përputhje me LPP, por në këtë rast çmimi nuk duhet të jetë fiks “i pandryshuar” sikundër është përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor. Ritheksojmë se, në rastin konkret neni 45 pika 2.1 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 përcakton se: “Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përllogaritet bazuar në: a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike; b) elementet fiskale; c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës”.

Në kushtet e mungesës së dokumentacionit të ri justifikues, observacioni mësipërm nuk merret në konsideratë.

**Observacioni i mësipërm nuk pranohet**

*Për sa konstatuar më sipër, në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, në vëmendje të njësisë së prokurimit (specialistit të fushës).*

**Neni 2 i Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”** ku përcaktohet: “Qëllimi i këtij ligji është...a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;...”.

**Neni 45 pika 2.1 e VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021** “Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përllogaritet bazuar në: a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike; b) elementet fiskale; c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës”.

**Neni 76 pika 2 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar** “...Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht: *Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet*”.

Titulli Gjetjes: Përcaktim në mënyrë të gabuar i kriterit për shpalljen e ofertës fituese në lidhje me procedurën: “Blerje karburant për automjete”

Në procedurën “Blerje karburant për automjete” në mënyrë të gabuar, njësia e prokurimit ka vendosur si kriter për shpalljen e ofertës fituese atë të “*oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët*” (me vlerë fikse), duke mos zbatuar nenin 45 pika 2.1 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021, i cili përcakton elementët përbërës të çmimit. Neni 45 pika 2.1 i VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 përcakton se: “*Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlllogaritet bazuar në: a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike; b) elementet fiskale; c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës*”.

Mënyra e përlllogaritjes së çmimit nga ana e AK, specifikuar në shtojcën nr.2 të DST mungon dhe përcaktohet vetëm sasia e kërkuar e karburantit. Në procesverbalin e datë 09.02.2023 komisioni i përlllogaritjes së fondit limit specifikon çmimin mesatar pa TVSH prej 162.54 lekë për litër, *pa argumentim të nxjerrjes së tij*.

Operimi me një çmim fiks të përcaktuar është një devijim nga baza ligjore i cili mbart risk të lart në vetvete. Në rastin e procedurave me objekt furnizimin me karburant, kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlllogaritet bazuar në: a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike; b) elementet fiskale; c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës, në zbatim të nenit 45 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”. Kriteri i sipërcituar (oferta me çmim fiks) përbën një risk të shtuar për AK pasi luhatjet e çmimeve të karburanteve eventualisht mund të ndikojnë negativisht në Buxhetin e Shtetit.

Veprimet e mësipërme në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

#### ***AK (Personi Përgjegjës për Prokurimin) në lidhje me “zyrtarët pjesëmarrës në grupet e punës”:***

Referuar procedurës së sipërcituar, njësia e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit dhe përbëhet nga 2 anëtarë ndërkohë njësia e prokurimit 3 anëtar, duke patur pjesë të saj edhe përgjegjësin e njësisë.

Operuar në kundërshtim me neni 74, pika 2 e VKM nr.285 datë 19.05.2021, i ndryshuar e cila specifikon: *Në çdo rast, numri i anëtarëve të njësisë së prokurimit duhet të jetë numër tek dhe neni 78 pika 2 e cila specifikon: Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit.*

Si konkluzion, për sa konstatuar më sipër në zbatim të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, në vëmendje të njësisë së prokurimit (*specialistit të fushës*).

**Neni 74, pika 2 e LPP** ku përcaktohet: “*Në çdo rast, numri i anëtarëve të njësisë së prokurimit duhet të jetë numër tek*”.

**Neni 78, pika 2 e LPP** ku përcaktohet: “*Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit*”.

**Neni 45 pika 2.1 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, e ndryshuar** “*...Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e*

*favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlllogaritet bazuar në: a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike; b) elementet fiskale; c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës”.*

**Neni 76 pika 2 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, e ndryshuar “...Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht: Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrorit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.**

Nga auditimi konstatohet se AK Bashkia Këlcyrë për vitin 2023 ka caktuar si anëtar të njësisë së prokurimit dhe njëkohësisht person përgjegjës për prokurimin, Znj. F.S , e cila sipas të dhënave të Bashkisë Këlcyrë, është punonjëse me kohë të plotë e Bashkisë Tiranë.

Për këtë qëllim në datën 06.01.2022 është lidhur aktmarrëveshje midis Bashkisë Këlcyrë dhe Znj. F.S , pa numër protokoll. Bazuar në nenin 74 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, të VKM nr.285 dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në rast mungese personeli, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë staf të specializuar nga autoritete/ente të tjera kontraktore ose të punësojë ekspertë të jashtëm. Gjithashtu autoriteti/enti kontraktor mund të krijojë një njësi të përbashkët prokurimi me një apo më shumë autoritete/ente kontraktore.

Edhe pse kuadri ligjor në fuqi ka bërë parashikimet e mësipërme, nevoja për marrjen e një personi nga një autoritet tjetër kontraktor nuk është e argumentuar nga Bashkia Këlcyrë, pasi ky institucion nuk ndodhet në kushtet e mungesës së stafit për përcaktimin e personit përgjegjës për prokurimin dhe caktimin e njësisë së prokurimit. Kuadri ligjor në fuqi nuk përcakton detyrimin që subjektet të kenë pa tjetër një jurist në njësinë e prokurimit. Bashkia Këlcyrë ka në strukturën e saj personel me arsim të lartë për kryerjen e kësaj detyre, të cilët më parë duhet të trajnohen prej saj.

Detyrimi që ka vendosur nenin 74 i VKM nr.285 dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, lidhur me personin përgjegjës për prokurimin është:

Personi/at përgjegjës duhet të jenë minimalisht me arsim të lartë.

Gjithashtu po ky nen, ka vendosur detyrimin për titullarin e autoritetit kontraktor si vijon: Autoritetet/entet kontraktore duhet të nxisin trajnimin e personit/personave përgjegjës në fushën e prokurimit publik.

Nga auditimi konstatohet se, përveçse nuk plotësohen kushtet për marrjen nga Bashkia Këlcyrë të një personi nga një autoritet tjetër kontraktor, edhe procedura e ndjekur për këtë qëllim është e gabuar. Bashkia Këlcyrë nuk i është drejtuar me shkresë zyrtare asnjë autoriteti kontraktor, rasti konkretë Bashkisë Tiranë, në mënyrë që ky institucion të përcaktojë personin e kërkuar nga Bashkia Këlcyrë. Në rast të nevojave të tilla, është institucioni Bashkia Tiranë që përcakton se cili do të jetë punonjësi i kërkuar nga Bashkia Këlcyrë dhe nuk përcakton punonjësi për veten e vet që të bëhet pjesë njësisë së prokurimit dhe person përgjegjës, në një institucion tjetër, si në rastin konkret. Aktmarrëveshja midis Bashkisë Këlcyrë dhe Znj. F.S nuk është një marrëdhënie midis dy institucioneve, pasi nuk paraprihet nga aktmarrëveshja prej tyre, por marrëveshje midis një individi (të cilit për arsye se është i punësuar me kohë të plotë pranë Bashkisë Tiranë, nuk i lejohet të kryej detyra të tjera jashtë këtij institucioni pa autorizimin dhe miratimin e titullarit të Bashkisë Tiranë, brenda orarit zyrtar të punës) dhe Bashkisë Këlcyrë.

Në pikën 3 të nenit 74 të VKM nr.285 dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohen detyrat e personit përgjegjës për prokurimin, ku midis të tjerash janë: Personi/at përgjegjës për prokurimin kryen/jnë detyrat e mëposhtme:

- Sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;
- Hartimin e urdhrat të prokurimit;
- Përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme, që u bashkëlidhen atyre;
- Hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore;
- Administrimin e të gjitha procesverbaleve për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti;
- Ndjek procesin e komunikimit me operatorët ekonomikë të përfshirë në procesin e ankimimit, për çdo vendim në procesin e shqyrtimit të ankesës, sipas parashikimeve në këto rregulla;
- Administrimin e dokumentacionit në formë të shkruar, origjinal ose fotokopje të noterizuar të operatorit ekonomik fitues, përpara lidhjes së kontratës nga autoriteti/enti kontraktor;
- Ndjekjen e procedurave për konfiskimin e sigurimit të ofertës sipas përcaktimit në LPP dhe në këto rregulla;
- Administrimin e sigurimit të kontratës përpara lidhjes së kontratës nga autoriteti kontraktor; etj.

Të gjitha detyrat e përcaktuara më sipër, personi përgjegjës për prokurimin nuk mund ti kryej dot, pa miratimin e titullarit të institucionit ku punon, pasi kryerja e tyre kërkon kohën e nevojshme në dispozicion, kërkon angazhim konkret brenda orarit të punës dhe brenda institucionit të Bashkisë Këlcyrë. Me Bashkinë Tiranë, kjo gjë vështirësohet akoma më shumë për shkak të distancës midis dy institucioneve.

**AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me “Administrimin e Dokumentacionit”:**

Referuar procedurave së sipërcituara, konstatohet se dosjet fizike të prokurimit, të cilat ndër të tjera përmbajnë procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj, nuk janë të pajisura me inventarin e brendshëm të dosjes.

Referuar nenit 21, 59, 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, ndër të tjera, kërkohet që për çdo njësi ruajtjeje të hartohet inventari i brendshëm i dokumenteve që përmban njësia.

Gjithashtu, referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Veprimtaria e Kontrollit, si një prej pesë komponentëve të MFK, përmban detyrimin e hartimit të procedurave për dokumentimin, arkivimin dhe ruajtjen e informacionit, të cilat duhet të vendosen për të mbështetur kryerjen e operacioneve dhe kontrollimin e proceseve në njësinë publike.

Si konkluzion, mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara mbartin riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit.

Për sa më sipër, AK (personi përgjegjës për prokurimin) të marrë masa për inventarizimin e të gjithë dokumentacionit në lidhje me procedurën e sipërcituara, duke dokumentuar të gjithë procesin në rend kronologjik, sikurse kërkohet nga normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në RSH.



Për sa konstatuar më sipër, në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.05.2021 “Për prokurimin publik”, në vëmendje të personit përgjegjës për prokurimin.

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;  
Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”  
Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;  
Normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

### **b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.**

Në tender ka marrë pjesë vetëm OE “A ” ShPK.

Nr	Operatorët pjesëmarrës në tender	Vlera në lekë e ofertës pa TVSH	Kualifikimi	NIPT
1	“A ”	5,80	Kualifikuar, fitues	L...E

OE “A ” ShPK rezulton të mos ketë pikë tregtimi me pakicë në territorin e Këlcyrës, e për këtë arsye ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me nr.1668 rep, nr.467 kol datë 23.02.2022me D (Alpet).

Rezulton prania e kontratës mes palëve G.H në rolin e qeradhënësit dhe D ShPK në rolin e qeramarrësit, me nr.546 repertori, nr.145 koleksioni datë 26.02.2016

*Nga auditimi u konstatua se, tek kontrata e qeras mes D ShPK dhe qeradhënësit (G.H.) me objekt dhënie me qera e pasurisë “pikë karburanti” neni 2 rezulton pa afat fillimi i kontratës.*

Nga ana e titullarit të AK është kërkuar informacion shtesë drejtuar OE “A ” ShPK, kjo shkresë është pa datë dhe numër protokollit në dërgim, si dhe pa afat të specifikuar se kur duhet kryer dorëzimi i dokumentacionit.

Nga ana e KVO është hartuar raporti përmbledhës i procedurës (pa datë), në të specifikohet lloji i procedurës që është kryer, fondi limit, e gjithë situata deri në hapjen e shpalljeve të ofertave dhe ajo çfarë konstatohet është se në të specifikohet se, nga ana e KVO i është dërguar në SPE shkresë BOE “N ”dhe “SH ” ShPK, ndërkohë që këta OE nuk rezulton të kenë ofertuar as në SPF dhe as në dokumentacionin fizik në dosjen e prokurimit.

Veprimet e mësipërme tregojnë mos-seriozitet nga ana e AK në hartimin dhe menaxhimin e dokumentacionit lidhur me procedurën e prokurimit.

***Observacion i paraqitur pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr.844 prot., datë 22.04.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 136/4 prot., datë 25.04.2024.***

Pretendimi i sjellë nga ana e subjektit është i njëjtë me observacionin e sjellë me shkresën nr. 450 prot., datë 05.03.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.136/2 prot., datë 06.03.2024 sjellë në fazën e projekt raportit.

#### ***Komenti i grupit të auditimit:***

Risjellim në vëmendjen tuaj të njëjtën përgjigje dhënë nga ana e grupit të auditimit edhe në fazën e projekt raportit” Jemi në kushtet e *evidentimit të fenomenit/situatës* nga ana e grupit të auditimit.

Megjithatë, Nga ana e KVO është hartuar raporti përmbledhës i procedurës (pa datë), në të specifikohet lloji i procedurës që është kryer, fondi limit, e gjithë situata deri në hapjen e shpalljeve të ofertave dhe ajo çfarë konstatohet është se në të specifikohet se, nga ana e KVO i është dërguar në SPE shkresë BOE “N ”dhe “SH ” ShPK, ndërkohë që këta OE nuk rezulton të

kenë ofertuar as në SPF dhe as në dokumentacionin fizik në dosjen e prokurimit. Konkretisht faqja nr.2 paragrafi nr.8 dhe më tej vijohet në mes të faqës nr.3 me OE “A ” ShPK.

Sa më sipër nuk gjykohet si gabim njërezor, por *mos seriozitet në hartimin e dokumentave ligjore.*

***Observacioni i mësipërm nuk pranohet***

### **Mbi kualifikimin e OE ”A ” ShPK**

*Nga auditimi u konstatua se, vlera e ofruar nga Operatori Ekonomik fitues ( i vetëm garues) është sa 99.9% e fondit limit të tenderit.*

Në deklaratën e OE, pika B. “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme”, nga ana e OE nuk jepet informacion mbi numrin e punonjësve dhe mjetet e makineritë

### ***c-Në lidhje me kontratën.***

Mes palëve AK Bashkia Këlcyrë dhe OE A është nënshkruar kontrata për furnizim me karburant me nr.827 prot., datë 30.03.2023. Referuar kontratës rezulton se:

**Neni 7** Kushtet e dorëzimit specifikon se: ... *Kontraktori furnizon AK në pikën e shitjes me pakicë të karburantit që kontraktori administron kundrejt kartave elektronike me të cilat pajis AK. urnizimi do të bëhet në çdo ditë të javës dhe përgjatë 24 orëve.*

*Konstatim: Nga auditimi u konstatua se, AK në ndryshim nga sa është parashikuar në kontratë nuk ka rezultuar të kryej furnizim me kartë elektronike por ka operuar me tollon.*

### ***Pagesa:***

Nga ana e OE është operuar në devijim të bazës ligjore si dhe të çmimit të parashikuar në kontratë prej 162,5 l/litër.

Për periudhën 01.01.2023 deri në 07.06.2023 në territorin e Republikës së Shqipërisë ka funksionuar Bordi i transparencës për karburantet (BMK), në tabelën në vijim paraqiten çmimet respektive sipas Vendimeve të nxjerra nga ky Bord dhe krahasimi me çmimet e ofruara nga OE dhe paguara nga AK për çdo blerje:

Vendimi Bordit	Cmimi sipas Vendimit all/litër	Data e furnizimit	Cmimi Paguar nga AK all/litër
28.03	<= 184	31.03	184
20.04	181	05.04	184
28.04	174	13.04	184
0305	172	25.04	181
04.05	169	<b>28.04</b>	<b>177</b>
26.05	176	08.05	169
		<b>18.05</b>	<b>173</b>
		31.05	176

Deri në momentin që ka funksionuar BMK si organ rregullator në dy raste është tejkalluar çmimi i vendosur me Vendim Bordi, konkretisht dt 28.04 dhe dt.18.05

Diferencat në vlerë për çdo rast si vijon:

- 28.04.2023 marr me 177 l/litër nga 174 l/litër, pra 3 l/litër më tepër

3 lekë/litër \* 3000 litër = 9.000 lekë paguar më tepër

- 18.05.2023 marr me 173 l/litër nga 169 l/litër, pra 4 l/litër më tepër

4 lekë/litër \* 2000 litër = 8,000 lekë paguar më tepër.

***Vlera e plotë prej 16,000 lekë konsiderohet dëm ekonomik.***

Për periudhën në vijim, qershor 2023-dhjetor 2023, pas shfuqizimit të BMK (02.06.2023) trendi i pagesave ka qenë:

Data e furnizimit	Paguar nga AK all/litër	Çmimi parashikuar në kontratë	Sasia e marr/litra	Vlera totale paguar	Diferenca me çmimin e parashikuar në kontratë	Vlera referuar kontratës
22.06	181,54	162.5	2000	363.080	19.04	325.000
03.07	197,67	162.5	2000	395.340	35.17	325.000
17.07	181	162.5	2000	362.000	18.5	325.000
08.08	192,83	162.5	3000	578.490	30.33	487.500
04.09	197,17	162.5	2000	394.340	34.5	325.000
03.10	207	162.5	2000	414.000	44.5	325.000
10.10	198,45	162.5	1000	198.450	35.95	162.500
24.10	201,54	162.5	2000	403.080	39.04	325.000
<i>Paguar total</i>				3.108.780		2.600.000

Diferenca prej 508.780 lekë mes çmimit të parashikuar në kontratë dhe atij të paguar faktikisht, në kushtet e mos specifikimit të formulës së përlllogaritjes së këtij çmimi konsiderohet si përdorim jo me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet i parasë publike.

*Për sa konstatuar më sipër, në zbatim të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 i ndryshuar në vëmendje të personit përgjegjës për prokurimin.*

Titulli i Gjetjes: Pagesa jo në përputhje me kontratën

Sa i takon procedurës së prokurimit me objekt: “Karburant për Automjete” mes palëve AK Bashkia Këlcyrë dhe OE A është nënshkruar kontrata për furnizim me karburant me nr.827 prot., datë 30.03.2023.

Nga auditimi lidhur me pageën e karburantit rezultoj se, ana e OE është operuar në devijim të bazës ligjore si dhe të çmimit të parashikuar në kontratë prej 162,5 l/litër. Për periudhën 01.01.2023 deri në 07.06.2023 në territorin e Republikës së Shqipërisë ka funksionuar Bordi i transparencës për karburantet (BMK). Deri në momentin që ka funksionuar BMK si organ rregullator në dy raste është tejkaluar çmimi i vendosur me Vendim Bordi, me diferencë në vlerë totale prej 16.000 lekë të paguar më tepër. Vlerë e cila konsiderohet si dëm ekonomik i buxhetit të njësisë vendore, e për rrjedhojë i buxhetit të shtetit.

Veprimet e mësipërme në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Titulli i Gjetjes: Pagesa jo në përputhje me kontratën

Sa i takon procedurës së prokurimit me objekt: “Karburant për Automjete” mes palëve AK Bashkia Këlcyrë dhe OE A është nënshkruar kontrata për furnizim me karburant me nr.827 prot., datë 30.03.2023.

Nga auditimi lidhur me pageën e karburantit rezultoj se, ana e OE është operuar në devijim të bazës ligjore si dhe të çmimit të parashikuar në kontratë prej 162,5 l/litër. Pas shfuqizimit të BMK (02.06.2023) rezultoj që trendi i pagesës për karburant të ishte i paqëndrueshëm, në rritje permanente e konkretisht asnjëherë në përmbajtje të çmimit të parashikuar në kontratë. Diferenca totale prej 508,780 lekë mes çmimit të parashikuar në kontratë dhe atij të paguar faktikisht, (në kushtet e mos specifikimit të formulës së përlllogaritjes së këtij çmimi) konsiderohet si përdorim jo me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet i parasë publike.

Veprimet e mësipërme në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**Neni 45 pika 2.1 e VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021** “Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përllogaritet bazuar në: a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike; b) elementet fiskale; c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës”.

**Neni 76 pika 2 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar** “...Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, konkretisht: *Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet*”.

### **Afatet kohore**

Nga auditimi u konstatua moszbatim korrekt i afateve kohore për publikimin e njoftimit të fituesit në SPE sikundër parashikohen në Ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik” duke publikuar fituesin me 2 ditë vonesë. Referuar SPE vlerësimi i ofertave ka përfunduar më 07.03.2023 dhe publikimi i fituesit është kryer më 13.03.2023 nga data 11.03.2023 që duhej kryer për shkak të ditëve pushim (e shtunë). Operuar kështu jo në përputhje me nenin 97, pika 1 e LPP 162/2020 “Për prokurimin publik” ku specifikohet se: *...Menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit. Me publikimin e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik, operatorëve ekonomikë i lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109 të këtij ligji.*

### **Observacion i paraqitur pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr.844 prot., datë 22.04.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 136/4 prot., datë 25.04.2024**

Pretendimi i sjellë nga ana e subjektit është i njëjtë me observacionin e sjellë me shkresën nr. 450 prot., datë 05.03.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.136/2 prot., datë 06.03.2024 sjellë në fazën e projekt raportit.

#### **Komenti i grupit të auditimit:**

Sjellim në vëmendjen tuaj se, konstatimi i grupit të auditimit i referohet hedhjes së të dhënave në sistemin e prokurimit elektronik, ku referuar SPE vlerësimi/rivlerësimi i ofertave rezultoi të jetë përfunduar në datën 07.03.2023.

Në kushtet e mos sjelljes së dokumentacionit të ri justifikues, observacioni mësipërm nuk merret në konsideratë.

#### **Observacioni i mësipërm nuk pranohet**

### **Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës i prokurimit që është marr me hedhjen e të dhënave në SPE znj.F.S**

Për sa konstatuar më sipër, në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.05.2021 “Për prokurimin publik”, në vëmendje të personit përgjegjës për prokurimin.

Neni 97, pika 1 e LPP 162/2020 “Për prokurimin publik” ku specifikohet se: *...Menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit. Me publikimin e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik, operatorëve ekonomikë i lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109 të këtij ligji.*

Titulli Gjetjes: Moszbatim korrekt i afateve kohore për publikimin e njoftimit të fituesit në SPE Situata: Nga auditimi u konstatua moszbatim korrekt i afateve kohore për publikimin e njoftimit të fituesit në SPE sikundër parashikohen në Ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik” duke publikuar fituesin me 2 ditë vonesë. Referuar SPE vlerësimi i ofertave ka përfunduar më 07.03.2023 dhe publikimi i fituesit është kryer më 13.03.2023 nga data 11.03.2023 që duhej kryer për shkak të ditëve pushim (e shtunë). Operuar kështu jo në përputhje me nenin 97, pika 1 e LPP 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Veprimet e mësipërme në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

#### ***Nga auditimi u konstatua, mos hartimi i planit për zbatimin e kontratës***

Nga auditimi konstatohet se Bashkia Këlcyrë nuk ka hartuar plan të monitorimit të zbatimit të kontratës dhe nuk ka përcaktuar person apo grup pune për monitorimin e zbatimit të kontratës, për të gjitha kontratat e lidhura si rezultat i zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, për mbikëqyrjen e veprimtarinë së kontraktorit, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë dhe legjislacionin në fuqi, për çështjet organizative të kontratës, afatet, çështjet ekonomike teknike etj. Plani duhet të nënshkruhet nga autoriteti/enti kontraktor dhe operatori ekonomik, brenda 7 (shtatë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe, në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj. Një kopje e këtij plani i dërgohet APP-së brenda 5 (pesë) ditëve nga nënshkrimi.

*Personi përgjegjës për prokurimin Znj. F.S , ka patur detyrimin që të raportojë pranë APP informacionin lidhur me monitorimin e zbatimit të kontratës, detyrë të cilën nuk e ka kryer, pasi ka munguar informacioni për shkak të mos përcaktimit nga titullari të personit për monitorimin e zbatimit të kontratës. Nga auditimi nuk u konstatua që në rrugë shkresore, personi përgjegjës për prokurimin të ketë vënë në dijeni titullarin e autoritetit kontraktor, për mungesën e këtij informacioni i cili ka sjellë dhe mos përmbushjen e detyrës nga personi përgjegjës për prokurimit, gjë që e ngarkon me përgjegjësi Znj. F.S .*

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 124 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku thuhet: *Për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti ose enti kontraktor, nisur nga natyra e objektit të kontratës dhe kohëzgjatja e zbatimit të saj, harton planin e zbatimit të kontratës, duke përfshirë në veçanti çështjet organizative, afatet, çështjet ekonomike e teknike të kontratës së nënshkruar, në përputhje me çdo akt tjetër ligjor.*

*Plani i zbatimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj.*

*Çdo modifikim i kontratës në përputhje me nenin 127 të këtij ligji, pasqyrohet në planin e zbatimit.*

*Autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me planin, ndjek zbatimin e kontratës, administron dokumentacionin e monitorimit dhe harton raportet e monitorimit.*

nenin 107 i VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku thuhet: “...Personi apo strukturat e ngarkuara për ecurinë e zbatimit të kontratës, në funksion të legjislacionit të prokurimit publik ka/në këto përgjegjësi:

a) Harton e ndjek ecurinë e planit të zbatimit të kontratës;

b) Kryen monitorimin e zbatimit të detyrimeve të palëve në kontratë, në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë;

c) Administron dhe verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga kontraktori, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

ç) Sigurohet për kontrollin real e ligjor të kostove, cilësisë, dhe afateve, kur është rasti;

d) Menaxhon dhe trajton problematikat që shfaqen gjatë ekzekutimit të kontratës dhe që nuk sjellin domosdoshmërisht ndryshime/modifikime/përshtatje të saj;

dh) Raporton te titullari i autoritetit/entit kontraktor për shkelje të dispozitave kontraktuale;

e) Administron kërkesat për ndryshime/modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës, dhe sigurohet që këto kërkesa të kalojnë për miratim në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë;

ë) Mban korrespondencën e përditësuar me të gjitha dokumentet e shkëmbyera me kontraktorin lidhur me zbatimin e kontratës;

f) Përgatit informacion për çështjet e sipërcituara dhe ia përcjell personit përgjegjës për prokurimin, i cili raporton pranë APP-së”.

**Observacion i paraqitur pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr.844 prot., datë 22.04.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 136/4 prot., datë 25.04.2024**

Pretendimi i sjellë nga ana e subjektit është i njëjtë me observacionin e sjellë me shkresën nr. 450 prot., datë 05.03.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.136/2 prot., datë 06.03.2024 sjellë në fazën e projekt raportit.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Sjellim në vëmendjen tuaj se, personi përgjegjës për prokurimin Znj. F.S , ka patur detyrimin që të raportojë pranë APP informacionin lidhur me monitorimin e zbatimit të kontratës, detyrë të cilën nuk e ka kryer, pasi ka munguar informacioni për shkak të mos përcaktimit nga titullari të personit për monitorimin e zbatimit të kontratës. Nga auditimi nuk u konstatua që në rrugë shkresore, personi përgjegjës për prokurimin të ketë vënë në dijeni titullarin e autoritetit kontraktor, për mungesën e këtij informacioni i cili ka sjellë dhe mos përmbushjen e detyrës nga personi përgjegjës për prokurimit.

Në kushtet e mos sjelljes së dokumentacionit të ri justifikues, observacioni mësipërm nuk merret në konsideratë

**Observacioni i mësipërm nuk pranohet**

*Për veprime dhe mosveprime lidhur me sa më sipër trajtuar mbajnë përgjegjësi:*

*z. K.N , në rolin e Titullarit të Institucionit në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor;*

*Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Oferatve z. A.Q , z.O.H , z.Q.P ;*

*Anëtarët e Njësisë së Prokurimit z.F.S , z.V.K , z.J.N*

**3. Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Rikonstrukcion shkolla 9 vjeçare Kamber Bënja, Këlcyrë”, me fond limit 74,242,135.8 lekë, zhvilluar në vitin 2023**

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:</b> “Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare Kamber Bënja, Këlcyrë”,.REF-80295-09-18-2023		
<b>1.Urdhër Prokurimi</b> nr.72 prot., datë 08.09.2023 Njësia e Prokurimit 1. E.A (përgjegjës) 2. V.K 3. J.N	<b>3. Komisioni për llogaritjes së vlerës limit, ngritur me:</b> Urdhër nr. 71 prot., datë 08.09.2023 1. J.N 2. V.K Komisioni Hapjes së Ofertave: 1. R.S 2. O.H 3. A.Q	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave:</b> Urdhër nr.73, datë 08.09.2023: 1. O.H , 2. R.S , 3. A.Q Urdhër nr.85, datë 25.10.2023: 1. A.Q 2. O.H 3. E.B
<b>2.Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “Marrëveshje Kuadër”		
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> 74,242,135.80 lekë	<b>6.Oferta fituese:</b> “Z ” ShPK 71,961,251.8 lekë (pa tvsh)	<b>7.Diferenca me fondin limit</b> 2,280,884 lekë (pa tvsh)
<b>8. Data e hapjes (zhvillimit) të tenderit:</b> 11.10.2023	<b>9.Burimi Financimit:</b> Buxheti Ministrisë së Arsimit 63,105,815.43 lekë + vetfinancim 11,136,320.37 lekë	<b>10. Operoret Ekonomik</b> a) Pjesëmarrës në tender: 5 OE b) S’kualifikuar - 4 c) Kualifikuar 1 OE
<b>11.Ankimime:</b> AK: Nuk ka patur ankesa	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK:</b>	<b>13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP:</b>
<i>b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</i>		
<b>14.Lidhja e kontratës</b> 14.11.2023	<b>15.Vlera e kontratës:</b> 89,090,563 lekë me TVSH	16. Likuiduar deri

#### **a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.**

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se;

#### **AK në lidhje me “Për llogaritjen e Fondit Limit” :**

Me urdhër nr.71 datë 08.09.2023 të Kryetarit të Bashkisë Këlcyrë është ngritur komision “Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike”, me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare Kamber Bënja, Këlcyrë”.

#### **Ky komision përbëhej nga dy anëtar, prej z. J.N dhe z.V.K**

Nga ana e këtij komisioni është materializuar në një dokument të posaçëm fondi limit. Në rastin konkret, në proces verbalin pa numër, më datë 08.08.2023 i mbajtur prej z. J.N dhe z.V.K , si persona të ngarkuar me urdhër të titullarit për për llogaritjen e fondit limit, specifikohet se: Nga analiza zë për zë e çdo lloji punimi të parashikuar në preventivin e administruar rezulton se të gjitha çmimet e preventivit të objektit “Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare Kamber Bënja, Këlcyrë” janë konform manualit në fuqi. Preventivi është i shoqëruar me analizat e çmimeve që bëjnë analizat e kostos për çdo zë të preventivit që është në manual. Gjithashtu edhe specifikimet teknike janë korrekte dhe i përgjigjen kërkesave të projektit dhe bazës ligjore në fuqi për prokurimet.

Sa më sipër, procesverbali i hartuar nga ana e komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike nuk është në përputhje nenin 76 pika 2 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar “Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë për llogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

Nga auditimi u konstatua problematik në datën e hartimit të procesverbalit, dokument i cili mban datën 08.08.2023, hartuar përpara nxjerrjes së Urdhërit të titullarit për nisjen e procedurës

së prokurimit e më tej përbërjen e komisionit të përllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike.

Procesverbali është hartuar nga persona të cilët në momentin e hartimit të tij nuk kanë patur tagër ligjor (Urdhër/autorizim) të kryerjes së tij, e po ashtu nuk ka patur gjurmë të procedurës që do të kryhej në atë cast (Urdhri i prokurimit përmban nr.72 prot., datë 08.09.2023).

Sa më sipër, operuar në kundërshtim me pikën 3, të nenit 76 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, konkretisht: *Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, titullari i autoritetit/entit kontraktor mund të caktojë struktura të posaçme. Në rast se nuk ngrihen struktura të posaçme, kjo detyrë i ngarkohet specialistit të fushës ose njësisë së prokurimit.*

***Observacion i paraqitur pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr.844 prot., datë 22.04.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 136/4 prot., datë 25.04.2024***

Pretendimi i sjellë nga ana e subjektit është i njëjtë me observacionin e sjellë me shkresën nr. 450 prot., datë 05.03.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.136/2 prot., datë 06.03.2024 sjellë në fazën e projekt raportit.

***Komenti i grupit të auditimit:***

Sjellim në vëmendjen tuaj se, procesverbal datës 08.08.2023 me nënshkrim të Z. J.N dhe Z. V.K , specifikon dokumentat me të cilat ka punuar grupi punës dhe *Nga analiza zë për zë e çdo lloji punimi të parashikuar në preventivin e administruar rezulton se të gjitha çmimet e preventivit të objektit “Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare Kamber Bënja, Këlcyrë” janë konform manualit në fuqi. Preventivi është i shoqëruar me analizat e çmimeve që bëjnë analizat e kostos për çdo zë të preventivit që është në manual. Gjithashtu edhe specifikimet teknike janë korrekte dhe i përgjigjen kërkesave të projektit dhe bazës ligjore në fuqi për prokurimet.*

Sa më sipër, NUK është konstatim i grupit të auditimit, por specifikim i komisionit në procesverbal.

Grupi auditimit, bazuar mbi këtë procesverbal nuk arrin të marr siguri të arsyeshme mbi argumentimin dhe dokumentimin e përllogaritjes së vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

Pra konstatimi është se ky procesverbal nuk është hartuar në përputhje me nenin 76 pika 2 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar.

Në kushtet e mos sjelljes së dokumentacionit të ri justifikues, observacioni mësipërm nuk merret në konsideratë

***Komenti i grupit të auditimit:***

Sikundër përgjigjur edhe në fazën e projekt raportit, përmbledhtazi:

Risjellim në vëmendjen tuaj se, grupi auditimit, bazuar mbi këtë procesverbal nuk arrin të marr siguri të arsyeshme mbi argumentimin dhe dokumentimin e përllogaritjes së vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

Në kushtet e mos sjelljes së dokumentacionit të ri justifikues, observacioni mësipërm nuk merret në konsideratë

***Observacioni mësipërm nuk pranohet.***

Titulli i Gjetjes: Kryerja e procedurës së prokurimit jo në përputhje dhe zbatim të bazës ligjore mbi prokurimet.

Nga auditimi i procesverbalit të hartuar nga ana e komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike rezultoj se është hartuar në kundërshtim me nenin 76 pika 2 të VKM-së



nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar sipas së cilit: ...“Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”.

Nga auditimi u konstatua problematik në datën e hartimit të procesverbalit, dokument i cili mban datën 08.08.2023, hartuar përpara nxjerrjes së Urdhërit të titullarit për nisjen e procedurës së prokurimit (UP nr.72 datë 08.09.2023) e më tej përbërjen e komisionit të përlllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike (U nr.71 datë 08.09.2023).

Procesverbali është hartuar nga persona të cilët në momentin e hartimit të tij nuk kanë patur tagër ligjor (Urdhër/autorizim) të kryerjes së tij, e po ashtu nuk ka patur gjurmë të procedurës që do të kryhej në atë cast (Urdhri i prokurimit përmban nr.72 prot., datë 08.09.2023).

Sa më sipër, operuar në kundërshtim të plotë me pikën 3, të nenit 76 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, konkretisht: Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, titullari i autoritetit/entit kontraktor mund të caktojë struktura të posaçme. Në rast se nuk ngrihen struktura të posaçme, kjo detyrë i ngarkohet specialistit të fushës ose njësisë së prokurimit.

Veprimet e mësipërme në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

#### ***AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” :***

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga ana e titullarit të AK, në zbatim të LPP-së, është ngritur një komision paraprak me Urdhrin nr. 71 datë 08.09.2023 “Për krijimin e komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike”. Në zbatim të këtij urdhri, është ngritur komisioni i përbërë nga, z. J.N dhe z. V.K . Projekti dhe preventivi i punimeve janë hartuar nga shoqëria ‘D’ Sh.P.K me kontratë dhurimi.

#### ***AK (NJP) në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriteve”:***

##### **Mbi ndryshimin e dokumentave standarte të tenderit**

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Këlcyrë, bazuar në rekomandimet e bëra nga Agjensia e Prokurimit Publik (25.09.2023), vendosi që të bëjë ndryshime në dokumentat standarte të tenderit (03.10.2023) me objekt: “Rikonstruksion i shkollës 9 vjecare, Kamber Bënja, Këlcyrë me fond limit 74,242,135.8 lekë pa tvsh si vijon:

Ishte	Bëhet
<p><b>2.3.2</b> Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:</p> <p><b><u>Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• N.P - 1 A Punime gërmimi në tokë</li> <li>• N.P - 3 C Ndërtime civile e industriale</li> <li>• N.P. 12 A Punime të inxhinierisë mjedisore</li> </ul>	<p>“Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:</p> <p><b><u>Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• N.P - 1 A Punime gërmimi në tokë</li> <li>• N.P - 3 C Ndërtime civile e industriale</li> </ul> <p><b><u>Për punimet speciale të ndërtimit:</u></b></p>

<p><b><u>Për punimet speciale të ndërtimit:</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>N.S - 1 A</b> Punime për prishjen e ndërtimeve</li> <li>• <b>N.S - 2 A</b> Impiante hidro-termosanitare dhe mirembajtja e tyre</li> <li>• <b>N.S - 4 B</b> Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues</li> <li>• <b>N.S - 12 A</b> Punime strukturore speciale</li> <li>• <b>N.S - 14 A</b> Impiante Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit;</li> <li>• <b>N.S - 18 A</b> Punime topogjeodezike</li> </ul> <p>Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktues dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues”.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>N.S - 1 A</b> Punime për prishjen e ndërtimeve</li> <li>• <b>N.S - 2 A</b> Impiante hidro-termosanitare dhe mirembajtja e tyre</li> <li>• <b>N.S - 4 B</b> Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues</li> <li>• <b>N.S - 12 A</b> Punime strukturore speciale</li> <li>• <b>N.S - 14 A</b> Impiante Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit;</li> <li>• <b>N.S - 18 A</b> Punime topogjeodezike</li> </ul> <p>Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktues dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues”.</p>
<p>2.3.3 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar:</p> <p>Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Inxhinier Ndërtimi Profili Konstruktor/Strukturist 1 (një)</li> <li>• Inxhinier Mekanik 1 (një)</li> <li>• Inxhinier Elektrik 1 (një)</li> <li>• Inxhinier Hidroteknik 1 (një)</li> <li>• Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder 1 (një)</li> <li>• Inxhinier Mjedisi 1 (një)</li> </ul> <p>Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues. Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Kontratë punë noteriale e vlefshme</i></li> <li>• <i>Diploma</i></li> </ul> <p>Secili prej drejtuesve teknik të mësipërm, duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimalisht 3 (tre) muajt e fundit. Përsa i përket Inxhinierit Mekanik duhet të jetë i pajisur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Çertifikatë për Sistemet Ngrohje-Ftohje, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.</i></li> </ul> <p>Për 1 (një) prej drejtuesve teknik të mësipërm të shoqërisë duhet të paraqitet edhe:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>“Certifikatë e Audituesit Energjitik” në ndërtesa, lëshuar nga Agjencia për Eficencën e</i></li> </ul>	<p>2.3.3 të kapacitetit teknik:</p> <p>Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Inxhinier Ndërtimi Profili Konstruktor/Strukturist 1 (një)</li> <li>• Inxhinier Mekanik 1 (një)</li> <li>• Inxhinier Elektrik 1 (një)</li> <li>• Inxhinier Hidroteknik 1 (një)</li> <li>• Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder 1 (një)</li> </ul> <p>Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues. Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Kontratë punë noteriale e vlefshme</i></li> <li>• <i>Diploma</i></li> </ul> <p>Secili prej drejtuesve teknik të mësipërm, duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimalisht 3 (tre) muajt e fundit. Përsa i përket Inxhinierit Mekanik duhet të jetë i pajisur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Çertifikatë për Sistemet Ngrohje-Ftohje, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.</i></li> </ul> <p>Për 1 (një) prej drejtuesve teknik të mësipërm të shoqërisë duhet të paraqitet edhe:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>“Certifikatë e Audituesit Energjitik” në ndërtesa, lëshuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë në përputhje me VKM Nr. 407 datë 19.06.2019.</i></li> </ul>

<p><i>Energjisë në përputhje me VKM Nr. 407 datë 19.06.2019.</i></p> <p>Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit”.</p>	<p>Në rastin e mosdisponimit të audituesit të energjisë si drejtues teknik ose në listëpagesat e shoqërisë, ofertuesit do të lejohen ta plotësojnë edhe nëpërmjet kontraktimit për këtë objekt prokurimi.</p> <p>Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit”.</p>
<p>2.3.7 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar:</p> <p>“Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë minimalisht në listëpagesat e muajit të fundit, punonjës të specializuar/të kualifikuar si më poshtë :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 (nje) punonjës të pajisur me çertifikatë si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.</li> </ul> <p><i>* Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësën e kërkuar si më sipër, emër/mbiemër, numrin dhe datën e çertifikatës, si dhe institucionin që ka lëshuar këtë dokument.</i></p> <p>1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores”, “Për sigurinë në kantier”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.</p> <p><i>* Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësën e kërkuar si më sipër, emër/mbiemër, numrin dhe datën e çertifikatës, si dhe institucionin që ka lëshuar këtë document”.</i></p>	<p>2.3.7 të kapacitetit teknik:</p> <p>Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë minimalisht në listëpagesat e muajit të fundit, punonjës të specializuar/të kualifikuar si më poshtë :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 (nje) punonjës të pajisur me çertifikatë si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.</li> </ul> <p><i>* Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësën e kërkuar si më sipër, emër/mbiemër, numrin dhe datën e çertifikatës, si dhe institucionin që ka lëshuar këtë dokument.</i></p>

Me Vendim të titullarit të AK nr.78 datë 03.10.2023 është *Pezulluar procedura e prokurimit* për arsye të disa ndryshimeve në dokumentat standarte të tenderit sipas rekomandimeve të APP-së.

Me Vendim të titullarit të AK nr.79 datë 03.10.2023 është *Hequr pezullimi i procedurës së prokurimit*, për arsye të publikimit me sukses të shtojcës me ndryshimet sipas rekomandimeve të APP-së.

*Referuar Dokumenteve Standarte të Tenderit, rezulton se:*

Në pikën 2.3.8 të Dokumenteve Standarte të Tenderit (DST) nga AK kërkohet që Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë minimalisht në pagesat e muajit të fundit, punonjës të specializuar/kualifikuar si më poshtë vijonë:

- 1 (një) përgatites i konstruksioneve metalike, 2 (dy) Specialist Fasade, dhe 2 (dy) Karpentierë që të disponojnë çertifikatë trajnimi “Për punime në lartësi”, sipas V.K.M nr.312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në pikën 2.3.9 të Dokumenteve Standarte të Tenderit (DST) nga AK kërkohet që Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë minimalisht në listëpagesat e muajit të fundit, punonjës të specializuar/të kualifikuar si më poshtë :

- 1 (një) punonjës të trajnuar dhe të kualifikuar për përdorimin dhe instalimin e kaldajave me avull dhe ujë të nxehtë sipas “Rregullores së sigurimit teknik të kaldajave të avullit dhe ujit të nxehte” dhe ligjit Nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë;
- 1 (një) punonjës të trajnuar dhe të kualifikuar për përdorimin dhe instalimin e rezervuarëve të gazit (GLN ose LPG) mbi tokë dhe nëntokë sipas vendimit Nr. 1062, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet dhe bashkësitë nën presion” dhe ligjit Nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në pikën 2.3.10 të Dokumenteve Standarte të Tenderit (DST) nga AK kërkohet që Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 53 (pesëdhjetë e tre) persona për të paktën muajin e fundit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë ofertues duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për të paktën muajin e fundit, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8 .

Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë :

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit, për periudhën si më sipër.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën si më sipër.

*Kriteret për pikat 2.3.8-2.3.9 për punonjësit nuk është janë argumentuar teknikisht, se për çfarë u janë kërkuar OE pjesëmarrës, referuar grafikut dhe preventivit të punimeve. Duke përmbushur pjesërisht parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik sipas nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:*

*“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës” .*

Për sa konstatuar më sipër, në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në vëmendje të personit përgjegjës për prokurimin.

*Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi specialisti i fushës, hartues i kritereve të seksionit të kapacitetit teknik, përgjegjës i njësisë së prokurimeve Z. E.A kryetar i nj.p, si dhe anëtarët e tjerë Z. J.N dhe Z. V.K*

***Observacion i paraqitur pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr.844 prot., datë 22.04.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 136/4 prot., datë 25.04.2024***

Pretendimi i sjellë nga ana e subjektit është i njëjtë me observacionin e sjellë për fazën e projekt raportit me shkresën nr. 450 prot., datë 05.03.2024 protokolluar në KLSH me nr.136/2 prot., datë 06.03.2024.

***Komenti i grupit të auditimit:***

Sjellim në vëmendjen tuaj se, konstatimi i grupit të auditimit i referohet dokumentave standarte të tenderit, hartimit të pjesës mbi kapacitetet teknike. Mënyrës se si ato janë hartuar, ky konstatim nuk ka të bëjë me argumentimin nga ana juaj tani, për efekt të materialit që po dërgoni me observim. *Këto argumentime teknike duhet të ishin pjesë e DST.*

Në kushtet e mos sjelljes së dokumentacionit të ri justifikues, observacioni mësipërm nuk merret në konsideratë

***Observacioni mësipërm nuk pranohet.***

Nga auditimi rezultoj se, në dy procedura prokurimi, nga ana e AK mungon argumentimi i çdo kriteri për kualifikim.

Kështu, për procedurën “Rikonstruksioni i shkollës 9 vjecare, Kamber Bënja” Referuar Dokumenteve Standarte të Tenderit, rezulton se:

- ✓ Në pikën 2.3.8 të Dokumenteve Standarte të Tenderit (DST) nga AK kërkohet që Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë minimalisht në pagesat e muajit të fundit, punonjës të specializuar/kualifikuar si më poshtë vijonë:
  - 1 (një) përgatites i konstruksioneve metalike, 2 (dy) Specialist Fasade, dhe 2 (dy) Karpentierë që të disponojnë çertifikatë trajnimi “Për punime në lartësi”, sipas V.K.M nr.312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në pikën 2.3.9 të Dokumenteve Standarte të Tenderit (DST) nga AK kërkohet që Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë minimalisht në listëpagesat e muajit të fundit, punonjës të specializuar/të kualifikuar si më poshtë :

- 1 (një) punonjës të trajnuar dhe të kualifikuar për përdorimin dhe instalimin e kaldajave me avull dhe ujë të nxehtë sipas “Rregullores së sigurimit teknik të kaldajave të avullit dhe ujit të nxehtë” dhe ligjit Nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë;
- 1 (një) punonjës të trajnuar dhe të kualifikuar për përdorimin dhe instalimin e rezervuarëve të gazit (GLN ose LPG) mbi tokë dhe nëntokë sipas vendimit Nr. 1062, datë 23.12.2015 “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet dhe bashkësitë nën presion” dhe ligjit Nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe

*instalimeve nën presion*”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Sa më sipër, operuar në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar sikundër më lartë specifikuar. Në kushtet kur, argumentimi teknik i kriterëve i shërben AK për të përcaktuar në mënyrë efikase nivelin e tyre, mosargumentimi i kriterëve eventualisht mund të ndikojë tek AK për vendosjen e kriterëve në nivel më të ulët se ato të domosdoshme për realizimin e kontratës, çka përbën një risk të shtuar për realizimin në kohë dhe cilësi të objektit.

✓ për procedurën “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara” në dokumentat standartë të tenderit (DST), në pikën 2.4.1/1, të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: “Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- 1 (një) Arkitekt

Kërkesa për një arkitekt është e *pa argumentuar teknikisht* në procesverbalin e hartuar për argumentimin e kriterëve të veçanta të DT. Nuk argumentohet lidhja me natyrën dhe tipologjinë e kontratës, dhe nevoja e specifikuar në preventiv për zëra punimesh që diktojnë nevojën për arkitekt. Ky kriter gjykohet si i pa nevojshëm, dhe pa lidhje të ngushtë me aftësinë zbatuese të kontratës, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, si dhe pikën 1 të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”.

✓ Nga auditimi i procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, të hartuar nga njësia e prokurimit, konstatohet se kriteret e kapacitetit teknik nuk janë të argumentuara nga ana teknike. Në këtë procesverbal nga njësia e prokurimit është dokumentuar vetëm baza ligjore, e cila i jep të drejtën autoritetit kontraktor, që gjatë hartimit të kriterëve mund t’u kërkojë ofertuesve plotësimin e një numri të caktuar kriteresh të nevojshme, por nuk është argumentuar teknikisht lidhja e kriterit të vendosur me objektin e kontratës, me zërin konkret të preventivit. Operuar në kundërshtim me neni 2, pika 2, gërma (c); neni 39 pika 6 gërma ç, neni 78 pika 1 dhe 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.12 Operatorët ekonomik ofertues për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet teknike si më mëposhtë :

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia	OE
1	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbi 10 ton	Pronësi/Qera	copë	1	1
2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtës 5-10 ton	Pronësi/Qera	cope	2	2
3	Kamioncine me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton	Pronësi/Qera	copë	1	1
4	Kamioncine me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	Pronësi/Qera	copë	1	1
5	Kamioncine me vinc me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	Pronësi/Qera	copë	1	1
6	Autovinc me kapacitet ngritës mbi 5 ton	Pronësi/Qera	copë	2	1

7	Eskavator	Pronësi/Qera	copë	1	1
8	Minieskavator	Pronësi/Qera	copë	2	1
9	Ngjeshes/ kompaktor	Pronësi/Qera	copë	1	1
10	Total station	Pronësi/Qera	copë	1	1
11	Motogjenerator / Gjenerator	Pronësi/Qera	copë	1	1
12	Depozite uji 5000 litra	Pronësi/Qera	copë	2	2
13	Matrapik	Pronësi/Qera	copë	5	5
14	Vidiator	Pronësi/Qera	copë	2	2
15	Trapan	Pronësi/Qera	copë	2	2
16	Nivelues me lazer	Pronësi/Qera	copë	1	1
17	Aparat lidhje per fiber optike	Pronësi/Qera	copë	1	1
18	Freze per rrafshim/hapje kanalesh ne mur	Pronësi/Qera	copë	1	1
19	Pompë uji	Pronësi/Qera	copë	2	2
20	Betoniere	Pronësi/Qera	copë	2	2
21	Skela metalike të kompletuara	Pronësi/Qera	copë	Min 500 m <sup>2</sup>	500m
22	Kompresor ajri	Pronësi/Qera	copë	2	2
23	Makineri/Pompe lysterje	Pronësi/Qera	copë	1	1
24	Pompë presioni për testimin e tubave nën presion	Pronësi/Qera	copë	2	2
25	Pajisje/Makineri për bashkimin e tubave PPR	Pronësi/Qera	copë	1	1
26	Pajisje/Makineri për bashkimin e tubave PEX	Pronësi/Qera	copë	2	2
27	Saldatrice/Motosaldatrice	Pronësi/Qera	copë	1	1

- a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik si dhe çertifikatën e transportit të mallrave (të vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme).
- b) Për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik si dhe çertifikatën e transportit të mallrave (të vlefshme), siguracionin e mjetit, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.
- d) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës përkatëse. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- e) Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara më sipër do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak për skualifikim. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

Sa më sipër rezultoj se, autovinç me kapacitet ngritës mbi 5 ton dhe minieskavator nga 2 që kërkoheshin OE dispononte vetëm 1 prej secilit.

**AK (Personi Përgjegjës për Prokurimin) në lidhje me “zyrtarët pjesëmarrës në grupet e punës”:**

Nga auditimi konstatohet se AK Bashkia Këlcyrë për vitin 2023 ka caktuar si anëtar të njësisë së prokurimit dhe njëkohësisht person përgjegjës për prokurimin, Z. E.A , i cila sipas të dhënave të Bashkisë Këlcyrë, nuk është punonjës i këtij institucioni por është kontraktuar.

Për këtë qëllim në datën 01.09.2023 me nr.1982 prot., është lidhur aktmarrëveshje midis Bashkisë Këlcyrë dhe Z. E.A

Nga ana e Bashkisë Këlcyrë nuk argumentohet e as justifikohet punësimi/kontraktimi i këtij personi, pasi ky institucion nuk ndodhet në kushtet e mungesës së stafit për përcaktimin e personit përgjegjës për prokurimin dhe caktimin e njësisë së prokurimit. Kuadri ligjor në fuqi nuk përcakton detyrimin që subjektet të kenë pa tjetër një jurist në njësinë e prokurimit. Bashkia Këlcyrë ka në strukturën e saj personel me arsim të lartë për kryerjen e kësaj detyre, të cilët më parë duhet të trajnohen prej saj.

Detyrimi që ka vendosur neni 74 i VKM nr.285 dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, lidhur me personin përgjegjës për prokurimin është:

Personi/at përgjegjës duhet të jenë minimalisht me arsim të lartë.

Gjithashtu po ky nen, ka vendosur detyrimin për titullarin e autoritetit kontraktor si vijon: Autoritetet/entet kontraktore duhet të nxisin trajnimin e personit/personave përgjegjës në fushën e prokurimit publik.

Sa më sipër, për kryerjen e procedurës së kontraktimit është operuar jo në mbështetje të nenit 74 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, të VKM nr.285 dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku specifikohet se, *...në rast mungese personeli, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë staf të specializuar nga autoritete/ente të tjera kontraktore ose të punësojë ekspertë të jashtëm.* Gjithashtu autoriteti/enti kontraktor mund të krijojë një njësi të përbashkët prokurimi me një apo më shumë autoritete/ente kontraktore.

*Nga auditimi konstatohet se, për personin në fjalë praktika dokumentare e kontraktimit të tij është ajo e lidhjes së një aktmarrëveshje mes personit fizik (jurist) dhe Bashkisë Këlcyrë, e jo punësimit të një eksperti të jashtëm.*

Në pikën 3 të nenit 74 të VKM nr.285 dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohen detyrat e personit përgjegjës për prokurimin, ku midis të tjerash janë: Personi/at përgjegjës për prokurimin kryen/jnë detyrat e mëposhtme:

- Sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;
- Hartimin e urdhrat të prokurimit;
- Përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme, që u bashkëlidhen atyre;
- Hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore;
- Administrimin e të gjitha procesverbaleve për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti;
- Ndjek procesin e komunikimit me operatorët ekonomikë të përfshirë në procesin e ankimimit, për çdo vendim në procesin e shqyrtimit të ankesës, sipas parashikimeve në këto rregulla;
- Administrimin e dokumentacionit në formë të shkruar, origjinal ose fotokopje të noterizuar të operatorit ekonomik fitues, përpara lidhjes së kontratës nga autoriteti/enti kontraktor;
- Ndjekjen e procedurave për konfiskimin e sigurimit të ofertës sipas përcaktimit në LPP dhe në këto rregulla;



- *Administrimin e sigurimit të kontratës përpara lidhjes së kontratës nga autoriteti kontraktor; etj.*

Të gjitha detyrat e përcaktuara më sipër, personi përgjegjës për prokurimin nuk mund ti kryej dot duke mos qenë pjesë e strukturës së institucionit.

Titulli i Gjetjes: Anomali në përcaktimin e personit përgjegjës të prokurimit.

Nga auditimi konstatohet se AK Bashkia Këlcyrë për vitin 2023 ka caktuar si anëtar të njësisë së prokurimit dhe njëkohësisht person përgjegjës për prokurimin, Z. E.A , i cila sipas të dhënave të Bashkisë Këlcyrë, nuk është punonjës i këtij institucioni por është kontraktuar.

Nga ana e Bashkisë Këlcyrë nuk argumentohet e as justifikohet punësimi/kontraktimi i këtij personi, e nuk rezulton që ky institucion të ndodhet në kushtet e mungesës së stafit për përcaktimin e personit përgjegjës për prokurimin dhe caktimin e njësisë së prokurimit. Bashkia Këlcyrë ka në strukturën e saj personel me arsim të lartë për kryerjen e kësaj detyre, e ndërkohë kuadri ligjor në fuqi nuk përcakton detyrimin që subjektet të kenë pa tjetër një jurist në njësinë e prokurimit.

Detyrimi që ka vendosur neni 74 i VKM nr.285 dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, lidhur me personin përgjegjës për prokurimin është:

Personi/at përgjegjës duhet të jenë minimalisht me arsim të lartë.

Gjithashtu po ky nen, ka vendosur detyrimin për titullarin e autoritetit kontraktor si vijon: Autoritetet/entet kontraktore duhet të nxisin trajnimin e personit/personave përgjegjës në fushën e prokurimit publik.

Sa më sipër, për kryerjen e procedurës së kontraktimit është operuar jo në mbështetje të nenit 74 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, të VKM nr.285 dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku specifikohet se, ...në rast mungese personeli, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë staf të specializuar nga autoritete/ente të tjera kontraktore ose të punësojë ekspertë të jashtëm. Gjithashtu autoriteti/enti kontraktor mund të krijojë një njësi të përbashkët prokurimi me një apo më shumë autoritete/ente kontraktore.

Nga auditimi konstatohet se, për personin në fjalë praktika dokumentare e kontraktimit të tij është ajo e lidhjes së një aktmarrëveshje mes personit fizik (jurist) dhe Bashkisë Këlcyrë, e jo punësimin të një eksperti të jashtëm.

Në pikën 3 të nenit 74 të VKM nr.285 dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohen detyrat e personit përgjegjës për prokurimin, ku midis të tjerash janë: Personi/at përgjegjës për prokurimin kryen/jnë detyrat e mëposhtme:

- Sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;

- Hartimin e urdhrin të prokurimit;

- Përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme, që u bashkëlidhen atyre;

- Hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore;

- Administrimin e të gjitha procesverbaleve për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti;

- Ndjek procesin e komunikimit me operatorët ekonomikë të përfshirë në procesin e ankimimit, për çdo vendim në procesin e shqyrtimit të ankesës, sipas parashikimeve në këto rregulla;

- Administrimin e dokumentacionit në formë të shkruar, origjinal ose fotokopje të noterizuar të operatorit ekonomik fitues, përpara lidhjes së kontratës nga autoriteti/enti kontraktor;
- Ndjekjen e procedurave për konfiskimin e sigurimit të ofertës sipas përcaktimit në LPP dhe në këto rregulla;
- Administrimin e sigurimit të kontratës përpara lidhjes së kontratës nga autoriteti kontraktor; etj.

Të gjitha detyrat e përcaktuara më sipër, personi përgjegjës për prokurimin nuk mund ti kryej dot duke mos qenë pjesë e strukturës së institucionit.

Kriteri: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,

VKM nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

***AK (personi përgjegjës për prokurimin) në lidhje me “Administrimin e Dokumentacionit”:***

Referuar procedurave së sipërcituara, konstatohet se dosjet fizike të prokurimit, të cilat ndër të tjera përmbajnë procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj, nuk janë të pajisura me inventarin e brendshëm të dosjes.

*Referuar nenit 21, 59, 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, ndër të tjera, kërkohet që për çdo njësi ruajtjeje të hartohet inventari i brendshëm i dokumenteve që përmban njësia.*

Gjithashtu, referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Veprimtaria e Kontrollit, si një prej pesë komponentëve të MFK, përmban detyrimin e hartimit të procedurave për dokumentimin, arkivimin dhe ruajtjen e informacionit, të cilat duhet të vendosen për të mbështetur kryerjen e operacioneve dhe kontrollimin e proceseve në njësinë publike.

*Si konkluzion, mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara mbartin riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit.*

Për sa më sipër, AK (personi përgjegjës për prokurimin) të marrë masa për inventarizimin e të gjithë dokumentacionit në lidhje me procedurën e sipërcituara, duke dokumentuar të gjithë procesin në rend kronologjik, sikurse kërkohet nga normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në RSH.

Për sa konstatuar më sipër, në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në vëmendje të personit përgjegjës për prokurimin.

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;  
Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”  
Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;  
Normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

***Për sa konstatuar më sipër, në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në vëmendje të personit përgjegjës për prokurimin.***

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;  
Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”  
Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;  
Normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

### **Vlerësimi i ofertave**

Me Urdhër nr.73 prot., datë 08.09.2023 u ngrit Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me anëtar O.H , R.S dhe A.Q . Me Urdhër nr.86 datë 26.10.2023 të titullarit të Bashkisë, u ndryshuar Komisioni Vlerësimit të Ofertave ku anëtari R.S u zëvendësua me E.B .

*Nga auditimi u konstatua se, në SPE nuk rezulton gjurmë e pasqyrimet të këtij ndryshimi në anëtarët e KVO.*

Në datën 08.11.2023, KVO ka hartuar raportin përmbledhës, protokolluar me nr.2616 prot., datë 08.11.2023.

Me shkresën nr. 2596 prot., datë 06.11.2023, titullari i autoritetit kontraktor Z. K.N dhe ka shpallur fituesin.

### ***Observacion i paraqitur pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr.844 prot., datë 22.04.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 136/4 prot., datë 25.04.2024***

Pretendimi i sjellë nga ana e subjektit është i njëjtë me observacionin e sjellë me shkresën nr. 450 prot., datë 05.03.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.136/2 prot., datë 06.03.2024 sjellë në fazën e projekt raportit.

#### ***Komenti i grupit të auditimit:***

Sjellim në vëmendjen tuaj se, sikundër herën e parë argumentuar, nga ana e grupit të auditimit me kredencialet e veta nuk arrin ta gjeneroj dot këtë të dhënë, nderkohë me anën e observacioneve nuk është sjellë provë e re që të ndryshojë faktet (screenshot apo spin i faktit).

***Observacioni mësipërm nuk pranohet.***

Kohëzgjatja e kontratës: 7 muaj

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: *oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmim*

Në tender kanë marrë pjesë 5 operator ekonomik, sipas të dhënave të mëposhtme:

Nr	Operatorët pjesëmarrës në tender	Vlera në lekë e ofertës pa TVSH	Kualifikimi	NIPT
1	“E.C ”		S’kualifikuar	M...I
2	“F ”	74,072,833	S’kualifikuar	M...Q
3	“R ”		S’kualifikuar	J...E
4	“V ”	73,447,385.8	S’kualifikuar	K...E
5	“Z ”	71,961,251.8	Kualifikuar, fitues	L...O

Me procesverbalin e datës 25.10.2023 (me korrigjim data) nga KVO janë argumentuar arsyet për skualifikim/kualifikim të secilit OE.

#### **Mbi s’kualifikimin e OE “E.C ” PF**

OE E.C person fizik, ka paraqitur vetëm ekstraktin e thjeshtë

Sa më sipër OE rezulton me mungesa në dokumentacion dhe skualifikohet.

#### **Mbi s’kualifikimin e OE “F ” ShPK**

OE ka paraqitur vetëm ekstraktin e QKB, formularin e ofertës, certifikatë rregjistrimi si dhe formularin përmbledhës të vetëdeklarimit me mungesa të shumta duke mos dhënë informacion për mjetet, stafin teknik dhe punonjësit e specializuar.

Sa më sipër OE rezulton me mungesa në dokumentacion dhe skualifikohet.

### **Mbi s'kualifikimin e OE "R" ShPK**

OE ka paraqitur vetëm vërtetimin për taksat vendore për vitin 2023

Sa më sipër OE rezulton me mungesa në dokumentacion dhe skualifikohet.

### **Mbi s'kualifikimin e OE "V" ShPK**

OE nuk plotëson

- pikën 2.3.5 të DST për punonjës të kualifikuar si dhe nuk ka paraqitur punonjës për hekurpunues, termoizolues, specialist gipsi, marangoz/mobilier si dhe përgatitës të konstruksioneve metalike
- pikën 2.3.7 të DST pasi nuk ka paraqitur punonjës të pajisur me Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave dhe punonjës të pajisur me certifikatë si përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë
- 2.3.9 të DST pasi nuk ka paraqitur punonjës të trajnuar dhe të kualifikuar për përdorimin dhe instalimin e kaldajave me avull dhe ujë të nxehtë sipas "Rregullores së sigurimit teknik të kaldajave të avullit dhe ujit të nxehtë" dhe ligjit Nr. 32/2016 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion" si dhe punonjës të trajnuar dhe të kualifikuar për përdorimin dhe instalimin e rezervuarëve të gazit (GLN ose LPG) mbi tokë dhe nëntokë sipas vendimit Nr. 1062, datë 23.12.2015 "Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet dhe bashkësitë nën presion" dhe ligjit Nr. 32/2016 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion".
- 2.3.11 të DST pasi nuk ka paraqitur asnjë ISO
- pikën 2.3.11 të DST pasi nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi, ose distributor të autorizuar ose marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalent i tij/saj) të noterizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose miidis ofertuesit distributor – prodhues për të gjitha materialet e kërkuar.
- pikën 2.3.14 të DST pasi nuk ka paraqitur pronësi, kontratë qeraje ose furnizimi për pllakat e gurit.

Sa më sipër OE rezulton me mungesa në dokumentacion dhe skualifikohet.

Nga auditimi u konstatua se, arsyeja për skualifikim lidhur me

- pikën 2.3.7 për mos paraqitjen e punonjës me certifikatë si përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë është kriter i hequr nga APP, i cili rezulton i pazbatuar pavarësisht se në shtojcën e DST është hequr edhe prej AK.
- Pikën 2.3.11 sikundër më lart sqaruar, (pikën 2.3.11 të DST pasi nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi, ose distributor të autorizuar ose marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalent i tij/saj) të noterizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose miidis ofertuesit distributor – prodhues për të gjitha materialet e kërkuar) nuk rezulton të jetë pjesë e formatit të DST konkrete për këtë procedurë.

***Observacion i paraqitur pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr.844 prot., datë 22.04.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 136/4 prot., datë 25.04.2024***

Skualifikimi për shkak se, pikën 2.3.7 për mosparaqitjen e punonjës me certifikatë si përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë është hequr si kriter nga APP, dhe i cili rezulton i pazbatuar, KVO gjykon se : Ofertuesi "V" shpk nuk plotëson edhe 5 kritere të tjera në DST, dhe për rrjedhojë gjendja e tij faktike/juridike do të mbetet përsëri i skualifikuar dhe nuk ka ndikuar drejtëpërdrejtë në vlerësimin e këtij të fundit.

Në lidhje me pikën tjetër të DST, sqarojmë se është një lapsus nga AK kur thuhet për paraqitjen e autorizim prodhuesi ose distributori, e cila duhet të ishte pika 2.3.13 dhe jo pika 2.3.11. Kriteri i cili është kërkuar në DST konkretisht në pikën 2.3.13.

***Komenti i grupit të auditimit:***

Sjellim në vëmendjen tuaj se, nga ana e grupit të auditimit është evidentuar situata dhe nuk ka të bëj me përgjigjen tuaj.

***Observacioni mësipërm nuk pranohet.***

**Mbi kualifikimin e OE “Z ” ShPK**

Nga verifikimi i plotësimit të kriterëve të kapacitetit teknik, u konstatua se,

- pika 2.3.12, autovinç me kapacitet mbi 5 ton dhe minieskavator nga 2 copë që kërkohej prej AK, OE i dispononte në sasinë 1 copë;
  - *me qera:*
- për kontratë furnizimi (Amendim Kontrate) me nr.repertori 1279, nr.koleksioni 619 (me shkrim dore /1) datë 03.10.2023 mes palëve Z Sh.P.K qeramarrës dhe F Sh.P.K qeradhënës me objekt kontrate furnizimi me pllaka guri, nga ana e AK nuk është kërkuar kontrata origjinale por janë mjaftuar me amendimin e saj. Neni 3 Cmimi i mallit, nga palët nuk është vendosur një çmim mesatar apo reference, por është rënë dakort që do të jetë çmimi i tregut në momentin dhe vendin e dorëzimit.
- U konstatua prania e vërtetimit përkthimi me datë 29.09.2020 nga noterë A.D , i cili vërteton se *përkthimi i dokumentit nga gjuha angleze në gjuhën shqip bashkëlidhur është i njëjtë me origjinalin*; ndërkohë dokumentat bashkangjitur nga Agjencia Doganore me objekt Deklarata e eksportit të lirë me datë 05.06.2020 është në gjuhën italiane dhe jo angleze.
  - *pronësi:*
- nga auditimi u konstatua se, për të gjithë mjetet e deklaruara në statusinë “pronësi” prej OE, në shtojcën nr.8 vetëdeklarimi, në kolonën të tjera ku jepen specifikime të dokumentave justifikuese mbështetëse, është cituar vetëm emërtesa faturë tatimore pa numër serial dhe datë të saj.

Në këto kushte pamundësohet verifikimi i këtyre objekteve krahasuar me dokumentat e vendosura në dispozicion. Nga auditimi zë për zë i dosjes së tyre u konstatua se,

- për objektin *minieskavatorë*, specifikuar në deklaratë si objekt në pronësi dhe se për të disponohej faturë tatimore por mungonin të dhënat specifike të tij; në aktzhdoganim rezultonte *eskavatorë* me të dhëna AA188XL/AER087;

*Sa më sipër nga ana e AK është operuar duke kryer vlerësimi të OE dhe kualifikimi të tij pa kërkuar paraprakisht shpjegime mbi mangësitë në plotësimin e kriterëve.*

***Observacion i paraqitur pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr.844 prot., datë 22.04.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 136/4 prot., datë 25.04.2024***

Pretendimi i sjellë nga ana e subjektit është i njëjtë me observacionin e sjellë me shkresën nr. 450 prot., datë 05.03.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.136/2 prot., datë 06.03.2024 sjellë në fazën e projekt raportit.

***Komenti i grupit të auditimit:***

Sa i takon pretendimit mbi mjetet e deklaruara në statusin “pronësi” prej OE, për të cilët në shtojcën nr.8 vetëdeklarimi, në kolonën të tjera ku jepen specifikime të dokumentave justifikuese mbështetëse, është cituar vetëm emërtesa faturë tatimore pa numër serial dhe datë

të saj. Ju shpreheni se i keni grumbulluar fizikisht këto dokumenta, por në mungesë të specifikimeve në shtojcën nr.8 grupi auditimit nuk arrinë të marrë siguri të arsyeshme mbi vërtetësinë e tyre, po ashtu këto dokumenta grupit të auditimit nuk i janë vendosur në dispozicion.

Sa i takon pretendimit tuaj mbi eskavatorë, sjellim në vëmendjen tuaj se, objekti minieskavatorë, i specifikuar në deklaratë si objekt në pronësi dhe konstatimi i referohet plotësisë së faturës si dokument justifikues vendosur në dispozicion. Në akt zhdoganim rezulton i marr eskavatorë me të dhëna AA188XL/AER087 dhe grupi auditimit nuk arrin të marr siguri të arsyeshme mbi faktin e të qenurit e njëjta pajisje.

Me anën e observacioneve nuk është sjellë provë e re që të ndryshojë faktet.

***Observacioni mësipërm nuk pranohet.***

***Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi komisioni vlerësimit të ofertave Z. O.H Z. A.Q dhe Z. E.B***

Titulli i Gjetjes: Vlerësimi i shoqërive (OE) pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit dhe kualifikimi i tyre me “devijanca të vogla”.

Situata: Nga verifikimi i plotësimit të kriterëve të kapacitetit teknik, u konstatua se,

✓ me qera:

- për kontratë furnizimi (Amendim Kontrate) me nr.repertori 1279, nr.koleksioni 619 (me shkrim dore /1) datë 03.10.2023 mes palëve Z Sh.P.K qeramarrës dhe F Sh.P.K qeradhënës me objekt kontrate furnizimi me pllaka guri, nga ana e AK nuk është kërkuar kontrata origjinale por janë mjaftuar me amendimin e saj. Neni 3 Cmimi i mallit, nga palët nuk është vendosur një çmim mesatar apo reference, por është rënë dakort që do të jetë çmimi i tregut në momentin dhe vendin e dorëzimit.

- U konstatua prania e vërtetimit përkthimi me datë 29.09.2020 nga noterë A.D , i cili vërteton se përkthimi i dokumentit nga gjuha angleze në gjuhën shqip bashkëlidhur është i njëjtë me origjinalin; ndërkohë dokumentat bashkangjitur nga Agjencia Doganore me objekt Deklarata e eksportit të lirë me datë 05.06.2020 është në gjuhën italiane dhe jo angleze.

✓ pronësi:

- nga auditimi u konstatua se, për të gjithë mjetet e deklaruara në statusinë “pronësi” prej OE, në shtojcën nr.8 vetëdeklarimi, në kolonën të tjera ku jepen specifikime të dokumentave justifikuese mbështetëse, është cituar vetëm emërtesa faturë tatimore pa numër serial dhe datë të saj.

Në këto kushte pamundësohet verifikimi i këtyre objekteve krahasuar me dokumentat e vendosura në dispozicion. Nga auditimi zë për zë i dosjes së tyre u konstatua se,

- për objektin minieskavatorë, specifikuar në deklaratë si objekt në pronësi dhe se për të disponohej faturë tatimore por mungonin të dhënat specifike të tij; në aktzhdoganim rezultonte eskavatorë me të dhëna AA188XL/AER087;

Kualifikimi i shoqërive (OE) pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit, pa kërkuar dhe dokumentuar paraprakisht shpjegimet mbi mangësitë në plotësimin e kriterëve, qofshin këto edhe devijime të vogla, përbën një risk të shtuar për realizimin e kontratës.

Veprimet e mësipërme në kundërshtim me Neni 82, pika 2, germa i) të VKM nr. 285, datë 23.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” , Neni 92 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” , Neni 74, 76, 78 pika 2 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021

*Konstatim:* Nga verifikimi i plotësimit të kriterëve të kapacitetit teknik, për procedurën e prokurimit “*Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare Kamber Bënja, Këlcyrë*”, rezultoj se, është vijuar me vlerësimin e OE pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit dhe kualifikim pa kërkuar paraprakisht shpjegime mbi mangësitë në plotësimin e kriterëve. Kështu:

➤ *me qera:*

- për kontratë furnizimi (Amendim Kontrate) me nr.repertori 1279, nr.koleksioni 619 (me shkrim dore /1) datë 03.10.2023 mes palëve Z Sh.P.K qeramarrës dhe F Sh.P.K qeradhënës me objekt kontrate furnizimi me pllaka guri, nga ana e AK nuk është kërkuar kontrata origjinale por janë mjaftuar me amendimin e saj. Neni 3 Cmimi i mallit, nga palët nuk është vendosur një çmim mesatar apo reference, por është rënë dakort që do të jetë çmimi i tregut në momentin dhe vendin e dorëzimit.

- U konstatua prania e vërtetimit përkthimi me datë 29.09.2020 nga noterë A.D , i cili vërteton se *përkthimi i dokumentit nga gjuha angleze në gjuhën shqip bashkëlidhur është i njëjtë me origjinalin*; ndërkohë dokumentat bashkangjitur nga Agjencia Doganore me objekt Deklarata e eksportit të lirë me datë 05.06.2020 është në gjuhën italiane dhe jo angleze.

➤ *pronësi:*

- nga auditimi rezultoi se, për të gjithë mjetet e deklaruara në statusinë “*pronësi*” prej OE, në shtojcën nr.8 vetëdeklarimi, në kolonën *të tjera* ku jepen specifikime të dokumentave justifikuese mbështetëse, është cituar vetëm emërtesa faturë tatimore pa numër serial dhe datë të saj.

*Në këto kushte pamundësohet verifikimi i këtyre objekteve krahasuar me dokumentat e vendosura në dispozicion. Nga auditimi zë për zë i dosjes së tyre u konstatua se, për objektin minieskavatorë, specifikuar në deklaratë si objekt në pronësi dhe se për të disponohej faturë tatimore por mungonin të dhënat specifike të tij; në aktzhdoganim rezultonte eskavatorë me të dhëna AA188XL/AER087;*

Sa më sipër, operuar jo në përputhje me nenin 82, pika 2, germa i) , neni 74, 76, 78 pika 2 të VKM nr. 285, datë 23.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe neni 92 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”

Nga ana e Bashkisë Këlcyrë është kryer interpretim dhe zbatim i gabuar i LPP-së dhe akteve nënligjore nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, duke shkaktuar kualifikim të shoqërive (OE) pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit, pa kërkuar dhe dokumentuar paraprakisht shpjegimet mbi mangësitë në plotësimin e kriterëve, qofshin këto edhe devijime të vogla, duke përbërë një risk të shtuar për realizimin e kontratës.

***Observacion i paraqitur pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr.844 prot., datë 22.04.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 136/4 prot., datë 25.04.2024.***

Pretendimi i sjellë nga ana e subjektit është i njëjtë me observacionin e sjellë me shkresën nr. 450 prot., datë 05.03.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.136/2 prot., datë 06.03.2024 sjellë në fazën e projekt raportit.

***Komenti i grupit të auditimit:***

Sjellim në vëmendjen tuaj se,

- Sa i takon kontratës për furnizimi (Amendim Kontrate) nga ana e AK nuk është kërkuar kontrata origjinale por janë mjaftuar me amendimin e saj, sjellim në vëmendjen tuaj se, nga ana e AK nevojitet të merret siguri mbi OE që po përzgjedh e për këtë arsye është e nevojshme të kërkohet kontrata origjinale e të mos mjaftohet me amendimin e saj. Për më tepër që në amendim çmimi nuk është i specifikuar. Neni 3 “*Cmimi i mallit, nga palët nuk është vendosur*

*një çmim mesatar apo reference, por është rënë dakort që do të jetë çmimi i tregut në momentin dhe vendin e dorëzimit”. Kjo pjesë e observimit, në mungesë të dokumentacionit të ri justifikues nuk merret në konsideratë.*

- Sa i takon konstatimit mbi praninë e vërtetimit përkthimi me datë 29.09.2020 nga noterë A.D , i cili vërteton se *përkthimi i dokumentit nga gjuha angleze në gjuhën shqip bashkëlidhur është i njëjtë me origjinalin*; Sjellim në vëmendjen tuaj se Dichiarazione di libera esportazione/deklarata e transportit të lirë të mjetit dokument i vendosur në dispozicion të grupit të auditimit prej jush, rezultoi të jetë në gjuhën italiane. Ndërkohë noteri deklaroi përkthim nga gjuha angleze të kësaj deklarë. Konstatimi i grupit të auditimit, sikundër ju vendosur në dijeni, është pikërisht mbi këtë fakt.

Në kushtet e mosparaqitjes së dokumentacionit të ri justifikues, nuk merren në konsideratë pretendimet e sipërcituara.

***Observacioni mësipërm nuk pranohet.***

#### *Konstatim*

*Mbi afatet kohore, nga auditimi u konstatua zvonësia e afateve kohore për publikimin e lidhjes së kontratës. Nga data 14.12.2023 që kjo kontratë është nënshkruar, në SPE është publikuar më 20.12.2023, si dhe nuk është publikuar nga personi përgjegjës i prokurimit por nga z. J.N . Mbi vlerën e TVSH-së në formularin e lidhjes së kontratës dhe asaj në DST: Nga auditimi u konstatua se, vlera e shpallur fituese prej 71,961,251.8 (shtatëdhjetë e një milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e dyqind e pesëdhjetë e një presje tetë) lekë pa tvsh, ose 85,262,782.2 (tetëdhjetë e pesë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e dy presje dy lekë me tvsh nuk është e njëjtë me vlerën e specifikuar në DST prej. “TVSH nuk përputhet me atë të vendosur në SPE për shkak se disa pajisje të parashikuara në preventivin e punimeve janë mallra të cilat nuk i nënshtrohet tatimit mbi vlerën e shtuar dhe për rrjedhojë totali me tvsh del me diferencë me totalin e vendosur në SPE për arsye se në SPE TVSH del automatikisht”). Mallrat të cilat nuk i nënshtrohen tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) janë pajisjet mekanike sipas preventivit të punimeve dhe ofertës së paraqitur kanë vlerën 5,453,600 lekë.*

***Observacion i paraqitur pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr.844 prot., datë 22.04.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 136/4 prot., datë 25.04.2024***

Pretendimi i sjellë nga ana e subjektit është i njëjtë me observacionin e sjellë me shkresën nr. 450 prot., datë 05.03.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.136/2 prot., datë 06.03.2024 sjellë në fazën e projekt raportit.

#### ***Komenti i grupit të auditimit:***

Sjellim në vëmendjen tuaj se, sikundër herën e parë argumentuar, nga ana e grupit të auditimit është evidentuar situata dhe nuk gjen vend observacioni i kryer nga ana juaj.

***Observacioni mësipërm nuk pranohet.***

#### ***c-Plan monitorimi të zbatimit të kontratës***

Nga auditimi konstatohet se, Bashkia Këlcyre nuk ka hartuar plan të monitorimit të zbatimit të kontratës dhe nuk ka përcaktuar person apo grup pune për monitorimin e zbatimit të kontratës, për mbikëqyrjen e veprimtarisë së kontraktorit, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë dhe legjislacionin në fuqi, për çështjet organizative të kontratës, afatet, çështjet ekonomike teknike etj. Operuar sa më sipër në kundërshtim me nenin 123 pika 1 të Ligjit nr.162/2020 “Për



prokurimin Publik” sipas së cilit specifikohet se: ...Plani duhet të nënshkruhet nga autoriteti/enti kontraktor dhe operatori ekonomik, brenda 7 (shtatë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe, në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj. Një kopje e këtij plani i dërgohet APP-së brenda 5 (pesë) ditëve nga nënshkrimi

Personi përgjegjës për prokurimin Z. E.A , ka patur detyrimin që të raportojë pranë APP informacionin lidhur me monitorimin e zbatimit të kontratës, detyrë të cilën nuk e ka kryer, pasi ka munguar informacioni për shkak të mos përcaktimit nga titullari të personit për monitorimin e zbatimit të kontratës. Nga auditimi nuk u konstatua që në rrugë shkresore, personi përgjegjës për prokurimin të ketë vënë në dijeni titullarin e autoritetit kontraktor, për mungesën e këtij informacioni i cili ka sjellë dhe mos përmbushjen e detyrës nga personi përgjegjës për prokurimit, gjë që e ngarkon me përgjegjësi Z. E.A .

Si konkluzion, për sa konstatuar më sipër në zbatim të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, në vëmendje të njësisë së prokurimit (specialistit të fushës).

**Neni 124, pika të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,** ku përcaktohet se: “Për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti ose enti kontraktor, nisur nga natyra e objektit të kontratës dhe kohëzgjatja e zbatimit të saj, harton planin e zbatimit të kontratës, duke përfshirë në veçanti çështjet organizative, afatet, çështjet ekonomike e teknike të kontratës së nënshkruar, në përputhje me çdo akt tjetër ligjor. Plani i zbatimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj. Çdo modifikim i kontratës në përputhje me nenin 127 të këtij ligji, pasqyrohet në planin e zbatimit. Autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me planin, ndjek zbatimin e kontratës, administron dokumentacionin e monitorimit dhe harton raportet e monitorimit”.

**Neni 107 i VKM nr. 285, datë 23.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar:** “Personi apo strukturat e ngarkuara për ecurinë e zbatimit të kontratës, në funksion të legjislacionit të prokurimit publik ka/në këto përgjegjësi:

a) Harton e ndjek ecurinë e planit të zbatimit të kontratës;

b) Kryen monitorimin e zbatimit të detyrimeve të palëve në kontratë, në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë;

c) Administron dhe verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga kontraktori, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

ç) Sigurohet për kontrollin real e ligjor të kostove, cilësisë, dhe afateve, kur është rasti;

d) Menaxhon dhe trajton problematikat që shfaqen gjatë ekzekutimit të kontratës dhe që nuk sjellin domosdoshmërisht ndryshime/modifikime/përshtatje të saj;

dh) Raporton te titullari i autoritetit/entit kontraktor për shkelje të dispozitave kontraktuale;

e) Administron kërkesat për ndryshime/modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës, dhe sigurohet që këto kërkesa të kalojnë për miratim në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë;

ë) Mban korrespondencën e përditësuar me të gjitha dokumentet e shkëmbyera me kontraktorin lidhur me zbatimin e kontratës;

f) Përgatit informacion për çështjet e sipërcituara dhe ia përcjell personit përgjegjës për prokurimin, i cili raporton pranë APP-së”.

***Observacion i paraqitur pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr.844 prot., datë 22.04.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 136/4 prot., datë 25.04.2024***

Pretendimi i sjellë nga ana e subjektit është i njëjtë me observacionin e sjellë me shkresën nr. 450 prot., datë 05.03.2024 protokolluar në KLSH me shkresën nr.136/2 prot., datë 06.03.2024 sjellë në fazën e projekt raportit.

***Komenti i grupit të auditimit:***

Nga ana juaj në observacion specifikohet bashkangjitja e planit të zbatimit të kontratës me nr.2899 prot., datë 18.12.2023, ***por në dokumentacion e sjell më shkresën nr. 450 prot., datë 05.03.2024 nuk rezulton gjurma e një dokumenti të tillë.***

Po ashtu, sa i takon planit të monitorimit të zbatimit të kontratës, mungon gjurma shkresore e tij. *Plani duhet të nënshkruhet nga autoriteti/enti kontraktor dhe operatori ekonomik, brenda 7 (shtatë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe, në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj. Një kopje e këtij plani i dërgohet APP-së brenda 5 (pesë) ditëve nga nënshkrimi.*

*Po ashtu, neni i përmendur prej jush i referohet administrimit të kontratës dhe jo planit të monitorimit të zbatimit të kontratës.*

Në kushtet e mungesës së dokumentacionit të ri justifikues, observacioni mësipërm nuk merret në konsideratë.

***Observacioni i mësipërm nuk pranohet***

Titulli i Gjetjes: Mos hartimi i planit për zbatimin e kontratës

Nga auditimi konstatohet se, nga Bashkia Këlcyre nuk ka hartuar plan të monitorimit të zbatimit të kontratës dhe nuk ka përcaktuar person apo grup pune për monitorimin e zbatimit të kontratës, për të gjitha kontratat e lidhura si rezultat i zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, për mbikëqyrjen e veprimtarinë së kontraktorit, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë dhe legjislacionin në fuqi, për çështjet organizative të kontratës, afatet, çështjet ekonomike teknike etj. Plani duhet të nënshkruhet nga autoriteti/enti kontraktor dhe operatori ekonomik, brenda 7 (shtatë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe, në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj. Një kopje e këtij plani i dërgohet APP-së brenda 5 (pesë) ditëve nga nënshkrimi. Personi përgjegjës për prokurimin për secilën procedurë ( Blerje karburanti për automjetet Znj. F.S , Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara Z. J.N dhe Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçarë Kamber Bënja Z. E.A ) kanë patur detyrimin që të raportojë pranë APP informacionin lidhur me monitorimin e zbatimit të kontratës, detyrë të cilën nuk e kanë kryer, pasi ka munguar informacioni për shkak të mos përcaktimit nga titullari të personit për monitorimin e zbatimit të kontratës. Nga auditimi nuk u konstatua që në rrugë shkresore, personi përgjegjës për prokurimin të ketë vënë në dijeni titullarin e autoritetit kontraktor, për mungesën e këtij informacioni i cili ka sjellë dhe mos përmbushjen e detyrës nga personi përgjegjës për prokurimit. Mos hartimi planit për monitorimin e kontratës dhe mos përcaktimi i personit konkret për këtë qëllim, ka rrisht në mos njohjen si duhet nga AK të situatës së zbatimit të kontratës.

Veprimet e mësipërme në kundërshtim me nenin 107 të VKM nr. 285, datë 23.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” , Neni 124 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

*Për veprime dhe mosveprime lidhur me sa më sipër trajtuar mbajnë përgjegjësi:*

*z. K.N , në rolin e Titullarit të Institucionit në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor; Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Oferatve z. A.Q , z.O.H , znj.E.B ;*

**Pika 4.4. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik fitues.**

**Kontrata**

- 1- Mes AK Bashkia Këlcyrë dhe BOE “A ” ShPK dhe “E ” ShPK është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes me nr. 2892 datë 15.12.2023 me afat realizimi të kontratës 3 muaj kalendarik nga data e nënshkrimit, përfundimi punimeve përlllogaritur më datë 15.03.2024 Aktualisht objekti është në fazën e punimeve në terren.
- 2- Mes AK Bashkia Këlcyrë dhe OE Z ShPK është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes me nr. 2680 prot., datë 14.11.2023 me afat realizimi të kontratës 7 muaj duke filluar ky afat nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve. Përfundimi punimeve përlllogaritur më datë 14.07.2024 Aktualisht objekti është në fazën e punimeve në terren.

- **Parregullsi në inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve të procedurave të prokurimit në arkivë:**

Nga auditimi rezultoi se në Bashkinë Këlcyrë të gjitha dosjet e procedurave të prokurimeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse nuk rezultuan të jenë të numëruara sipas inventarit dhe të arkivuara pranë sektorit të arkiv-protokollit.

Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara mbartin riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit.

Për sa konstatuar më sipër, në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.05.2021 “Për prokurimin publik”, në vëmendje të personit përgjegjës për prokurimin.

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat” Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit; Normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.
---

Titulli i Gjetjes: Parregullsi në lidhje me “Administrimin e Dokumentacionit” të dosjes së procedurave të prokurimit.

Referuar procedurave të prokurimit (“Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”, “Blerje karburanti për automjete”, “Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare Kamber Bënja, Këlcyrë”), rezulton se të gjitha dosjet fizike të prokurimit, të cilat ndër të tjera përmbajnë procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj, nuk janë të pajisura me inventarin e brendshëm të dosjes. Sa më sipër operuar në kundërshtim me Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të painventarizuara mbartin riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit.

Operuar në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit; Normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

### **Pika 5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit**

Sipas Vendimit nr.2 datë 04.01.2023, në strukturën e Bashkisë Këlcyrë funksionon si strukturë Sektori i Urbanistikës dhe Planifikimit Territorit, Emergjencia Civile dhe Kadastër me 3 punonjës.

Për periudhën objekt auditimi, nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Bashkia Këlcyre janë 3 aplikime për *leje ndërtimi dhe leje zhvillimi*, nga të cilat rezultojnë

- 1 leje ndërtimi me objekt rikonstruksion, shtesë anësorë dhe mbi ngritje kati, banesa dy kateshe, plus+ bodrum me sipërfaqe 246 m<sup>2</sup>,
- -1 leje zhvillimore kompleksi blegtoral dhe ambiente shërbimi të kompleksit (stalla + hangarë) me sipërfaqe 1,952.8 m<sup>2</sup>
- -1 leje ndërtimi për Agro Biznes, Dhoma, Akomodim, Shërbim, Restorant “Në procedurë”.

*Baza ligjore:*

Ligji Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar Neni 46 “Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”, VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar Neni 10 pika 1 germa (ç) “Dokumentacioni për pajisjen me leje zhvillimi”, Neni 10/1 pika 6 “Shqyrtimi i kërkesave për leje zhvillimi”, Neni 14 pika 1 “Kushtet për lëshimin e lejes së zhvillimit”, Neni 15 pika 1 germa (b, e.), pika 1/1 germa (i, iii, iv) “Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi”, Neni 34 pika 2 “Distancat minimale midis ndërtimeve”, Neni 37, pika 3 “Lartësia e ndërtimeve”, Ligji nr. 95/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr. 9632, datë 30.06.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, Neni 9 pika 2, VKM 162, datë 27.03.2019 “Për disa ndryshime në vendimin nr.132, datë 07.03.2018 të Këshillit të Ministrave “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueseve të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës” Aneksi 1, Aneksi 2 germa (a, b), Ligji nr. 9244, datë 16.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës”, Neni 14, pika 4 .

*5.1. Auditim mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatim e procedurave ligjore në dhënien e lejeve zhvillimore ,ndërtimore dhe në miratimi i certifikatave të përdorimit. Sipas dokumentacionit rezulton:*

1-Leje ndërtimi me objekt rikonstruksion, shtesë anësore dhe mbi ngritje kati, banese 2 kat, plus bodrum me sipërfaqe 246 m<sup>2</sup>, dhënë leja e ndërtimit në datën 13.09.2023 sipas privativit të paraqitur, në vlerën 9,520,347 lekë dhe likuiduar taksën e infrastrukturës në vlerën 285,610 lekë.

-Pra rezulton se objekti është i pa përfunduar, i pa kolauduar dhe mungon *situacion përfundimtar leja ndërtimore e dhënë në fund të vitit 2023, ngelet për tu audituar në auditimin e tjetër pasi objekti nuk është i përfunduar dhe afatin përfundimtar e ka 18 muaj.*

*Në dosje nuk ka dokumentacion tjetër plotësues verifikimi dhe bashkëpunimi me istucionet e tjera ,sipas VKM nr. 22, datë 12.01.2018 (pika ç),ku shprehimet thuhet :*

“ Bashkia kryen verifikimin në terren, në bazë të dispozitave ligjore në fuqi për planifikimin e territorit, përfshirë edhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim dhe njofton AZHT-në;”

2-Leje ndërtimi zhvillimore kompleksi blegtoral dhe ambiente shërbimi të kompleksit (stalla + hangarë) me sipërfaqe 1,952.8 m<sup>2</sup>.

Sipas dokumentacionit të paraqitur rezulton se është pajisur me lejë ndërtimi me nr.1451 datë 26.06.2023 për sipërfaqen totale 1952 .8m<sup>2</sup> në pronën e vet në zonën kadastrale 3713 me nr. pasurie 34/3, toke arrë me sipërfaqe 19 200 m<sup>2</sup>, në fshatin Varibop për “Kompleks blegtoral dhe ambiente të kompleksit (stalle hangar) sipas privativit të paraqitur mbi përshkrimin e punimeve rezulton se vlera totale e investimit është 18,031,136 lekë dhe e llogaritur me 3% taksë e infrastrukturës ka likuiduar 540,934 lekë.

Sipas *paktës fiskale* të Bashkisë Këlcyrë me vendimin nr. 38.datë 30.11.2022 rezulton se taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e rreja është vendosur 3% e vlerës së investimit dhe privativit të përgatitur nga vetë investitori në përshtatshmëri me VKM nr.168,datë 27.03.2019.

-Pra rezulton se objekti është i pa përfunduar, i pa kolauduar dhe mungon *situacion përfundimtar leja ndërtimore e dhënë në gjashtëmujorin e dytë të 2023.*

*-Për sa i përket ndërtimit të stallës nisur nga privativi i paraqitur rezulton se ka gërmime dheu mure, çati llamarine, e konstruksione hekuri dhe në baze të preventivit të paraqitur vlera e preventivit është shume e ulet, sipas VKM 168 datë 27.03.2019 mbi çmimet referues të ndërtesave ( Aneksi 1) si dhe udhëzimi nr. 3 datë 28.02.2016 “Mbi mesataren e ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar për vitin 2026”.*

*Pra ngelet në ndjekjen e volumit të punimeve të situacionit përfundimtar dhe kolaudimit të objektit për llogaritjen dhe analizën financiare, për të vlerësuar realisht volumin e punimeve.*

Pra ngelet për tu audituar në auditimin e tjetër pasi objekti “*nuk është i përfunduar*” sipas afatit dhe grafikut të ndërtimeve mbaron me 26.04.2024.

3- Subjekti A.B., ka aplikuar në datën 07.08.2023 me nr.1788, në fushën e Argotizmit “ E.H ” me aktivitet Akomodim, Shërbim Restorant dhe kërkesën të dorëzuar elektronikisht me datën 11.09.2023.

Nga dokumentet e paraqitura nuk janë të bashkangjitur sipas radhës kronologjike dhe nuk përshkruhen hapat e ndjekjes se procedurave ligjore nga Sektori i Planifikimin dhe Zhvillimit të Territorit nuk ka regjistër për secilin subjekt i cili aplikon për lejë zhvillimi në Bashkinë Këlcyrë.

Në dokumentet e paraqitur rezulton se është shkresa në datën 07.04.2023 është kthyer përgjigje “Mbi plotësimin e dokumentacionit të kërkesës me Lejë Zhvillimorë me nr. AN040420230027, datë 04.04.2023, nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Sektori i Planifikimin dhe Zhvillimit të Territorit ka kthyer përgjigje në datën 21.09.2023, rezulton se përgjigjet janë të njëjtit format ku shprehimisht thuhet “ Dokumentacioni i dorëzuar elektronikisht është i plotë dhe për pasojë propozohet të vijohet me shqyrtimin në themel të kërkesës për lejë “, *pra nuk argumentojnë dokumentet që duhen të plotësojë i interesuari.*

Megjithëse në dosje janë dokumenti nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit e cila rekomandon “ Duhet ti nënshtrohet Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis” datë 08.11.2023 me nr. 4458/1 prot, pra konstatojmë zvarritje te procesit dhe mos bashkëpunim me Ministrinë e linjës për certifikimin e subjektit në fushën e Agro Biznesit sipas VKM nr. 22, datë 12.01.2018 (pika 22),ku shprehimisht thuhet :

“Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Agjencia e Zhvillimit të Territorit si dhe organet e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi”.

- Nga Agjencia Shtetërorë e Kadastrës (AVSHK)Gjirokastrë ku shprehimisht thuhet “Leja e Zhvillimit të E.H ju bëjmë me die se për miratimin e statusit të pasurisë duhet ti drejtoheni Zyrës Vendore Përmet” datë 21.08.2023 me nr. 4458 prot, pra në dosje nuk ka dokumentacion e vazhdimësi të procedurave për të marrë informacion nga Zyrës Vendore Përmet.

*Pra rezulton se nuk është mbajtur regjistër i saktë me të gjitha modalitetet e duhura nga momenti i aplikimit, rrugët shkresore të ndjekura dhe bashkëpunimi me subjektin e interesuar, pra rezulton se ka zvarritje të procesit kur ka gati një vit nga aplikimi dhe nuk është plotësuar dosja sipas ligjit Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar Neni 10 pika 1 germa (ç) “Dokumentacioni për pajisjen me leje zhvillimi”, Neni 10/1 pika 6 “Shqyrtimi i kërkesave për leje zhvillimi”, Neni 14 pika 1 “Kushtet për lëshimin e lejes së zhvillimit”, Neni 15 pika 1 germa (b, e.), pika 1/1 germa (i, iii, iv) “Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi” dhe Rregullores së Brendshme me nr.13 datë 25.02.2022 “Detyrat e Specialistit”.*

*5.2 Auditimi mbi mandat pagesat dhe ballafaqimi me fletën e përlogaritjes së bërë nga Drejtoria e PZHT, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe llogaritjen e pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuara nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Taksave ,etj:*

Sipas organigramës së Bashkisë Këlcyrë me nr.25 Prot. datë 04.01.2023 dhe Urdhrit me nr.2 datë 04.01.2023 është miratuar struktura organizative e punonjësve sipas nivelit të pagave për vitin 2023.

Në strukturë nuk është miratuar Sektor i Urbanistikës Planifikimit Territorit ,Emergjencia Civile dhe Kadaster.

Për lejet e dhëna në vitin 2023 në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe llogaritjen e pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuara nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Taksave, 2 lejet e ndërtimit, lejë ndërtimi me objekt rikonstruksion, shtesë anësore dhe mbi ngritje kati, banesa dy kashte, plus+ bodrum me sipërfaqe 246 m<sup>2</sup>, dhe leje zhvillimore kompleksi blegtoral dhe ambiente shërbimi të kompleksit (stalla + hangarë) me sipërfaqe 1,952.8 m<sup>2</sup> të cilat janë ne proces ndërtimi dhe nuk kanë paraqitur situacionin përkatës mbi volumin e ndërtimeve ne vitin 2023-2024,pasi janë brenda afateve kohore(ngelet për tu audituar në auditimin e ardhshëm pasi periudha e afatit të ndërtimit mbyllet në vitin 2024).

Për sa më sipër në dy lejet e ndërtimit të dhëna në fund të vitit 2022, si dhe janë me afat 18 mujor, duke qenë në proces dhe nuk shprehemi dot (nuk është kryer kolaudimi dhe nuk ka situacion përmbyllës).

*Për sa me sipër mbajnë përgjegjësi punonjësit, J.N me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës B.A me detyrë Specialist i Urbanistikës dhe O.H ,me detyrë Specialist i Urbanistikës .*

## **Pika 6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore (IMT)**

Sipas organigramës së Bashkisë Këlcyrë me nr.25 Prot datë 04.01.2023 dhe Urdhrit me nr.2 datë 04.01.2023 është miratuar struktura organizative e punonjësve sipas nivelit të pagave për vitin 2023.

Në strukturë nuk është miratuar Sektor i IMT – Këlcyrë dhe gjatë vitit 2023 megjithëse është lënë detyrë në auditimin e mëparshëm me nr 426/1 datë 19.05.2023 “si masë organizative”, përsëri nuk ka funksionuar në vitin 2023.

*- Nuk është krijuar i Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, duke mos garantuar ruajtjen dhe mirë menaxhim të territorit ndërtimet pa leje, si dhe problematika të lindura me aseteve, përfshirë pronat në pronësi dhe përdorim, si dhe kontrollin e territorit dhe zbatimin e ligjshmërisë dhe standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.*

6.1.Auditimi mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.

6.2 Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV: Për subjektet të cilët kanë kryer kundra vajtje administrative dhe procedurat e ndjekura për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.

6.3 Auditim mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëpunimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Nga auditimi rezultoi se Bashkia Këlcyrë nuk ka krijuar në strukturën e saj Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor, duke mos garantuar ruajtjen kontrollin e territorit dhe zbatimin e ligjshmërisë dhe standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Për këtë ka përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Z. K.N .

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin 107/2014 “Për planifikimin e territorit” si dhe ligjin 9780 “Për inspektimin e ndërtimit” Neni 4 “Përgjegjësitë e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës Pranë çdo bashkie/komune ngrihet inspektorati ndërtimor e urbanistik, i cili, nëpërmjet kryeinspektorit e inspektorëve, ushtron përgjegjësinë e kontrollit dhe zbatimit të ligjshmërisë e të standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës dhe ato të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera, brenda territorit administrativ të bashkisë/komunës. Struktura e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës miratohet nga këshilli vendor përkatës, me propozimin e kryetarit të bashkisë/komunës. Inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet nga kryetari i bashkisë/komunës. Për përmbushjen e përgjegjësive të parashikuara me ligj, inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës mbështetet nga policia bashkiake/komunale dhe pajiset me mjetet dhe makineritë e nevojshme nga bashkia/komuna”.

Neni 5 “Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës Gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji, inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës merr masat e mëposhtme: a) vendos përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës; b) vendos gjoba sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës; c) paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën

*për heqje të licencës profesionale personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit pa leje, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të punimeve të ndërtimit; ç) vendos pezullimin e punimeve në ndërtim në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës; d) vendos prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm; dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi; e) jep informacionin e kërkuar Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, si dhe krijon të gjitha lehtësitë për përmbushjen e detyrave të këtij Inspektorati” në kundërshtim me Rregullores së Brendshme me nr.13 datë 25.02.2022 e cilësuar “Detyrat e Specialistit”*

Titulli i Gjetjes: IMT bashkia Këlcyrë nuk është strukturë pasi ka vetëm një person të punësuar në këtë sektor për vitin 2023.

Nga auditimi rezultoi se Bashkia Këlcyrë nuk ka krijuar në strukturën e saj Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor, duke mos garantuar ruajtjen kontrollin e territorit dhe zbatimin e ligjshmërisë dhe standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Për këtë anomali ka përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Z. K.N .

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin 107/2014 “Për planifikimin e territorit” si dhe ligjin 9780 “Për inspektimin e ndërtimit” Neni 4 “Përgjegjësitë e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës Pranë çdo bashkie/komune ngrihet inspektorati ndërtimor e urbanistik, i cili, nëpërmjet kryeinspektorit e inspektorëve, ushtron përgjegjësinë e kontrollit dhe zbatimit të ligjshmërisë e të standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës dhe ato të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera, brenda territorit administrativ të bashkisë/komunës. Struktura e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës miratohet nga këshilli vendor përkatës, me propozimin e kryetarit të bashkisë/komunës. Inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet nga kryetari i bashkisë/komunës. Për përmbushjen e përgjegjësiave të parashikuara me ligj, inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës mbështetet nga policia bashkiake/komunale dhe pajiset me mjetet dhe makineritë e nevojshme nga bashkia/komuna”. Neni 5 “Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës Gjatë ushtrimit të përgjegjësiave të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji, inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës merr masat e mëposhtme: a) vendos përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës; b) vendos gjoba sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës; c) paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit pa leje, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të punimeve të ndërtimit; ç) vendos pezullimin e punimeve në ndërtim në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës; d) vendos prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm; dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi; e) jep informacionin e kërkuar Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, si dhe krijon të gjitha lehtësitë për përmbushjen e detyrave të këtij Inspektorati”.

#### **Pika 7. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.**



Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, të dërguara nga KLSH me nr. 426/9 prot., datë 28.09.2023 rezultoj se, Bashkia Këlcyrë është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, në kundërshtim nenin 15, shkronja “j”, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

**1. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.**

- Nga auditimi rezultoj se, Bashkia Këlcyrë është mjaftuar më hartimin e planit të veprimit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit të mëparshëm dhe nuk ka vijuar hapat e mëparshëm të formalizimit të procesit. Duke mos dërguar shkresë me kthim përgjigje, brenda 20 ditëve, në kundërshtim nenin 15, shkronja “j”, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” sipas të cilit KLSH duhet të vihet në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, dërgon planin e veprimeve, duke përcaktuar pranimin e rekomandimeve të KLSH-së, ose refuzimin e zbatimit të rekomandimit në rastin e masës për shpërblim dëmi.

*Për veprime dhe mosveprime sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë z. K.N.*

**2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”**

- Bashkia Këlcyrë në lidhje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, sipas strukturave përgjegjëse, deri në përfundim të auditimit (28.02.2024) nuk ka përgatitur planin e masave të marra lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me pikën 2, të nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi rezultoj se, nga bashkia Këlcyrë nuk është raportuar pranë KLSH ecurinë e zbatimit të rekomandimeve pas përmbushjes së afatit 6 mujor në kundërshtim me pikën 2, të nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua, mungesë e gjurmës së raportimit në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 - Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

**Mos raportim në KB mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së.**

**Nuk është raportuar** rregullisht në Këshillin e Njësisë (Këshillin Bashkiak), në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe

*raporton rregullisht në këshillin e njësisë.* Veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë z. K.N .

Titulli i Gjetjes: Mos raportim në KB mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së. Nga verifikimi rezulton se Bashkia Këlcyrë nuk ka raportuar rregullisht në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë. Veprime dhe mosveprime ngarkojnë me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë z. K.N .

Operuar në kundërshtim me Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5.

**Shënim:** Nga auditimi i statusit të zbatimit të rekomandimeve, rezultoj se, në fazën e ushtrimit të misionit auditues në terren që u konkludua me lënien e Akt konstatimeve, për 4 (katër) prej rekomandimeve grupi i auditimit nuk arrinte të shprehej me siguri të arsyeshme mbi zbatueshmërinë e tyre, kjo për shkak se ishin të lidhur me pasqyrat financiare të institucionit. Pasqyrat financiare janë dërguar në degën e thesarit me nr.349 prot., datë 21.02.2024, katër ditë përpara mbylljes së misionit auditues çka e pengonte grupin e auditimit për marrjen e sigurisë mbi to gjatë kësaj periudhe. Në fazën e përgatitjes së Projekt Raportit dhe Raportit Përfundimtar të auditimit, kohë përgjatë së cilës u pritën edhe observacionet, u rivlerësua edhe njëherë statusi i zbatueshmërisë së tyre.

#### **A. Masa organizative**

*Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Këlcyrë 16 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht 16, nga masat e pranuar është zbatuar plotësisht 1 masë, janë në proces zbatimi 2 masa, nuk janë zbatuar 13 masa organizative.*

lekë

Rekomandime	Gjithsej		Pranuar		Zbatuar plotësisht		Pjesërisht		Në proces		Pa zbatuar	
	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
Përmirësim Ligjor	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Organizative	16	-	16	-	1	-	-	-	2	-	13	-
Shpërblim dëmi	1	339,337	1	339,337	-	-	-	-	-	-	1	339,337
Për eliminimin e efekteve negative në fondeve publike	5	-	5	-	-	-	2	-	1	-	2	-
Administrative	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Disiplinore	1	-	1	-	-	-	-	-	-	-	1	-
Gjithsej	23	339,337	23	339,337	1	-	2	-	3	-	17	339,337

Sa sipër rezulton se janë dhënë gjithsej 23 rekomandime të cilët janë pranuar plotësisht (100 %), dhe rezultojnë të zbatuar plotësisht 1 masë (4%), zbatuar pjesërisht 2 masa (9%), në proces zbatimi 3 masa (13%) dhe pazbatuar 17 masa (74%).

*Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si vijon:*

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Bashkia Këlcyrë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim. Nuk janë evidentuar nevojat për trajnim dhe nuk janë hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit. Hartimi dhe zbatimi i strukturës organizative nuk garanton realizimin e plotë të objektivave të njësisë vendore për disa fusha të veprimtarisë së saj, si vijon:

- Nuk është krijuar Sektori i Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Teritorit Vendor, duke mos garantuar ruajtjen dhe një mirë menaxhim të asetëve, përfshirë pronat në pronësi dhe përdorim, si dhe kontrollin e territorit dhe zbatimin e ligjshmërisë dhe standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

- Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Juridike, Njësia e Auditit të Brendshëm dhe Sektori i Planifikimi dhe Zhvillimit të Territorit nuk janë plotësuar me të gjithë punonjësit sipas numrit të strukturës së miratuar.

Nuk është hartuar, miratuar dhe arkivuar harta (lista) e proceseve të punës, si dhe gjurma e auditimit për këto procese.

Nuk është hartuar rregjistër i rrishtit, duke mos marrë masa për evidentimin e rrishtit që rrezikojnë objektivat e institucionit dhe minimizimin e efekteve negative të tyre.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim nenin 16, 20, 21 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualin e MFK, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, nenin 64, pika h dhe j të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, VKB Nr. 03, datë 18.01.2022.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 16-19 dhe pikën 3, faqe 41-60, të raportit përfundimtar të auditimit).*

**1.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë të marrë masa për hartimin e programit vjetor për trajnimin e stafit, mbi bazën e evidentimit më parë të nevojave reale për trajnim.

*Deri më 31.12.2023*

**1.2. a)** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë të parashikojë në strukturën organizative të institucionit: - Krijimin e sektorit të Administrimit të Aseteve me qëllim garantimin e ruajtjes dhe mirë menaxhimi të asetëve, përfshirë pronat në pronësi dhe përdorim;

- Krijimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Teritorit Vendor, me qëllim garantimin e zbatimit të ligjshmërisë dhe standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

**b)** Të plotësohet sipas numrit të strukturës së miratuar në VKB Nr. 03, datë 18.01.2022, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Juridike dhe Njësia e Auditit të Brendshëm.

*Deri më 31.12.2023*

**1.3.** Nga secili sektor të hartohet rregjistri i rrishtit, për evidentimin e rrishtit që rrezikojnë objektivat e institucionit dhe minimizimin e efekteve negative të tyre, të hartohet harta e proceseve të punës dhe gjurma e auditimit për këto procese.

*Deri më 31.12.2023*

### **Përgjigjja e institucionit:**

#### **Komenti i grupit të auditimit:**

Në kushtet e mungesës së dokumentacionit justifikues provues të stadi në të cilin ndodhet zbatimi i rekomandimeve, si dhe mungesës së përgjigjes së dhënë nga ana e Bashkisë Këlcyrë rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se nuk është bërë miratimi i tavaneve buxhetore afatmesëm 2022-2024 me Vendim të Këshillit Bashkiak, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 37.

Nuk është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2022- 2024.

Nuk janë përgatitur nga strukturat përkatëse të institucionit dhe nuk ka vendim të Këshillit Bashkiak për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2022-2024, si dhe për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Këlcyrë për këtë periudhë, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 33, 34.

Mungon plani i masave dhe veprimet, për fazën përfundimtare të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe projektbuxhetit vjetor për të gjithë periudhën e auditimit. Në këto plane duhet të përcaktoheshin aktivitetet që do të zhvillohen, afati, personat përgjegjës.

Ka mungesë të dokumenteve (dëgjesa publike, takime për llogaridhënie për zbatimin e buxhetit etj), të cilat të dokumentojnë se janë konsultuar me komunitetin dhe grupet e interesit.

Nuk dokumentohet mbledhja e njësisë vendore dhe institucioneve të varësisë në lidhje me kërkesat e tyre buxhetore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 19-28 të raportit përfundimtar të auditimit).*

**2.1.Rekomandim:** Bashkia Këlcyrë për hartimin e PBA dhe buxhetit vjetor, më parë të kryej konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit, njësitë administrative etj. dhe të bëjë dokumentimin e këtyre konsultimeve. Të ngrihet grupi i punës për hartimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe kalendarit të miratohet në Këshillin Bashkiak.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

### **Përgjigjia e institucionit:**

Miratimi i tavaneve buxhetore (PBA 2022-2024) është kaluar në Këshillin Bashkiak dhe është miratuar me Vendimin nr. 48 datë 22.12.2021 dhe i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën me nr. 1179/1 prot datë 07.01.2022.

Me shkresën tonë me nr. 1356 prot datë 22.06.2021 është dërguar dokumenti i PBA-së 2022-2024 pranë Ministrisë së Financave.

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Argumentimi dhënë nga ana e subjektit fokusohet vetëm tek procedura e hartimit të PBA – së, por nuk ka gjurmë justifikuese të ndërveprimit me grupet e interesit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

**3. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Këlcyrë nuk ka marrë masa të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, pasi brenda vitit buxhetor konstatohet fenomeni i pagesës së një pjesë të këtij detyrimi, por njëkohësisht edhe krijimi i detyrimeve të reja të prapambetura. Konkretisht në datën 01.01.2022 vlera e detyrimeve të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta, është 42,260,660 lekë, ku peshën kryesore e zënë detyrimet për investime në vlerën 39,297,136 lekë. Gjatë vitit buxhetor 2022 nga detyrimi i mësipërm është likuiduar vlera 13,807,190 lekë, por njëkohësisht gjatë këtij viti janë krijuar edhe detyrime të reja të prapambetura për shpenzime operative në vlerën 1,156,274 lekë. Kjo ka bërë që vlera reale e uljes së detyrimeve të prapambetura gjatë vitit 2022 të jetë jo 13,807,190 lekë, por 12,650,916 lekë. Detyrimet e prapambetura janë krijuar nga mos realizimi i të ardhurave dhe

nga marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, veprime të cilat janë në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 19-28 të raportit përfundimtar të auditimit).*

**3.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë dhe Zyra e Financës të marrin masa që në hartimin e PBA dhe buxhetit vjetor, prioritet të kenë detyrimet e prapambetura nga vitet e mëparshme, duke mbuluar më parë me fonde këto detyrime. Të eliminohet fenomeni i krijimit të detyrimeve të reja të prapambetura gjatë vitit buxhetor.

Lidhja e kontratës me operatorët ekonomik të bëhet vetëm pasi fondi i parashikuar në kontratë të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

### **Përgjigjia e institucionit:**

Gjate vitit 2023 është bërë e mundur zbutja e detyrimeve të prapambetura duke likuiduar:

- shumën prej 8,524,875 lekë që përbejnë pagat dhe sigurimet e muajit dhjetor 2022,
- shumën prej 1,156,274 lekë që përbejnë shpenzimet operative për faturat e ujit, energji, telefon, shërbime postare etj shpenzime të muajit dhjetor 2022.
- shumën prej 13,857,913 lekë që përbën shumën për investime gjatë viteve.

Pra nga ana jonë janë marrë masa për zbutjen e detyrimeve të prapambetura dhe mos krijimin e detyrimeve të reja, përveç atyre të investimeve që janë në vazhdim të miratuara më parë me vendim të Këshillit Bashkiak.

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion u konstatua se pjesa e parë e rekomandimit rezulton e zbatuar. Sa i takon rekomandimit “Lidhja e kontratës me operatorët ekonomik të bëhet vetëm pasi fondi i parashikuar në kontratë të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor”, mbetet për tu verifikuar në momentin e lidhjes së kontratave të reja. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti **i zbatuar**.

**4.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Këlcyre, në lidhje me kontratat e qirave për pyje dhe kullota, rezulton se për vitin 2022 janë lidhur 30 kontrata, për të cilat nuk ka detyrime të pa likuiduara, por u konstatuan anomalitë si vijon:

Në kontratat në çdo rast nuk është bërë përcaktimin se kujt akti i janë referuar për ndarjen e kullotave (*sipas vendimit të komisionit të ndarjes së kullotave apo vendimit të këshillit të komunës*).

Në kontratë është përcaktuar se ato i referohen hartës bashkëlidhur çdo kontrate, por në fakt nuk administrohet një dokument i tillë, por vetëm një skicë e thjeshtë e cila nuk është miratuar nga titullari i institucionit apo strukturat e tjera të ngarkuara prej tij.

-Për të gjitha kontratat, konstatohet se nuk ka ekstrakt nga QKR për objektin e veprimtarisë të secilit fermer që ka përfutur kontratë, si dhe nuk ka certifikatë nga Drejtoria e Shërbimeve Veterinare për numrin e regjistrimit të bagëtive dhe matrikullin e tyre, duke mos u dokumentuar

numri real i secilit blegtor.

Lidhja e tyre përgjithësisht është bërë në mungesë të konfirmimit (vërtetimit) të numrit të bagëtive, dokument i cili lëshohet nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve Veterinare, dhe konfirmon regjistrin e bagëtive dhe matrikullit të tyre sipas sistemit “Ruda”, duke mos bërë krahasimin e llojit dhe numrit të krerëve sipas kontratës me regjistrin e DRSHV, për secilin vit, si dhe eliminimit të rasteve të lidhjes së kontratave me persona të cilët nuk figurojnë të regjistruar në listën e blegtorëve.

Nuk është kryer inventarizimi kadastral pyjor për përditësimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullimore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës).

Nuk është mbajtur bilanci i fondit të tokës shprehur në sipërfaqe në tërësi, ndarë në fondin e tokës bujqësore, fondin e tokës së zënë me pyje, fondin e tokës së zënë me kullota e livadhe dhe fondin e tokës truall.

Lidhur me pyjet e kullotat, ndonëse kanë kaluar në pronësi, nuk janë pasqyruar në kontabilitet, llogaria nr. 211 “pyjet, kullotat dhe plantacione”, pasi aktivi i bilancit nuk paraqet fare gjendjen e kësaj llogarie.

Nuk është kryer procedura e aplikimit të regjistrimit të parcelave në ish-ZVRPP Gjirokastër, sot ASHK Drejtoria Gjirokastër.

Nuk ka plan mbarështimi për secilën ngastër apo nën ngastër, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimë të ndryshme.

Nuk janë mbajtur akte të kontrollit të përdorimit të sipërfaqes.

Nuk janë përcaktuar kritere lidhur me afatin i cili duhet të jetë një vjeçar dhe pagesa të bëhet e menjëhershme në momentin e kontratës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 28-41 të raportit përfundimtar të auditimit).*

**4.1.Rekomandim:** Për të gjitha kontrata e dhënies me qira të fondit pyjor e kullosor, duhet të krijohet dosje individuale, ku të pasqyrohen qartazi të gjitha të dhënat mbi fermerin, llojin e bagëtive që mbarështon, numrin e tyre, si dhe vërtetimin nxjerrë nga sistemi RUDA me të dhënave e marra nga AZHBR, si dhe parcela kullimore e dhënë në përdorim, sipas skicës së miratuar dhe të bashkëlidhur çdo kontrate.

**4.2.Rekomandim:** Të merren masa që kontratat për sipërfaqet kullimore të jepen në raport me numrin e krerëve që disponon çdo subjekt, sipas vërtetimit të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve Veterinare (dokument i cili duhet të shoqërojë kontratën) dhe të dhënave të AZHBR (Sistemi Rud), mbi numrin e krerëve të deklaruar dhe regjistruar në këtë sistem.

*Menjëherë e në vijimësi*

### **Përgjigjia e institucionit:**

Pasi u njohëm me gjetjet nga auditimi, detyrat dhe rekomandimet e lëna nga auditi, nga zyra e pyjeve dhe kullotave konkretisht janë marrë këto masa:

- Për lidhjen e kontratave për kullotje e kositje bari i jemi referuar dispozitave të ligjit nr. 7850 datë 29.07.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe mbështetur në nenin 15 të ligjit Nr. 9693, datë 19/03/2007, “Për fondin Kullosor”, i ndryshuar, ne VKM 632 datë 11.06.2009 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje”, si dhe Udhëzimin e Ministrit nr.2 datë 20.07.02016 Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”

- I jemi referuar Vendimit të Këshillit Bashkisë (çdo vit) sipas listës përfundimtare e inventarit të pyjeve dhe kullotave në territorin administrativ të Bashkisë Këlcyrë, sipas VKM nr.398 datë 13.05.2020.
- Pas paraqitjes së kërkesave nga fermerët u kemi kërkuar që bashkë me kërkesën të sjellin sipas auditit këto dokumenta:
  - QKR-në për objektin e veprimtarisë të secilit fermer
  - Vertetimin veterinar bashkë me numurin e bagëtive të lëshuar nga veterineri i DRSHV-së për çdo vit.
  - Kontrata shoqërohet me hartën përkatëse e firmosur nga titullari, procesverbalin e dorëzimit, e firmosur nga fermeri dhe përfaqësuesi i zyrës pyje kullota.

#### ***Jemi në punë e sipër:***

- Në bashkëpunim me zyrën e financës dhe zyrën e tatim-taksave për të bërë pasqyrën përmbledhëse në kontabilitet sipas llogarisë nr. 211 “pyjet kullotat dhe platancionet”.
- Me sigurimin e fondeve dhe miratimin e tyre në buxhet, me gjithë kërkesën që i është drejtuar këshillit bashkiak, lidhur me planet e mbarështimit për çdo parcele.
- Procedura për aplikim dhe regjistrim të parcelave në ish-ZVRPP Gjirokastër, sot ASHK Drejtoria Gjirokastër.

#### **Komenti i grupit të auditimit:**

Referuar përgjigjes së dhënë nga ana e Bashkisë Këlcyrë dhe njëkohësisht mungesës së dokumentacionit justifikues provues të stadi në të cilin ndodhet zbatueshmëria e rekomandimit, por mbajtur në konsideratë sa shprehur në çështjen trajtuar “*planifikimi, zbatimi dhe monitorimi i planit të buxhetit*” grupi auditimit e konsideron në proces zbatimi. Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***në proces zbatimi***.

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin”, (debitor datë 31.12.2022) në aktiv të pasqyrave financiare nuk është e saktë, sepse kjo llogari ka vlerën 8,524,875 lekë, por në fakt duhet të ketë vlerën 36,978,285 lekë. Pra llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin”, është e nënvlerësuar me vlerën 28,453,410 lekë. Llogaria 4342 është kundërparti e shumës së llogarive të mëposhtme dhe nuk rakordon me to për vlerën 28,453,410 lekë:

-Llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vlerën 28,453,410 lekë, llog.42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 6,153,280 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 201,001 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 2,170,594 lekë, llog.436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 0 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 32 e tij. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3. faqe 36-54 të raportit përfundimtar të auditimit*).

**5.1.Rekomandim:** Nëpunësi Zbatues të marrë masa për sistemimin në kontabilitet të llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin”, në mënyrë që kjo llogari të paraqesë vlerën e saktë në pasqyrat financiare.

***Në mbyllje të pasqyrave financiare 2023***

#### **Përgjigja e institucionit:**

Këto parregullsi dhe anomali do të sistemohen nga ana jonë në mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2023

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Referuar pasqyrave financiare të vitit 2023, depozituar në degën e thesarit Përmet me shkresën nr. datë .02.2024 rezultoi se, nga ana e Bashkisë Këlcyrë nuk janë ndërmarr masa për kryerjen e veprimeve rregulluese lidhur me llogarinë 4342 “të tjera operacione me shtetin”, për rrjedhojë fenomeni i nënvlerësimit të kësaj llogarie vijon, e për më tepër vlera është rritur krahasuar me vitin e kaluar.

Kështu, për vitin 2024, llogaria 4342 rezulton të jetë në vlerën 14,306,792 lekë nga 51,022,975 lekë që realisht duhet të jetë. Kështu kjo llogari rezulton e nënvlerësuar me 36,716,183 lekë. Llogaria 4342 është kundërparti e shumës së llogarive (401-408; 42; 431; 435-436) sikundër në vijim trajtuar, e nga auditimi rezulton mos rakordim me to për vlerën e nënvlerësimit (36,716,183 lekë).

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

**6.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se llogarisë 202 “*Studime dhe Kërkime*” paraqitet në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 në vlerën neto 100,204 lekë. Paraqitja e kësaj vlere në pasqyrat financiare, nuk mbështetet me dokumentacion, pasi struktura e financës nuk administron analizën analitike të kësaj llogarie. Për këtë arsye pasqyrat financiare nuk japin siguri se jo llogari është e saktë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), me VKM nr 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e qëndrueshme të pa trupëzuara” Pika 1/b “Klasifikimi kontabël”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3. faqe 41-60 të raportit përfundimtar të auditimit*).

**6.1.Rekomandim:** Nëpunësi Zbatues të hartojë listën analitike të llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” në mënyrë që vlera e paraqitur në pasqyrat financiare të jetë e mbështetur ne dokumentacionin vërtetues. Për rastet kur investimi ka përfunduar, të kalohet vlera e projektit në vlerën e investimit, duke u paksuar me vlerën e projektit llogaria 202 “Studime dhe Kërkime”.

*Në mbyllje të pasqyrave financiare 2023*

### **Përgjigjja e institucionit:**

Shuma e llog 202 “*Studime dhe Kërkime*” prej **100,204** lekë është e përbërë në mënyrë analitike si me poshtë:

- Studim plani rregullues i qytetit Këlcyrë në shumën prej 54,066 lekë e vitit 2010.
- Rikonstruksion ujësjellësi Varibop dhe Kuqar në shumën prej 20,972 lekë e vitit 2012.
- Rikonstruksion kanali vaditës fshati Beduqas në shumën prej 25,166 lekë e vitit 2013.

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Referuar pasqyrave financiare të vitit 2023, depozituar në degën e thesarit Përmet me shkresën nr. datë .02.2024 rezultoi se,



Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” nga viti 2022 në vitin 2023 është pakësuar për vlerën 22,746 lekë, që pasqyron amortizimin e llogarisë.

Në përbërje të kësaj llogarie rezultojnë tre studime, konkretisht:

- Plani rregullues i qytetit prej vitit 2010
- Rikonstruksioni i ujësjellësit Varibop dhe Kuqar prej vitit 2012
- Rikonstruksioni i kanalit vaditës të fshati Beduqas prej vitit 2013

Nga auditimi i përbërjes së kësaj llogarie, për shkak të periudhës së largët kohore, rezulton mungesë e pjesshme e dokumentacionit justifikues të studim/projektiveve. Ndërkohë, të tre këto studime janë trupëzuar. Sa më sipër, rezulton se, prej financës së bashkisë Këlcyrë, ende nuk janë kryer veprimet rregulluese tranzitore të vlerave nga llogaria 202 ‘studime dhe projekte’ në llogarinë e investimeve apo llogaritë konkrete të aktivitetit.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

**7.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se për vitin 2022 Kryetari i Bashkisë Këlcyrë dhe Nëpunësi Zbatues nuk kanë marrë masa për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve për llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe llogarinë 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” të cilat në bilanc paraqiten në vlerën 0 lekë.

Mos kryerja e procesit të inventarizimit është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE Nr.8/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NJQP”, pika 16,18. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3. faqe 41-60 të raportit përfundimtar të auditimit*).

**7.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve afatgjata materiale, të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërin 211 “Pyje, kullota, plantacione” dhe zërin 210 “Toka, troje, terrene”.

***Në mbyllje të pasqyrave financiare 2023***

### **Përgjigjia e institucionit:**

*Mungon*

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Referuar pasqyrave financiare të vitit 2023, depozituar në degën e thesarit Përmet me shkresën nr.349 prot., datë 21.02.2024 rezultoi se, nga ana e bashkisë Këlcyrë të dyja këto llogari (llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe llogaria 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”) vijnë në paraqitje pa zëra në bilancin kontabël të pasqyrave financiare. Duke denaturuar në këto kushte pamjen e plotë të këtyre pasqyrave dhe cënuar dhënien e opinionit mbi to.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

**8.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Bashkia Këlcyrë nuk ka hartuar regjistër kontabël për aktivet afatgjata dhe afatshkurtra që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat e njësisë vendore. Për këtë arsye nuk ka të dhëna të sakta për aktivet lidhur me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF Nr. 30 Datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 26-33. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3. faqe 41-60 të raportit përfundimtar të auditimit*).

**8.1.Rekomandim:** Nëpunësi zbatues të marrë masa për hartimin e regjistrit kontabël për të gjitha aktivet e njësisë vendore, atyre afatshkurtra dhe afatgjata, përfshirë edhe pronat e njësisë vendore në pronësi apo në përdorim.

*Deri më 31.12.2023*

**Përgjigjja e institucionit:**

*Mungon*

**Komenti i grupit të auditimit:**

Në kushtet e mungesës së përgjigjes së dhënë nga ana e institucionit dhe dokumentacionit justifikues mbështetës, rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

**9.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kriterëve të veçanta të DT, seksioni i kapacitetit teknik, u konstatua se në tre procedura prokurimi janë vendosur kriterë të cilat nuk kanë lidhje të ngushtë me objektin e kontratës, me aftësinë zbatuese të saj, pasi zërat e preventivit nuk justifikojnë kriteret e vendosura. Të tilla janë si kërkesa për licenca, kërkesa e një numri mjetesh shumë më i madh se numri i drejtuesve të mjetit, kërkesa për ekspert zjarrfikës, shërbime për auditim mjedisor etj. Anomalitë e mësipërme u konstatuan në procedurat e prokurimit me objekt: “Ndërtim Ujësjiellësish për njësinë administrative Ballaban, Sukë dhe Dishnicë, Loti I (Nj.A Ballaban & Sukë)”, vlerë të fondit limit 252,277,207 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, “Përmirësim i banesave ekzistuese”, vlerë të fondit limit 16,478,713 lekë, zhvilluar në vitin 2022 “Sistemim asfaltim i rrugës Ura e Mbrezhanit – Malshovë”, vlerë të fondit limit 58,333,333 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021. Veprimet e mësipërme në hartimin e kriterëve të veçanta të DST, bien në kundërshtim me kërkesat e nenit 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pikën 1 të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 39, pika 4, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1. faqe 60-79 të raportit përfundimtar të auditimit).*

**9.1.Rekomandim:** Titullari i autoritetit kontraktor dhe njësia e prokurimit të marrin masa për eliminimin e mangësive në hartimin e kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit, duke shmangur vendosjen e kriterëve të cilët nuk kanë lidhje me objektin e kontratës.

*Menjëherë e në vijimësi*

**Përgjigjja e institucionit:**

*Mungon*

**Komenti i grupit të auditimit:**

Në kushtet e mungesës së përgjigjes së dhënë nga ana e institucionit dhe dokumentacionit justifikues mbështetës, rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

**10.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, të hartuar nga njësia e prokurimit, konstatohet se kriteret e kapacitetit teknik nuk janë të argumentuara nga ana teknike. Në këtë

procesverbal nga njësia e prokurimit është dokumentuar vetëm baza ligjore, e cila i jep të drejtën autoritetit kontraktor, që gjatë hartimit të kriterëve mund t'u kërkojë ofertuesve plotësimin e një numri të caktuar kriteresh të nevojshme, por nuk është argumentuar teknikisht lidhja e kriterit të vendosur me objektin e kontratës, se me cilin zë konkret të preventivit lidhet kriteri i vendosur. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 1 dhe 2, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. . (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1. faqe 60-79 të raportit përfundimtar të auditimit).

**10.1.Rekomandim:** Titullari i autoritetit kontraktor dhe njësia e prokurimit të marrin masa që gjatë hartimit të kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit, të bëhet argumentimi teknik i secilit kriter të vendosur, ku të shpjegohet se me cilin zë të preventivit lidhet çdo kriter i hartuar nga autoriteti kontraktor.

*Menjëherë e në vijimësi*

### **Përgjigjia e institucionit:**

*Mungon*

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Në kushtet e mungesës së përgjigjes së dhënë nga ana e institucionit dhe dokumentacionit justifikues mbështetës, rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

**11.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në një rast, në tenderin me objekt “Përmirësim i banesave ekzistuese”, vlerë të fondit limit 16,478,713 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2022, asnjë nga operatorët ekonomik nuk plotëson kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, por KVO ka kualifikuar si fitues, BOE A ” ”& “E ” ShPK, me vlerë të ofertës ekonomike 16,391,400 lekë pa TVSh. KVO duhet ti kishte propozuar titullarit të autoritetit kontraktor anulimin e tenderit. Këto veprime kanë sjellë lidhjen e kontratës me një operatorë ekonomik të shpallur fitues në kundërshtim me nenin 98, pika të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, me nenin 82, pika 2, germa (i) të VKM nr.285, datë 23.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1. faqe 60-79 të raportit përfundimtar të auditimit).

**11.1.Rekomandim:** Titullari i autoritetit kontraktor të marrë masa për një vlerësim të barabartë të operatorve ekonomik dhe të shmang rastet e kualifikimit të operatorit ekonomik në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të DT. Në raste të tilla të bëhet anulimi i tenderit.

*Menjëherë e në vijimësi*

### **Përgjigjia e institucionit:**

*Mungon*

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Në kushtet e mungesës së përgjigjes së dhënë nga ana e institucionit dhe dokumentacionit justifikues mbështetës, rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

**12.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se AK Bashkia Këlcyrë për vitin 2021 dhe

2022 ka caktuar si anëtar të njësisë së prokurimit dhe njëkohësisht person përgjegjës për prokurimin Znj. F.S , e cila sipas të dhënave të Bashkisë Këlcyrë, është punonjëse me kohë të plotë e Bashkisë Tiranë.

Për këtë qëllim në datën 06.01.2022 është lidhur aktmarrëveshje midis Bashkisë Këlcyrë dhe Znj. F.S , pa numër protokolli.

Nevoja për marrjen e një personi nga një autoritet tjetër kontraktor nuk është e argumentuar nga Bashkia Këlcyrë, pasi ky institucion nuk ndodhet në kushtet e mungesës së stafit për përcaktimin e personit përgjegjës për prokurimin dhe caktimin e njësisë së prokurimit. Kuadri ligjor në fuqi nuk përcakton detyrimin që subjektet të kenë pa tjetër një jurist në njësinë e prokurimit. Detyrimi që ka vendosur nenin 74 i VKM nr.285 dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, lidhur me personin përgjegjës për prokurimin është:

Personi/at përgjegjës duhet të jenë minimalisht me arsim të lartë.

Gjithashtu po ky nen, ka vendosur detyrimin për titullarin e autoritetit kontraktor si vijon: Autoritetet/entet kontraktore duhet të nxisin trajnimin e personit/personave përgjegjës në fushën e prokurimit publik. Bashkia Këlcyrë ka në strukturën e saj personel me arsim të lartë për kryerjen e kësaj detyre, të cilët më parë duhet të trajnohen prej saj.

Nga auditimi konstatohet se edhe procedura e ndjekur për këtë qëllim është e gabuar. Bashkia Këlcyrë nuk i është drejtuar me shkresë zyrtare asnjë autoriteti kontraktor, pra as Bashkisë Tiranë, në mënyrë që ky institucion, nëse pranon kërkesën, të përcaktojë vetë personin.

Në rast të nevojave të tilla, është institucioni Bashkia Tiranë që përcakton se cili do të jetë punonjësi i kërkuar nga Bashkia Këlcyrë dhe, nuk pranon dhe miraton punonjësi për veten e vet që të bëhet pjesë e njësisë së prokurimit dhe person përgjegjës në një institucion tjetër.

Aktmarrëveshja midis Bashkisë Këlcyrë dhe Znj. F.S nuk është një marrëdhënie midis dy institucioneve, pasi nuk paraprihet nga aktmarrëveshja prej dy institucioneve, por një marrëveshje midis Bashkisë Këlcyrë dhe punonjësit të Bashkisë Tiranë (të cilit për arsye se është i punësuar me kohë të plotë pranë Bashkisë Tiranë, nuk i lejohet të kryej detyra të tjera jashtë këtij institucioni pa autorizimin dhe miratimin e titullarit të Bashkisë Tiranë, brenda orarit zyrtar të punës). Në pikën 3 të nenit 74 të VKM nr.285 dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohen detyrat e personit përgjegjës për prokurimin, kryerja e të cilave kërkon kohën e nevojshme në dispozicion, angazhim konkret brenda orarit të punës dhe brenda institucionit të Bashkisë Këlcyrë që në rastin konkret janë të pa mundura, për arsyet e shpjeguar më sipër. Me Bashkinë Tiranë, kjo gjë vështirësohet akoma më shumë për shkak të distancës midis dy institucioneve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 74 të VKM nr.285 dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.1. faqe 60-79 të raportit përfundimtar të auditimit).*

**12.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, të marrë masa për ndërprerjen e aktmarrëveshjes që ka bërë me Znj. F.S , në të cilën është përcaktuar si person përgjegjës për prokurimin publik, si dhe të përcaktojë në këtë pozicion punonjës brenda strukturës së vet, duke siguruar trajnimin e tyre. Në rastet e tenderave që do të kërkojnë njohuri të specializuara, Bashkia Këlcyrë të kërkojë staf të specializuar nga autoritete/ente të tjera kontraktore ose të punësojë ekspertë të jashtëm, duke ndjekur procedurat e duhura ligjore.

*Menjëherë e në vijimësi*

**Përgjigjja e institucionit:**

*Mungon*

**Komenti i grupit të auditimit:**

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion, më datë 05.01.2023 është lidhur akt marrëveshje mes Bashkisë Këlcyrë dhe Znj. F.S me profesion juriste. Sipas kësaj Akt Marrëveshje, janë specifikuar detyrat e znj. F.S mes të tjerave pika 5 e autorizon për ngarkim të dokumentave në SPE si përfaqësuese të njësisë së prokurimit, Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

**13.Gjetja nga auditimi:** Në kontratën me objekt “*Ndërtim i rrjetit të jashtëm të ujësjellësit Këlcyrë*” është parashikuar instalimi i sistemit SCADA në stacionin e pompimit Këlcyrë si dhe në depon 700 m<sup>3</sup>. Ky sistem do të bëjë të mundur matjen e prurjeve, nivelin e rezervuarit dhe konsumin në dalje të depos nëpërmjet matësve elektronik e kështu komandimin në distancë të elektro-pompave duke minimizuar kostot e prodhimit me ngritje mekanike. Gjithashtu nëpërmjet matësve në sistemin e shpërndarjes bëhet kontrolli i humbjeve në rrjet duke i krahasuar me konsumin total të klientëve. Referuar sasisë që hyn në sistemin e shpërndarjes, e matur nga matësat elektronik në dalje të depos, bëhet dezinfektimi i ujit të pijshëm me hipoklorit natriumi të koordinuara nëpërmjet sistemit SCADA. Nga auditimi në terren në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve dhe përfaqësuesit të Bashkisë Këlcyrë u konstatua se ishin instaluar pajisjet e sistemit SCADA të parashikuara në kontratë por, ky sistem ishte jashtë funksionit, i pa programuar, matësat elektronik nuk tregonin matjet në panelet përkatëse si dhe sistemi i klorinimit ishte jo funksional. Në dosjen teknike nuk gjenden gjurmë që në përfundim të punimeve dhe aktin e kolaudimit sistemit SCADA ti jetë kryer testi i funksionimit (test report). Mosfunksionimi i sistemit të klorinimit tregon se sasia e ujit në sistemin e shpërndarjes për konsumatorët nuk është sipas kushteve higjieno-sanitare të përcaktuara në legjislacion. Mungesa e klorifikimit të ujit të pijshëm rrezikon shëndetin publik të konsumatorëve dhe është në kundërshtim me VKM nr. 379, datë 25.05.2016 “Për miratimin e rregullores cilësia e ujit të pijshëm”, neni 6 “Kriteret e cilësisë së ujit të pijshëm” pika 1 dhe Kontrata Nr.2292 Prot. datë 01.11.2019 (specifikimet teknike). (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 79-84 të raportit përfundimtar të auditimit*).

**13.1.Rekomandim:** Bashkia Këlcyrë në bashkëpunim me Ujësjellës Kanalizime Këlcyrë SHA të marrë masa të menjëhershme për vendosjen në funksionim të sistemit SCADA, i cili do të kryej një kontroll sa më efikas të sistemit të prodhimit e të shpërndarjes për uljen e kostove të prodhimit me ngritje mekanike. Gjithashtu të vendoset në funksion sistemi i klorinimit, i koordinuar në mënyrë automatike me sistemin SCADA, duke mbajtur në parametrat e kërkuar sasinë e klorit e për rrjedhojë ruajtjen e shëndetit publik dhe uljen e kostove të klorinimit.

***Menjëherë e në vijimësi***

**Përgjigjia e institucionit:**

*Mungon*

**Komenti i grupit të auditimit:**

Në kushtet e mungesës së përgjigjes së dhënë nga ana e institucionit dhe dokumentacionit justifikues mbështetës, rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

**14.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në sistemin e-leje konstatohet se në tre raste, si më poshtë vijon, në dhënien e lejeve të ndërtimit nuk është marrë mendim nga institucionet e duhura ligjore si AZHT,ASHK,UK. Konkretisht rastet janë si vijon:

- Leje ndërtimi datë 28/09/2022 i jepet zhvilluesit A. S., i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: M.G , NIPT L...A, leja e ndërtimit për objekt banimi 2 kat, adresa e realizimit të punimeve fshat Zhepovë, Bashkia Këlcyrë.

-leje ndërtimi nr. 1148, datë 28/05/2021 i jepet: zhvilluesit Z.K, S.K, i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: R.SH leja e ndërtimit për objektin banesë 2 kat, adresa e realizimit të punimeve fshat Podgoran, Bashkia Këlcyrë.

- Leje ndërtimi, datë 28/05/2021 i jepet shoqërisë “L ” SHPK me nipt M...U, dhe licence nz.8031 drejtues ligjor E.L. zhvilluesit: Z.K , S.K i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: R.SH leja e ndërtimit për objektin banesë 2 kat, adresa e realizimit të punimeve fshat Podgoran, Bashkia Këlcyrë.

- Leje ndërtimi nr. 876, datë 20/04/2022 i jepet zhvilluesit A.R i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: J.X leja e ndërtimit për objektin “Objekt 3 kate, kati pare njësi shërbimi, 2 kate njësi hyrëse ne funksion te bujtinës (Diamanda), adresa e realizimit të punimeve Këlcyrë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Vendim Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territori”, Neni 15 pika ë). (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5. faqe 84-86 të raportit përfundimtar të auditimit*).

**14.1.Rekomandim:** Nga DPKZHT Bashkia Këlcyrë të merren masa që në rastin e dhënies së lejeve të ndërtimit, më para të merret mendim nga institucionet e duhura ligjore si AZHT, ASHK, UK.

*Menjëherë e në vijimësi*

#### **Përgjigjia e institucionit:**

*Mungon*

#### **Komenti i grupit të auditimit:**

Në kushtet e mungesës së përgjigjes së dhënë nga ana e institucionit dhe dokumentacionit justifikues mbështetës, rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

**15.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në sistemin e-leje konstatohet se leje ndërtimi datë 28/09/2022 i jepet: zhvilluesit A.S i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: M.G , NIPT L...A, leja e ndërtimit për objektin banim 2 kat, adresa e realizimit të punimeve fshat Zhepovë, Bashkia Këlcyrë. Sipas projektuesit preventivi i llogaritur për këtë projekt është 5,289,082 lekë, ndërkohë kostoja minimale e këtij objekti llogaritur me koston e ndërtimit është 7,207,694 lekë. Për sa më sipër, hartimi i preventivit me vlerë nën koston e ndërtimit të miratuar nga Enti Kombëtar i Banesave, është në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 3 datë 28.12.2016 “Për Miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave” është 32,614 lekë/m2. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5. faqe 84-86 të raportit përfundimtar të auditimit*).

**15.1.Rekomandim:** Nga DPKZHT Bashkia Këlcyrë të merren masa për të mos pranuar preventiv punimesh, vlera e të cilave është nën koston e ndërtimit që është miratuar nga Enti Kombëtar i Banesave.

*Menjëherë e në vijimësi*

### **Përgjigjia e institucionit:**

Në aplikimiet e lejeve të ndërtimit në vazhdimësi do merren masat për mospranimin e vlerave nën koston e ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *në proces zbatimi*.

**16.Gjetje nga auditimi:** Nga kontrolli në sistemin e-leje konstatohet se leje ndërtimi nr. 876, datë 20/04/2022 i jepet: zhvilluesit A.R i regjistruar si subjekt me të dhënat e mëposhtme: J.X leja e ndërtimit për objektin “Objekt 3 kate, kati pare njësi shërbimi, 2 kate njësi hyrëse në funksion te bujtinës (Diamanda), adresa e realizimit të punimeve Këlcyrë. Objekti në orientimin jugor duhet ta kishte distancën nga kufiri i pronës jo më pak se 4 metër, por nga auditimi u konstatua se kjo distancë është 2.7 metër dhe 3.1 metër), në kundërshtim me neni 35 të Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territori”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5. faqe 84-86 të raportit përfundimtar të auditimit*).

**16.1.Rekomandim:** Nga DPKZHT Bashkia Këlcyrë të merren masa për të ndërprerë praktikën e miratimit të lejeve të ndërtimit pa respektuar distancat e lejuara nga kufiri i pronës, sipas legjislacionit në fuqi.

*Menjëherë e në vijimësi*

### **Përgjigjia e institucionit:**

*Mungon*

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Në kushtet e mungesës së përgjigjes së dhënë nga ana e institucionit dhe dokumentacionit justifikues mbështetës, rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.**

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, **nga Titullari i Njësisë Publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **339,337 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga Auditimi:** Në objektin “Ndërtim i rrjetit të jashtëm të ujësjellësit Këlcyrë” sipas kontratës të lidhur midis Bashkisë Këlcyrë dhe BOE “B ” sh.p.k & “H ” sh.p.k me Nr.2292 Prot. datë 01.11.2019 në lidhje me zbatimin e punimeve me vlerë 177,466,647 lekë me TVSH

me afat përfundimi të punimeve 8 muaj dhe ky afat i ndryshuar me amendimin e kontratës nr.1943prot. datë 03.07.2020, sipas dokumentacionit të dosjes teknike dhe vizitës në terren të përfaqësuesve shtetërorë të KLSH në prezencë të përfaqësuesit të mbikëqyrësit (supervizori i punimeve) rezultuan se; në librezat e masave dhe në situacionet përfundimtar, janë përfshirë volume punimesh të pakryera në fakt, për 6 (gjashtë) zëra punimesh në shumën 362,733 lekë pa TVSH e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, Udhëzimi nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 8.1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3; - Kontratën e shërbimit e lidhur midis Bashkisë Këlcyrë dhe OE “Z ” sh.p.k me Nr.2041Prot. datë 04.10.2019 me objekt: “Mbikëqyrje e punimeve në objektin, Ndërtim i rrjetit të jashtëm të ujësjellësit Këlcyrë”, Neni 7, pika 7.1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 86-89 të raportit përfundimtar të auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e shumës 339,337 lekë pa TVSH, nga BOE “B ” sh.p.k & “H ” sh.p.k, për volume punimesh të likuajuara, por të pakryera në fakt sipas kontratës së lidhur me Nr.2292 Prot. datë 01.11.2019 për realizimin e punimeve civile, vlerë e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore.

*Deri më 30.11.2023*

### **Përgjigjia e institucionit:**

*Mungon*

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Në kushtet e mungesës së përgjigjes së dhënë nga ana e institucionit dhe dokumentacionit justifikues mbështetës, rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

## **C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË TYRE.**

**1.Gjetje nga auditimi:** Si rezultat i mos marrjes së masave shtrënguese nga Bashkia Këlcyrë, janë krijuar debitorë nga kategoria e taksapaguesve privat dhe familjar.

Gjendja e debitorëve më 31.12.2022 është në shumën **72,228 mijë lekë**, nga e cila debitorët e kategorisë private kanë vlerën 16,784 mijë lekë, ndërsa debitorët e kategorisë familjare kanë vlerën 55,444 mijë lekë, ose 76 % të totalit. Kjo vlerë konsiderohet e ardhur e planifikuar, por e pa arkëtuar nga Bashkia Këlcyrë. Në vitin 2022 vlera e debitorëve ka ardhur në rritje krahasuar me vitin 2021, pasi në fund të vitit 2021 vlera e debitorëve është 63,685 mijë lekë, ndërsa në fund të vitit 2022 kjo vlerë është 72,228 mijë lekë, ose 8,543 mijë lekë më e lartë. Pra gjatë vitit 2022 janë krijuar debitorë të rinj në vlerën 8,543 mijë lekë.

Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Këlcyrë, ka zbatuar vetëm procedurën e njoftimit të subjekteve dhe asnjë masë tjetër shtrënguese për arkëtimin e debitorëve.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore



në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni nenet 15 dhe 181 -*Mospagimi i taksave dhe tatimeve*<sup>2</sup>, apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit “Për Kundërvajtjet Administrative” (brenda 2 viteve), (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 28-41 të raportit përfundimtar të auditimit*).

**1.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë dhe Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët privat dhe familjar, si dhe në vijim të ndjekin të gjitha rrugët ligjore në rend shterues, për arkëtimin e detyrimeve prej 72,228 mijë lekë nga debitorët e privat dhe familjar.

*Deri më 31.12.2023*

### **Përgjigjia e institucionit:**

Gjatë vitit 2023 janë marrë masa për mbledhjen e debitorve nga ana e zyrës së tatim taksave.

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Në kushtet e mungesës së përgjigjes së dhënë nga ana e institucionit dhe dokumentacionit justifikues mbështetës, rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se për katër subjekte të cilët zhvillojnë aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, nga Bashkia Këlcyrë nuk është aplikuar tarifa për paisjen me autorizim për zhvillimin e aktivitetit të mësipërm. Nga këto veprime në total është krijuar një e ardhur e munguar në vlerën **8,000,000 lekë**, sipas detyrimeve të subjekteve në vijim:

Subjekti D , për vlerën prej 1,800,000 lekë.

-Subjekti E SHPK, për vlerën prej 3,300,000 lekë.

-Subjekti D. , për vlerën prej 2,200,000 lekë.

-Subjekti A. SHPK, për vlerën prej 700,000 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 35, VKM nr. 344, datë 19.04.2017, për disa ndryshime ne VKM nr. 970, pika 15.1. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 28-41 të raportit përfundimtar të auditimit*).

**2.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **8,000,000 lekë** nga 4 subjektet si vijon:

-Subjekti D , për vlerën prej 1,800,000 lekë.

-Subjekti E SHPK, për vlerën prej 3,300,000 lekë.

-Subjekti D , për vlerën prej 2,200,000 lekë.

-Subjekti A SHPK, për vlerën prej 700,000 lekë.

*Deri më 31.12.2023*

### **Përgjigjia e institucionit:**

- Subjekti A , vlerën 700,000 lekë po e shlyen me këste ne baze akt-marrëveshjes se lidhur midis subjektit dhe zyrës tatim -taksave me nr. 1332 prot datë 15.06.2022.

- Subjekti E SHPK nuk e ushtron aktivitetin e saj ne territorin e Bashkisë Këlcyrë

<sup>2</sup> “*Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, megjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.*”

Nga verifikimet e bëra nga agjentet tatimor te zyres rezulton se nuk e ushtron aktivitetin. Per kete jane mbajtur dhe akt-kostatime nga ana e zyrës Tatim –Taksa me datën 07.08.2023.

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Referuar përgjigjes së dhënë nga ana e Bashkisë Këlcyrë rezulton se, nga ana e saj janë ndërmarr masa për 2 nga 4 subjektet e lëna në rekomandimin e grupit të auditimit.

Kështu me akt marrëveshjen nr.1332 prot., datë 15.06.2022 është rregulluar arkëtim i pjesshëm, i vetëm 400,000 lekë nga 700,000 lekë që rezulton totali;

Ndërkohë që përmes një akt konstatimi me shkrim dore, që mban datë 07.08.2023 është specifikuar se subjekti E sh.p.k me vlerë detyrimi total prej 3,300,000 lekë nuk ushtron më veprimtarinë e tij.

Për dy subjektet e tjera nuk është ndërmarr asnjë nismë arkëtimi.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet ***i pranuar*** nga subjekti dhe ***i zbatuar pjesërisht***.

**3.Gjetje nga auditimi:** Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Këlcyrë, për planifikimin e të ardhurave nga taksa për tokën bujqësore, nuk është mbështetur në fondin e disponueshëm, ndarjen sipas kategorisë dhe numrit të familjeve që posedojnë tokë bujqësore. Ka mospërputhje të theksuar midis planifikimit dhe asaj çfarë duhej të ishte planifikuar, sipas bazës së taksueshme. Kjo tregon se Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, gjatë procesit të përgatitjes së paketës fiskale, nuk është konsultuar me sektorët e tjerë në bashki, për të marrë evidencë të saktë dhe për të realizuar një proces sa më real të planifikimit të të ardhurave.

Sipas të dhënave të paraqitura nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, konstatohet se për vitin 2022 realizimi paraqitet në masën 50.6% ose nga 2,300 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera prej 1,163 mijë lekë, ndërsa referuar të dhënave të Sektorit të Bujqësisë në Bashkinë Këlcyrë, rezulton se toka bujqësore u përket kategorive IV deri VII, sipas përkatësisë, Kategoria e V 753 Ha, kategoria VI 1,971 Ha dhe kategoria VII 1,928 Ha. Gjithsej fondi i tokës bujqësore për Bashkinë Këlcyrë është **4,652 Ha**. Nga sa më sipër diferenca në planifikim është **3,127,250 lekë** për vitin 2022 (5,427,250 - 2,300,000), gjë e cila ka sjell të ardhura të planifikuara më pak për buxhetin e bashkisë për vitin 2022 në vlerën **3,127,250 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 23. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 28-41 të raportit përfundimtar të auditimit*).

**3.1.Rekomandim:** Për një planifikimin të saktë të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore të krijojë rregjistrin e taksapaguesve familjar për tokën bujqësore, duke evidentuar të gjithë personat të cilët janë pajisur me tokë bujqësore, sipas AMTP. Për plotësimin e të dhënave të bashkëpunohet me Sektorin e Bujqësisë.

*Deri më 31.12.2023*

### **Përgjigja e institucionit:**

Për planifikimin e sakte të tokës bujqësore është krijuar regjistri i taksapaguesve familjar për tokën bujqësore duke evidentuar të gjithë personat që janë pajisur me tokë bujqësore.

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion, nga ana e Bashkisë Këlcyrë janë hartuar 6 regjistra në trajtën e formatit excel , për të cilat po vijohet plotësimi referuar rekomandimit të dhënë.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *në proces zbatimi*.

**4.Gjetje nga auditimi:** Në auditimi u konstatua se nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë 7 persona, në vlerën totale **188,754 lekë**, prej të cilëve dy persona në vlerën totale 46,394 lekë i përkasin vitit 2022, ndërsa 5 persona në vlerën totale 142,360 lekë i përkasin periudhës përpara vitit 2022. Vlera 188,754 lekë konsiderohet e ardhur e munguar për Bashkinë Këlcyrë (sipas listës analitike të pasqyruar në aneksin nr. 3 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit). Gjithashtu, konstatohet se nga Bashkia Këlcyrë, nuk është mbajtur korespondencë me ASHK Gjirokastër, për tu informuar lidhur me numrin e legalizimeve që ka bërë kjo agjenci, në mënyrë që Bashkia Këlcyrë të evidentojë personat të cilët kanë bërë legalizim objekti, por nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe, mbi bazën e këtij informacioni të kërkojë prej tyre shlyerjen e detyrimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, i ndryshuar, pika nr. 5 -Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja që janë në proces legalizimi. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 28-41 të raportit përfundimtar të auditimit).

**4.1.Rekomandim:** Bashkia Këlcyrë të marrë masa për arkëtimin e vlerës 188,754 lekë nga 7 persona debitor, sipas listës analitike të pasqyruar në aneksin nr. 3 pika 2.6 bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit.

**4.2. Rekomandim** Të mbajë korespondencë të vazhdueshme me ASHK Gjirokastër për të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi, me qëllim njohjen e situatës dhe përcaktimin e personave të cilët nuk kryejnë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe nxjerrjen e tyre si debitor ndaj Bashkisë Këlcyrë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

#### **Përgjigjia e institucionit:**

ASHK Gjirokastër nuk duhet të lëshojë lejen e legalizimit përpara se të marrë konfirmimin e pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga Bashkia Këlcyrë, dhe më pas të vazhdohet me procedurën e hipotekimit.

#### **Komenti i grupit të auditimit:**

Në kushtet e mungesës së dokumentacionit justifikues provues të stadit në të cilin ndodhet zbatimi i rekomandimeve, po thjesht dhënies së një argumentimi për mënyrën se si ASHK Gjirokastër duhet të operoj, rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

**5.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit për subjektet të cilat kanë kryer punime dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit me fonde publike në territorin e Bashkisë Këlcyrë për periudhën 01.07.2020-31.12.2022, konstatohet se kanë lidhur kontrata me bashkinë 4 operator ekonomik për të cilët nuk është aplikuar dhe arkëtuar tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit me pasojë të ardhura të munguara për Bashkinë Këlcyrë në vlerën **153,400 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me vendimin nr. 86 datë 26.12.2019 të Këshillit të Bashkisë Këlcyrë dhe vendimi nr.39 datë 28.12.2020 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe udhëzimit përkatës nr.24, datë

02.09.2008 i ndryshuar 43.1/1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 28-41 të raportit përfundimtar të auditimit).

**5.1.Rekomandim:** Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Këlcyrë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **153,400 lekë**, nga subjektet të cilat kanë zhvilluar aktivitetet dhe kanë lidhur kontratë me Bashkinë Këlcyrë, për arsye të shpalljes fitues në procedurat e prokurimit publik, sipas listës së mëposhtme:

- Subjekti “A SHPK”, me NIPT L...J, detyrimi në vlerën 57,600 lekë (në dy procedura prokurimi);
- Subjekti “B ” SHPK, me NIPT K...A, detyrimi në vlerën 67,000 lekë;
- Subjekti “SH “Shpk” me NIPT K...Ë, detyrimi në vlerën 28,800 lekë;

*Deri më 30.11.2023*

**Përgjigjia e institucionit:**

Subjekti “A SHPK”, ME NIPT:L...J ka shlyer deri tani vlerën prej 28,800 lekë.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion, rezulton se nga ana e Bashkisë Këlcyrë, janë ndërmarr nisma për arkëtim vetëm ndaj subjektit “A SHPK” dhe vetëm për vlerën prej 28,800 lekë.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *pjesërisht i zbatuar*.

**D. MASA DISIPLINORE.**

**I. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.**

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ligjin 139/2015” Për vetëqeverisjen vendore”, pika 4 e nenit 15, si dhe në pikën 1, germa (i), si dhe kontratë individuale të punës, **i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë Këlcyrë**, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH dhe **në proporcion me shkeljen e kryer**, të fillojnë procedurat për dhënie e masës disiplinore nga “Vërejtje”, deri në “Zgjidhje të kontratës së punës”, **për punonjësit e mëposhtëm:**

**1. Znj. V.K**, me detyrë Përgjegjëse e Financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues, për shkeljet e mëposhtme:

-Për anomali të konstatuara në hartimin e pasqyrave financiare.

- Për mos marrjen e masave të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe krijimin e detyrimeve të reja ndaj të tretëve për periudhën 01.01.2022 -31.12.2022.

(Më hollësisht, mangësitë trajtuar në pikën nr.2.1-2.5, faqe 19-28 dhe pikën 3, faqe 41-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2. Znj. L.J**, me detyrë përgjegjës në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore;

**3. Z. M.Ç** me detyrë Specialist në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore;

**4. Z. I.K** me detyrë Specialist në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, për mangësitë e mëposhtme:

- Për mos zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreu XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 93 “Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë” neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”,

me pasojë mos marrjen e masave të plota për arkëtimin e detyrimit 83,544 mijë lekë nga debitorët e taksave dhe tarifave vendore.

**5. Z. J.N**, me detyrë përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës, Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimeve, specialisti i fushës, për anomalië e konstatuara në hartimin e kriterëve të të vecanta të seksionit të kapacitetit teknik të DT, në tre tendera, me objekt: “Ndërtim Ujësjiellësish për njësinë administrative Ballaban, Sukë dhe Dishnicë, Loti I (Nj.A Ballaban & Sukë)”, zhvilluar në vitin 2021, “Përmirësim i banesave ekzistuese”, zhvilluar në vitin 2022, “Sistemim asfaltim i rrugës Ura e Mbrezhanit – Malshovë”, zhvilluar në vitin 2021.

Në hartimin e kriterëve është vpruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 2 “Dokumentimi i procesit”, pika 2, germa (c), - nenin 39, pika 6.ç, neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 1 dhe 2 (Trajtuar më hollësisht në pikën 4.1-4.3, faqe 60-79 të raportit të auditimit).

-Gjithashtu për anomalië e konstatuara në cilësinë e përgjegjës të Zyrës së Urbanistikës, Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (Trajtuar më hollësisht në pikën 5, faqe 84-86 të raportit të auditimit).

**6. Z. O.H**, me detyrë specialist i lartë në emergjenca civile & kadastrës;

**7. Z. A.Q**, me detyrë specialist i taksave e tarifave vendore;

**8. Z. Q.P**, me detyrë teknik i mesëm pyjesh. Të tre punonjësit, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, për shkeljet e konstatuara në tenderin me objekt “Përmirësim i banesave ekzistuese”, vlerë të fondit limit 16,478,713 lekë, zhvilluar në vitin 2022. Në këtë tender është bërë kualifikimi i operatorit ekonomik në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të DT dhe nuk është anuluar tenderi, veprime në kundërshtim me nenin 98, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 82, pika 2, germa (i) të VKM nr.285, datë 23.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar (Trajtuar më hollësisht në pikën 4.1-4.3, faqe 60-79).

## **E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.**

Për punonjësit që do të jepen masa disiplinore, Bashkia Këlcyrë pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

**b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

### **Përgjigjja e institucionit:**

*Mungon*

### **Komenti i grupit të auditimit:**

Referuar plan veprimit nr.2986 prot., datë 29.12.2023 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin e KLSH-së në auditimin e ushtruar në bashkinë Këlcyrë për periudhën 01.01.2022-

31.12.2022” rezulton ricitim i rekomandimit të lënë për punonjësit por pa masë specifike të vendosur.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet *i pranuar* nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

## **8. Të ndryshme të dala gjatë auditimit**

*Auditim tematik në 3 njësitë administrative Dishnice, Suke dhe Ballaban.*

### **Njësia Administrative Dishnice.**

*Dokumentacioni i punonjësve 2023.*

Njësia Administrative Dishnice përbëhet nga një organike prej 18 punonjës gjithsejtë për vitin 2023, nga këto: 1 administrator, 1 protokoll arshive, 1 specialist shërbimesh, 4 roje pyje-kullota, 8 punëtore rrugëve rurale, 3 punëtor pastrim gjelbërim.

Nga verifikimi i numrit punonjësve ne raport me ngarkesën e punës rezulton një raport i zhdrejte midis tyre, pasi organika është fryre me roje e punëtore, ndërsa mungon agronomi dhe ing. kadastrës, te domosdoshëm për problemet e tokës bujqësore.

*Pagesat për punonjësit* bëheshin nen mungesën e listë prezencave ditore, por është mjaftuar me kohëshënuesit mujore gjate vitit 2023 me konfirmimin e administratorit për tu dërguar pranë financës bashkisë për të kryer veprimet.

Mungon dokumentacioni për punonjësit e normuar te 8 punëtoreve te rrugëve rurale, te 3 punëtorëve te pastrim gjelbërimit, përkatësisht: mungojnë situacionet, preventivat, urdhra pune nga titullari, mungojnë fotot e terrenit para dhe pas meremetimit te rrugëve rurale dhe pastrim gjelbërimit, sipas vendit dhe emërtimit te tyre, ku janë kryer këto punime etj. Mungesa e dokumentacionit ditor për prezencën ne pune dhe mungesa e dokumentacionit për pasqyrimin e punës te punonjësve pastrim gjelbërimit dhe punonjësve te rrugëve rurale, nuk argumenton pagesën e 7 punonjësve dhe 11 punëtorëve te njësisë Dishnice, ne kundërshtim me udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin aktiveve njësitë publik,*”.

*AMTP dhe korrespondenca me ASHK Përmet për vitin 2023.*

U krye auditim tematik mbi: procedurave te ndjekura nga njësia administrative Dishnice për konfirmimin e saktësisë te AMTP dhe pozicionimit te plan vendosjeve te tyre, ne reference te dispozitave te ligjit nr. 20/2020 “*Për Kadastrën*”. Dokumentacionit dërguar për regjistrim ne ASHK dhe konfirmimi i akteve dhe plan rilevimit, sipas kërkesave te ASHK. Praktikate dërguara për regjistrim ne ASHK, konfirmuar me pare nga Kadastra Gjirokastrë. Dokumentacionit për vendimet qe konfirmojnë vlefshmërine AMTP, për regjistrim ASHK.

Dokumentacionit për vendimet qe fuqizojnë pjesërisht AMTP, për shkak te tejkalimit te normës për fryme, për shkaqe qe lidhen me legjitimitimin ose me llojin e pasurisë. Listën e sipërfaqeve tepër tokës bujqësore kaluar “shtet” nga ASHK, sipas subjekteve private objekt AMTP, si rezultat i diferencave sipërfaqeve tepër ne terren nga ato ne AMTP. Listën e sipërfaqeve tepër te tokës kaluar “shtet” nga ASHK, sipas subjekteve private objekt i legalizimeve, për diferencat midis sipërfaqeve te zaptuara me ato te miratuara me legalizim, te cilat kane mbetur në posedim dhe shfrytëzim te subjekteve private në mënyrë të paligjshme për një periudhë pa kufi kohor, që shfrytëzohen pa asnjë detyrim, taksë apo qira, për efekt menaxhimi dhe administrimi te tyre. Zenia dhe demtimi i tokes bujqësore nga ndertimet e paligjshme (*pa leje*), e cila bie ndesh me nenin 10 dhe 14 te ligjit nr. 9244 datë 17.06.2004 “*Per mbrojtjen e tokes bujqësore*” dhe me nenin 21 te ligjit nr. 7501 datë 19.07.1991 “*Per token*”. Sa sipër, Nga auditimi me zgjedhje për vitin 2023, rezultoi se:

- ✓ Njësia Dishnice nuk ka specialist te fushës për kadastrën, kjo e domosdoshme pasi aktiviteti kryesor i saj është bujqësia-blegtoaria.
- ✓ Njësia Dishnice nuk ka korrespondence me ASHK Përmet, madje dhe AMTP nuk disponoheshin ne njësinë administrative.

*Taksat vendore, tokës bujqësore, biznesit e tjera për vitin 2023.*

Disponoheshin njoftimet ndaj debitorëve familjar dhe biznesit vogël, për pagesën e taksës tokës bujqësore dhe taksave tjera vendore te vitit 2023 dhe para këtij viti, por këto njoftime pak efekte kane dhëne, pasi debitorët vazhdojnë mos pagesën e detyrimeve.

Nga Njësia nuk janë ndërmarrë hapat tjera ligjore dhe puna ne terren ka funksionuar dobët ne lidhje me arkëtimin e debitorëve dhe taksave vendore te vitit ushtrimor.

Veprime qe bien ndesh me kërkesat: ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006, ndryshuar, ligjit nr. 9745, datë 28.05.2007 “Për sistemin e taksave vendore”, udhëzimin e Ministrisë Financave dhe Ministrisë Brendshme nr. 655/1, datë 06.02.2007, nuk janë zbatuar procedurat e nevojshme të përcaktuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 10415, datë 07.04.2011”.

Ngarkohet me përgjegjësi administratori z. D.K .

### **Njësia Administrative Suke.**

*Dokumentacioni i punonjësve 2023.*

Njësia Administrative Suke përbëhet nga një organike prej 23 punonjës gjithsejtë për vitin 2023, nga këto: 1 administrator, 1 protokoll arshive, 1 ndihme ekonomike, 1 elektrikist, 1 agjent tatimor, 2 specialist shërbimesh, 1 roje godinës njësisë, 1 roje shkolle, 3 roje pyje-kullota, 5 punëtore rrugëve rurale, 6 punëtor pastrim gjelbërim.

Nga verifikimi i numrit punonjësve ne raport me ngarkesën e punës rezulton një raport i zhdrejte midis tyre, pasi organika është fryre me punonjës pa ngarkese pune, ndërsa mungon agronomi dhe ing. kadastrës, te domosdoshëm për problemet e tokës bujqësore.

Pagesat për punonjësit bëheshin në mungesën e listë prezencave ditore, por me një kohëshënues prezence mujore, ne vend qe te mbaheshin për çdo dite gjate vitit 2023 me konfirmimin e administratorit për tu dërguar pranë financës bashkisë për të kryer veprimet.

Gjithashtu mungon dokumentacioni për punonjësit e normuar te punëtoreve te rrugëve rurale, te punëtorëve te pastrim gjelbërimit, përkatësisht: situacione, preventiva, urdhra pune, foto te terrenit para dhe pas meremetimit te rrugëve rurale, te vendit ku kryhen këto punime etj.

Kështu, mungesa e dokumentacionit justifikues për prezencën ne pune dhe për punën ne rrugët rurale dhe pastrim gjelbërimit ne njësinë Suke, bie ndesh me UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitë sektorit publik,”.

*AMTP dhe korrespondenca me ASHK Përmet për vitin 2023.*

U krye auditim tematik mbi: procedurave te ndjekura nga njësia administrative për konfirmimin e saktësisë te AMTP dhe pozicionimit te plan vendosjeve tyre, ne reference dispozitave ligjit 20/2020 “Për Kadastrën”. dokumentacionit dërguar për regjistrim ne ASHK dhe konfirmimi i akteve dhe plan rilevimit, sipas kërkesave te ASHK. praktikate e dërguara për regjistrim ASHK, konfirmuar me pare nga Kadastra e KQ Gjirokastër. dokumentacionit për vendimet qe konfirmojnë vlefshmërinë AMTP, për regjistrim ne ASHK. dokumentacionit për vendimet qe fuqizojnë AMTP, për shkak te jkalimit normës për fryme, për shkaqe qe lidhen me legjitimitimin ose me llojin e pasurisë. listën e sipërfaqeve tepër te tokës kaluar “shtet” nga ASHK, sipas subjekteve private objekt i legalizimeve, për diferencat midis sipërfaqeve te zaptuara me ato te miratuara me legalizim, te cilat kane mbetur në posedim dhe shfrytëzim te

subjekteve private në mënyrë të paligjshme për një periudhë pa kufi kohor, që shfrytëzohen pa asnjë detyrim, taksë apo qira, për efekt menaxhimi dhe administrimi të tyre. Zenia dhe demtimi i tokës bujqësore nga ndertimet e paligjshme (*pa leje*), e cila bie ndesh me nenin 10 dhe 14 të ligjit nr. 9244 datë 17.06.2004 “*Per mbrojtjen e tokës bujqësore*” dhe me nenin 21 të ligjit nr. 7501 datë 19.07.1991 “*Per token*”. **Sa sipër,**

- ✓ Njësia administrative Suke nuk ka specialist të fushës për kadastrën, për rrjedhojë nuk ka korrespondencë me ASHK Përmet.
- ✓ Njësia administrative Suke disponon AMTP, por nga verifikimi i tyre, rezultojnë se disa AMTP ishin të parregullta, pasi kanë korrigjime, mungojnë kufitare, pasqyrojnë truall, i cili nuk është objekt i AMTP, por i listës trojeve 001, në kundërshtim me pikën 5 të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “*Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrat të regjistruarit*”, me UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “, përforcuar me shkresën nr. 7217/3 datë 15.07. 2021 të DP ASHK.

*Taksat vendore, tokës bujqësore, biznesit e tjera për vitin 2023.* Nuk u audituan taksat vendore, të tokës bujqësore dhe taksave tjera vendore të vitit 2023 si dhe debitorëve familjar dhe biznesit vogël, pasi mungonte agjenti tatimor i njësisë Suke.

Ngarkohet me përgjegjësi administratori z. SH.I .

### **Njësia Administrative Ballaban.**

*Dokumentacioni i punonjësve 2023.*

-Njësia Administrative Ballaban përbëhet nga një organike prej 17 punonjës gjithsej për vitin 2023, nga këto: 1 administrator, 1 protokoll arshive, 1 ndihme ekonomike, 1 gjendja civile, 1 agjent tatimor, 1 specialist shërbimesh, 1 specialist pyje-kullota, 1 punëtor ujitje – kullim, 1 roje shkolle, 5 punëtore rrugëve rurale, 3 punëtor pastrim gjelbërim.

Nga verifikimi i numrit punonjësve në raport me ngarkesën e punës rezultojnë një raport i zhdrejtë midis tyre, pasi organika është fryre me punonjës pa ngarkesë pune, ndërsa mungon punonjësi kadastrës e agronomi.

Pagesat për punonjësit bëheshin në mungesën e listë prezencave ditore, por është mjaftuar me një listë prezencë mujore ose kohëshënuesit për çdo muaj, në vend që të mbaheshin për çdo ditë gjatë vitit 2023 me konfirmimin e administratorit për tu dërguar pranë financës bashkisë për të kryer veprimet.

- Gjithashtu mungon dokumentacioni për punonjësit e normuar të 5 punëtoreve të rrugëve rurale, të 3 punëtorëve të pastrim gjelbërimit, përkatësisht: situacione, preventiva, urdhra pune nga titullari, foto të terrenit para dhe pas meremetimit të vendit ku kryhen këto punime etj.

Sa sipër, mungesa e dokumentacionit për prezencën në punë dhe për punën në rrugët rurale dhe pastrim gjelbërim, për efekt të justifikimit të pagesës të punonjësve dhe punëtorëve të njësisë Ballaban, bie ndesh me udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin aktiveve njësive të sektorit publik*”.

*AMTP dhe korrespondenca me ASHK Përmet për vitin 2023.*

U krye auditim tematik mbi: procedurave të ndjekura nga njësia administrative Ballaban për konfirmimin e saktësisë të AMTP dhe pozicionimit të plan vendosjeve të tyre, në referencë të dispozitave të ligjit nr. 33/2012, nr. 111/2018 dhe nr. 20/2020. dokumentacionit dërguar për regjistrim në ASHK dhe konfirmimi i akteve dhe plan rievimit, sipas kërkesave të ASHK. praktikave dërguara për regjistrim në ASHK, konfirmuar me pare nga Kadastra KQ Gjirrokastër. dokumentacionit për vendimet që konfirmojnë vlefshmërinë e AMTP, për regjistrim në ASHK.



dokumentacionit për vendimet që fuqizojnë pjesërisht AMTP, për shkak të tejkalimit të normës për fryme, për shkak që lidhen me legjitimitimin ose me llojin e pasurisë. listën e sipërfaqeve të tokës bujqësore kaluar “shtet” nga ASHK, sipas subjekteve private objekt AMTP, si rezultat i diferencave sipërfaqeve të tokës në terren nga ato të pasqyruara AMTP. listën e sipërfaqeve të tokës kaluar “shtet” nga ASHK, sipas subjekteve private objekt i legalizimeve, për diferencat midis sipërfaqeve të zaptuara me ato të miratuara me legalizim, tokat “shtet” që kanë mbetur në posedim dhe shfrytëzim të subjekteve private në mënyrë të paligjshme për një periudhë pa kufi kohor, të cilët i shfrytëzojnë pa asnjë detyrim, taksë apo qira, për efekt menaxhimi dhe administrimi të tyre.

- zënia dhe demtimi i tokës bujqësore nga ndertimet e paligjshme (*pa leje*), e cila bie ndesh me nenin 10 dhe 14 të ligjit nr. 9244 datë 17.06.2004 “*Per mbrojtjen e tokës bujqësore*” dhe me nenin 21 të ligjit nr. 7501 datë 19.07.1991 “*Per token*”.

Sa sipër, nga auditimi me zgjedhje për vitin 2023, rezultoi se:

- ✓ njësia Ballaban nuk ka specialist të fushës për kadastrën, për rrjedhojë nuk ka korrespondencë me ASHK Përmet.
- ✓ disa AMTP ishin të parregullta, me korrigjime, mungojnë kufitaret, në 1 rast mungonin firmat e komisionit të tokës për AMTP 1667 datë 5.6.1992 si dhe në disa AMTP pasqyrojnë truall, i cili nuk është objekt i AMTP, por i listës trojeve 001, në kundërshtim me nenin 3, pikë c, nenin 10, nenin 15 të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008 “*Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore krijimit të titujve pronësisë mbi tokën bujqësore*”, me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “*Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit*”, me UKM nr. 2, datë 13.06.2013 “*Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me AMTP*”, përforcuar me shkresën nr. 7217/3 datë 15.07.2021 të DP ASHK.

*Taksat vendore, tokës bujqësore, biznesit e tjera për vitin 2023.*

Disponoheshin njoftimet për 2023 ndaj 14 debitorëve të biznesit vogël për vlerën 140,191 lekë, nga këta kanë paguar 3 subjekte për 34,794 lekë, ndërsa nuk kanë paguar taksat 11 subjekte për vlerën 105,397 lekë. Disponohen njoftimet për debitorët e taksave vendore për biznesin e vogël, sipas shkresës nr. 100 datë 02.06.2023. Për taksën e tokës bujqësore dhe taksave tjera vendore të vitit 2023 nuk disponohet evidence përmblendhëse vjetore, por disponohet regjistri sipas familjeve. Debitorët janë të regjistruar, por për taksën e tokës bujqësore nuk ka njoftime, nën pretekstin se shumica e familjeve janë larguar dhe emigruar brenda dhe jashtë shtetit.

Veprime që bien ndesh me kërkesat e ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006, ndryshuar me ligjin nr. 9745, datë 28.05.2007 “*Për sistemin e taksave vendore*”, udhëzimin e Ministrisë Financave dhe Ministrisë Brendshme nr. 655/1, datë 06.02.2007, si dhe nuk janë zbatuar procedurat e nevojshme ligjore të përcaktuara në ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën Shqipërisë*”, ndryshuar me ligjin nr. 10415, datë 07.04.2011”.

Ngarkohet me përgjegjësi administratori z. D. M.

Titulli gjetjes: Parregullsi dhe mungesë dokumentacioni, mosrakordim me ASHK Përmet.

Situata: Në 3 njësitë administrative Dishnice, Suke dhe Ballaban u konstatuan këto mangësi dhe shkelje:

- PAGESAT PËR PUNONJËSIT BËHESHIN NËN MUNGESËN E LISTË PREZENCAVE DITORE, POR ËSHTË MJAFTUAR ME NËJË LISTË PREZENCE MUJORE, NË VEND QË TË MBAHEJ ÇDO DITË KOHËSHËNUESI GJATË VITIT 2023 ME KONFIRMIMIN E ADMINISTRATORIT PËR TË DËRGUAR PRANË FINANCËS SË BASHKISË PËR TË KRYER VEPRIMET.

- Mungon dokumentacioni për punonjësit e normuar të rrugëve rurale dhe të pastrim gjelbërimit, përkatësisht: *situacione dhe preventiva me zëra pune, urdhra pune nga titullari, foto të terrenit para dhe pas meremetimit të vendit ku kryhen këto punime, normativa sipas llojit të punëve, etj.*

- 3 njësitë administrative nuk kanë specialist të fushës për kadastrën, për rrjedhojë nuk ka korrespondencë me ASHK Përmet.

- Punë e pamjaftueshme e agjenteve tatimor në mbledhjen e taksës së tokës bujqësore dhe taksave të tjera vendore të vitit 2023

Operuar në këto kushte në moszbatim të ligjit nr. 20/2020 “Për Kadastrën”, Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006, ndryshuar me ligjin nr. 9745, datë 28.05.2007 “Për sistemin e taksave vendore”, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, ndryshuar me ligjin nr. 10415, datë 07.04.2011”. pikës 36 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, UMF dhe MB nr. 655/1, datë 06.02.2007 Duke riskuar kështu ndjekjen dhe arkëtimin e taksave vendore (taksë bujqësore).

## **8.2 Mbi organizimin dhe funksionin e Policisë Bashkiake në Territorit Njësia Vendore dhe zyrës së protokollit në vitin 2023)**

*Mbi organizimin dhe funksionimin e Policisë Bashkiake në Këlcyrë.*

Spas organigramit të Bashkisë Këlcyrë me nr.25 Prot datë 04.01.2023 dhe Urdhrit me nr.2 datë 04.01.2023 është miratuar struktura organizative e punonjësve sipas nivelit të pagave për vitin 2023 për Policinë Bashkiake për dy punonjës, por në ralisht ndodhet vetëm një punonjës, në aktivitetin vjetor të vitit 2023 rezultoi se, planet e punës janë mbajtur për çdo muaj, të protokolluar dhe miratuar nga titullari, kostatohet se planet mujore janë të njëjtit format dhe përpilues dhe zbatues është i njëjti person, pas ka mugesë personeli në strukturë .

Në strukturën me nr. 25 prot. datë 04.01.2023 është miratuar Sektor i Policisë Bashkiake – Këlcyrë gjatë vitit 2023, me dy persona dhe faktikisht rezultoi se ka vetëm një punonjës, pra figuron një vend vakant duke e lënë sektorin e Policisë Bashkiake me një punonjës.

Në datën 18.03.2023 është larguar punonjasi i Policisë Bashkiake A.P , pa dorzuar detyrën, pa dorzim dokumentacioni dhe pa kërkesë istucionit mbi arsyet e largimit, pra nga marsi 2023 si dhe nuk ka dokument ligjor mbi ndërprerjen e punës nga Sektori i Policisë Bashkiake..

Në dokumentacionin e ndodhur në Zyrën e Burimet Njerzore për punonjës të bashkisë rezultoi se dosjet janë të pa kopletuara dhe mugesë dokumentacioni si me poshtë:

1. Mungon vendimi nga Këshilli i Rrethit për emërimin e kryeinspektorit të Policisë Bashkiake, nuk është kryer testim i punonjësit A.P nga komisioni, veprim në kundërshtim me (piken 2) të ligjit 8224 datë 15.05.1997 dhe (neni 9,10,11 ) VKM 452, datë 26.07.2023
2. Nuk ka funksionuar komision për zgjedhjen e punonjësve të Policisë Bashkiake veprim në kundërshtim me (nenin 5) të ligjit 8224 datë 15.05.1997 dhe VKM 452, datë 26.07.2023.
3. Nuk ka asnjë dokument në dosje për pëshatshmeri me vendin e punës për të kryer detyrën në Polici bashkiake, veprim që bie në kundërshtim me (nenin 5) të kreut VII, ”Rregullat Sandarte në kryerjen e detyrave ku shprehimisht thuhet :
4. “Asnjë punonjës i policisë bashkiake e të komunes, nuk vendoset në detyrë pa kaluar në formim në Akademinë e Policisë së Rendit sipas programit të miratuar për këtë qëllim” sipas ligjit 8224 datë 15.05.1997 dhe VKM 452, datë 26.07.2023.

5. Në dosje nuk ka as një vlersim mbi punen e kryer çdo punonjes, dhe dokumenti i largimit nga pozicioni që ka kryer si punonjes në Policinë bashkiake në kundërshtim me të ligjit 8224 datë 15.05.1997 dhe (neni 6 dhe 16) VKM 452, datë 26.07.2023.
6. Në protokollin e Bashkisë Këlcyrë nuk ndodhet pezullimi nga puna ose urdheri i pezullimit, si dhe kërkesa për largim nga puna, pasi punonjisi është larguar pa lenë as një dokument dhe dorzim të detyrës.

Veprime në kundërshtim me ligji nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë të Bashkisë dhe të Komunës” (I ndryshuar); si dhe VKN nr.452, datë 26.07.2023 Regullore e Policisë Bashkiake, për sa me sipër mos mbajtja e dokumentacionit në dosje përkatse të punonjësve të administratës mban përgjegjësi Nen/Kryetari i Bashkisë R. A.

Në aktivitetin e vitit 2023 nga Policia Bashkiake rezulton se janë mbajtur 7 ( akt kostatime) kryesisht në subjektet e mbyllura dhe subjekte debitore dhe në 3 raste përshkruhet se janë larguar në emigracion ndërsa në 4 raste për subjektet debitore, në akt kostatimet shkruhet se “Nuk kanë shlyer detyrimet dhe do ti shlyejnë në vitin 2023 ose brenda 3 mujorit ” pra theksojme se nuk ka vijueshmëri e ndjekje të problematikës së debitorve, nuk ka të bashkëgjatur në akt kostatim vlerë në detyrimet dhe mandat pagesën e detyrimit të krijuar, pra tregon formalizem në detyrën funksjonale si të Policisë Bashkiake dhe punonjësve të tatimeve pa nxjerre një urdher nga titullari i detyrës.

Nga verifikimet e me zyrën e finances rezulton se përsëri janë debitore subjektet të cilëve ju është dhënë afati dhe nuk janë rrikontrolluar persëri, subjekti B.M nuk ka likuiduar detyrimin në vlerën 17,537 lekë, subjekti G.RR nuk ka likuiduar detyrimin në vlerën 21,012 lekë, subjekti A.K nuk ka likuiduar detyrimin në vlerën 133,176 lekë, subjekti B.A në vlerën 68,504 lekë për, pra këtyre subjekteve ju është mbajtur Akt kostatimi nga Inspektori i Tatim Taksave M.Ç dhe I.K në prani të punonjësve të Policisë Bashkiake nga E.L .

Gjithashtu kostatojme se gjatë vitit 2023 Policia Bashkiake nuk është paisur me proces verbale për të kryer funksionimin e detyrës dhe me uniformë të saj dhe gjatë vitit ushtrimor nuk ka mbajtur as një proces verbale nga policia bashkiake për shkëmbimin e ligjit ,në kundërshtim me (nenin 3) të VKM nr 452 ,datë 26.07.2023.

*Zyra e Protokollit e Bashkisë Këlcyrë funksionimi dhe administrimi i dokumentave i të gjitha shkresave, ankesave, informacioneve që kërkojnë nga institucionet e ndryshme, urdhërave, etj .*

Nga marrja e informacionit nga Zyra e protokollit, mbi ankesat e qytetarëve dhe problemeve të ndryshme të kostatuara në Bashkinë Këlcyrë kostatohet se në librat e protokollit nuk janë mbushur sipas formatit të dukur, nuk përshkruhen veprimet sipas kolonave me të gjitha modalitetet përkatse dhe në ankesat e bëra, nuk shkruhet kujt i adresohet ankesa, dhe kthimi i përgjigjes me datat përkatse, e cila kostaton mos evidentimin e çështjeve në Bashkinë Këlcyrë. Sipas kontrollit të librit të vitit 2023 me nr. protokollit 2709 dhe mbaron me nr. protokollit 2990 kostatohet se libri i pa sekretuar me numrin e faqeve të librit dhe mbarimin e tij, nga 281 shkresa të ardhura dhe të protokoluara rrezulton se **132 shkresa të protokolluara, nuk kanë plotësuar kollonat përkatse, nuk kanë adresën e sektorit përkatës dhe nuk kanë përgjigjen e shkresës përkatse, veprime në kundërshtim me ligjin nr.9154, datë 06.11.2003”Për arkivat“** për sa me sipër mban përgjegjësi protokollistja E.SH .

*Në as një rast nuk na u paraqiten urdhera të dala nga titullari delegimin e tyre dhe bashkëpunim me sektorin e Urbanistikës pasi Inspektariat të Kontrollit të territorit dhe Policinë Bashkiake, sektori i Tatim Taksave Vendore pra nuk ka bashkëpunim me sektoret dhe nuk dokumentohet si kanë funksionuar këta sektore për urdherat e shkresat e ardhura në protokollin e Bashkisë Këlcyrë dhe Komunitat.*

*Për sa me sipër mbajnë përgjegjësi punonjësit E.L me detyrë Policia Bashkiake, A.P me detyrë ish/Policia Bashkiake, E. Sh. me detyrë Përgjegjëse e Zyrës Protokollit, R.A nën/Kryetar i Bashkisë dhe Përgjegjës i Kulturës e Sportit, M.Ç me detyrë Specialist i Taksave dhe Tatimeve, I.K me detyrë Specialist i Taksave dhe Tatimeve.*

Titulli i Gjetjes: Policia Bashkiake Këlcyrë nuk ka strukturë të plotësuar në këtë sektor për vitin 2023.

Situata: Nga auditimi rezultoi se Bashkia Këlcyrë nuk ka krijuar në strukturën e saj Policinë Bashkiake, duke mos garantuar ruajtjen kontrollin e territorit dhe zbatimin e ligjshmërisë dhe standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë të Bashkisë dhe të Komunës” (I ndryshuar); si dhe VKB nr.452, datë 26.07.2023 Rregullore e Policisë Bashkiake.

Mos ekzistenca e Policisë Bashkiake ndikon direkt në zhvillimin jo të duhur të sipërfaqes që zotëron kjo bashki pasi i jep mundsi abuzivizmit të shkeljeve të ligjit nga qytetaret e pandërgjegjësuar.

Për këtë anomali ka përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Z. K.N .

**Shënim:** Në auditimin e ushtruar në Bashkinë Këlcyrë, nga ana e grupit të auditimit të KLSH nuk janë audituar ose janë audituar jo plotësisht **nënpika 2.6 e programit** (burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve), **pika 5 e programit** (mbi organizimin dhe funksionimin e strukturës së planifikimit dhe zhvillimit të territorit) dhe **nënpika 4.4** (mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike), të cilat do të jenë objekt i auditimit të radhës.

#### IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konstatohet se nga Bashkia Këlcyrë, nuk është zbatuar ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, *konkretisht:*

- Nuk është ngritur një sistem efektiv i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, dhe ka mangësi të plotë të rregullave të shkruara për funksionimin e institucionit.

- Në strukturën organizative pavarësisht se është përcaktuar pozicioni i punës së Përgjegjës të zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Juristit, ky pozicion rezulton të jetë vakant për gjithë periudhën e audituar, ndërkohë që nuk ka asnjë shpallje për vend të lirë pune. Situata e njëjtë edhe për përgjegjës të zyrës IT.

- Nuk ka hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre, në kundërshtim me pikën 8 të ligjit të MFK.

- Nuk është hartuar, miratuar dhe arkivuar harta (lista) e proceseve të punës, si dhe gjurma e auditimit për këto procese. Nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kreu III, paragrafi 3.1

- Nuk janë kryer trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS- n), si dhe nuk rezulton asnjë dokumentim i mbledhjeve të kryera nga GMS, në kundërshtim me Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 ‘Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike.’
- Nuk ka hartuar një strategji risku, në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit nr. 10296 për MFK.
- Nuk është miratuar gjurma e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK.
- Nga ana e nëpunësit autorizues, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut dhe dokumentimin e tij, si dhe nuk janë regjistruar dhe raportuar masat e marra për parandalimin e këtyre fenomeneve.
- Nga auditimi i dosjeve të punonjësve u konstatua se, nuk ishte nënshkruar kontrata e punës, siç përcaktohet nga Kodi i Punës, por ishte mjaftuar vetëm me Urdhrin e emërimit të nxjerrë nga Titullari.
- Një numër i konsiderueshëm punonjësish, kanë rregulluar marrëdhënien e punës sipas dispozitave të Kodit të Punës, ndërkohë që pozicionet e tyre të punës, evidentohen si pozicione me status “Nëpunës Civil” dhe për rrjedhojë rekrutimi i tyre është bërë në kundërshtim me ligjin.
- Nuk ka plotësuar me numrin e duhur të punonjësve strukturën e Policisë Bashkiake duke mos garantuar ruajtjen kontrollin të territorit dhe zbatimin e ligjshmërisë, në kundërshtim me ligjin nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë të Bashkisë dhe të Komunës” i ndryshuar dhe me VKM nr. 452, datë 26.07.2023 “Rregullore e Policisë Bashkiake“ (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.1 , faqe 16 - 22 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Këlcyre, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues, si dhe Kryetarit të GMS-së, duhet të marrë masa të menjëhershme për:

- Hartimin e një kuadri të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përshkrimit të tyre detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësive dhe të drejtave të punonjësve të njësisë.
- Plotësimin e pozicioneve vakante si: Përgjegjës i zyrës së Burimeve Njerëzore, pozicionin e Juristit të njësisë, përgjegjës i zyrës IT, specialisti i buxhetit, si pozicione të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit në mënyrë ligjore.
- Hartimin dhe plotësimin e gjitha dosjeve të punonjësve me kontratën individuale të punës, konform përcaktimeve të “Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë”.
- Rregullimin e pozicioneve të punës për punonjësit të cilët sipas ligjit, duhet të trajtohen si “Nëpunës Civilë”, bazuar në ligjin “Për statusin e nëpunësit Civil”, por që janë trajtuar si punonjës bazuar në “Kodin e Punës”, si dhe të njoftojë DAP për procedurat e konkurrencës, duke zbatuar procedurat e përcaktuara në ligjin për Nëpunësin Civil.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2024**

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi hartimin dhe funksionimin e strukturës organike të Bashkisë Këlcyrë, nuk gjejmë të pasqyruar strukturën e Auditit të Brendshëm (AB), kjo për mungesë të specialistëve si dhe nuk ka lidhur aktmarrëveshje me bashkitë kufitare për kryerjen e këtij shërbimi, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, shkronja (c), si dhe nenit 64, shkronja (a) të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, pikat 3 dhe 6, te VKM nr. 83, datë 3.2.2016, pika 6 shkronja (a). (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.1 , faqe 16 - 22 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

## **2.1 Rekomandimi:**

Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, të marrë masa për ngritjen dhe miratimin në strukturën organizative të Bashkisë Këlcyrë, Njësinë e Auditit të Brendshëm për kryerjen e funksioneve kontrolluese të veprimtarisë ekonomike financiare të kësaj njësie vendore. Në rast të mos plotësimit të kësaj strukturë me personel të kualifikuar, të shikohet mundësi e lidhjes së aktmarrëveshjes me bashkitë kufitare për kryerjen e këtij shërbimi.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2024*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të marrë pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore rezultoi se, rekrutimi i punonjësve pozicioni i të cilëve korrespondon me status të nëpunësit civil nuk është kryer në zbatim të ligjit nr. 152/2013, datë 17.10.2013, "Për nëpunësin civil" i ndryshuar.

Konkretisht, nga 41 vende pune me statusin e nëpunësit civil, asnjë punonjës nuk ka statusin e nëpunësit civil. Vendet që i korrespondojnë pozicionit të nëpunësit civil janë plotësuar me punonjës të cilët nuk i përkasin kategorisë së vendeve por thjeshtë janë punësuar për të plotësuar numrin e punonjësve i cili është miratuar me Vendimin nr. 36 të Këshillit Bashkiak, datë 30.11.2022, "Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Këlcyrë, e njëjste në varësi dhe caktimin e kufijve të pagave e shpërblimeve të funksionarëve të zgjedhur dhe emëruar, të nëpunësve civil e punonjësve administrative të njëjste të vetëqeverisjes vendore për vitin 2023". (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2 , faqe 22 - 49 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

**3.1 Rekomandimi:** Drejtorja e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Këlcyrë të marrë masa për rekrutimin e punonjësve dhe plotësimin e vendeve vakante sipas detyrave funksionale nëpërmjet shpalljeve në Shërbimin Kombëtar të Punësimin.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2024*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi programimin e planit afatmesëm të buxhetit dhe atij vjetor për vitin 2023 paraqiten këto mangësi:

- Nuk është bërë analiza dhe monitorimi i buxhetit çdo 4-mujor gjatë vitit 2023.  
- Raportet e monitorimit nuk janë diskutuar dhe miratuar në Këshillin Bashkiak, dhe nuk janë dërguar në Ministrinë e Financave brenda afateve ligjore, sipas kërkesave të shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe shtojcës 5 "Treguesit monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të UMFE nr.22 datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde monitorimit buxhetit njëjste vetëqeverisjes vendore", si dhe nuk janë të plota me të gjitha anekset, sipas kërkesave të ligjit 68/2017 "Për Financat Vetëqeverisjes Vendore", neni 48 dhe Udhëzimit 22 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde monitorimit buxhetit njëjste vendore", pika 10, 12, 28, 29, 48.

- Ka mungesë dokumentacioni për dëgjesat publike me komunitetin dhe grupet e interesit (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2 , faqe 22 - 49 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

**4.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë në bashkëpunim me sektorin e Buxhetit, për hartimin e PBA dhe buxhetit vjetor, më parë të kryej konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit, njësitë administrative etj duke dokumentuar në çdo rast këto konsultime.

- Të marrë masa për plotësimin e raporteve të monitorimit me të gjitha anekset e domosdoshme për justifikimin e veprimtarisë.

- Të kryej analizën dhe monitorimin e buxhetit çdo 4-mujor duke i kaluar për miratim në Këshillin Bashkiak.

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i shpenzimeve të buxhetit të Bashkisë Këlcyrë për 2023, rezultoi se:

- Shpenzimet për karburant për automjetet e bashkisë shoqërohen me fletudhëtime, me përjashtim të mjetit teknologjik të pastrimit, për të cilin nuk janë mbajtur fletudhëtime, për pasojë nuk ka dhe rakordime përkatëse nga sektori i shërbimeve që mbulon pastrimin e qytetit, për efekt të justifikimit të karburantit.

- Sektori i shërbimeve të Bashkisë Këlcyrë paraqet mangësi në dokumentacionin justifikues së pagesave të kryera për punëtorët e normuar (56 punëtorë të normuar), lidhur me riparimin e rrugëve rurale dhe pastrim-gjelbërimin e qytetit.

Shpenzimet për pastrimin e gjelbërimin e qytetit nuk disponojnë dokumentacion të plotë, pasi mungojnë procesverbalet ditore për cilësinë e shërbimeve sipas zërave pastrimit, për pasqyrimin e vërejtjeve, për pasqyrimin e ditëve me shi, për zbritjen e zërave të fshirjes të sipërfaqeve të rrugëve të zëna nga rikonstruksionet e vitit 2023.

Veprime në kundërshtim me rregulloren e brendshme të bashkisë dhe me UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” si dhe me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2, faqe 22 - 49 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

**5.1 Rekomandimi:** Kryetari i bashkisë në bashkëpunim me përgjegjës të shërbimeve të marrë masa për:

- Një shpërndarje të drejtë të karburantit sipas sektorëve të bashkisë Këlcyrë, referuar nevojave që ato paraqesin, ku nga këto të fundit të argumentohet lëvizja e tyre me dokumentacion ligjor. Në çdo rast fletudhëtimet duhet të shoqërohen me autorizim të nëpunësit autorizues, ku të specifikohen arsyeja e lëvizjes dhe sasia e karburantit. Nga personi përgjegjës të hartohen dhe bashkëlidhen fletudhëtimet PV mbi shërbimin e kryer dhe të nënshkruhen nga personi përgjegjës që merr karburantin.

- Të ngrejë një grup pune për monitorimin e kontratës dhe në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të verifikojë punët e kryera në terren, bazuar kjo në volumet e punëve faktike, në raport me numrin e punëtorëve dhe mjeteve të angazhuara në fakt, sipas akteve të mbajtura për këtë qëllim, si dhe vetëm mbi bazën e këtyre akteve të hartohet situacioni përkatës për likuidimin e kontratave.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Këlcyrë paraqet një detyrim ndaj të tretëve në fund vitit 2023 për vlerën 41,049,202 lekë, e cila u përket 3 faturave të pa likuiduara për investime, që i përket periudhave të prapambetura 2021-2023, konkretisht:

- ✓ fatura nr. 6/2021 datë 03.11.2021 për 5,889,346 lekë e subjektit H shpk, për “Rruga Goricë Podgoran Fushe etj”, nuk është likuiduar për një periudhë mbi 1 vit,
- ✓ fatura nr. 164/2021 datë 15.12.2021 për 1,879,632 lekë e subjektit “SH ” shpk, për “Sistemim asfaltim ura Mbrazh - Maleshove”, nuk është likuiduar mbi 1 vit,
- ✓ fatura nr. 8/2023 datë 12.01.2023 për 33,280,224 lekë e subjektit “SH ” shpk, për “Sistemim asfaltim ura Mbrazh - Maleshove”, nuk është likuiduar për 1 vit.

Pra, Bashkia Këlcyrë nuk ka shlyer detyrimet ndaj subjekteve në afatin e duhur prej 30-60 ditë, në kundërshtim me UMF 5 datë 27.12.2014 “Për shlyerjen detyrimeve prapambetura”, me Udhëzimin plotësues pikat 82-91 si dhe me nenin 52 të ligjit nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për

*menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar. Sqarojmë se: Bashkia Këlcyrë ka përfshirë në buxhetin e vitit 2024-2025 shlyerjen e plotë të detyrimeve të prapambetura prej 41,049,202 lekë, bazuar në udhëzimin e MFE nr. 37 date 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin e detyrimeve të prapambetura”.*

*(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2 , faqe 22 - 49 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

**6.1 Rekomandimi:** Kryetari i bashkisë në bashkëpunim me sektorin e financës të njoftojë Ministrinë e linjës për miratimin e fondeve, sipas grafikut të miratuar në fillim të projektit, kjo për të mundësuar likuidimin në afat të 3 faturave me vlerën 41,049,202 lekë.

***Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2024***

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i sektorit taksave vendore Bashkia Këlcyrë, rezultoi se:  
- **10 subjekte rezultojnë pa leje ose NIPT** pranë degës së tatimeve dhe ndaj tyre nuk ka bllokime nga policia bashkiake (*ndërsa ka njoftim në adresë të DRT Gjirokastrë*), në kundërshtim me Kreun XI-Mbledhja me forcë detyrimit tatimor papaguar, të ligjit 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, ndryshimet dhe Udhëzimit 24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, me ndryshime; ligjin nr. 7895 datë 27.01.1995, “Kodi Penal i RSH”, ndryshuar neni 15 dhe 181 Mospagimi i taksave dhe tatimeve, apo të parashikimit vendimeve gjobave, përcaktuar në nenin 46 ligjit “Për Kundërvajtjet Administrative”.

- **Në 5 raste, u konstatua tejkalim i afatit ligjor nga 1 vit deri 3 vjet në pagesën e qirasë së tokës** bujqësore, për të cilat **nuk janë aplikuar penalitete** për vlerën **15,180 lekë**, në kundërshtim me kërkesat e nenit 2/a, e nenit 6 “sanksione” të kontratave përkatëse, konkretisht: R.H 5,400 lekë, A.A 900 lekë, F.A 4,500 lekë, T.A 1,500 lekë dhe G.B 2,880 lekë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.2 , faqe 22 - 49 të Raportit Përfundimtar të auditimit).*

**7.1.Rekomandimi:** Kryetari i bashkisë Këlcyrë në bashkëpunim me sektorin e taksave dhe tarifave vendore të marrë masa:

- Për regjistrimin e 10 subjekteve fizike pranë DRT Gjirokastrë dhe të vjele detyrimet e taksave.  
- Për ndalesën e vlerës 15,180 lekë penalitete në 5 raste, për tejkalim afatit ligjor në pagesën e qirasë së tokës bujqësore.

***Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2024***

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultojë zbatim i pjesshëm i VKM nr. 500, datë 14.08.2001 *Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.*

- Konkretisht për 3 (tre) pronat që mbajnë statusin “*në përdorim*” mungon mbajtja e korrespondencës me ASHK për të vijuar procedurat për kalim në pronësi, lista e inventarit, plan rilevimi i tokës, relacioni shpjegues dhe konfirmimi nga ASHK.

Sa më sipër në kundërshtim me pikën nr. 10, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

Gjithashtu, periudha e hyrjes dhe regjistrimit të aseteve në aktivet e Bashkisë Këlcyrë është shumë e largët në krahasim me periudhën aktuale. Gjatë kësaj kohe nga ana e institucionit nuk janë kryer rivlerësime të aseteve me qëllim përafrimin e vlerës kontabël me vlerën aktuale të tregut për aktivin në moszbatim të SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale”, Paragrafi “Trajtimet kontabël për aktivet afatgjata materiale”, pika 23-32 “Modeli i rivlerësimit”.



- Bashkia Këlcyrë për vitin 2023 nuk ka aplikuar dhe nuk ka pajisur me certifikatë pronësie pronat e paluajtshme brenda territorit të juridiksionit të saj, pranë ASHK Përmet, përkatësisht: Bashkia Këlcyrë 197 prona, Njësia Administrative Suke 274 prona, Njësia Ballaban 170 prona dhe Njësia Dishnice 310 prona, në kundërshtim me Ligjin nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësit e qeverisjes vendore” neni 18, me Ligjin nr. 20/2020 “Për Kadastrën”, neni 43 “tarifat e regjistrimit për institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore” pika 1 dhe 2 , e cila favorizon regjistrimin e pronave shtetërore me shërbime të reduktuara, me UMF 30 datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin aktiveve në njësitë publik” pikat 37, 42, 60, 74, me ligjit 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar e Kontrollin”, me pikat 20, 21, 22 .
- Pyjet e kullotat nuk janë pasqyruar në kontabilitet, pra llogaria nr. 211 “pyjet, kullotat dhe plantacione” nuk pasqyrohet në aktiv të bilancit kontabël dhe nuk ka aplikime në ASHK Gjirokastrë për regjistrimin dhe pajisjen e tyre me certifikate pronësie (*Më hollësisht trajtuar në faqe 51 - 73 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

#### **8.1 Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë,

- Të ngrëjë grup punë për përgatitjen e dokumentacionit teknik të aseteve në pronësi dhe përdorim për të mundësuar në këto kushte regjistrimin e pronave pranë ASHK, më tej të reflektoj ndryshimet në llogarinë 212 “ndërtime e konstruksione”.
- Të marr masa që aktivet afatgjata të rivlerësohen me vlerën aktuale në mënyrë që pasqyrat financiare të japin një pamje të plotë dhe reale të aktiveve që ky subjekt disponon.
- Të kryej regjistrimin dhe pajisjen me certifikata pronësie të pronave të saj, sipas llojit tyre, duke bashkëpunuar me institucionet tjera dhe ASHK Përmet.
- Të kryej pasqyrimin në kontabilitet të llogarisë 211 “pyjet, kullotat dhe plantacione” dhe të aplikojë në ASHK për regjistrimin dhe pajisjen e tyre me certifikate pronësie.

### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultojë mungesë e gjurmës dokumentare justifikuese të llogarisë 202 “studime dhe projektme” si dhe mungesë e një liste analitike të përbërjes së tyre në mënyrë që vlera e paraqitur në pasqyrat financiare të jetë e mbështetur në dokumentacionin vërtetues.

- Të tre këto studime janë jetësuar por vijojnë të mbahen në llogarinë 202 “studime dhe projektme” pa kryer veprimet tranzitore rregulluese nëpër llogaritë përkatëse.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e qëndrueshme të pa trupëzuara” Pika 1/b “Klasifikimi kontabël”.

Për të tre këto studime vijon të llogaritet amortizim, ku rezulton problematik lidhur me normën e përdorur, pasi në disa raste përdoret norma 25% dhe në disa raste të tjera norma 20%, në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr.8 datë 9.3.2018 pika 36 e tij dhe VKM nr. 401, datë 23.10.1989 Kreut III, pika 3.7.2 “Normat e amortizimit sipas grupeve”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3 , faqe 49 - 70 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

#### **9.1 Rekomandimi:** Sektori i Financës Bashkia Këlcyrë të marrë masa si vijon:

- Të plotësojë me listë analitike të detajuar llogarinë studime dhe projektme, të vijohet me

kryerjen e veprimeve rregulluese lidhur me llogaritjen e drejtë të amortizimit e më tej pasqyrimin në bilancin kontabël.

- Në këtë listë të vendosen vetëm projektet dhe studimet për investimet e pa përfunduara dhe të pa marra në dorëzim nga Bashkia Këlcyrë.

- Për rastet kur investimi ka përfunduar, të kalohet vlera e projektit në vlerën e investimit, duke u paksuar me vlerën e projektit llogaria 202 “Studime dhe Kërkime”.

#### ***Me mbylljen e pasqyrave viti 2024***

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2023 rezultoi se, llogaria 4342 “*Të tjera operacione me shtetin*” nuk kuadron me kundër partin e vet për vlerën 28,453,410 lekë, si rrjedhojë rezulton të jetë e nënvlerësuar për këtë vlerë.

Kjo llogari është kundër parti e shumës së llog.401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*”, llog.42 “*Detyrime ndaj personelit*”, llog.431 “*Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa*”, llog.435 “*Sigurime shoqërore*” dhe llog. 436 “*Sigurime shëndetësore*”, dhe nuk rakordon me to për vlerën 28,453,410 lekë. (Llog.401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” për vlerën 28,453,410 lekë, llog.42 “*Detyrime ndaj personelit*” për vlerën 6,153,280 lekë, llog.431 “*Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa*” për vlerën 201,001 lekë, llog.435 “*Sigurime shoqërore*” për vlerën 2,170,594 lekë, llog. 436 “*Sigurime shëndetësore*” për vlerën 0 lekë).

Sa më sipër operuar në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr.8 datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” pika 32 e tij (i ndryshuar). (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3 , faqe 49 - 70 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

**10.1 Rekomandimi:** Sektori i Financës Bashkia Këlcyrë të marrë masa për sistemimin në kontabilitet të llogarisë 4342 “*Të tjera operacione me shtetin*”, në mënyrë që kjo llogari të paraqesë vlerën e saktë në pasqyrat financiare.

#### ***Me mbylljen e pasqyrave viti 2024***

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se, për Bashkinë Këlcyrë nuk rezulton i hartuar regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Operuar në kundërshtim me Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, kapitulli III “*Regjistri i aktiveve*.”

(*Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3 , faqe 49 - 70 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

**11.1 Rekomandimi:** Sektori i Financës Bashkia Këlcyrë të marrë masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e s’ kadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

#### ***Menjëherë***

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se referuar detyrimeve të prapambetura llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” e cila pasqyrohet në bilancin kontabël në vlerën 29,234,563 lekë dhe përbëhet nga detyrimet që 73 persona e subjekte kanë ndaj Bashkisë Këlcyrë. Nga ana e Bashkisë Këlcyrë përpjekjet për arkëtimin e shumave kanë qenë të

pamjaftueshme dhe jo rezultative për arkëtimin e tyre duke i lënë të kalojë në debitorë pa shpresë arkëtimi.

Në totalin e këtyre detyrimeve, detyrimet që KLSH ka lënë nga auditimet e ndryshme të zhvilluara janë në vlerën 22,122,211 lekë ose 75.6% e totalit të detyrimeve.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21 dhe 33 dhe me ligjin 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi Procedurave Administrative në RSH” nenet 98 dhe 102. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3 , faqe 49 - 70 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

**12.1 Rekomandimi:** Sektori i Financës Bashkia Këlcyrë në bashkëpunim me Sektorin Juridik të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e drejtave të arkëtueshme (debitorët) për vlerën 29,234,56 lekë, deri në finalizimin e arkëtimit të këtyre vlerave.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2024**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se, lidhur me inventarizimin e aktiveve Sektori i Financës për vitin 2023 nuk ka kryer inventarizimin fizik të pasurisë të institucionit, njësisë administrative, gjendjeve civile, shkollave, kopshteve, etj, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2011, kreu IV, “Sistemi i Kontrollit periodik të aktiveve”, pika 73 dhe 74 e tij duke mos kryer procesin e inventarizimit.

Si rezultat, gjendja e të dhënave kontabël në pozicionin financiar të vitit 2023, nuk është rakorduar me gjendjen fizike dhe nuk arrijmë të japim dot siguri të arsyeshme mbi pohimet e nevojshme që lidhen me saktësinë e vlerave të aktiveve. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.3 , faqe 49 - 70 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

**13.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Sektorin i Financës Bashkia Këlcyrë të marrë masa për të iniciuar procedurat e inventarizimit të Aseteve të njësisë dhe çdo aktiv tjetër që ky Institucion disponon/zotëron. Të kryhet rakordimi i gjendjes fizike me gjendjen kontabël në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së aktiveve të njësisë.

**Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2024**

#### **14. Gjetje nga auditimi:**

*Nga Bashkia Këlcyrë për vitin 2023 janë realizuar 3 procedura me vlerë të lartë me fond limit 96,966,398.1 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 116,290,160.2 lekë. Sipas materialiteti nga grupi janë vlerësuar për auditim 3 procedura me vlerë të fondit limit 96,966,398.1 lekë pa TVSH lekë dhe vlerë kontrate 116,290,160.2 lekë me TVSH , nga ku ka rezultuar se:*

- Në dy procedurat e prokurimit me objekt: “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”; “Rikonstrukcion shkolla 9 vjeçare Kamber Bënja, Këlcyrë”) rezulton se, në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, hartuar nga njësia e prokurimit, kriteret e kapacitetit teknik nuk janë të argumentuara nga ana teknike, në kundërshtim me neni 2, pika 2, germa (c); neni 39 pika 6 germa ç, neni 78 pika 1 dhe 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

- Në tre procedurat e prokurimit me objekt: “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”; “Karburant për automjetet”; “Rikonstrukcion i shkollës 9 vjeçare Kamber Bënja”), rezultojë se, në kriteret e veçanta të DT, seksioni i kapacitetit teknik, kualifikimi është kryer pa kërkuar paraprakisht shpjegime mbi mangësitë në plotësimin e kriterëve, në kundërshtim me nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin

publik” dhe nenin 82, pika 2, paragrafi IV, të VKM nr.285, datë 23.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

- Në procedurën me objekt: “Rikonstrukcion shkolla 9 vjeçare Kamber Bënja, Këlcyrë”, rezultojë se, procesverbali i hartuar nga ana e komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike është hartuar në kundërshtim me nenin 76 pika 2 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar. Operuar në kundërshtim të plotë me pikën 3, të nenit 76 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

- Nga verifikimi i dokumentacionit në dosjen fizike dhe SPE për procedurën e prokurimit “Blerje karburant për automjetet” rezultuan parregullsi në dokumentet e tenderit, si:

- Për përlllogaritjen e fondit limit kanë marrë pjesë 2 nga 3 anëtarët e njësisë së prokurimit pa përgjegjësin e njësisë, në kundërshtim me neni 78, pika 2 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

- Prania e dy Urdhrave të ndryshëm prokurimi me vlera të ndryshme;

Procesverbali argumentues mban datën 09.02.2023, pra është hartuar pas nxjerrjes së U.P të parë i cili ka dhe fondin limit të përcaktuar që është marr si referencë në vijim. Sa më sipër, operuar në kundërshtim me pikën 2, të nenit 76 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4 , faqe 70 - 127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

#### **14.1 Rekomandimi:**

- Bashkia Këlcyrë, të marrë masat e nevojshme në vijimësi, në zhvillimin e procedurave të prokurimit të argumentojë teknikisht dhe ligjërishit kriteret e vendosura, si dhe kriteret e veçanta për kualifikim në DT të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të vlerësojë si të vlefshme dhe të kualifikojë një ofertë vetëm kur ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit që autoriteti kontraktor ka vlerësuar të nevojshme.

#### ***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje karburanti për automjetet”, është konstatuar se kriteri për shpalljen e ofertës fituese “oferta me çmim më të ulët fiks”, është një kriter i përcaktuar në mënyrë të gabuar, në kundërshtim me nenin 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenin 45 pika 2.1 të VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4 , faqe 70 - 127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**15.1 Rekomandimi:** Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të vlerësojë si të vlefshme dhe të kualifikojë një ofertë vetëm kur ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit që autoriteti kontraktor ka vlerësuar të nevojshme.

#### ***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se AK Bashkia Këlcyrë për vitin 2023 për dy procedura prokurimi janë caktuar si anëtar të njësisë së prokurimit dhe njëkohësisht persona përgjegjës për prokurimin dy punonjës të cilët nuk janë pjesë e strukturës organizative të bashkisë.

Kështu për procedurën “Blerje karburanti për automjetet” është kontraktuar **Znj. F.S** , e cila sipas të dhënave të Bashkisë Këlcyrë, është punonjëse me kohë të plotë e Bashkisë Tiranë.

Për këtë qëllim në datën 05.01.2023 është lidhur aktmarrëveshje midis Bashkisë Këlcyrë dhe **Znj. F.S** , pa numër protokolli. Aktmarrëveshja midis Bashkisë Këlcyrë dhe **Znj. F.S** nuk është një marrëdhënie midis dy institucioneve, pasi nuk paraprihet nga aktmarrëveshja prej tyre, por marrëveshje midis një individi (të cilit për arsye se është i punësuar me kohë të plotë pranë Bashkisë Tiranë, nuk i lejohet të kryej detyra të tjera jashtë këtij institucioni pa autorizimin dhe miratimin e titullarit të Bashkisë Tiranë, brenda orarit zyrtar të punës) dhe Bashkisë Këlcyrë.

- Detyrat e përcaktuara në pikën 3 të nenit 74 të VKM nr.285 dt.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, personi përgjegjës për prokurimin nuk mund ti kryej dot, pa miratimin e titullarit të institucionit ku punon, pasi kryerja e tyre kërkon kohën e nevojshme në dispozicion, kërkon angazhim konkret brenda orarit të punës dhe brenda institucionit të Bashkisë Këlcyrë. Me Bashkinë Tiranë, kjo gjë vështirësohet akoma më shumë për shkak të distancës midis dy institucioneve.

Për procedurën “*Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare Kambër Bënja, Këlcyrë*” është caktuar si anëtar i njësisë së prokurimit dhe person përgjegjës **Z. E.A** .

Nga ana e Bashkisë Këlcyrë nuk argumentohet e as justifikohet punësimi/kontraktimi i këtij personi, pasi ky institucion nuk ndodhet në kushtet e mungesës së stafit për përcaktimin e personit përgjegjës për prokurimin dhe caktimin e njësisë së prokurimit.

- Në të dy rastet, nga Bashkia Këlcyrë nuk plotësohen kushtet për marrjen të një personi nga një autoritet tjetër kontraktor, për aq kohë sa Bashkia Këlcyrë ka në strukturën e saj personel me arsim të lartë për kryerjen e kësaj detyre, të cilët më parë duhet të trajnohen prej saj.

Edhe pse kuadri ligjor në fuqi ka bërë parashikimet e mësipërme, nevoja për marrjen e një personi nga një autoritet tjetër kontraktor, në të dy rastet, nuk është e argumentuar nga Bashkia Këlcyrë, pasi ky institucion nuk ndodhet në kushtet e mungesës së stafit për përcaktimin e personit përgjegjës për prokurimin dhe caktimin e njësisë së prokurimit

Në të dy rastet, procedura e ndjekur për kontraktim është e gabuar. Bashkia Këlcyrë nuk i është drejtuar me shkresë zyrtare asnjë autoriteti kontraktor, (pra as Bashkisë Tiranë) në mënyrë që ky institucion të përcaktojë personin e kërkuar nga Bashkia Këlcyrë. (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4 , faqe 70 - 127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**16.1 Rekomandimi:** Në rastet e tenderave që do të kërkojnë njohuri të specializuara, Bashkia Këlcyrë të kërkojë staf të specializuar nga autoritete/ente të tjera kontraktore ose të punësojë ekspertë të jashtëm, duke ndjekur procedurat e duhura ligjore.

*Menjëherë e në vijimësi*

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi publikimin e njoftimit të fituesit në SPE për procedurën “*Karburant për Automjetet*”, rezultojë moszbatim korrekt i afateve kohore, duke publikuar fituesin me 2 ditë vonesë, në kundërshtim me nenin 97, pika 1 e LPP 162/2020 “Për prokurimin publik”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4 , faqe 70 - 127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**17.1 Rekomandimi:** Titullari i AK në bashkëpunim me personin personi përgjegjës i prokurimit në Bashkinë Këlcyrë, të marrë masa që të hedh në sistemin e prokurimit elektronik të dhënat në kohë reale dhe brenda afateve ligjore të përcaktuara në aktet rregullatorë mbi procedurat e prokurimit publik.

*Menjëherë e në vijimësi*

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultojë se, Bashkia Këlcyrë nuk ka hartuar plan të monitorimit të zbatimit të kontratës dhe nuk ka përcaktuar person apo grup pune për monitorimin e zbatimit të kontratës, për të gjitha kontratat e lidhura si rezultat i zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, për mbikëqyrjen e veprimtarisë së kontraktorit, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë dhe legjislacionin në fuqi, për çështjet organizative të kontratës, afatet, çështjet ekonomike teknike etj. Në kundërshtim me nenet 124 dhe 125 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik “dhe neni 107 i VKM 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4 , faqe 70 - 127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**18.1 Rekomandimi:** Titullari i Autoritetit Kontraktor Bashkia Këlcyrë, të marrë masa që për çdo kontratë të lidhur me operatorët ekonomik në fushën e prokurimit publik, të hartojë plan të monitorimit të zbatimit të kontratës dhe të përcaktojë personin apo grupin e punës për monitorimin e zbatimit të kontratës.

*Menjëherë e në vijimësi*

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjeve të procedurave të prokurimit, rezulton se, të gjitha dosjet fizike të prokurimit, të cilat ndër të tjera përmbajnë procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj, nuk janë të pajisura me inventarin e brendshëm të dosjes. Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara mbartin riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit. Nga ana e AK është operuar në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Ligji nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”, Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë. (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4 , faqe 70 - 127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**19.1 Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës për prokurimin) të marrë masa për inventarizimin e të gjithë dokumentacionit në lidhje me procedurat e sipërcituara, duke dokumentuar të gjithë procesin në rend kronologjik, sikurse kërkohet nga normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në RSH.

*Menjëherë e në vijimësi*

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në sistemin e-leje të ndërtimit rezulton se, leje ndërtimi datë 26/06/2023 i jepet: Leje ndërtimi zhvillimore e kompleksi blegtoral dhe ambiente shërbimi të kompleksit (stalla + hangarë) me sipërfaqe 1,952.8 m2 në fshatin Varibop për “Kompleks blegtoral dhe ambiente të kompleksit (stalle hangar)”.

Referuar preventivit të paraqitur mbi përshkrimin e punimeve rezulton se, hartimi i tij është nën koston e ndërtimit të miratuar nga Enti Kombëtar i Banesave, megjithëse objekti është i pa kualiduar dhe nuk ka mbaruar plotësisht objektin dhe nuk ka paraqitur Stacion përfundimtar, mbetet për verifikim sipas Udhëzimit Nr. 3 datë 28.12.2016 “Për Miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave” është 32,614 lekë/m2. (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr.5 , faqe 127 -130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**20.1 Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë dhe sektori i DPKZHT të marrë masa dhe të verifikojë preventivin e punimeve krahasuar me situacionin përfundimtar të punimeve, dhe për diferencën midis tyre të llogarisë taksën e infrastrukturës që duhet paguar nga subjekti.

## ***Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2024***

**21. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Këlcyrë për vitin 2023, sipas strukturës, mungon Sektori i Aseteve, nuk ka aplikuar dhe nuk ka pajisur me certifikatë pronësie pronat e paluajtshme brenda territorit të juridiksionit të saj, pranë ASHK Përmet, përkatësisht: Bashkia Këlcyrë ka 197 prona, Njësia Administrative Suke 274 prona, Njësia Ballaban 170 prona dhe Njësia Dishnice 310 prona sipas VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar Nga Bashkia nuk ka korrespondencë të rregullt me ASHK Përmet në 3 prona ka mungesë dokumentacioni dhe nuk kanë vlerësuar, vlerën e secilit aset, në kundërshtim me Ligjin nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” neni 18, me Ligjin nr. 20/2020 “Për Kadastrën”, neni 43 “tarifat e regjistrimit për institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore” pika 1 dhe 2, e cila favorizon regjistrimin e pronave shtetërore me shërbime të reduktuara, me UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë publik” pikat 37, 42, 60, 74, me ligjit 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar e Kontrollin”, me pikat 20, 21, 22 .

- Pyjet e kullotat nuk janë pasqyruar në kontabilitet, pra llogaria nr. 211 “pyjet, kullotat dhe plantacione” nuk pasqyrohet në aktiv të bilancit kontabël dhe nuk ka aplikime në ASHK Gjirokastrë për regjistrimin dhe pajisjen e tyre me certifikatë pronësie (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr.5 , faqe 127 -130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**21.1 Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë të marrë masa:

Bashkia Këlcyrë të ngrejë grup punë për përgatitjen e dokumentacionit teknik të asetëve në pronësi dhe përdorim për të mundësuar në këto kushte regjistrimin e pronave pranë ASHK-Përmet dhe pajisjen e tyre me certifikatë pronësie, të reflektojë ndryshimet në llogarinë 212 “ndërtim e konstruksione” dhe pasqyrimin në kontabilitet “pyjet, kullotat dhe plantacione” sipas ligjit.

## ***Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2024***

**22. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Këlcyrë nuk ka krijuar Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor, duke mos garantuar ruajtjen kontrollin e territorit dhe zbatimin e ligjshmërisë dhe standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, në kundërshtim me ligjin 107/2014 “Për planifikimin e territorit” , me ligjin 9780 “Për inspektimin e ndërtimit” Neni 4 “Përgjegjësitë e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës”, Neni 5 “Detyrat e inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës”, me rregulloren e brendshme nr.13 datë 25.02.2022 “Detyrat e Specialistit”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr.6 , faqe 130 - 132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**22.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Sektorin e Burimeve Njerëzore të marrë masa për krijimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, me qëllim garantimin e zbatimit të ligjshmërisë dhe standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe ndërtimet.

## ***Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2024***

**23. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në sistemin e-lejeve të ndërtimit rezulton se, në 3 (tre) raste në dhënien e lejeve të ndërtimit nuk është marrë mendim nga institucionet e duhura ligjore si AZHT, ASHK, UK si dhe Ministria e linjës, konkretisht sa vijon:

- Lejë ndërtimi datë 13.09.2023 me objekt “Rikonstruksion, shtesë anësore dhe mbi ngritje kati, banese 2 kat, plus bodrum“, me sipërfaqe 246 m<sup>2</sup>,
- Leje ndërtimi zhvillimore datë 26.06.2023 “kompleksi blegtoral dhe ambiente shërbimi të kompleksit (stalla + hangarë)”, me sipërfaqe 1,952.8 m<sup>2</sup>,
- Subjekti “E.H” ka aplikuar në Bashkinë Këlcyre sipas shkresës nr.1788, datë 07.08.2023 dhe kërkesën të dorëzuar elektronikisht me datë 11.09.2023, për biznes në fushën e Argo-turizmit “Akomodim, Shërbim Restorant “.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 21 “Shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi nga autoriteti vendor”, pika 6. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.6 , faqe 130 - 132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**23.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) dhe Bashkia Këlcyre të marrin të gjitha masat për të kërkuar dhe respektuar, në çdo rast që aplikohet për leje ndërtimi, mendimin e autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, me qëllim marrjen e sigurisë së plotë mbi konformitetin e objektit në zhvillim me kriteret, dispozitat, infrastrukturën si dhe projektet e planifikuara të këtyre autoriteteve.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**24. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Këlcyre, Sektori i Policisë Bashkiake dhe Sektori i të Ardhurave nuk ka marre masa të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të subjekteve në vitin 2023 , detyrime të vendosur nga Sektori i Tatim Taksave, të pa likujduara, konkretisht: Subjekti “B.M për vlerën 17,537 lekë, subjekti “G.RR ” për vlerën 21,012 lekë, subjekti “A.K ” për vlerën 133,176 lekë dhe subjekti “B.A ” për vlerën 68,504 lekë. Veprime në kundërshtim me nenin 88/4 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.8 faqe 154 - 160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**24.1 Rekomandimi:** Sektori i Policisë Bashkiake në bashkëpunim me Sektorin e të ardhurave Bashkia Këlcyre, të marrin masa dhe të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për likuidimin e detyrimeve për vlerën **240,229 lekë**, përkatësisht: B.M në vlerën 17,537 lekë, G.RR në vlerën 21,012 lekë, A.K në vlerën 133,176 lekë dhe B.A në vlerën 68,504 lekë.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2024*

**25. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të personelit rezultojë se ato kanë mungesë dokumentacioni, konkretisht: mungojnë CV-të e punonjësve, vlerësimet e punës, vendimet e pezullimit dhe largimet nga puna, dorëzimet e detyrës etj, veprime në kundërshtim me pikat 1,3,4 të VKM nr. 833 datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishtme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjes të personelit e të regjistrit qendror të personelit” (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.8 faqe 154 - 160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**25.1 Rekomandimi:** Bashkia Këlcyre të marrë masa të plotë dosjet e personelit me dokumentet e munguar për secilin punonjës sipas kërkesave ligjore.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2024*

**26. Gjetje nga Auditimi:** Në tenderin “Blerje karburant për automjetet” sipas kontratës të lidhur midis Bashkisë Këlcyre dhe OE “A ” sh.p.k me Nr.827 Prot. datë 30.03.2023 me vlerë



5,806,775 lekë pa TVSH, sipas dokumentacionit të dosjes teknike rezultojë se: Për periudhën 01.01.2023 deri në 07.06.2023 në territorin e Republikës së Shqipërisë ka funksionuar Bordi i transparencës për karburantet (BTK) si organ rregullator për çmimin e karburantit. Gjatë kësaj periudhe, ana e AK në dy raste është operuar në devijim të bazës ligjore duke tejkaluar çmimin e vendosur me Vendim Bordi.

Diferencat në vlerë për çdo rast si vijon:

- 28.04.2023 marr me 177 l/litër nga 174 l/litër, pra 3 l/litër më tepër

*3 lekë/litër \* 3000 litër = 9.000 lekë paguar më tepër*

- 18.05.2023 marr me 173 l/litër nga 169 l/litër, pra 4 l/litër më tepër

*4 lekë/litër \* 2000 litër = 8,000 lekë paguar më tepër.*

Vlera e plotë prej **16,000 lekë** konsiderohet dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër është vepruar në kundërshtim me: Kontratën e shërbimit e lidhur midis Bashkisë Këlcyrë dhe OE "A" sh.p.k me Nr.827 Prot. datë 30.03.2023 me objekt: "Blerje karburant për automjetet", Neni 18, pika 18.1 dhe shtojca nr.1/1 Formulari i Ofertës (*Më hollësisht trajtuar në faqe 73 - 143 të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

**26.1 Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë të vlerësojë dhe analizojë vlerën prej **16,000 lekë** e cila rezulton e paargumentuar.

*Brenda datës 30.6.2024*

## **ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM.**

### **27. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në bashkinë Këlcyrë, (të dërguara nga KLSH me shkresën me nr. 426/9 prot., datë 28.09.2023) rezulton se, subjekti i audituar:

- Nuk ka miratuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH dhe nuk ka dërguar shkresë me kthim përgjigje, brenda 20 ditëve, në kundërshtim me nenin 15, shkronja "j", të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

- Nuk ka raportuar pranë KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, brenda 6 muajve, në kundërshtim me nenin 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

- Nuk ka raportuar rregullisht në Këshillin e Njësisë (Këshillin Bashkiak), në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Neni 50-Auditimi i jashtëm.

- Për 23 rekomandime të dhëna gjithësej, të cilët janë pranuar plotësisht (100 %), statusi i zbatimit të tyre rezulton: zbatuar plotësisht 1 masë (4%), zbatuar pjesërisht 2 masa (9%), në proces zbatimi 3 masa (13%) dhe pazbatuar 17 masa (74%).

*(Më hollësisht trajtuar në pikën nr.7 faqe 132 - 154 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

### **27.1 Rekomandimi:**

Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju ri kërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshtetimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

#### **A. Masa organizative.**

**1.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë të marrë masa për hartimin e programit vjetor për trajnimin e stafit, mbi bazën e evidentimit më parë të nevojave reale për trajnim.

**1.2. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë të parashikojë në strukturën organizative të institucionit krijimin e sektorit të Administrimit të Aseteve me qëllim garantimin e ruajtjes dhe mirë menaxhimi të asetëve, përfshirë pronat në pronësi dhe përdorim.

Krijimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, me qëllim garantimin e zbatimit të ligjshmërisë dhe standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Të plotësohet sipas numrit të strukturës së miratuar në VKB nr. 03, datë 18.01.2022, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Juridike dhe Njësia e Auditit të Brendshëm.

**1.3. Rekomandim:** Nga secili sektor të hartohet regjistri i riskut, për evidentimin e risqeve që rrezikojnë objektivat e institucionit dhe minimizimin e efekteve negative të tyre, të hartohet harta e proceseve të punës dhe gjurma e auditimit për këto procese.

**2.1. Rekomandim:** Bashkia Këlcyrë për hartimin e PBA dhe buxhetit vjetor, më parë të kryej konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit, njësitë administrative etj. dhe të bëjë dokumentimin e këtyre konsultimeve. Të ngrihet grupi i punës për hartimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe kalendari të miratohet në Këshillin Bashkiak..

**5.1.Rekomandim:** Nëpunësi Zbatues të marrë masa për sistemimin në kontabilitet të llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin”, në mënyrë që kjo llogari të paraqesë vlerën e saktë në pasqyrat financiare.

**6.1.Rekomandim:** Nëpunësi Zbatues të hartojë listën analitike të llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” në mënyrë që vlera e paraqitur në pasqyrat financiare të jetë e mbështetur në dokumentacionin vërtetues. Për rastet kur investimi ka përfunduar, të kalohet vlera e projektit në vlerën e investimit, duke u paksuar me vlerën e projektit llogaria 202 “Studime dhe Kërkime”.

**7.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve afatgjata materiale, të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërin 211 “Pyje, kullota, plantacione” dhe zërin 210 “Toka, troje, terrene”.

**8.1 Rekomandimi:** Nëpunësi zbatues të marrë masa për hartimin e regjistrit kontabël për të gjitha aktivet e njësisë vendore, atyre afatshkurtra dhe afatgjata, përfshirë edhe pronat e njësisë vendore në pronësi apo në përdorim.

**9.1.Rekomandim:** Titullari i autoritetit kontraktor dhe njësia e prokurimit të marrin masa për eliminimin e mangësive në hartimin e kritereve të veçanta të dokumenteve të tenderit, duke shmangur vendosjen e kritereve të cilët nuk kanë lidhje me objektin e kontratës.

**10.1 Rekomandimi:** Titullari i autoritetit kontraktor dhe njësia e prokurimit të marrin masa që gjatë hartimit të kritereve të veçanta të dokumenteve të tenderit, të bëhet argumentimi teknik i secilit kriter të vendosur, ku të shpjegohet se me cilin zë të preventivit lidhet çdo kriter i hartuar nga autoriteti kontraktor.

**11.1 Rekomandim:** Titullari i autoritetit kontraktor të marrë masa për një vlerësim të barabartë të operatoreve ekonomik dhe të shmang rastet e kualifikimit të operatorit ekonomik në kushtet e mos plotësimit të kritereve të DT. Në raste të tilla të bëhet anulimi i tenderit.

**12.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë, të marrë masa për ndërprerjen e aktmarrëveshjes që ka bërë me Znj. F.S , në të cilën është përcaktuar si person përgjegjës për prokurimin publik, si dhe të përcaktojë në këtë pozicion punonjës brenda strukturës së vet, duke siguruar trajnimin e tyre. Në rastet e tenderave që do të kërkojnë njohuri të specializuara, Bashkia Këlcyrë të kërkojë staf të specializuar nga autoritete/ente të tjera kontraktore ose të punësojë ekspertë të jashtëm, duke ndjekur procedurat e duhura ligjore.

**13.1.Rekomandim:** Bashkia Këlcyrë në bashkëpunim me Ujësjellës Kanalizime Këlcyrë SHA të marrë masa të menjëhershme për vendosjen në funksionim të sistemit SCADA, i cili do të kryej një kontroll sa më efikas të sistemit të prodhimit e të shpërndarjes për uljen e kostove të prodhimit me ngritje mekanike. Gjithashtu të vendoset në funksion sistemi i klorinimit, i koordinuar në mënyrë automatike me sistemin SCADA, duke mbajtur në parametrat e kërkuar sasinë e klorit e për rrjedhojë ruajtjen e shëndetit publik dhe uljen e kostove të klorinimit.

**14.1.Rekomandim:** Nga DPKZHT Bashkia Këlcyrë të merren masa që në rastin e dhënies së lejeve të ndërtimit, më para të merret mendim nga institucionet e duhura ligjore si AZHT, ASHK, UK.

**16.1.Rekomandim:** Nga DPKZHT Bashkia Këlcyrë të merren masa për të ndërprerë praktikën e miratimit të lejeve të ndërtimit pa respektuar distancat e lejuara nga kufiri i pronës, sipas legjislacionit në fuqi.

**Menjëherë**

## **B. Masa shpërblim dëmi.**

**1.1 Rekomandimi:** Bashkia Këlcyrë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e shumës **339,337 lekë pa TVSH**, nga BOE “B ” sh.p.k & “H ” sh.p.k, për volume punimesh të likuajuara, por të pakryera në fakt sipas kontratës së lidhur me Nr.2292 Prot. datë 01.11.2019 për realizimin e punimeve civile, vlerë e cila përbën dëm ekonomik në buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore.

**Menjëherë**

## **C. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të tyre.**

**1.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Këlcyrë dhe Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët privat dhe familjar, si dhe në vijim të ndjekin të gjitha rrugët ligjore në rend shterues, për arkëtimin e detyrimeve prej 72,228 mijë lekë nga debitorët e privat dhe familjar.

**Menjëherë**

**4.1.Rekomandim:** Bashkia Këlcyrë të marrë masa për arkëtimin e vlerës 188,754 lekë nga 7 persona debitor, sipas listës analitike të pasqyruar në aneksin nr. 3 pika 2.6 bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit.

**2.2. Rekomandim** Të mbajë korrespondencë të vazhdueshme me ASHK Gjirokastër për të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi, me qëllim njohjen e situatës dhe përcaktimin e personave të cilët nuk kryejnë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe nxjerrjen e tyre si debitor ndaj Bashkisë Këlcyrë.

**Menjëherë**

## **D. Masa disiplinore.**

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ligjin 139/2015” Për vetëqeverisjen vendore”, pika 4 e nenit 15, si dhe në pikën 1, germa (i), si dhe kontratë individuale të punës, **i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë Këlcyrë**, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH dhe **në proporcion me shkeljen e kryer**, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “Vërejtje”, deri në “Zgjidhje të kontratës së punës”, **për punonjësit e mëposhtëm:**

**1. Znj. V.K**, me detyrë Përgjegjëse e Financës.

**2. Znj. L.J**, me detyrë përgjegjës në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore.

**3. Z. M.Ç** me detyrë Specialist në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore;

**4. Z. I.K** me detyrë Specialist në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore.

**5. Z. J.N**, me detyrë përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës, Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

6. **Z. O.H** , me detyrë specialist i lartë në emergjenca civile & kadastrës.  
7. **Z. A.Q** , me detyrë specialist i taksave e tarifave vendore.  
8. **Z. Q.P** , me detyrë teknik i mesëm pyjesh.

*Menjëherë*

## **B. MASA PËR ELIMINIM E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i sektorit taksave vendore të bashkisë Këlcyrë, për detyrimet nga taksat për subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e tregtisë së karburantit dhe GLN në territorin e Bashkisë Këlcyrë, u konstatua:

- Mos pagesë e licencave të tregtimit të hidrokarbureve deri në vitin 2023 për vlerën 10,200,000 lekë, të ardhura të munguara, konkretisht: D shpk 1,800,000 lekë, “E” shpk 4,400,000 lekë, A 700,000 lekë dhe D 3,300,000 lekë, në kundërshtim me ligjin 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin taksave vendore” ndryshuar, me nenin 35 të VKM 344 datë 19.04.2017 ndryshuar me VKM 970 datë 02.12.2015, pika 15/1 (Më hollësisht trajtuar në faqe 23 - 51 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Sektori i Taksave Vendore Bashkisë Këlcyrë të marrë masat e nevojshme për përditësimin e regjistrimit me subjektet e mësipërme si dhe ndjekjen e gjitha procedurave për arkëtimin e detyrimeve pa likuiduara në vlerën totale **10,200,000 leke**, respektivisht:

- vlera 1,800,000 lekë ndaj subjektit D shpk,
- vlera 4,400,000 leke ndaj subjektit “E” shpk,
- vlera 700,000 lekë ndaj subjektit A shpk,
- vlera 3,300,000 lekë ndaj subjektit “D” shpk.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2024*

**2. Gjetje nga auditimi:** Debitorët e taksave vendore pasqyrohen për vlerën 8,244,881 lekë, të cilët zënë 50% ndaj ardhurave gjithsej (16,628,000 lekë).

Debitorët sipas llojit të taksave paraqiten: 2,224,330 lekë debitor biznesi i madh, biznesi i vogël 1,396,184 lekë debitor familjet bashkisë Këlcyrë dhe 3 njësi administrative, 4,624,367 lekë debitor për token bujqësore.

Debitorët e taksave vendore sipas njësi administrative, paraqiten: 3,499,204 lekë Bashkia Këlcyrë, 1,717,532 lekë, Njësia administrative Dishnicë 1,565,141 lekë, Njësia administrative Sukë dhe 1,463,004 lekë Njësia administrative Ballaban. Pra peshën me të madhe prej 57 % e zënë debitorët e 3 njësi administrative (*taksë biznesi taksë bujqësore tarifë familjare*).

Gjithashtu rezultojë se, nuk është velur vlera debitorë prej 933,656 lekë ndaj 26 punonjësve bashkisë Këlcyrë, 3 njësi administrative dhe Ujësjiellit, për detyrimet e taksave familjare dhe biznesit të familjeve tyre, ku është i mundur arkëtimi i tyre, sipas tabelës në projekt raport (Më hollësisht trajtuar në faqe 23 - 51 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Sektori i taksave dhe tarifave vendore të bashkisë Këlcyrë të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët privat dhe familjar, si dhe në vijim të ndjekin të gjitha rrugët ligjore në rend shterues:

**a.** Për arkëtimin e detyrimeve prej **8,244,881 lekë, nga debitorët e privat dhe familjar**, të cilët nuk kanë likuiduar taksat e tarifave vendore, sipas pasqyrave përkatëse në bashkinë Këlcyrë.

b. Për arkëtimin e menjëhershëm të vlerës debitorë prej **933,656 lekë ndaj 26 punonjësve** të bashkisë Këlcyrë, 3 njësi administrative dhe Ujësllësit, për detyrimet e taksave familjare dhe biznesit të familjeve tyre, ku është i mundur arkëtimi i tyre pasi janë në marrëdhënie pune me bashkinë, sipas listës në tabelën e pasqyruar në raport.

*Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2024*

## C. MASA DISIPLINORE.

### C.1. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenin 15, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, të kontratës individuale, si dhe shkronja (k) e nenit 64, të Ligjit nr. 139/2015 datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Këlcyrë të vlerësojë shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, si dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Zgjidhjen e kontratës së punës”, për 10 (dhjetë) punonjësit, si më poshtë:

1. **Z. J.N** , në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimeve dhe specialist në hartimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit, në tenderin me objekt “Blerje karburanti për automjetet”, “Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare Kamber Bënja, Këlcyrë” dhe “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”, me detyrë përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës, Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4 , faqe 70 - 127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. **Z. O.H** , në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, në procedurën “Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare Kamber Bënja, Këlcyrë” , “Blerje karburanti për automjetet” dhe “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe në nevojë” me detyrë Specialist i lartë emergjenca civile & kadastër. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4 , faqe 70 - 127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3. **Z. A.Q** , në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, në procedurën “Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare Kamber Bënja, Këlcyrë” , “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe në nevojë” dhe “Blerje karburanti për automjetet” me detyrë Specialist lartë/mesëm i taksave e Tarifave Vendore. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4 , faqe 70 - 127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4. **Z. V.K** , në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit dhe specialist në hartimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit, në procedurën “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe në nevojë” dhe “Blerje karburanti për automjetet” me detyrë Përgjegjës zyre Ujitje dhe Kullim. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4 , faqe 70 - 127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5. **Znj. E.B** në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, në procedurën “Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare Kamber Bënja, Këlcyrë” dhe “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe në nevojë” me detyrë Specialist koordinator për dhunën në familje dhe barazia gjinore. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4 , faqe 70 - 127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6. Z. Q.P** , në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, në procedurën “*Blerje Karburanti për Automjetet*”, me detyrë Teknik i mesëm Pyjesh. (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4 , faqe 70 - 127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**7. Z. A.M** , me detyrë përgjegjës i shërbimeve publike të bashkisë Këlcyrë.

- Për mos kontrollin dhe mos menaxhimin për shërbimin e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, mirëmbajtjes varrezave, rrugëve rurale, KUZ, bujqësisë, ujitje-kullimit të qytetit Këlcyrë për vitin 2023, ku shërbejnë 108 punonjës të miratuar me VKB.

- Për mos mbajtjen e dokumentacionit për verifikimet e pastrimit në terren si: procesverbalet ditore dhe mujore për efekt të pasqyrimin të vërejtjeve për cilësinë e shërbimeve sipas zërave pastrimit, nuk pasqyrojnë zbritjet ditë me shi, nuk pasqyrojnë zbritjet në zërat e fshirjes rrugëve e shesheve dhe freskimit të tyre. Gjithashtu nuk kanë pasqyruar dhe zbritur sipërfaqet e shesheve dhe rrugëve të zënë nga rikonstruksionet e rrugëve të qytetit” të miratuara nga KB për 2023.

- Për mos mbajtjen e dokumentacionit për 56 punonjësit e normuar të pastrimit gjelbërimit konkretisht: liste prezencën ditore për çdo muaj, preventivin dhe situacionet mujore të punimeve sipas zërave të punës, planet dhe programet e punës etj, pra pagesa e kryer nuk shoqërohet me dokumentet që justifikojnë punën e kryer.

- Për lejimin e mjetit teknologjik të pastrimit mbeturinave urbane pa fletudhëtime sipas grafikut ditore dhe mujor, për pasqyrimin e km të përshkuara nga vendgrumbullimi deri tek pika e depozitimit gjatë vitit 2023, për efekt të justifikimit të karburantit të harxhuar.

Veprime në kundërshtim me rregulloren e brendshme të bashkisë, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” dhe me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”.

**8. S.S** , me detyrë Agjent Tatimor në Njësiti Administrative Dishnice.

**9. Y.I** , me detyrë Agjent Tatimor në Njësiti Administrative Suke.

**10. A.Q** me detyrë Agjent Tatimor në Njësiti Administrative Ballaban.

- Për mos ndjekjen dhe mos vjeljen e debitorëve të taksave vendore të 3 njësive administrative për vlerën 4,624,367 lekë debitor për tokën bujqësore, e cila zë peshën më të madhe prej 57 % (*taksë biznesi+ taksë bujqësore + tarifë familjare*). Debitorët e taksave, tarifave vendore deri më 31.12.2023 sipas 3 njësive administrative të bashkisë Këlcyrë, paraqiten:

- 1,717,532 lekë Njësia Administrative Dishnice,

- 1,565,141 lekë Njësia Administrative Suke,

- 1,463,004 lekë Njësia Administrative Ballaban,

Veprime në kundërshtim me ligjin 9632 datë 30.10.2006, ndryshuar me ligjin nr. 9745 datë 28.05.2007 “*Për sistemin e taksave vendore*”, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për procedurat tatimore në RSH*”, ndryshuar nr. 10415 datë 07.04.2011” dhe rregulloren e brendshme të bashkisë Këlcyrë. (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr.8, faqe 154 - 160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**C.2.** Për punonjësit e mëposhtëm, nga auditimi i veprimtarisë së Bashkisë Këlcyrë, u identifikuan problematika jo të përhapura dhe jo materiale në mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit, për të cilat nuk gjykohej të lihen masa disiplinore, pasi shkeljet e evidentuara janë në nivelin e materialitetit:

**1. Znj. E.SH** , me detyrë Protokolliste,

Nga marrja e informacionit nga Zyra e protokollit, mbi ankesat e qytetareve dhe problemeve të ndryshme të konstatuara në Bashkinë Këlcyrë konstatohet se në librat e protokollit nuk janë mbushur sipas formatit të dukur, nuk përshkruhen veprimet sipas kolonave me të gjitha

modalitetet përkatës dhe në ankesat e bëra, nuk shkruhet kujt i adresohet ankesa, dhe kthimi i përgjigjes me datat përkatës, e cila konstaton mos evidentimin e çështjeve në Bashkinë Këlcyrë.

**2. Z. I.K** , me detyrë Inspektori i Tatimeve dhe

**3. Z. M.C** , me detyrë Inspektori i të ardhurave.

Për të dy punonjësit: Nga verifikimet e kryera me zyrën e financës rezulton se, përsëri janë debitorë subjektet të cilëve ju është dhënë afati dhe nuk janë ri kontrolluar përsëri, subjekti B.M nuk ka likuiduar detyrimin në vlerën 17,537 lekë, subjekti G.RR nuk ka likuiduar detyrimin në vlerën 21,012 lekë, subjekti A.K nuk ka likuiduar detyrimin në vlerën 133,176 lekë, subjekti B.A në vlerën 68,504 lekë për, pra këtyre subjekteve ju është mbajtur Akt kostatimi nga Inspektori i Tatim Taksave dhe I.K në prani të Policisë Bashkiake nga E.L ,në kundërshtim me (nenin 3) të VKM nr 452 ,datë 26.07.2023.

**4. Z. E.L** , me detyrë inspektor i Policisë Bashkiake nuk është pajisur me proces verbale për të kryer funksionimin e detyrës dhe me uniformë të saj dhe gjatë vitit ushtrimor nuk ka mbajtur as një proces verbale nga policia bashkiake për shkelësit e ligjit ,në kundërshtim me (nenin 3) të VKM nr. 452, datë 26.07.2023.

**5. Z. J.N** ,

Nga dokumentet e paraqitura nuk janë të bashkangjitur sipas rradhës kronologjike dhe nuk përshkruhen hapat e ndjekjes së procedurave ligjore nga Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, nuk ka regjistër për secilin subjekt i cili aplikon për leje zhvillimi në Bashkinë Këlcyrë.

### **C.3. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR**

Për **ish- punonjësit**, të cilët nuk janë pjesë e strukturës së Bashkisë Këlcyrë, por janë kontraktuar vetëm për procedura specifike prokurimi, nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit e tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “Vërejtje” për punonjësin e larguar si më poshtë:

**1. Z. E.A** , në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, në procedurën “Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare Kamber Bënja, Këlcyrë”.

**2. Znj. F.S** në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, në procedurën “*Përmirësim i banesave egzistuese për komunitetet e varfëra dhe në nevojë*” dhe “*Blerje karburanti për automjetet*”

**3. Z. A.P ish/ Policia Bashkiake**

Në dosje nuk ka as një vlerësim mbi punën e kryer çdo punonjës, dhe dokumenti i largimit nga pozicioni që ka kryer si punonjës në Policinë bashkiake në kundërshtim me të ligjit 8224 datë 15.05.1997 dhe (neni 6 dhe 16) VKM nr. 452, datë 26.07.2023

### **D. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.**

Për punonjësit që do të jepen masa disiplinore, Bashkia Këlcyrë pasi të zbatojë procedurat e

nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarre veprimet si më poshtë:**

**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

**b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

Në zbatim të nenit 15, shkronja (j), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për masat e marra nga ana Juaj, të përgatiten programe me afate dhe persona përgjegjës dhe, për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit **brenda 20 ditëve** nga marrja e kësaj kërkesë. Në vijim e në zbatim të nenit 30, pika 2 e këtij ligji, kërkohet ndjekja e realizimit të tyre në vazhdimësi, duke nxjerrë aktet e nevojshme administrative dhe nisjen e procedurave disiplinore e administrative, apo hartimin e padive gjyqësore për shpërblimin e demit dhe mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, nga ana Juaj të raportohet (*me shkrim*) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit **brenda 6 muajve** nga marrja e njoftimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimeve.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

## V. Anekse

### Aneks nr.1

*Lista e debitorëve bashkia Këlcyrë viti 2023*

Nr.	EMRI E MBIEMRI	Shuma	Shenime
1	S.C	21,350	
2	D.H	7,560	
3	V.K	17,280	
4	F.D	7,950	
5	L.K	7,020	
6	V.K	1,999	
7	F.J	4,000	
8	D.L	3,500	
9	S.M	8,208	
10	A.B	7,241	
11	Z.T	63,300	
12	L.TH	2,000	
13	M.SH	900	
14	Q.A	1,470	
15	G.I	7,605	
16	G.K	915	
17	A	14,998	
18	Y.H	7,735	
19	E.K	3,650	
20	E.P	6,800	
21	S.B	17,221	
22	P.Z	1,240	
23	L.RR	15,900	
24	L.D	13,800	



25	E.Ç	5,400	
26	A.M	460	
27	K.P	577	
28	D.A	100	Vdekur
29	P.T	1,200	
30	Kryepëqte Tat. mbi te ardh.(Para vitit 2005)	25,874	Pa percaktuar
31	2 Keshillt.Tat. mbi te ardh.(para vitit 2005)	1,956	Pa percaktuar
32	B.H	400	
33	A.D	1,000	
34	E.Z	400	
35	A.B	78,037	Kaluar Z.Permbar.
36	A.K	1,183	
37	P.M	2,450	Vdekur
38	A.M	2,850	
39	K.D	2,000	
40	TH.ZH	3,100	
41	TH.RR	500	
42	Z.SH	3,100	
43	V.H	4,531	Vdekur
44	V.Q	4,531	
45	M.A	4,531	
46	A.S	4,531	
47	L.N	4,531	
48	A.E	4,531	
49	Y.A	4,531	
50	A.M	4,531	
51	B.M	4,531	
52	H.A	4,531	Vdekur
53	F.O	4,531	
54	N.E	4,531	
55	T.DH	4,531	
56	D.XH	4,531	
57	Y.P	4,531	
58	R.M	4,531	
59	H.Q	4,531	
60	V.S	4,531	
61	V.M	4,531	
62	P.C	4,531	
63	F.A	4,531	
64	K.T	4,531	
65	K.M	4,531	
66	SH.RR	4,531	
67	LL.T	4,232	
68	N.M	4,231	Vdekur
69	DH.M	4,531	
70	R.S	4,531	
71	K.M	4,531	
72	H.SH (41 396 L.Zak.+23 065 KLSH)	64,461	
73	V.Ç ( KLSH)K.Jeshil	23,065	
	<b>Shuma</b>	<b>592,555</b>	
1	D.A	-100	Vdekur
2	P.M	-2,450	Vdekur
3	V.H	-4,531	Vdekur
4	H.A	-4,531	Vdekur
5	N.M	-4,231	Vdekur
6	A.B Kaluar Z.Permbarimit	-78,037	Z.Permbarimit
7	Kryepëqte Tat. mbi te ardh.(Para vitit 2005)	-25,874	Pa percaktuar
8	2 Keshillt.Tat. mbi te ardh.(para vitit 2005)	-1,956	Pa percaktuar
		-121,710	
	SHUMA E LLOGARISE 468 ME 31.12.2021	470,845	
	Debitore shtese gjate vitit 2022 nga KLSH	22,718,218	sipas listes bashkelidhur
	Debitore shtese gjate vitit 2023 nga Zyra T.Taksa	1,033,632	sipas listes bashkelidhur

	Likuiduar debitore gjate vitit 2023 spas listes	596,007	sipas listes bashkelidhur
	<b>SHUMA LLOGARISE 468</b> me 31.12.2023	<b>23,626,688</b>	

## KONTROLI I LARTË I SHTETIT